



PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

Akte Ligjore dhe Nënligjore të Administratës Doganore

1999 - 2012

VELLIMI III

Ideuar, përpunuar, redaktuar dhe përgatitur për botim nga:

Ervina Domi

Borana Ajazi

Drejtoria Juridike pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave

Në hartimin e kësaj Përmbledhje Legjislacioni kanë kontribuar gjithashtu i gjithë stafi i Sektorit të legjislacionit dhe përafrimit me BE-në në Drejtorinë Juridike në DPD si dhe të gjitha strukturat e tjera me të cilat jemi konsultuar gjatë procesit të hartimit të kësaj Përmbledhje Legjislacioni.

Të nderuar lexues

Ndër vite Administrata Doganore Shqiptare e ka ndjerë nevojën e një përmbledhjeje zyrtare të akteve ligjore dhe nënligjore të të gjitha niveleve. Adaptimi e ratifikimi i akteve të ndryshme ndërkombetare, miratimi i ligjit 8449, datë 27.01.1999, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” dhe i VKM nr. 205, datë 13.04.1999, “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor” i hapi rrugë padyshim zhvillimeve dhe vizioneve të reja në Administratën Doganore Shqiptare. Për këtë qëllim ndër vite kjo administratë e ka pasuruar fondin e saj të akteve nënligjore me akte të ndryshme të të gjitha niveleve.

Zhvillimet integruese apo dokumentet strategjike të Qeverisë Shqiptare, gjithashtu janë pasuar me një sërë iniciativash ligjore e nënligjore të cilat në thelb kanë patur dhe kanë për qëllim, harmonizimin dhe përditësimin e procedurave doganore me atë të vendeve të BE-së, adaptimin e praktikave me të mira, krijimin e lehtësirave për biznesin dhe uljen e barrierave ndaj tij, mundësimin e përmbushjes së misioneve të rëndësishme të Administratës Doganore ku padyshim theksin ashtu si edhe vetë vendet e BE-së e kemi vendosur në sigurinë kombëtare, në mbrojtjen e kufijve, sigurinë shëndetin dhe konsumatorin, pronësisë intelektuale, lirisë së lëvizjes etj.

Tërësia e këtyre akteve të shumtë në vite në mungesë të një përmbledhjeje të tyre e bënte të vështirë përdorimin dhe zbatimin e tyre në praktikë. Për këtë qëllim Administrata Doganore, përmes Drejtorisë Juridike ndërmori këtë iniciativë vërtetë ambicioze për të mundur këtë përmbledhje të Legjislacionit të Administratës Doganore.

Kërkuam të jemi ambicioz në pretendimin tonë në lidhje me këtë Përmbledhje për shkak se ambiciet të drejtojnë drejt suksesit dhe mundësojnë realizimin e standarteve të larta. Kërkesat e larta dhe të papërmbushura janë në vetvete më të vlefshme sesa kërkesat e ulëta tërësisht të përmbushura (J. V. Gëtë).

Përmbledhja e Legjislacionit që po prezantojmë pranë Jush, përmbledh aktet më të rëndësishme mbi të cilat bazohet veprimtaria doganore pa pretenduar apo absolutizuar prezencën dhe përmbajtjen e të gjitha akteteve të të gjitha niveleve të miratuara ndër vite.

Kjo përmbledhje është hartuar mbi bazën e nivelit hierarkik të akteve sipas Kushtetutës së Shqipërisë, duke filluar me Konventat Ndërkombetare në fushën doganore ku vendi ynë ka aderuar, me Marrevëshjet Ndërkombëtare, Marrevëshjet Bilaterale, aktet ligjore me shumicë të cilësuar, ligjet e thjeshta dhe aktet nënligjore të nivelit të dyte dhe të tretë.

Ky padyshim është vetëm hapi i parë duke i lënë rrugë në këtë mënyrë përditësimeve dhe përmirësimeve të vazhdueshme të saj.

Flamur GJYMISHKA

Drejtor i Pergjithshem

Mbi mënyrën e përdorimit të Përmbledhjes së Legjislacionit.

Përmbledhja e legjislacionit është krijuar në një mënyrë të tillë që të krijojë lehtësira maksimale në përdorimin e saj. Ajo përbëhet nga 5 volume të renditur e numra nga 1-5. Secili volum në fillimin e tij ka një pasqyrë të lëndës, përmes së cilës lexuesi mund të orientohet lehtësisht për të kërkuar aktin që ai dëshiron.

Gjithashtu duke qënë së Përmbledhja është e ndarë në seksione sipas llojit të akteve apo sipas institutive të së drejtës doganore në fillim të çdo sesioni specifik për lehtësi do të gjeni edhe një pasqyrë të lëndës vetëm për aktet brenda atij seksioni.

Kjo Përmbledhje Legjislacioni gjithashtu do të jetë e adaptuar edhe në një program specifik të përgatitur për këtë qëllim nga Departamenti i IT në DPD, bazuar në kërkesat specifike të Drejtorisë Juridike për mënyrën e funksionimit të saj.

I. MARRËVESHJE NDËRKOMBËTARE

Faqe

• VELLIMI 2

Ligj Nr. 9733, datë 14.05.2007	Marrëveshje e Tregtisë së Lirë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Turqisë.	3
Ligj Nr. 10 199 datë 17.12.2009	Për ratifikimi e Prokollit 2 shtesë “Për perkufizimin e konceptit “Produkte origjinuese” dhe metodat e bashkëpunimit ekonomik, që zevendeson protokollin me të njëjtin numër të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Turqisë.	145
Ligj Nr. 10288, datë 17.06.2010	Për ratifikimin e Marrëveshjes se Tregtisë së Lirë ndërmjet Rëpublikës së Shqipërisë dhe Shtetëve EFTA dhe të Marrëveshjeve për Bujqësinë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Konfederatës së Zvicrës e Principatës së Lihtenshtejnit, Republikës së Shqiperisë e Republikës së Islandës si pjesë përbërëse e saj.	248
Ligj Nr. 10 421 datë 26.05.2011	Për ratifikimin e protokollit shtesë të marrëveshjes për ndryshimin dhe anëtarësimin në Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Europës Qendrore.	760
Ligj Nr. 10 372, datë 10.02.2011	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Marrëveshjen ndërmjet qeverive të vendeve pjesëmarrëse të bashkëpunimit ekonomik të Detit të Zi (BEDZ) “Për bashkëpunimin në ndihmën dhe përgjigjen ndaj emergjencave të fatkeqësive natyrore ose të shkaktuara nga njeriu dhe në protokollin shtesë të saj”.	772

II. MARREVESHJE BILATERALE

Vendim Nr. 331, datë 09.07.1993	Për miratimin e Marrëveshjes “Për bashkëpunimin e administratave doganore”, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Greqisë.	785
Vendim Nr. 6 datë 5.1.1998	Për miratimin në parim te "Projekt marreveshjes ndërmjet Qeverisë së Shqipërisë dhe Qeverise Maqedonase për ndihmën e ndërsjelltë ndërmjet Administratave të tyre Doganore".	792
L igj Nr.8555, datë 22.12.1999	Për ratifikimin e Marrëveshjes së asistencës administrative për parandalimin, zbulimin dhe ndëshkimin e shkeljeve doganore, ndërmjet qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Italisë.	800
Vendim Nr. 744, datë 6.11.2003	Per miratimin e Marreveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqiperise dhe Qeverisë së Republikës të Bullgarisë “Për asistencën e ndersjelltë administrative në çështjet doganore” .	811
VKM Nr.783, datë 26.11.2003	Për miratimin e Marrëveshjes “Për bashkëpunim dhe asistencën e ndërsjelltë në çështjet doganore”, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës se Kroacisë.	819
Vendim Nr.497, datë 23.7.2004	Për miratimin e Marreveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Moldavisë, për asistencë të ndërsjelltë në çështjet doganore.	829
Vendim Nr .10, datë 14.1.2004	Për miratimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Polonisë “Për bashkëpunim dhe asistencë të ndërsjelltë në çështjet doganore.	838
Vendim Nr. 9, datë 14.01.2004	Per miratimin e marreveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Rëpublikes se Shqiperise dhe Qeverise se Rumanise, “Për bashkëpunim	843

	dhe asistencë të ndërsjelltë administrative në çështjet doganore.	
Vendim Nr.154, datë 09.03.2005	Për miratimin e Marrëveshjes “Për bashkëpunim dhe asistencë të ndërsjelltë në çështjet doganore”, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Sllovakisë.	851
Vendim Nr.7, Datë 13.1.2006	Për miratimin e Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Qipros, për asistencën e ndërsjelltë administrative, për zbatimin e saktë të legjislacionit doganor dhe për parandalimin, hetimin dhe luftën ndaj shkeljeve doganore.	861
Vendim Nr. 150, datë 15.03.2006	Për miratimin e Marrëveshjes “Për bashkëpunim dhe asistencë të ndërsjelltë në çështjet doganore”, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Malit të Zi.	871
Vendim Nr. 188, datë 11.04.2007	Për miratimin e marrëveshjes “Per bashkëpunim dhe asistencë të ndërsjelltë në çështjet doganore”, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Austrisë.	883
Vendim Nr. 959, datë 11.06.2009	Për miratimin e Marrëveshjes “Për bashkëpunim dhe asistencë të ndërsjelltë në çështjet doganore”, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Spanjës”.	888
Vendim Nr. 851, datë 05.08.2009	Për miratimin në parim të Marrëveshjes “Për bashkëpunim dhe ndihmë të ndërsjelltë në çështjet doganore”, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës”.	897



LIGJ

Nr. 9733, datë 14.5.2007

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË TREGTISË SË LIRË NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS SË TURQISË”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e tregtisë së lirë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Turqisë”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr. 5333, datë 31.5.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

MARRËVESHJE E TREGTISË SË LIRË
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS SË TURQISË

PREAMBULË

Me dëshirën për të zhvilluar dhe forcuar marrëdhëniet miqësore, veçanërisht në fushat e bashkëpunimit ekonomik dhe tregtisë, me qëllimin që të kontribuojë në përparimin e bashkëpunimit ekonomik ndërmjet të dy vendeve dhe për të zgjeruar fushën e shkëmbimeve tregtare reciproke,

Republika e Shqipërisë dhe Republika e Turqisë (këtu e më tutje të quajtura “Palë” ose “Shqipëria” dhe “Turqia”, sipas rastit);

duke konfirmuar synimin e tyre për të marrë pjesë aktive në procesin e integrimit ekonomik në Evropë, duke shprehur gatishmërinë e tyre për të bashkëpunuar në gjetjen e mënyrave dhe mjeteve për të forcuar këtë proces;

duke marrë parasysh “Marrëveshjen për Krijimin e Asocimit ndërmjet Republikës së Turqisë dhe Komunitetit Ekonomik Evropian” dhe “Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit ndërmjet Komuniteteve Evropiane dhe Shteteve të tyre Anëtare dhe Republikës së Shqipërisë”;

duke pasur parasysh eksperiencën e fituar nga bashkëpunimi i zhvilluar ndërmjet Palëve në këtë Marrëveshje, si dhe ndërmjet tyre dhe partnerëve të tyre kryesorë tregtarë;

duke deklaruar gatishmërinë e tyre për të ndërmarrë aktivitete, me qëllim nxitjen e zhvillimit të harmonizuar të tregtisë së tyre, si dhe të zgjerimit dhe bërjes së larmishme të bashkëpunimit të tyre të ndërsjellë në fushat me interes të përbashkët, duke përfshirë fushat që nuk mbulohen nga kjo Marrëveshje, duke krijuar kështu një kuadër dhe mjedis mbështetës bazuar mbi barazinë, mosdiskriminimin dhe ekuilibrin e të drejtave dhe detyrimeve;

duke iu referuar interesit të përbashkët të Palëve dhe fuqizimin e vazhdueshëm të sistemit tregtar shumëpalësh dhe duke pasur parasysh që dispozitat dhe instrumentet e Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tarifat dhe Tregtinë 1994 (këtu quhet “GATT 1994”) dhe të Organizatës Botërore të Tregtisë (këtu quhet “OBT”) përbëjnë një bazë për politikat e tyre tregtare me jashtë;

të vendosur që për këtë qëllim të hartojnë dispozita që synojnë në eliminimin progresiv të pengesave në tregtinë ndërmjet Palëve, në pajtim me dispozitat e këtyre instrumenteve, në veçanti atyre që kanë të bëjnë me krijimin e zonave të tregtisë së lirë;

kanë vendosur, në pajtim me këto objektiva, të përfundojnë Marrëveshjen (këtu e më poshtë të quajtur “kjo Marrëveshje”).

Neni 1

Objektivat

1. Palët, duke pasur parasysh detyrimet e Turqisë që rrjedhin nga bashkimi doganor me BE-në dhe “Marrëveshjen e Stabilizimit dhe Asocimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe BE-së”, do të vendosin gradualisht një zonë të tregtisë së lirë në të gjithë tregtinë ndërmjet tyre, në një periudhë transitore që zgjat maksimalisht pesë vjet, që fillon nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, në pajtim me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje dhe në pajtim me nenin XXIV të GATT 1994 dhe të marrëveshjeve të tjera shumëpalëshe mbi tregtinë e mallrave, anekse të marrëveshjes që themeloi OBT-në.

2. Objektivat e kësaj Marrëveshjeje janë:

a) të zgjerojë dhe thellojë bashkëpunimin ekonomik ndërmjet Palëve dhe të rrisë standardin e jetesës së popullatës së të dy vendeve;

b) të eliminojë gradualisht vështirësitë dhe kufizimet në tregtinë e mallrave;

c) të nxisë, nëpërmjet zgjerimit të tregtisë reciproke, zhvillimin e harmonizuar të marrëdhënieve ekonomike ndërmjet Palëve;

d) të sigurojë kushte të drejta për konkurrencën në tregtinë ndërmjet Palëve;

e) të kontribuojë, me anë të heqjes të barrierave në tregti, në zhvillimin e harmonizuar dhe në zgjerimin e tregtisë botërore;

f) të krijojë kushte për inkurajimin e mëtejshme të investimeve, veçanërisht për zhvillimin e investimeve të përbashkëta në të dy vendet;

g) të nxisë tregtinë dhe bashkëpunimin ndërmjet Palëve në tregjet e vendeve të treta.

Neni 2

Tarifat doganore bazë

1. Në tregtinë ndërmjet Palëve që mbulohet nga kjo Marrëveshje, Palët zbatojnë tarifrat e tyre doganore përkatëse mbi klasifikimin e mallrave për importet tek ato.

2. Për secilin produkt, tarifa doganore bazë që do të zbatohet dhe që do t'i nënshtrohet reduktimeve të mëvonshme, të parashikuara në këtë Marrëveshje, duhet të jetë tarifa e parimit të kombit më të favorizuar (MFN), që është në fuqi te Palët në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

3. Nëse pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, zbatohen reduktime tarifore mbi

bazën erga omnes, veçanërisht reduktime që rezultojnë nga negociatat tarifore në OBT, tarifrat e reduktuara zëvendësojnë tarifrat doganore bazë, të përmendura në paragrafin 2, që nga data e zbatimit të këtyre reduktimeve.

4. Tarifrat doganore të reduktuara, të zbatuara nga Shqipëria, të llogaritura sipas parashikimit të kësaj Marrëveshjeje, rrumbullakosen në numra të plotë duke përdorur parime të njëjta aritmetike. Kështu, të gjitha shifrat që kanë më pak se 50 (e përfshirë) pas presjes dhjetore rrumbullakosen në numrin pasues më të vogël të plotë dhe të gjitha shifrat që kanë më shumë se 50, pas presjes dhjetore, rrumbullakosen në numrin pasues më të madh të plotë.

5. Palët i komunikojnë njëra-tjetrës tarifrat doganore të tyre përkatëse bazë.

KAPITULLI I

PRODUKTET INDUSTRIALE

Neni 3

Fusha

Dispozitat e këtij kapitulli do të zbatohen mbi produktet origjinuese të Palët që përfshihen në kapitujt 25 deri 97 të përshkrimit të mallrave në sistemin e harmonizuar dhe sistemit të kodimit, me përjashtim të produkteve të listuara në aneksin I të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 4

Detyrimet doganore mbi importet dhe tarifrat që kanë efekt të njëjtë

1. Në tregtinë ndërmjet Palëve, që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, nuk do të zbatohet asnjë tarifë doganore e re mbi importet apo tarifë që ka efekt të njëjtë.

2. Detyrimet doganore mbi importet në Turqi, për mallrat origjinuese në Shqipëri, do të eliminohen me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

3. Detyrimet doganore mbi importet në Shqipëri, për mallrat origjinuese në Turqi, të ndryshme nga ato të listuara në aneksin II, do të eliminohen me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

4. Detyrimet doganore mbi importet në Shqipëri të mallrave me origjinuese në Turqi, që janë të listuara në aneksin II, do të reduktohen progresivisht në pajtim me afatet e caktuara

për to.

5. Për produktet e listuara në aneksin II, origjinuese në Turqi, Shqipëria jep një trajtim jo më pak të favorshëm se ai që jepet për produktet e ngjashme origjinuese në Bashkimin Europian. Në rastin e një ndryshimi të favorshëm në trajtim të dhënë Bashkimit Evropian për produktet e listuara në aneksin II, Shqipëria pa vonesë do të reflektojë këto ndryshime në produktet origjinuese në Turqi, të listuara në këtë protokoll dhe për këtë njofton menjëherë Turqinë.

6. Shqipëria dhe Turqia do të eliminojnë në tregtinë ndërmjet tyre çdo tarifë që ka efekt të njëjtë me detyrimet doganore mbi importet, me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 5

Detyrimet doganore të natyrës fiskale

Dispozitat në lidhje me eliminimin e detyrimeve doganore mbi importet do të zbatohen edhe për detyrimet doganore të natyrës fiskale.

Neni 6

Detyrimet doganore mbi eksportet dhe detyrimet që kanë efekt të njëjtë

1. Nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, në tregtinë ndërmjet Palëve, nuk do të zbatohet asnjë detyrim i ri doganor apo tarifa që kanë efekt të njëjtë mbi eksportet.

2. Të gjitha detyrimet doganore mbi eksportet ndërmjet Palëve dhe çdo tarifë që ka efekt të njëjtë do të eliminohet me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 7

Kufizimet sasiore mbi eksportet dhe importet dhe masat që kanë efekt të njëjtë

1. Nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje nuk do të vendosen kufizime të reja sasiore mbi eksportet dhe importet apo masa që kanë efekt të njëjtë.

2. Të gjitha kufizimet sasiore mbi eksportet dhe importet të Palët dhe masat që kanë të njëjtin efekt do të eliminohen në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 8

Barrierat teknike të tregtisë

1. Të drejtat dhe detyrimet e Palëve, në lidhje me standardet ose rregullat teknike dhe masat përkatëse që lidhen me to, të rregullohen nga marrëveshja e OBT-së mbi barrierat teknike në tregti.

2. Palët do të bashkëpunojnë dhe shkëmbejnë informacion në fushën e standardizimit, metrologjisë, vlerësimit të konformitetit dhe akreditimit, me synimin e eliminimit të barrierave teknike të tregtisë.

3. Secila Palë, me kërkesën e Palës tjetër, paraqet informacion mbi çështje të veçanta individuale të standardeve, rregullave teknike dhe masave të ngjashme.

KAPITULLI II

PRODUKTET BUJQËSORE DHE TË PESHKIMIT

Neni 9

Fusha

1. Dispozitat e këtij kapitulli do të zbatohen për produktet bujqësore bazë, produktet bujqësore të përpunuara dhe produktet e peshkimit, origjinuese në territorin e secilës Palë.

2. Termi “produkte bujqësore bazë, produkte bujqësore të përpunuara dhe produktet e peshkimit” (këtu e më tutje të quajtura “produkte bujqësore”), për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, termi nënkupton produktet që përfshihen brenda kapitujve 01 deri 24 të përshkrimit të mallrave në sistemin e harmonizuar dhe të sistemit të kodimit, përfshirë edhe produktet e listuara në aneksin I të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 10

Shkëmbimi i koncesioneve

1. Palët në këtë Marrëveshje do të vendosin reciprokisht koncesionet e përcaktuara në protokollin I, në pajtim me dispozitat e këtij kapitulli.

2. Duke pasur parasysh rolin e bujqësisë në ekonomitë e tyre përkatëse, zhvillimin e

tregtisë të produkteve bujqësore, ndjeshmërinë e lartë të produkteve bujqësore dhe rregullat e politikave përkatëse bujqësore, Palët do të shqyrtojnë në Komitetin e Përbashkët mundësitë e dhënies njëra-tjetrës së koncesioneve të tjera në tregtinë e produkteve bujqësore.

Neni 11

Masat sanitare dhe fitosanitare

1. Palët do të zbatojnë rregullat e tyre të brendshme në fushat e kontrollit veterinar, sanitar dhe fitosanitar, në pajtim me marrëveshjen e OBT-së mbi masat sanitare dhe fitosanitare.

2. Masat në lidhje me kontrollin veterinar dhe fitosanitar ndërmjet Palëve do të harmonizohen mbi bazën e legjislacionit të BE-së.

3. Palët angazhohen të mos vendosin masa diskriminuese ose masa të tjera, të cilat çojnë në kufizimin e parregullt të rrjedhës së informacionit në lidhje me nivelin e mbrojtjes sanitare dhe fitosanitare, kafshëve, bimëve dhe produkteve.

Neni 12

Masat mbrojtëse specifike

Pavarësisht nga dispozitat e tjera të kësaj Marrëveshjeje, dhe veçanërisht nenin 21, duke pasur parasysh ndjeshmërinë e lartë të produkteve bujqësore, nëse importet e produkteve origjinuese të një Palë, që janë objekt i koncesioneve të dhëna në bazë të kësaj Marrëveshjeje në Palën tjetër, shkaktojnë shqetësime serioze në tregjet ose në mekanizmat e tyre të brendshme rregulluese, të dyja Palët do të fillojnë menjëherë konsultimet për të gjetur një zgjidhje të përshtatshme. Deri në gjetjen e zgjidhjes, Pala e interesuar mund të marrë masat që ajo i mendon të nevojshme në pajtim me rregullat përkatëse të OBT-së.

KAPITULLI III

SHËRBIMET DHE INVESTIMET

Neni 13

1. Palët e kësaj Marrëveshjeje njohin rëndësinë në rritje të shërbimeve dhe

investimeve. Në përpjekjet e tyre për të zhvilluar dhe zgjeruar gradualisht bashkëpunimin, veçanërisht në kontekstin e integritimit evropian, ato do të bashkëpunojnë me qëllim nxitjen e mëtejshme të investimeve dhe arritjes së një liberalizimi progresiv dhe hapjen reciproke të tregjeve të tyre për investimet dhe tregtinë në shërbime, duke pasur parasysh dispozitat përkatëse të Marrëveshjes së Përgjithshme të Tregtisë në Shërbimeve (GATS).

2. Palët do të diskutojnë në Komitetin e Përbashkët mbi këtë bashkëpunim, me qëllim zhvillimin dhe thellimin e marrëdhënieve të tyre në pajtim me këtë nen.

KAPITULLI IV

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 14

Taksimi i brendshëm

1. Palët do të heqin dorë nga çdo masë ose praktikë e një natyre të brendshme fiskale që përbën, drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt, diskriminim ndërmjet produkteve të një Pale dhe produkteve të ngjashme origjinuese në Palën tjetër.

2. Produktet e eksportuara në territorin e Palëve nuk duhet të përfitojnë nga rimbursimi i taksave të brendshme përtej shumës së taksës indirekte të zbatuar mbi to.

Neni 15

Bashkimet doganore, zonat e tregtisë së lirë dhe tregtia ndërkufitare

1. Kjo Marrëveshje nuk pengon mbajtjen ose krijimin e bashkimeve doganore, zonave të tregtisë së lirë ose tregtinë ndërkufitare të Palëve me vende të treta, në masën që këto nuk ndikojnë negativisht në regjimin tregtar dhe veçanërisht në dispozitat në lidhje me rregullat e origjinës, të parashikuara në këtë Marrëveshje.

2. Shkëmbimi i informacionit në lidhje me marrëveshjet që themelojnë këto bashkime doganore ose zona të tregtisë së lirë, do të bëhet me kërkesën e Palëve brenda Komitetit të Përbashkët.

Neni 16

Axhustime strukturore

1. Masa të jashtëzakonshme me kohëzgjatje të kufizuar, që anashkalojnë dispozitat e nenit 4, mund të merren nga Palët në formën e rritjes së detyrimeve doganore.

2. Këto masa mund të kenë të bëjnë vetëm me industrinë e reja ose sektorë të veçantë që po kryejnë ristrukturime ose po përballen me vështirësi të mëdha, veçanërisht kur këto vështirësi shkaktojnë probleme të rëndësishme sociale.

3. Detyrimet doganore mbi importet, të zbatueshme te Palët, për produktet origjinuese në Palën tjetër, të vendosura me anë të këtyre masave, nuk mund të kalojnë 25% ad valorem dhe do të mbeten një element preference për produktet me origjinë në Palën tjetër. Vlera e përgjithshme e importeve të produkteve që u nënshtrohen këtyre masave nuk mund të kalojë 15% të importeve të përgjithshme të produkteve industriale nga Pala tjetër, sipas përcaktimit në nenin 3, gjatë vitit të fundit për të cilin jepen të dhënat statistikore.

4. Këto masa zbatohen për një periudhë që nuk i kalon pesë vjet, përveç kur autorizohet një kohëzgjatje më e gjatë nga Komiteti i Përbashkët. Ato pushojnë së zbatuari jo më vonë se skadimi i periudhës transitore.

5. Asnjë nga këto masa nuk mund të zbatohet në lidhje me një produkt nëse kanë kaluar më shumë se tre vjet që nga eliminimi i të gjitha detyrimeve dhe kufizimeve sasiore ose tarifave doganore apo masat që kanë një efekt të njëjtë, në lidhje me këtë produkt.

6. Palët njoftojnë Komitetin e Përbashkët për çdo masë të jashtëzakonshme që ato synojnë të marrin dhe, me kërkesë të Palës tjetër, në Komitetin e Përbashkët mbahen konsultime për ato masa dhe sektorë për të cilat ato zbatohen, para zbatimit të tyre. Gjatë marrjes së këtyre masave, Palët i japin Komitetit të Përbashkët një plan kohor për eliminimin e detyrimeve doganore të vendosura në bazë të këtij neni. Ky plan kohor parashikon ndërprerjen graduale të këtyre detyrimeve doganore, duke filluar jo më vonë se dy vjet pas prezantimit të tyre, me nivele të barabarta. Komiteti i Përbashkët mund të vendosë për një plan të ndryshëm kohor.

Neni 17

Dumpingu dhe subvencionet

1. Asnjë nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk e ndalojnë Palën tjetër nga marrja e masave për mbrojtjen e tregtisë, në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni.

2. Nëse njëra nga Palët konstaton se në tregtinë me Palën tjetër po ndodh dumping dhe/ose subvencion kundërbalancues, ajo Palë mund të marrë masat e përshtatshme kundër

kësaj praktike, në pajtim me Marrëveshjen e OBT-së mbi zbatimin e nenit VI-të të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tarifat dhe Tregtinë 1994 dhe Marrëveshjen e OBT-së mbi Subvencionet dhe Masat Kundërbalancuese dhe legjislacionin e vet përkatës të brendshëm.

Neni 18

Masat mbrojtëse të përgjithshme

Nëse një produkt importohet në një nga Palët në sasi të tilla të rritura, secila Palë i mban të drejtat dhe detyrimet e saj në bazë të nenit XIX të GATT-it 1994 dhe Marrëveshjes së OBT-së mbi Masat Mbrojtëse. Kjo Marrëveshje nuk u jep Palëve të drejta ose detyrime shtesë në lidhje me masat mbrojtëse.

Neni 19

Rieksportimi dhe mungesat serioze

1. Nëse respektimi i dispozitave të neneve 6 dhe 7 çon në:

a) rieksport drejt një vendi të tretë, kundrejt të cilit Pala eksportuese në këtë Marrëveshje ruan për produktin përkatës kufizimet sasiore të eksportit, detyrimet për eksportin apo masat ose tarifatat doganore që kanë efekt të njëjtë; ose

b) një mungesë ose kërcënim për mungesë serioze të një produkti thelbësor për palën eksportuese, dhe nëse situatat e përmendura më sipër shkaktojnë ose mund të shkaktojnë vështirësi të mëdha për Palën eksportuese, kjo Palë mund të marrë masa të përshtatshme në bazë të kushteve dhe në pajtim me procedurat e parashikuara në nenin 21 të kësaj Marrëveshjeje.

2. Masat e marra si rezultat i situatës së përmendur në paragrafin 1 do të zbatohen në një mënyrë jodiskriminuese dhe do të eliminohen nëse kushtet nuk e justifikojnë mbajtjen e tyre.

Neni 20

Monopolet shtetërore

1. Palët do të rregullojnë në mënyrë progresive çdo monopol shtetëror të një karakteri tregtar, për të siguruar që në fund të vitit të katërt pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje të

mos ketë diskriminim në lidhje me kushtet në të cilat prokurohen dhe tregtohen mallrat ndërmjet shtetasve të Palëve.

2. Komiteti i Përbashkët duhet të informohet në lidhje me masat e marra për të zbatuar këtë objektiv.

Neni 21

Procedura e njoftimeve dhe konsultimeve për zbatimin e masave

1. Përpara fillimit të procedurës për zbatimin e një mase të përmendur në nenet 12, 19, 24 dhe 32, Palët e kësaj Marrëveshjeje do të përpiqen të zgjidhin çdo ndryshim ndërmjet tyre me anë të konsultimeve të drejtpërdrejta dhe informojnë për këtë Palën tjetër.

2. Një Palë që mendon të marrë masa njofton për këtë menjëherë Komitetin e Përbashkët. Pala e interesuar i jep Komitetit të Përbashkët informacionin përkatës dhe i jep atij asistencën e duhur për të shqyrtuar çështjen. Konsultimet ndërmjet Palëve kryhen pa vonesë në Komitetin e Përbashkët me qëllim gjetjen e një zgjidhjeje të pranueshme reciprokisht.

3. Nëse brenda një muaji që kur çështja i është dërguar Komitetit të Përbashkët, Pala përkatëse nuk i jep fund praktikës së kundërshtuar ose vështirësive të njoftuara dhe në mungesë të një vendimi nga Komiteti i Përbashkët për çështjen, Pala e interesuar mund të marrë masat që ajo i konsideron të nevojshme për të ndrequr situatën.

4. Masat e marra i njoftohen menjëherë Komitetit të Përbashkët. Ato kufizohen, në lidhje me masën dhe kohëzgjatjen, në atë që është tepër e nevojshme, me qëllim që të rregullohet situata, që ka shkaktuar zbatimin e tyre dhe nuk e tejkalojnë dëmin e shkaktuar nga praktika ose vështirësia në fjalë. Prioritet u jepet atyre masave që cenojnë më pak zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

5. Masat e marra u nënshtrohen konsultimeve të rregullta brenda Komitetit të Përbashkët, me qëllim zbutjen ose heqjen e tyre nëse kushtet nuk e justifikojnë vazhdimin e mbajtjes së tyre.

6. Nëse rrethanat e veçanta që kërkojnë veprim të menjëhershëm e bëjnë shqyrtimin paraprak të pamundur, Pala e interesuar, në rastet e neneve 12, 19, 24 dhe 32, zbaton menjëherë masat parandaluese që janë tepër të nevojshme për të korrigjuar situatën. Masat i njoftohen menjëherë Komitetit të Përbashkët dhe zhvillohen konsultime ndërmjet Palëve në këtë Marrëveshje brenda Komitetit të Përbashkët.

Neni 22

Rregullat e origjinës dhe bashkëpunimi ndërmjet administratave doganore

1. Palët bien dakord që në tregtinë ndërmjet tyre të zbatojnë rregullat preferenciale evropiane të origjinës, duke përfshirë të gjitha amendamentet ekzistuese dhe të mëtejshme. Në rast se këto rregulla të origjinës ndryshohen, Komiteti i Përbashkët fillon procedurën e ndryshimit të rregullave të origjinës.

2. Protokollu II i kësaj Marrëveshjeje përcakton rregullat e origjinës dhe metodat përkatëse të bashkëpunimit administrativ.

Neni 23

Pagesat

Palët marrin përsipër të autorizojnë, në një monedhë lehtësisht të konvertueshme, në pajtim me dispozitat e nenit VIII të neneve të Marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar, çdo pagesë dhe transfertë në llogarinë rrjedhëse të bilancit të pagesave ndërmjet Shqipërisë dhe Turqisë.

Neni 24

Rregullat e konkurrencës në lidhje me sipërmarrjet, ndihma shtetërore

1. Çfarë vijon janë në kundërshtim me zbatimin e rregullt të kësaj Marrëveshjeje, në masën që ato mund të prekin tregtinë ndërmjet Palëve:

a) të gjitha marrëveshjet ndërmjet sipërmarrjeve, vendimet nga shoqatat e sipërmarrjeve dhe praktikrat e planifikuara ndërmjet sipërmarrjeve që kanë si objekt të tyre ose ndikojnë në parandalimin, kufizimin ose deformimin e konkurrencës;

b) abuzimi nga një ose më shumë sipërmarrje me pozicionin dominues në territoret e Palëve si një e tërë ose në një pjesë thelbësore të tyre;

c) çdo ndihmë shtetërore që deformon ose kërcënon të deformojë konkurrencën, duke favorizuar sipërmarrje të caktuara ose prodhimin e mallrave të caktuara.

2. Secila Palë do të sigurojë transparencë në sferën e ndihmës shtetërore. Me kërkesë të njëjës Palë, Pala tjetër jep informacion në lidhje me raste individuale të veçanta të ndihmës shtetërore.

3. Nëse një Palë konsideron se një praktikë e caktuar nuk është në pajtim me termat e paragrafit të parë të këtij neni, dhe:

a) nuk trajtohet si duhet duke zbatuar rregullat e përmendura në paragrafin 4 të këtij neni, ose

b) në mungesë të këtyre rregullave, dhe nëse një praktikë e tillë shkakton ose kërcënon të shkaktojë dëme serioze në interesin e Palës tjetër ose dëm material në industrinë vendase, duke përfshirë industrinë e saj të shërbimeve, ajo mund të marrë masat e përshtatshme pas konsultimeve brenda Komitetit të Përbashkët ose pas tridhjetë ditë pune pas referimit për këto konsultime.

4. Në rastin e praktikave që nuk janë në pajtim me paragrafin 1 c) të këtij neni, këto masa të përshtatshme, nëse për këto zbatohet OBT/GATT 1994, mund të merren vetëm në pajtim me procedurat dhe kushtet e përcaktuara nga OBT/GATT 1994 dhe çdo instrument tjetër përkatës i negociuar nën kujdestarinë e tij, që janë të zbatueshëm ndërmjet Palëve.

5. Pavarësisht nga dispozitat me efekt të kundërt të miratuara në pajtim me këtë nen, Palët shkëmbejnë informacion duke marrë parasysh kufizimet e caktuara nga kërkesat e sekretit profesional dhe të biznesit.

Neni 25

Vështirësitë e bilancit të pagesave

1. Palët do të përpiqen kurdoherë që të jetë e mundur të mënjanojnë vendosjen e masave kufizuese, duke përfshirë masat në lidhje me importet, për qëllimet e bilancit të pagesave. Pala që merr masa të tilla i paraqet Palës tjetër, sa më shpejt që të jetë e mundur, një plan kohor për heqjen e tyre.

2. Nëse Shqipëria apo Turqia janë në vështirësi serioze për bilancin e pagesave, ose nën kërcënimin e afërt të tyre, Shqipëria ose Turqia, sipas rastit, në pajtim me kushtet e caktuara nën marrëveshjen e OBT-së, mund të marrin masa kufizuese, duke përfshirë masa në lidhje me importet, që do të jenë me kohëzgjatje të kufizuar dhe nuk mund të shkojnë tej asaj që është tepër e nevojshme për të korrigjuar situatën e bilancit të pagesave. Shqipëria ose Turqia, sipas rastit, do të informojnë menjëherë Palën tjetër.

3. Asnjë masë kufizuese nuk do të zbatohet për transfertat në lidhje me investimet dhe veçanërisht për riatdhesimin e shumave të investuara ose riinvestuara apo çdo lloj të ardhure që rrjedh prej tyre.

Neni 26

Të drejtat e pronësisë intelektuale

1. Palët në këtë Marrëveshje do të japin dhe do të garantojnë mbrojtje të përshtatshme, të efektshme dhe jodiskriminuese të të drejtave të pronësisë intelektuale, duke përfshirë masat për realizimin e këtyre të drejtave kundrejt shkeljeve të tyre, falsifikimit dhe piratërisë, në pajtim me dispozitat e këtij neni dhe marrëveshjeve përkatëse ndërkombëtare.

2. Palët në këtë Marrëveshje do t'u japin shtetasve të njëra-tjetrës një trajtim jo më pak të favorshëm se ai që u japin shtetasve të tyre. Përjashtimi nga ky detyrim duhet të jetë në pajtim me dispozitat thelbësore të nenit 3 të Marrëveshjes TRIPS.

3. Palët në këtë Marrëveshje do t'u japin shtetasve të njëra-tjetrës trajtim jo më pak të favorshëm se ai që u jepet shtetasve të një vendi tjetër. Përjashtimet nga ky detyrim duhet të jenë në pajtim me dispozitat thelbësore të marrëveshjes TRIPS, veçanërisht neneve 4 dhe 5 të saj.

4. Zbatimi i këtij neni do të rishikohet rregullisht nga Palët. Nëse ndodhin probleme në sferën e pronësisë intelektuale, që cenojnë kushtet e tregtisë, do të fillohen konsultime urgjente, me kërkesë të njërës Palë, me qëllim arritjen e zgjidhjeve reciprokisht të kënaqshme.

Neni 27

Prokurimi publik

1. Palët e konsiderojnë liberalizimin e tregjeve të tyre përkatëse të prokurimit publik si një objektiv të kësaj Marrëveshjeje. Palët synojnë zgjerimin e dhënies së kontratave mbi bazën e mosdiskriminimit dhe reciprocitetit.

2. Palët do të zhvillojnë progresivisht rregullat, kushtet dhe praktikat e tyre përkatëse për prokurimin publik, me synim dhënien furnitorëve të Palës tjetër mundësinë për pjesëmarrjen në procedurat e dhënies së kontratës në tregjet e tyre përkatëse të prokurimit publik, jo më pak të favorshme se ai që u jepet shoqërive të çdo vendi apo territori.

3. Komiteti i Përbashkët do të shqyrtojë zhvillimet në lidhje me arritjen e objektivave të këtij neni dhe mund të rekomandojë modalitetet praktike të zbatimit të dispozitave të paragrafit 2 për të siguruar hyrje të lirë, transparencë dhe hapje reciproke të tregjeve të tyre përkatëse të prokurimit publik.

4. Gjatë shqyrtimit të përmendur në paragrafin 3, Komiteti i Përbashkët, veçanërisht nën dritën e zhvillimeve dhe rregullave ndërkombëtare në këtë fushë, mund të konsiderojë mundësinë e zgjerimit të mbulimit dhe/ose shkallën e hapjes së tregut të parashikuar në paragrafin 1.

5. Palët do të përqipen të aderojnë në marrëveshjet përkatëse të negociuara nën kujdestarinë e GATT-it 1994 dhe të Marrëveshjes së Marrakeshit, që themeloi OBT-në.

Neni 28

Themelimi i Komitetit të Përbashkët

1. Themelohet një Komitet i Përbashkët në të cilin përfaqësohet secila Palë. Komiteti i Përbashkët është përgjegjës për administrimin e kësaj Marrëveshjeje dhe siguron zbatimin e saj të përshtatshëm.

2. Për qëllimet e zbatimit të përshtatshëm të kësaj Marrëveshjeje, Palët do të shkëmbejnë informacion dhe, me kërkesë të secilës Palë, do të mbajnë konsultime brenda Komitetit të Përbashkët. Komiteti i Përbashkët do të mbajë nën shqyrtim mundësinë e heqjes së mëtejshme të pengesave në tregtinë ndërmjet Palëve.

3. Komiteti i Përbashkët, në pajtim me dispozitat e paragrafit 3 të nenit 29, mund të marrë vendime në rastet e parashikuara në këtë Marrëveshje. Për çështjet e tjera Komiteti i Përbashkët mund të bëjë rekomandime.

Neni 29

Procedurat e Komitetit të Përbashkët

1. Për zbatimin e përshtatshëm të kësaj Marrëveshjeje, Komiteti i Përbashkët mbledhet në një nivel të përshtatshëm, kurdoherë që është e nevojshme, me kërkesë të njëres Palë, por të paktën një herë në vit. Secila Palë mund të kërkojë që të mbahet një mbledhje.

2. Komiteti i Përbashkët vendos me konsensus.

3. Nëse një përfaqësues i një Pale të kësaj Marrëveshjeje në Komitetin e Përbashkët ka pranuar një vendim, që i nënshtrohet rezervës për përmbushjen e kërkesave të brendshme ligjore, vendimi hyn në fuqi, nëse atje nuk parashikohet një datë tjetër e mëvonshme, në datën e marrjes së njoftimit me shkrim, ku deklarohet se këto kërkesa janë përmbushur.

4. Komiteti i Përbashkët miraton rregullat e veta të procedurës që, ndërmjet të tjerash, përmbajnë dispozita të caktuara për thirrjen e mbledhjeve dhe caktimin e kryetarit dhe mandatin e tij.

5. Komiteti i Përbashkët mund të vendosë për të krijuar nënkomitete dhe grupe pune që ai i konsideron të nevojshme për të asistuar në kryerjen e detyrave të tij.

Neni 30

Përrjashtimet e sigurisë

Asgjë në këtë Marrëveshje nuk i ndalon Palët të marrin çdo masë që ato e konsiderojnë të nevojshme për:

a) të parandaluar nxjerrjen e informacionit, në kundërshtim me interesat e saj thelbësore të sigurisë;

b) mbrojtjen e interesave të saj thelbësore të sigurisë ose për përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare ose politikat kombëtare:

i) në lidhje me trafikimin e armëve, municioneve dhe instrumenteve të luftës dhe për atë trafik të mallrave, materialeve dhe shërbimeve të tjera që kryhet drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt për qëllimet e furnizimit të një strukture ushtarake; ose

ii) në lidhje me mospërhapjen e armëve biologjike dhe kimike, armëve bërthamore dhe mjeteve të tjera eksplozive nukleare; ose

iii) në kohë lufte ose tensioni serioz ndërkombëtar që përbën kërcënim për luftë.

Neni 31

Përrjashtime të përgjithshme

Kjo Marrëveshje nuk përrjashton ndalimet ose kufizimet për importet, eksportet ose mallrat në transit, të justifikuar me arsyet e moralit publik, politikës publike ose sigurisë publike, mbrojtjen e shëndetit dhe jetës së njerëzve, kafshëve ose bimëve dhe ambientit, mbrojtjen e thesareve të brendshme që kanë vlera artistike, historike ose arkeologjike, mbrojtjen e pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare, ose rregullat në lidhje me arin ose argjendin, ose konservimin e burimeve natyrore në shterim, nëse këto masa janë bërë të efektshme në lidhje me kufizimet për prodhimin dhe konsumin vendas. Këto ndalime ose kufizime, megjithatë, nuk përbëjnë një mjet diskriminimi arbitrar apo kufizim të fshehur në tregtinë ndërmjet Palëve.

Neni 32

Përmbushja e detyrimeve

1. Palët marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar arritjen e objektivave të

kësaj Marrëveshjeje dhe përmbushjen e detyrimeve të tyre në bazë të kësaj Marrëveshjeje.

2. Nëse një Palë konsideron se Pala tjetër nuk ka përmbushur një detyrim në bazë të kësaj Marrëveshjeje, Pala e interesuar mund të marrë masat e duhura brenda kushteve dhe në pajtim me procedurat e parashikuara në nenin 21 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 33

Klauzolë zhvilluese

1. Nëse një Palë konsideron se do të jetë e dobishme dhe në interes të ekonomive të Palëve për të zhvilluar marrëdhëniet e vendosura nga kjo Marrëveshje duke i zgjeruar ato në fushat që nuk mbulohen prej saj, ajo i dërgon një kërkesë të arsyetuar Palës tjetër. Palët mund të udhëzojnë Komitetin e Përbashkët të shqyrtojë kërkesën dhe, sipas rastit, të bëjë rekomandime për to, veçanërisht me qëllim për hapjen e bisedimeve.

2. Marrëveshjet që rrjedhin nga procedurat e përmendura në paragrafin 1 i nënshtrohen ratifikimit ose aprovimit nga Palët në këtë Marrëveshje, në pajtim me legjislacionin e tyre vendas.

Neni 34

Amendimet

Amendimet në këtë Marrëveshje, si dhe në anekset dhe protokollet e saj, do të hyjnë në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim me anë të kanaleve diplomatike, me anë të të cilit Palët njoftojnë njëra-tjetrën se janë përmbushur të gjitha kërkesat e parashikuara nga legjislacioni i tyre i brendshëm, për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 35

Protokollet dhe anekset

Protokollet dhe anekset e kësaj Marrëveshjeje përbëjnë një pjesë të pandarë të saj. Komiteti i Përbashkët mund të vendosë të ndryshojë protokollet dhe anekset në pajtim me legjislacionin e brendshëm të Palëve.

Neni 36

Vlefshmëria dhe tërheqja

1. Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë të pacaktuar.
2. Secila Palë e kësaj Marrëveshje mund të tërhiqet nga kjo Marrëveshje me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar Palës tjetër. Shfuqizimi hyn në fuqi në ditën e parë të muajit të shtatë pas datës në të cilën njoftimi është marrë nga Pala tjetër.
3. Palët bien dakord që, në rastin e aderimit të njëres prej Palëve të kësaj Marrëveshjeje në Bashkimin Evropian, Marrëveshja shfuqizohet në datën para datës së aderimit në BE.

Neni 37

Hyrja në fuqi

- Palët do të ratifikojnë këtë Marrëveshje në pajtim me procedurat e tyre të brendshme.
- Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit të dytë, pas datës së marrjes së njoftimit të fundit me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike, me anë të cilës Palët informojnë njëra-tjetrën që janë përmbushur të gjitha kërkesat e nevojshme të parashikuara nga legjislacioni i brendshëm për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.
- Si dëshmi të kësaj, të plotfuqishmit e poshtëshënuar, duke qenë rregullisht të autorizuar, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.
- Bërë në Tiranë, më 22 dhjetor 2006, në tri origjinale, secila në gjuhët shqipe, turke dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëlloj autentike. Në rast mospërputhjeje në interpretim, mbizotëron teksti në anglisht.

SHTOJCA I E PROTOKOLLIT 3

SHËNIME PREZANTUESE TË LISTËS NË SHTOJCËN II

Shënim 1:

Lista vendos kushtet e kërkuara për të gjitha produktet për t'u konsideruar si të punuara ose përpunuara mjaftueshëm brenda kuptimit të nenit 6 të protokollit.

Shënim 2:

2.1 Dy kolonat e para në listë përshkruajnë produktin e përftuar. Kolona e parë jep numrin e kreut ose numrin e kapitullit, të përdorur në sistemin e harmonizuar dhe kolona e dytë jep përshkrimin e mallrave të përdorura në atë sistem për atë kre apo kapitull. Për secilën hyrje në dy kolonat e para specifikohet një rregull në kolonën 3 ose 4. Kur, në disa raste, hyrja në kolonën e parë parapritet nga një "ex", kjo nënkupton se rregullat në kolonën 3 ose 4 aplikohen vetëm për pjesën e atij kreu sikurse është përshkruar në kolonën 2.

2.2 Kur shumë numra krerësh grupohen së bashku në kolonën 1 ose jepet një numër kapitulli dhe kështu përshkrimi i produkteve në kolonën 2 jepet në terma të përgjithshëm, rregullat e afërta në kolonën 3 ose 4 aplikohen për të gjitha produktet, të cilat, nën sistemin e harmonizuar, klasifikohen në krerët e kapitullit ose në çdo kre të grupuar së bashku në kolonën 1.

2.3 Kur ka rregulla të ndryshme në listën që aplikohet për produkte të ndryshme brenda një kreu, secila pikë përmban përshkrimin e asaj pjese të kreut të rregulluar nga rregullat e afërta në kolonën 3 ose 4.

2.4 Kur, për një hyrje në dy kolonat e para, një rregull specifikohet në të dyja kolonat 3 dhe 4, eksportuesi mund të zgjedhë, si alternativë, që të aplikojë rregullin e vendosur në kolonën 3 ose atë të vendosur në kolonën 4. Në rast se nuk jepet ndonjë rregull origjine në kolonën 4, duhet të aplikohet rregulli i vendosur në kolonën 3.

Shënim 3:

3.1 Dispozitat e nenit 6 të protokollit, për sa u përket produkteve që kanë marrë statusin e origjinës, të cilat janë përdorur në prodhimin e produkteve të tjera, zbatohen, pavarësisht nëse ky status është marrë brenda fabrikës ku këto produkte po përdoren ose në një tjetër fabrikë në Shqipëri ose Turqi.

Shembull:

Një motor i kreut 8407, për të cilin rregulli thotë se vlera e materialeve pa origjinë të cilat mund të përfshihen në të nuk mund të kalojë 40% të çmimit ex-works është bërë nga "aliazh tjetër prej çeliku i formatuar për kudhër" të kreut ex 7224.

Në rast se ky çelik i temperuar është temperuar në Turqi nga një lëndë e parë pa origjinë, ky çelik ka marrë tashmë statusin me origjinë sipas rregullit për kreun ex 7224 në listë. Temperimi mund të llogaritet atëherë si me origjinë në vlerën e llogaritur për motorin, pavarësisht nëse çeliku u prodhua në të njëjtën fabrikë ose në një tjetër në Turqi. Vlera e lëndës së parë pa origjinë në këtë mënyrë nuk merret parasysh kur shtohet vlera e materialeve pa origjinë të përdorura.

3.2 Rregulli në listë përfaqëson sasinë minimale të kërkuar të punës ose të përpunimit, si dhe kryerja e më shumë pune apo përpunimi gjithashtu i jep statusin e origjinës; në të

kundërt, kryerja e më pak pune apo përpunimi nuk mund t'i japë statusin e origjinës. Kështu, në rast se një rregull thotë se një material pa origjinë, në një nivel të dhënë të prodhimit mund të përdoret, atëherë përdorimi i këtij materiali në një stad të hershëm të prodhimit lejohet dhe përdorimi i tij në një stad të mëvonshëm nuk lejohet.

3.3 Pa cenuar shënimin 3.2, kur një rregull përdor shprehjen se: “Prodhimi nga materialet e çdo kreu” mund të përdoret, materialet e të njëjtit kre/krekë (edhe materialet e të njëjtit përshkrim dhe kre si produkti), megjithatë duke iu nënshtruar kufizimeve specifike që mund të parashikohen nga rregulli.

Sidoqoftë, shprehja “Prodhim nga materiale të çdo kreu, duke përfshirë materiale të tjera të kreut ...” ose “Prodhim nga materialet e çdo kreu duke përfshirë materiale të tjera të të njëjtit kre si produkti” do të thotë që mund të përdoren vetëm materiale të çdo kreu, përveç atyre të të njëjtit përshkrim si produkti i dhënë në kolonën 2 të listës.

3.4 Kur një rregull në listë specifikon se një produkt mund të prodhohet nga më shumë se një material, kjo do të thotë që mund të përdoren një ose më shumë materiale. Ai nuk kërkon që të përdoren të gjitha materialet.

Shembull:

Rregulli për fabrikate të krerëve 5208 deri 5212 thotë se mund të përdoren fibrat natyrale dhe se materialet kimike, ndërmjet materialeve të tjera, mund të përdoren gjithashtu.

Kjo nuk do të thotë që të dyja duhet të përdoren; është e mundur të përdoret njëra ose tjetra, ose që të dyja.

3.5 Kur një rregull në listë specifikon se një produkt duhet të prodhohet nga një material i caktuar, ky kusht duket se nuk parandalon përdorimin e materialeve të tjera që, për shkak të natyrës së tyre, nuk mund të përmbushin rregullin (shiko gjithashtu shënimin 6.2 më poshtë në lidhje me tekstilet).

Shembull:

Rregulli për ushqimet e përgatitura në kreun 1904, i cili në mënyrë specifike përjashton përdorimin e drithërave dhe derivateve të tyre, nuk parandalon përdorimin e kripërave minerale, e kimikateve dhe shtesave të tjera, të cilat nuk janë prodhime nga drithërat.

Megjithatë, kjo nuk aplikohet te produktet, të cilat, edhe pse nuk mund të prodhohen nga materiale të veçanta të specifikuar në listë, mund të prodhohen nga një material i së njëjtës natyrë në një stad më të hershëm të prodhimit.

Shembull:

Në rastin e një artikulli veshjeje të ex kapitullit 62, i përbërë nga materiale jo të thurura, në rast se lejohet përdorimi i vetëm fillit pa origjinë për këtë lloj artikulli, nuk është e mundur të fillosh nga pëlhurë jo e thurur – edhe nëse pëlhurat jo të thurura normalisht nuk mund të bëhen prej filli. Në raste të tilla, materiali fillestar duhet të jetë në një stad përpara të

qenit fill, pra në gjendjen fibër.

3.6 Kur, në një rregull në listë, jepen dy përqindje për vlerën maksimale të materialeve pa origjinë që mund të përdoren, atëherë këto përqindje mund të mos shtohen së bashku. Me fjalë të tjera, vlera maksimale e të gjitha materialeve pa origjinë të përdorura nuk mund të kalojë asnjëherë përqindjen më të lartë të dhënë. Për më tepër, përqindjet individuale nuk duhet të tejkalohen, në lidhje me materialet e veçanta për të cilat ato aplikohen.

Shënim 4:

4.1 Termi "fibra natyralë" përdoret në listë për t'ju referuar fibrave të tjera nga ato artificiale ose sintetike. Kufizohet për statet përpara se të ndodhë tjerja, duke përfshirë mbetjet dhe, nëse nuk specifikohet ndryshe, përfshin fibrat të cilat janë përdredhur, krehur ose përpunuar ndryshe, por që nuk janë kthyer në fill.

4.2 Termi "fibra natyralë" përfshin qimen e kalit të kreut nr.0503, mëndafshin e krerëve 5002 dhe 5003, po ashtu si dhe fibrat e leshit dhe qime të imët ose të ashpër kafshe të krerëve 5101 deri 5105, fibra pambuku të krerëve 5201 deri 5203, si dhe fibra të tjerë vegjetalë të krerëve 5301 deri 5305.

4.3. Termat "pulp tekstili", "materiale kimike" dhe "materiale për prodhim letre" përdoren në listë për të përshkruar materialet, e paklasifikuara në kapitujt 50 deri 63, të cilat mund të përdoren për të prodhuar fibra ose fije artificiale, sintetike ose letre.

4.4 Termi "fibra kryesorë të bëra nga njeriu" përdoret në listë për t'ju referuar filamenteve artificiale apo sintetike, fibrave zëvendësuese ose mbetjeve, të krerëve 5501 deri 5507.

Shënim 5:

5.1 Aty ku, për një produkt të dhënë në listë, bëhet referencë te ky shënim, kushtet e vendosura në kolonën 3 nuk zbatohen për ndonjë material bazë tekstili të përdorur në prodhimin e këtij produkti dhe të cilat, të marra së bashku, përfaqësojnë 10% ose më pak të peshës totale të materialeve bazë tekstile të përdorura (Shiko gjithashtu shënimet 5.3 dhe 5.4 me poshtë).

5.2 Sidoqoftë, toleranca e përmendur në shënimin 5.1 mund të aplikohet vetëm te produktet e përziera, të cilat janë bërë nga dy ose më shumë materiale tekstili bazë.

Materialet tekstile bazë, jepen si më poshtë :

- mëndafsh,
- lesh,
- qime kafshe e ashpër,
- qime kafshe e hollë,
- qime kali,

- pambuk,
- materiale për prodhim letre dhe letër,
- fiye liri,
- fiye kërpi,
- jute dhe fibra të tjera tekstili,
- sisal dhe fibra të tjera të gjinisë Agave,
- fibra nga arra kokosi, abaka, ramie dhe fibra të tjera vegjetale tekstile,
- filamente sintetike të bëra nga njeriu,
- filamente artificiale të bëra nga njeriu,
- filamente percjellëse rryme,
- fibra sintetike të bëra nga njeriu prej polipropileni,
- fibra sintetike të bëra nga njeriu prej poliesteri,
- fibra sintetike të bëra nga njeriu prej poliamidi,
- fibra sintetike të bëra nga njeriu prej poliakrilonitrili,
- fibra sintetike të bëra nga njeriu prej poliimidi,
- fibra sintetike të bëra nga njeriu prej politetrafluoroetileni,
3. Produktet origjinuese në një prej vendeve apo territoreve të referuara në paragrafin 1, që nuk i nënshtrohen ndonjë punimi apo procesi në Shqipëri, e ruajnë origjinën e tyre nëse eksportohen në një prej këtyre vendeve apo territoreve.
4. Kumulimi i dhënë nga ky nen është i zbatueshëm vetëm kur:
- a) një marrëveshje tregtare preferenciale në pajtim me nenin XXIV të Marrëveshjes së Përgjithshme për Tarifat dhe Tregtinë (GATT) është e zbatueshme ndërmjet vendeve apo territoreve të përfshira në marrjen e statusit të origjinës dhe vendit të destinacionit;

b) materialet dhe produktet kanë marrë statusin e origjinës në bazë të rregullave të origjinës identike me ato të dhëna në këtë protokoll; dhe

c) njoftimet që tregojnë përmbushjen e kërkesave të nevojshme për aplikim për kumulim janë botuar në Gazetën Zyrtare të Shqipërisë dhe në Turqi sipas procedurave të saj. Kumulimi i dhënë në këtë nen është i zbatueshëm që nga data e treguar në njoftimin e botuar në Gazetën Zyrtare të Shqipërisë dhe Turqisë.

Shqipëria i siguron Turqisë, nëpërmjet detajeve të Marrëveshjeve, përfshirë datat e tyre të hyrjes në fuqi, dhe rregullat e origjinës përkatëse, të cilat janë të zbatueshme me vendet e tjera apo territoret e përmendura në paragrafin 1.

Produktet në aneksin V përjashtohen nga kumulimi i dhënë nga ky nen.

Neni 4

Kumulimi në Turqi

1. Pa paragjykuar dispozitat e nenit 2(2), produktet konsiderohet origjinuese në Turqi kur këto produkte përftohen atje, duke bashkëngjitur materiale origjinuese në Shqipëri, Turqi ose në

¹ Vendimi nr.1/95 i Këshillit të Asociimit KE-Turqi i 22 dhjetorit 1995 i referohet produkteve të tjera prej atyre bujqësore të përcaktuara në marrëveshje, që vendos një asocim ndërmjet Komunitetit Ekonomik Evropian dhe Turqisë, si dhe ndryshe nga produktet e qymyrit dhe çelikut siç përcaktohen në marrëveshjen ndërmjet Komunitetit Evropian të Qymyrit dhe Çelikut dhe Republikës së Turqisë për tregtinë e produkteve të mbuluara nga traktati themelues i Komunitetit Evropian të Qymyrit dhe Çelikut.

cilindo vend tjetër apo territor pjesëmarrës në procesin e Stabilizim-Asociimit¹ të Bashkimit Evropian ose që merr bashkëngjitur materiale origjinuese në Komunitet për të cilat zbatohet vendimi nr 1/95 i Këshillit të Asocimit KE-Turqi i 22 dhjetorit 1995², me kusht që punimi ose përpunimi i kryer në Turqi të shkojë përtej operacioneve të referuara në nenin 7. Nuk është e nevojshme që materiale të tilla të kenë kaluar punime apo përpunime të mjaftueshme.

2. Kur punimi apo proceset e kryera në Turqi nuk shkojnë përtej operacioneve të referuara në nenin 7, produkti i përftuar konsiderohet si origjinues në Turqi vetëm kur vlera shtesë është më e madhe sesa vlera e materialeve të përdorura në cilindo prej vendeve të tjera apo territoreve të referuara në paragrafin 1. Në rast të kundërt, produkti i përftuar konsiderohet si

originues në vendin i cili ka vlerën më të madhe të materialeve originuese të përdorura për përpunim në Turqi .

3. Produktet originuese në një prej vendeve apo territoreve të referuara në paragrafin 1, të cilat nuk i nënshtrohen punimeve apo proceseve në Turqi, e ruajnë origjinën e tyre nëse eksportohen në një nga këto vende apo territore.

4. Kumulimi i dhënë nga ky nen është i zbatueshëm vetëm kur:

a) një marrëveshje tregtare preferenciale në pajtim me nenin XXIV të Marrëveshjes së Përgjithshme për Tarifat dhe Tregtinë (GATT) është e zbatueshme ndërmjet vendeve apo territoreve të përfshira në marrjen e statusit të origjinës dhe vendit të destinacionit;

b) materialet dhe produktet kanë marrë statusin e origjinës në bazë të rregullave të origjinës identike me ato të dhëna në këtë protokoll;

dhe

c) njoftimet që tregojnë përmbushjen e kërkesave të nevojshme për aplikim për kumulim janë botuar në Fletoren Zyrtare të Turqisë dhe në Shqipëri sipas procedurave të saj. Kumulimi i dhënë në këtë nen është i zbatueshëm që nga data e treguar në njoftimin e botuar në Fletoren Zyrtare të Turqisë dhe të Shqipërisë.

Turqia i siguron Shqipërisë, nëpërmjet detajeve të Marrëveshjeve, përfshirë datat e hyrjes së tyre në fuqi, si dhe rregullat e origjinës përkatëse të zbatueshme me vendet e tjera apo territoret e përmendura në paragrafin 1.

Produktet në aneksin V përjashtohen nga kumulimi i dhënë nga ky nen.

Neni 5

Produktet tërësisht të përfuara

1. Produktet e mëposhtme konsiderohen si tërësisht të përfuara në Shqipëri ose në Turqi:

a) produkte minerale të nxjerra nga shtresat e tyre tokësore dhe nëntoka ujore e detit;

b) produktet bimore të korrura atje;

c) kafshët e gjalla të lindura dhe të rritura atje;

d) produkte nga kafshët e gjalla të rritura atje;

e) produkte të përfuara nga gjuetia apo peshkimi të kryera atje;

f) produkte të peshkimit ose produkte të tjera të marra nga deti jashtë ujërave territoriale të Shqipërisë ose Turqisë nga barkat e tyre;

g) produkte të prodhuara në bordet e anijeve të tyre fabrikë ekskluzivisht nga produktet e referuara në nënparagrafin “f”;

h) artikujt e përdorur, të mbledhur atje, që përshtaten vetëm për përpunimin e lëndëve të para, duke përfshirë gomat e përdorura të përshtatshme vetëm për ritrajtim ose që përdoren si mbetje;

i) mbetje dhe skrape të rezultuara nga operacionet e përpunimit të kryera atje;

¹ Siç përcaktohet nga përfundimet e Këshillit për Çështjet e Përgjithshme në prill 1997 dhe Komunikata e Komisionit e majit 1999 për vendosjen e procesit të Stabilizim-Asocimet me vendet e Ballkanit Perëndimor.

² Vendimi Nr.1/95 i Këshillit të Asocimit KE-Turqi i 22 dhjetorit 1995 i referohet produkteve të tjera prej atyre bujqësore të përcaktuara në Marrëveshje, që vendos një Asociim ndërmjet Komunitetit Ekonomik Evropian dhe Turqisë si dhe ndryshe nga produktet e qymyrit dhe çelikut siç përcaktohen në Marrëveshjen ndërmjet Komunitetit Evropian të Qymyrit dhe Çelikut dhe Republikës së Turqisë, për tregtinë e produkteve të mbuluara nga traktati themelues i Komunitetit Evropian të Qymyrit dhe Çelikut.

j) produkte të nxjerra nga shtresat ose nënshtresat tokësore në ujërat detare, jashtë ujërave të tyre territoriale, me kusht që të kenë të drejtën vetëm për t'i punuar këto shtresa apo nënshtresa;

k) mallra të prodhuara atje ekskluzivisht nga produktet e specifikuar në nënparagrafin nga “a” deri “j”.

2. Termi “barkat e tyre” dhe “anijet e tyre fabrikë” në paragrafin 1 “f” dhe “g” aplikohen vetëm për barkat dhe anijet fabrikë:

a) të cilat janë të regjistruara ose të mbajtura në Shqipëri apo në Turqi;

b) të cilat lundrojnë nën flamurin e Shqipërisë apo të Turqisë;

c) të cilat janë në pronësi të paktën në masën 50 për qind nga nënshtetasit e Shqipërisë ose Turqisë, ose nga një shoqëri tregtare me zyrat e saj kryesore në një nga këto shtete, menaxheri apo menaxheret e të cilëve, kryetari i bordit të drejtorëve ose bordi mbikëqyrës dhe shumica e anëtarëve të bordeve të tilla janë nënshtetas të Shqipërisë ose Turqisë dhe të cilëve, veç kësaj, në rastin e bashkëpronësisë ose shoqërive me përgjegjësi të kufizuar, të paktën gjysma e kapitalit i përket këtyre shteteve ose institucioneve publike apo nënshtetasve të shteteve të mësipërme;

d) pronarët dhe drejtuesit e të cilave janë nënshtetas të Shqipërisë ose të Turqisë; dhe

e) në të cilat të paktën 75% e ekuipazhit janë nënshtetas të Shqipërisë ose të Turqisë.

Neni 6

Produkte të punuara ose të përpunuara në masë të mjaftueshme

1. Për qëllime të nenit 2, produktet të cilat nuk janë tërësisht të përfituara konsiderohen të punuara ose të përpunuara mjaftueshëm kur janë përmbushur kushtet e vendosura në listën e aneksit II.

Kushtet e referuara në paragrafin e mësipërm, për të gjitha produktet që mbulon kjo Marrëveshje, i referohen punimit ose përpunimit që duhet t'u nënshtrohen materialet joorigjinuese të përdorura për prodhim dhe janë të zbatueshme vetëm në lidhje me materiale të tilla. Përkatësisht, nëse një produkt, i cili e ka marrë statusin e origjinës duke plotësuar kushtet e vendosura në listë, është përdorur në prodhimin e një produkti tjetër, kushtet e zbatueshme ndaj produktit ku është përfshirë nuk aplikohen për të, dhe nuk do të merren parasysh materialet joorigjinuese, të cilat mund të jenë përdorur në prodhimin e tij.

2. Pavarësisht nga paragrafi 1, materialet joorigjinuese të cilat sipas kushteve të vendosura në listë nuk duhet të përdoren në prodhimin e një produkti, mund edhe të përdoren nëse sigurohet që:

a) vlera e tyre totale nuk i kalon 10 për qind të çmimit ex-works të produktit;

b) ndonjë nga përqindjet e dhëna në listë për maksimumin e vlerës së materialeve joorigjinuese nuk tejkalohen përmes aplikimit të këtij paragrafi. Ky paragraf nuk zbatohet për produktet e renditura nga kapitulli 50 deri te kapitulli 63 i sistemit të harmonizuar.

3. Paragrafët 1 dhe 2 zbatohen duke iu nënshtuar dispozitave të nenit 7.

Neni 7

Punimet ose përpunimet e pamjaftueshme

1. Pa cenuar paragrafin 2, operacionet e mëposhtme konsiderohen si punime ose përpunime të pamjaftueshme për t'i dhënë statusin e origjinës së produktit, pavarësisht nëse janë plotësuar apo jo kërkesat e nenit 6:

a) kryerja e operacioneve për të siguruar mbajtjen e produktit në kushte të mira gjatë transportit dhe magazinimit;

b) thyerjet dhe bashkimet e paketimeve;

c) larja, pastrimi, heqja e pluhurit, oksideve, vajit, njollave apo mbulimeve të tjera;

- d) hekurosja ose presimi i tekstileve;
- e) operacionet e thjeshta të lyerjeve apo shkëlqimit;
- f) tharja, zbardhimi i pjesshëm ose i përgjithshëm, shkëlqimi dhe ndriçimi i farërave dhe orizit;
- g) operacionet e ngjyrosjes së sheqerit ose dhënia e formave të ndryshme sheqerit;
- h) qërimi, pastrimi i pjesës së brendshme të frutave, arrave dhe perimeve;
- i) ndarjet, bluarjet ose prerjet e thjeshta;
- j) heqja e pjesëve mbuluese, mbrojtja nga dëmtuesit e jashtëm, përzgjedhjet, klasifikimi, përshkallëzimet dhe matjet (duke përfshirë vendosjen e pjesëve të artikujve);
- k) thjesht vendosjet në shishe, kënaçe, epruveta, çanta, valixhe, kuti, sirtarë, fiksimi në to i letrave ose mbështjellësve, si dhe të gjitha operacionet e tjera të paketimit të thjeshtë;
- l) fiksimi ose printimi i markave, etiketave, logove, si dhe i shenjave të tjera të dallueshme mbi produkte ose mbi paketimin e tyre;
- m) përzierje e thjeshtë e produkteve, të llojeve të ndryshme apo jo, përzierja e sheqerit me çfarëdo materiali tjetër;
- n) bashkimi i thjeshtë i pjesëve të artikujve për të përfunduar një material të plotë ose ndarja e produktit në pjesë;
- o) kombinimi i dy ose më shumë operacioneve të specifikuara në nënparagrafët nga “a” në “n”;
- p) therja e kafshëve.

2. Të gjitha operacionet që kryhen në Shqipëri ose në Turqi në një produkt të caktuar konsiderohen së bashku në rastet kur duhet përcaktuar nëse punimet ose proceset përpunuese mbi të cilat ka kaluar produkti janë të pamjaftueshme brenda kuptimit të paragrafit 1.

Neni 8

Njësia e kualifikimit

1. Njësia e kualifikimit për aplikimin e dispozitave të këtij protokollit quhet produkti i veçantë, i cili konsiderohet si njësi bazë me qëllim klasifikimin sipas nomenklaturës së sistemit të harmonizuar.

Përkatësisht procedohet si më poshtë:

a) kur një produkt i përbërë nga një grup ose bashkim artikujsh është i klasifikuar nën termat e sistemit të harmonizuar në një kre të vetëm, e tëra përbën njësinë e klasifikimit;

b) kur një dërgesë përfaqëson një numër produktesh identike të klasifikuara nën të njëjtin kre të sistemit të harmonizuar, çdo produkt duhet të merret individualisht në rastin e aplikimit të dispozitave të këtij protokollit.

2. Kur, nën rregullin e përgjithshëm 5 të sistemit të harmonizuar, për qëllime klasifikimi paketimi përfshihet bashkë me produktin, kjo përfshirje bëhet për qëllim të përcaktimit të origjinës.

Neni 9

Plotësuesit, pjesët e këmbimit dhe instrumentet

Plotësuesit, pjesët e këmbimit dhe instrumentet të lidhura me një pjesë pajisjeje, makinerie, aparati apo mjeti, të cilat janë pjesë e një pajisjeje normale dhe përfshihen në çmim të saj ose që nuk jepen me faturë më vete, konsiderohen si një me pjesën e pajisjes, makinerisë, aparatit ose mjetit në fjalë.

Neni 10

Kompletet

Sipas përcaktimit në rregullin e përgjithshëm 3 të sistemit të harmonizuar, kompletet konsiderohen si origjinuese kur të gjitha produktet përbërëse janë origjinuese. Megjithatë, kur një komplet përbëhet nga produkte origjinuese dhe joorigjinuese, kompleti si i tërë konsiderohet si origjinues me kusht që vlera e produkteve joorigjinuese të mos kalojë 15 për qind të çmimit “ex works” të kompletit.

Neni 11

Elementet neutrale

Me qëllim për të përcaktuar nëse një produkt është origjinues, nuk është e nevojshme të përcaktohet origjina e zërave të mëposhtëm, të cilët mund të jenë përdorur për prodhimin e produktit në fjalë:

a) energjia elektrike dhe karburanti;

b) toka dhe pajisjet;

c) makineritë dhe veglat;

d) mallrat të cilat nuk hyjnë dhe nuk synohen të përfshihen në përbërjen finale të produktit.

TITULLI III

KËRKESAT TERRITORIALE

Neni 12

Parimi i territorialitetit

1. Shqipëria ose Turqia duhet të plotësojnë pa ndërprerje kushtet për përfitimin e statusit origjinues të përcaktuar në titullin II, me përjashtim të rasteve të referuara në nenet 3 dhe 4 të këtij aneksi.

2. Me përjashtim të rasteve të referuara në nenet 3 dhe 4, kur mallrat origjinuese të eksportuara nga Shqipëria apo Turqia në një vend tjetër kthehen, ato konsiderohen joorigjinuese, përveç rasteve kur autoriteteve doganore u demonstron në mënyrë të mjaftueshme se:

a) mallrat e kthyera janë po ato që janë eksportuar; dhe

b) mallrat nuk u janë nënshtruar ndonjë procesi, përveç atyre të nevojshme për t'i ruajtur ato në kushte të mira gjatë kohës që kanë ndenjur në atë vend ose gjatë eksportimit.

3. Përftimi i statusit origjinues në përputhje me kushtet e përcaktuara në titullin II, nuk ndikohet nga punime apo procese të kryera jashtë Shqipërisë ose Turqisë ndaj materialeve të eksportuara nga Shqipëria ose Turqia dhe riimportuara atje, duke siguruar që:

a) materialet në fjalë janë plotësisht të përftuara në Shqipëri ose Turqi, ose që punimet apo përpunimet përtej operacioneve të referuara në nenin 7 janë kryer para se të ishin eksportuar; dhe

b) të binden autoritetet doganore se:

i) mallrat e riimportuara kanë qenë përftuar nga punime apo përpunime të materialeve të eksportuara; dhe

ii) vlera totale shtesë e përftuar jashtë Shqipërisë ose Turqisë sipas zbatimit të dispozitave të këtij neni, nuk kalon 10 për qind të çmimit ex works të produktit përfundimtar për të cilin është kërkuar statusi origjinues.

4. Për qëllime të paragrafit 3, kushtet për përfitimin e statusit origjinues përcaktuar në titullin II nuk zbatohen për punime apo përpunime të bëra jashtë Shqipërisë ose Turqisë. Në rastet kur, në listën e aneksit II, një rregull i caktuar për vlerën maksimale të të gjitha materialeve të

përfshira jooriginuese zbatohet për përcaktimin e statusit të origjinës së produktit përfundimtar, vlera totale e materialeve jooriginuese të përfshira në territorin e palës së interesuar, marrë së bashku me vlerën totale shtesë të përftuar jashtë Shqipërisë ose Turqisë sipas zbatimit të dispozitave të këtij neni, nuk duhet të tejkalojë përqindjen e përcaktuar.

5. Për qëllime të zbatimit të dispozitave të paragrafëve 3 dhe 4, “vlera totale shtesë” merret në kuptimin e të gjitha kostove të bëra jashtë Shqipërisë ose Turqisë, përfshi dhe vlerën e materialeve të përfshira atje.

6. Dispozitat e paragrafëve 3 dhe 4 nuk zbatohen për produktet që nuk përmbushin kushtet e përcaktuara në listën e aneksit II, ose të cilat mund të konsiderohen të punuara ose përpunuara në masë të mjaftueshme vetëm nëse zbatohet toleranca e lejueshme e dhënë në nenin 6 (2).

7. Dispozitat e paragrafëve 3 dhe 4 nuk zbatohen për produktet e kapitujve nga 50 deri në 63 të sistemit të harmonizuar.

8. Çfarëdo lloj punimi apo përpunimi që është objekt i dispozitave të këtij neni dhe është kryer jashtë Shqipërisë ose Turqisë, bëhet me anë të marrëveshjeve të përpunimit të jashtëm ose marrëveshjeve të ngjashme.

Neni 13

Transporti i drejtpërdrejtë

1. Trajtimi preferencial i siguar në marrëveshje zbatohet vetëm për produktet që plotësojnë kërkesat e këtij protokollit, të cilat janë transportuar direkt mes Shqipërisë dhe Turqisë, ose mes shteteve apo territoreve të tjera të përcaktuara në nenet 3 dhe 4. Sidoqoftë, produktet që përbëhen nga një dërgesë e vetme mund të transportohen nëpërmjet territoreve të tjera me, nëse gjykohet e nevojshme, lëvizje transit ose magazinim të përkohshëm në këto territore, me kusht që ato të qëndrojnë nën vëzhgimin e autoriteteve doganore të vendit transit ose të magazinimit dhe që nuk i nënshtrohen operacioneve të tjera veç atyre të ngarkim-shkarkimit ose ndonjë operacioni tjetër me synim për t'i mbajtur ato në kushte të mira. Produktet origjinuese mund të transportohen me anë të tubacioneve përmes territorit e ndryshme nga ajo e Shqipërisë ose Turqisë.

2. Provat që vërtetojnë se kushtet e përcaktuara në paragrafin 1 janë plotësuar tërësisht, duhet t'iu jepen autoriteteve doganore të vendit importues në formën e:

a) një dokumenti të vetëm transporti që tregon kalimin nga vendi eksportues përmes vendit transit; ose

b) një certifikate të lëshuar nga autoritetet doganore të vendit transit:

i) ku jepet përshkrimi i saktë i produkteve;

ii) ku paraqiten datat e shkarkimit dhe ngarkimit të produkteve dhe, nëse është e zbatueshme, emrat e anijeve, ose llojeve të tjera të transportit të përdorur; dhe

iii) që vërteton kushtet nën të cilat kanë qëndruar produktet në vendin transit; ose

c) nëse nuk mundësohen këto dokumente, ndonjë dokument tjetër thelbësor.

Neni 14

Ekspozitat

1. Produktet origjinuese të dërguara për ekspozim në një vend apo territor tjetër të ndryshëm nga ato të referuara në nenet 3 dhe 4, dhe të shituara pas ekspozimit për importim në Shqipëri ose Turqi, përfitojnë në import nga dispozitat e Marrëveshjes, nëse ato tregojnë në nivel të pranueshëm për autoritetet doganore se:

a) një eksportues i ka dërguar këto produkte nga Shqipëria ose Turqia në vendin në të cilin bëhet ekspozita dhe i ka ekspozuar ato atje;

b) produktet janë shitur ose në të kundërt u janë vënë në dispozicion nga ky eksportues një personi në Shqipëri ose Turqi;

c) produktet janë dorëzuar gjatë ekspozitës ose menjëherë pas saj në gjendjen në të cilën ato janë dërguar për ekspozim;

dhe

d) produktet nuk janë përdorur, që nga momenti kur ato u dërguan në ekspozitë, për ndonjë qëllim tjetër veçse atij të ekspozimit.

2. Dëshmia e origjinës duhet të jetë lëshuar ose bërë në përputhje me dispozitat e titullit V dhe të jetë depozituar pranë autoriteteve doganore të vendit importues në formë normale. Emri dhe adresa e ekspozitës duhet të jenë të shprehura qartë në të. Kur gjykohet e nevojshme, mund të kërkohen të dhëna shtesë dokumentimi në lidhje me kushtet e produkteve gjatë ekspozimit.

3. Paragrafi 1 zbatohet për çdo lloj ekspozimi tregtar, industrial, bujqësor apo artizanal, panairi apo prezantimi publik të ngjashëm ose demonstrim që nuk është organizuar për qëllime private në dyqane apo ambiente biznesi me synimin e shitjes së mallrave nga jashtë, dhe gjatë të cilave produktet u nënshtrohen kontrollit doganor.

TITULLI IV

RIMBURSIMI OSE PËRJASHTIMI

Neni 15

Ndalimi i rimbursimit ose përjashtimeve nga taksat doganore

1. Materialet joorigjinuese të përdorura në prodhimin e një produkti origjinues në Shqipëri, në Turqi ose në një prej vendeve apo territoreve të tjera të referuara në nenet 3 dhe 4 për të cilat vërtetimi i origjinës është lëshuar ose bërë në përputhje me dispozitat e titullit V nuk do të

jenë në Shqipëri ose Turqi subjekt rimbursimi apo përjashtimi nga taksat doganore të çfarëdo lloji.

2. Ndalimi në paragrafin 1 zbatohet për çdo lloj rregullimi për rimbursim, anulimi i borxheve ose mospagesave, të pjesshme ose tërësore, të tarifave doganore ose detyrimeve të tjera me të njëjta efekte të aplikueshme në Shqipëri ose në Turqi për materialet e përdorura në prodhim, ku rimbursimet, anulimet e borxheve ose mospagimet e tilla zbatohen, shprehimisht ose me efekt, kur produktet e përfuara nga materialet e mësipërme janë eksportuar dhe jo kur ato mbahen për përdorim shtëpiak atje.

3. Eksportuesi i produkteve të shoqëruara me dëshmi origjine duhet të përgatitet të paraqesë në çdo kohë me kërkesën e autoriteteve doganore, të gjitha dokumentet e nevojshme që provojnë se asnjë rimbursim nuk është bërë në lidhje me materialet joorigjinuese të përdorura në prodhimin e produkteve në fjalë dhe se të gjitha tarifatat doganore ose detyrimet e tjera me të njëjta efekte, të aplikueshme për të tilla materiale, aktualisht kanë qenë paguar.

4. Dispozitat e paragrafëve nga 1 në 3, gjithashtu zbatohen për sa i përket paketimit, brenda kuptimit të nenit 8(2), plotësuesit, pjesët e këmbimit dhe instrumentet, brenda kuptimit të nenit 9 dhe produktet në një komplet, brenda kuptimit të nenin 10, kur përbërës të tillë janë joorigjinues.

5. Dispozitat e paragrafëve nga 1 në 4, zbatohen vetëm për materialet të cilat janë të llojit për të cilat zbatohet marrëveshja. Për më tepër, nuk përjashtohet aplikimi i ndonjë sistemi të rimbursimit të eksporteve për produktet bujqësore, të aplikueshme për eksportet në përputhje me dispozitat e marrëveshjes.

TITULLI V

VËRTETIMI I ORIGJINËS

Neni 16

Kërkesa të përgjithshme

1. Produktet origjinuese në Shqipëri gjatë importimit në Turqi dhe produktet origjinuese në Turqi gjatë importimit në Shqipëri, përfitojnë nga kjo Marrëveshje me paraqitjen e njërës nga të mëposhtmet:

a) një certifikatë qarkullimi mallrash EUR.1, një model i së cilës tregohet në aneksin III; ose

b) në rastet e specifikuar në nenin 22(1), një deklaratë, referuar rrjedhimisht si “deklaratë faturë”, dhënë nga eksportuesi në një faturë, një dëftesë dërgese ose dokument tjetër tregtar, i cili përshkruan produktet përkatëse në detaje të mjaftueshme për t’u identifikuar; teksti i deklaratës faturë paraqitet në aneksin IV.

2. Pavarësisht nga paragrafi 1, produktet origjinuese në kuptimin e këtij protokollit, përta i takon rasteve të specifikuara në nenin 27, përfitojnë nga kjo Marrëveshje, pa qenë e nevojshme të depozitohet ndonjë nga dokumentet e përmendura më sipër.

Neni 17

Procedurat për lëshimin e certifikatës së qarkullimit të mallrave eur.1

1. Një certifikatë qarkullimi mallrash EUR.1 lëshohet nga autoritetet doganore të vendit eksportues mbështetur në aplikimin e bërë me shkrim nga eksportuesi ose, nën përgjegjësinë e eksportuesit, nga përfaqësuesi i tij i autorizuar.
2. Për këtë qëllim, eksportuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar plotësojnë të dyja dokumentet, certifikatën e qarkullimit të mallrave EUR.1 dhe formularin e aplikimit, modelet e të cilave tregohen në aneksin III. Këta formularë plotësohen në një nga gjuhët në të cilat është hartuar kjo marrëveshje dhe në përputhje me dispozitat e ligjit vendas të vendit eksportues. Nëse ato janë të shkruara me dorë, ato plotësohen me bojë me germa kapitale. Përshkrimi i produkteve duhet të jepet në kutinë e rezervuar për këtë qëllim pa lënë ndonjë rresht bosh. Kur kutia nuk është e plotësuar tërësisht, një vizë horizontale duhet të hiqet poshtë rreshtit të fundit të përshkrimit, duke kaluar përmes hapësirës boshe.
3. Eksportuesi që aplikon për lëshimin e një certifikate qarkullimi mallrash eur.1 përgatitet për të depozituar në çdo kohë, me kërkesën e autoriteteve doganore të vendit eksportues ku certifikata e qarkullimit të mallrave EUR.1 është lëshuar, të gjitha dokumentet e nevojshme që provojnë statusin origjinues të produktit në fjalë, si dhe plotësimin e kërkesave të tjera të këtij protokollit.
4. Certifikata e qarkullimit të mallrave EUR.1 lëshohet nga autoritetet doganore të Shqipërisë ose të Turqisë nëse produktet në fjalë konsiderohen origjinuese në Shqipëri ose në Turqi, apo në një prej vendeve dhe territoreve të tjera të përcaktuara në nenet 3 dhe 4, dhe që plotësojnë kërkesat e tjera të këtij protokollit.
5. Autoritetet doganore që lëshojnë certifikatën e qarkullimit të mallrave EUR.1 ndërmarrin masa apo hapa të nevojshëm për të verifikuar statusin e origjinës së produkteve dhe plotësimin e kërkesave të tjera të këtij protokollit. Për këtë qëllim, ato kanë të drejtë të kërkojnë çdo evidencë apo të ndërmarrin çfarëdo inspektimi të llogarive financiare të eksportuesit ose ndonjë kontroll tjetër që ata e konsiderojnë të nevojshëm. Autoritetet doganore në lëshimin e certifikatave të tilla gjithashtu sigurojnë që formularët referuar paragrafit 2 janë plotësuar përkatësisht. Në veçanti, ata do të kontrollojnë nëse hapësira e rezervuar për përshkrimin e produkteve është plotësuar në mënyrë të tillë që përjashton të gjitha mundësitë për shtesa false.
6. Data e lëshimit të një certifikate qarkullimi mallrash EUR.1 tregohet në kutinë 11 të certifikatës.

7. Një certifikatë qarkullimi mallrash EUR.1 lëshohet nga autoritetet doganore dhe i vihet në dispozicion eksportuesit sapo kryhet ose sigurohet eksportimi në fjalë.

Neni 18

Certifikatat e qarkullimit të mallrave EUR.1, të lëshuara në retrospektivë

1. Pavarësisht nga neni 17(7), një certifikatë qarkullimi mallrash EUR.1 mund në raste të veçanta, të lëshohet pas eksportimit të produkteve të cilave iu referohet, nëse:

a) ajo nuk është lëshuar në kohën e eksportimit për shkak të gabimeve ose mungesave të pavullnetshme ose rrethanave të veçanta;

ose

b) është demonstruar pranë autoriteteve doganore që një certifikatë qarkullimi mallrash EUR.1 është lëshuar, por që për arsye teknike nuk është pranuar gjatë importimit.

2. Për zbatimin e paragrafit 1, eksportuesi duhet të tregojë në aplikimin e tij vendin dhe datën e eksportimit të produkteve për të cilat certifikata e qarkullimit të mallrave EUR.1 lëshohet, dhe të tregojë arsyet për këtë kërkesë.

3. Autoritetet doganore mund të lëshojnë një certifikatë qarkullimi mallrash EUR.1 në retrospektivë, vetëm pasi të jetë verifikuar së informacioni i dhënë nga eksportuesi në aplikim është i njëjtë me atë të dosjes korresponduese.

4. Certifikata e qarkullimit të mallrave EUR.1 lëshuar në retrospektivë duhet të mbyllet me frazën e mëposhtme në anglisht: "Issued retrospectively",

5. Faza referuar në paragrafin 4 vendoset në kutinë "Vërejtje" të certifikatës së qarkullimit të mallrave EUR.1.

Neni 19

Lëshimi i dublikatës së certifikatës së qarkullimit të mallrave EUR.1

1. Në rast vjedhjeje, humbjeje apo shkatërrimi të një certifikate qarkullimi mallrash EUR.1, eksportuesi mund të aplikojë tek autoritetet doganore, të cilat e kanë lëshuar atë për një dublikatë që bëhet në bazë të dokumenteve të eksportit në zotërim të tyre.

2. Dublikata e lëshuar në këtë mënyrë duhet të mbyllet me fjalën e mëposhtme në anglisht: "Duplicate".

3. Shënimi i referuar në paragrafin 2 vendoset në kutinë “Vërejtje” të dublikatës së certifikatës së qarkullimit të mallrave EUR.1.

4. Dublikata e cila duhet të përmbajë edhe datën e lëshimit të certifikatës origjinale të qarkullimit të mallrave EUR, hyn në fuqi që nga kjo datë.

Neni 20

Lëshimi i certifikatës së qarkullimit të mallrave EUR.1 mbi bazën e vërtetimit të origjinës, të lëshuar apo bërë më parë

Kur produktet origjinuese vihen nën kontrollin e një zyre doganore në Shqipëri ose Turqi, është i mundur zëvendësimi i vërtetimit origjinal të origjinës me një apo më shumë certifikata të qarkullimit të mallrave EUR.1 për qëllime të dërgimit të të gjitha ose disa nga këto produkte diku tjetër brenda Shqipërisë ose Turqisë. Certifikata(t) zëvendësuese të qarkullimit të mallrave EUR.1 lëshohet nga zyra doganore nën kontrollin e së cilës janë vendosur këto produkte.

Neni 21

Segregacioni i llogaritur

1. Kur ka kosto të konsiderueshme dhe vështirësi materiale për të mbajtur të ndarë sasi të materialeve origjinuese prej atyre joorigjinuese, të cilat janë identike dhe të ndërkyembyeshme, autoritetet doganore, mbështetur në kërkesën me shkrim të personave të interesuar, mund të autorizojnë përdorimin e metodës së ashtuquajtur “segregacioni i llogaritur” për administrimin e këtyre sasive.

2. Kjo metodë duhet të garantojë, për një periudhë kohore specifike, që numri i produkteve të përfutur që mund të konsiderohen “origjinues” është i njëjtë me numrin që do të ishte përfutur po të ishte bërë segregacioni fizik i sasive.

3. Autoritetet doganore mund ta japin këtë lloj autorizimi, kundrejt çfarëdo kushtesh që gjykohen të përshtatshme prej tyre.

4. Kjo metodë regjistrohet dhe zbatohet në bazë të parimeve të përgjithshme të kontabilitetit që zbatohen në vendin ku produkti është prodhuar.

5. Përfutuesi i kësaj procedure mund të lëshojë ose të aplikojë për dëshmi origjine, siç mund të jetë rasti, për sasinë e produkteve që mund të konsiderohen origjinuese. Me kërkesë të autoriteteve doganore, përfutuesi dorëzon një deklaratë që përshkruan se si janë menaxhuar sasi të.

6. Autoritetet doganore monitorojnë se si përdoret autorizimi dhe mund ta tërheqin atë kurdo kur përfituesi e përdor autorizimin në çfarëdo mënyre të parregullt, ose kur nuk arrin të përmbushë të gjitha kushtet e përcaktuara në këtë protokoll.

Neni 22

Kushtet për bërjen e një deklarate faturë

1. Një deklaratë faturë, siç referohet në nenin 16(1)(b), mund të bëhet:

a) nga një eksportues i aprovuar në kuptimin e nenit 23; ose

b) nga një eksportues i ndonjë dërgese të përbërë nga një ose më shumë paketime që përmbajnë produkte origjinuese, vlera totale e të cilave nuk i kalon 6 000 euro.

2. Një deklaratë faturë mund të bëhet nëse produktet në fjalë konsiderohen si produkte origjinuese në Shqipëri, në Turqi ose në një prej vendeve apo territoreve të tjera të referuara në nenet 3 dhe 4 dhe kur përmbushen të gjitha kërkesat e tjera të këtij protokoll.

3. Eksportuesi që bën një deklaratë faturë duhet të përgatitet të paraqesë në çdo kohë, me kërkesën e autoriteteve doganore të vendit eksportues, të gjitha dokumentet e nevojshme që provojnë statusin origjinues të produkteve në fjalë, si dhe plotësimin e kërkesave të tjera të këtij protokoll.

4. Një deklaratë faturë duhet të bëhet nga eksportuesi duke shtypur, stampuar ose printuar mbi faturën, dëftesën e dërgesës ose ndonjë dokument tjetër tregtar, teksti i së cilës jepet në aneksin IV, duke përdorur një nga versionet gjuhësore të përcaktuara në atë aneks dhe në përputhje me dispozitat e ligjit vendas të vendit eksportues. Nëse deklarata është e shkruar me dorë, duhet të shkruhet me bojë në germa kapitale.

5. Deklaratat faturë duhet të kenë firmën origjinale të eksportuesit të shkruar me dorë. Sidoqoftë, një eksportuesi të aprovuar sipas kuptimit të nenit 23, nuk do t'i kërkohej të nënshkruajë deklarata të tilla me kusht që t'i paraqesë autoriteteve doganore të vendit eksportues një deklaratë me shkrim ku merr përsipër me përgjegjësi të plotë për çfarëdo deklarate faturë, e cila e identifikon atë njësoj si të ishte nënshkruar me shkrim dore prej tij.

6. Një deklaratë faturë mund të bëhet nga eksportuesi kur produktet të cilave ajo u referohet eksportohen, ose mbas eksportimit me kusht që ajo të jetë paraqitur në vendin importues jo më vonë se dy vjet mbas importimit të produkteve të cilave ajo u referohet.

Neni 23

Eksportuesi i aprovuar

1. Autoritetet doganore të vendit eksportues mund të autorizojnë çdo eksportues, këtu e më pas të referuar si “eksportuesi i aprovuar”, që bën dërgesa të shpeshta të mallrave sipas kësaj Marrëveshjeje, të bëjë deklarata faturë pavarësisht nga vlera e produkteve në fjalë. Një eksportues që kërkon një autorizim të tillë, duhet të paraqesë, sipas kërkesave të autoriteteve doganore, të gjitha garancitë e nevojshme për të vërtetuar statusin origjinues të produkteve, si dhe plotësimin e kërkesave të tjera të këtij protokolli.
2. Autoritetet doganore mund të japin statusin e eksportuesit të aprovuar kundrejt çfarëdo kushtesh që gjykohen të përshtatshme prej tyre.
3. Autoritetet doganore i japin eksportuesit të aprovuar një numër autorizimi doganor, i cili duhet të shfaqet në deklaratën faturë.
4. Autoritetet doganore monitorojnë përdorimin e autorizimeve nga ana e eksportuesit të aprovuar.
5. Autoritetet doganore mund të tërheqin autorizimin në çdo kohë. Ata mund ta bëjnë këtë kur eksportuesi i aprovuar nuk ofron më garancitë referuar në paragrafin 1, si dhe nuk përmbush më kërkesat referuar paragrafit 2 ose kur kryen përdorim jokorrekt të autorizimit.

Neni 24

Vlefshmëria e vërtetimit të origjinës

1. Dëshmia e origjinës është e vlefshme për katër muaj nga data e lëshimit në vendin eksportues dhe duhet depozituar brenda kësaj periudhe tek autoritetet doganore të vendit importues.
2. Dëshmitë e origjinës të cilat depozitohen pranë autoriteteve doganore të vendit importues pas datës së fundit për paraqitje, e specifikuar në paragrafin 1, mund të pranohen nisur nga aplikimi i trajtimit preferencial, kur pamundësia për depozitimin e këtyre dokumenteve deri në datën përfundimtare është shkaktuar nga rrethana të jashtëzakonshme.
3. Në rastet e tjera të depozitimeve mjaft të vonuara, autoritetet doganore të vendit importues mund ta pranojnë vërtetimin e origjinës kur produktet janë depozituar përpara datës përfundimtare.

Neni 25

Paraqitja e vërtetimit të origjinës

Vërtetimi i origjinës duhet të paraqitet pranë autoriteteve doganore të vendit importues në përputhje të plotë me procedurat që zbatohen në atë vend. Këto autoritete mund të kërkojnë një përkthim të vërtetimit të origjinës dhe gjithashtu mund të kërkojnë deklaratën e importit që duhet t'i bashkëngjitet një deklarami nga importuesi që vërteton se produktet plotësojnë kushtet e kërkuara për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 26

Importimet me dërgesë të parë

Kur, me kërkesën e importuesit dhe me kushtet e parashtruara nga autoritetet doganore të vendit importues, produktet e ndara ose jo të grupuara në kuptimin e rregullit të përgjithshëm 2(a) të sistemit të harmonizuar, që janë në seksionet XVI dhe XVII apo në krerët nr.7308 dhe 9406, janë importuar me dërgesë të parë, një vërtetim i origjinës për produkte të tilla duhet të paraqitet pranë autoriteteve doganore gjatë importimit të dërgesës së parë.

Neni 27

Përfshirjet nga vërtetimi i origjinës

1. Produktet e dërguara në paketime të vogla nga persona privatë te personat privatë ose që janë pjesë e bagazheve personale të udhëtarëve, pranohen si produkte origjinuese pa qenë nevoja për të paraqitur vërtetimin e origjinës, nëse sigurohet se këto produkte nuk janë importuar për qëllime tregtie dhe janë deklaruar se plotësojnë kërkesat e këtij protokollit dhe kur nuk ka dyshime rreth vërtetësisë së një deklarimi të tillë. Në rastin e produkteve të dërguara me postë, kjo deklaratë mund të bëhet në deklarin doganor CN22/CN23 ose në një fletë të veçantë letre që i bashkëngjitet atij dokumenti.
2. Importet të cilat janë të rastësishme dhe përbëjnë vetëm produkte për përdorim personal nga marrësi ose udhëtari, ose familjarët e tyre, nuk konsiderohen si importe për qëllime tregtie kur nisur nga pikëpamja e natyrës dhe sasisë së produkteve është evidente që nuk ka qëllime tregtie për to.
3. Për më tepër, vlera totale e këtyre produkteve nuk duhet të tejkalojë 500 euro në rastin e pakove të vogla ose 1200 euro në rastin e produkteve që janë pjesë e bagazheve personale të udhëtarëve.

Neni 28

Dokumentet mbështetëse

Dokumentet referuar në nenet 17(3) dhe 22(3), që përdoren për qëllime vërtetimi se produktet e shoqëruara me një certifikatë qarkullimi mallrash EUR.1 ose një deklaratë faturë, mund të konsiderohen si produkte origjinuese në Shqipëri, në Turqi ose në një prej vendeve apo territoreve të tjera referuar në nenet 3 dhe 4 dhe që plotësojnë të gjitha kërkesat e tjera të këtij protokollit, mund të jenë si më poshtë:

- a) provë e drejtpërdrejtë e proceseve të kryera nga eksportuesi ose furnizuesi për të përfunduar produktet në fjalë, që mbahen për shembull në llogaritë ose në librat e kontabilitetit të tij të brendshëm;
- b) dokumentet që vërtetojnë statusin e origjinës së materialeve të përdorura, të lëshuara ose të bëra në Shqipëri ose në Turqi, ku këto dokumente përdoren në përputhje me ligjin vendas;
- c) dokumentet që vërtetojnë punimet ose përpunimet e materialeve në Shqipëri ose në Turqi, të lëshuara ose të bëra në Shqipëri ose në Turqi, ku këto dokumente përdoren në përputhje me ligjin vendas;
- d) certifikata të qarkullimit të mallrave EUR.1 ose deklarata faturë që vërtetojnë statusin e origjinës së materialeve të përdorura, të lëshuara ose të bëra në Shqipëri ose në Turqi në përputhje me këtë protokoll ose në një prej vendeve apo territoreve të tjera të referuara në nenet 3 dhe 4, në përputhje me rregullat e origjinës që janë identike me rregullat e këtij protokollit.
- e) prova të përshtatshme në lidhje me punimet apo përpunimet jashtë Shqipërisë apo Turqisë me anë të aplikimit të nenit 12, që vërteton se janë përmbushur kërkesat e atij neni.

Neni 29

Ruajtja e vërtetimit të origjinës dhe e dokumenteve mbështetëse

1. Eksportuesi që aplikon për lëshimin e një certifikate qarkullimi mallrash EUR.1 duhet t'i mbajë dokumentet referuar në nenin 17 (3) për të paktën tre vjet.
2. Eksportuesi që bën një deklaratë faturë duhet të mbajë për të paktën tre vjet një kopje të kësaj deklarate faturë, si dhe dokumentet referuara në nenin 22(3).
3. Autoritetet doganore të vendit eksportues që lëshojnë një certifikatë qarkullimi mallrash EUR.1 duhet të mbajnë për të paktën tre vjet formularin e aplikimit referuar në nenin 17(2).

4. Autoritetet doganore të vendit importues duhet të mbajnë për të paktën tre vjet certifikatat e qarkullimit të mallrave eur.1, si dhe deklaratat faturë që iu dorëzohen atyre.

Neni 30

Mospërputhjet dhe gabimet formale

1. Në rast se gjenden mospërputhje të vogla në deklarimet e bëra në vërtetimin e origjinës dhe ato të bëra në dokumentet e paraqitura në zyrën doganore për qëllime të kryerjes së formaliteteve për importimin e produkteve, kjo nuk e bën të pavlefshme vërtetimin e origjinës nëse është evidentuar se ky dokument i korrespondon produkteve të paraqitura.

2. Gabimet formale të dukshme të tilla si gabime gjatë shtypjes në vërtetimin e origjinës nuk do të bëhen shkas që ky dokument të anulohet, nëse këto gabime nuk janë të tilla që të krijojnë dyshime në lidhje me korrektësinë e deklarimit të bërë në atë dokument.

Neni 31

Shumat e shprehura në euro

1. Në zbatim të dispozitave të nenit 22(1)(b) dhe nenit 27(3) në rastet kur produktet faturohen në një monedhë tjetër nga euro, shumat në monedhën kombëtare të Shqipërisë, të Turqisë, ose të një prej vendeve apo territoreve të tjera referuar në nenet 3 dhe 4, ekuivalente me shumat e shprehura në euro, duhet të vendosen çdo vit nga secili vend i interesuar.

2. Një dërgesë malli përfiton nga dispozitat e nenit 22(1)(b) ose nenit 27(3), duke iu referuar monedhës në të cilën është përgatitur fatura, sipas shumës së vendosur nga vendet e interesuara.

3. Shumat në çfarëdo monedhe kombëtare duhet të jenë të barabarta me shumat e shprehura në euro që në ditën e parë të punës së muajit tetor. Palët duhet t'i komunikojnë njëra-tjetrës deri më 15 tetor dhe ato do ta zbatojnë që nga 1 janari i vitit pasues.

4. Një vend mund të rumbullakosë më lart ose më poshtë shumën që rezulton nga konvertimi në monedhën e vet kombëtare i një shume të shprehur në euro. Sasia e rumbullakosur nuk duhet të ndryshojë me më shumë se 5% nga sasia e rezultuar prej konvertimit. Një vend mund të mbajë të pandryshuar ekuivalentin e monedhës së vet kombëtare të një shume të shprehur në euro, në rast se gjatë kohës së rregullimeve vjetore sipas paragrafit 3, konvertimi i kësaj shume përpara rumbullakosjes rezulton me një rritje më pak se 15% në ekuivalentin e monedhës kombëtare.

Ekuivalenti i monedhës kombëtare mund të mbahet i pandryshuar në rast se konvertimi do të rezultonte në një pakësim në këtë vlerë ekuivalente.

5. Shumat e shprehura në euro rishikohen nga Komiteti i Përbashkët me kërkesë të Shqipërisë ose Turqisë. Gjatë kryerjes së këtij rishikimi, Komiteti i Përbashkët duhet të marrë parasysh dëshirën për t'u mbrojtur nga pasojat e efekteve të kufizimeve në terma realë. Për këtë qëllim, ai mund të vendosë për të modifikuar shumat e shprehura në euro.

TITULLI VI

RREGULLIMET PËR BASHKËPUNIMIN ADMINISTRATIV

Neni 32

Bashkëpunimi i ndërsjellë

1. Autoritetet doganore të Shqipërisë dhe Turqisë i sigurojnë njëra-tjetrës, nëpërmjet organeve kompetente doganore me kopje të llojit të vulave të përdorura në zyrat e tyre doganore për lëshimin e certifikatave të qarkullimit të mallrave eur.1 dhe adresat e autoriteteve doganore përgjegjëse për verifikimin e këtyre certifikatave dhe deklaratave faturë.

2. Me qëllim aplikimin e duhur të këtij protokoli, Shqipëria dhe Turqia duhet ta ndihmojnë njëra-tjetrën, nëpërmjet administratave doganore kompetente, në kontrollin e origjinalitetit të certifikatave të qarkullimit të mallrave eur.1 ose të deklaratave faturë, si dhe korrektësinë e informacionit të dhënë në këto dokumente.

Neni 33

Verifikimi i vërtetimeve të origjinës

1. Verifikimet e duhura të vërtetimeve të origjinës duhet të kryhen me metodën e zgjedhjes së rastësishme ose sa herë që autoritetet doganore të vendit importues kanë dyshime të arsyeshme për origjinalitetin e dokumenteve të tilla, për statusin e origjinës së produkteve përkatëse ose për përmbushjen e kërkesave të tjera të këtij protokoli.

2. Për qëllimet e zbatimit të dispozitave të paragrafit 1, autoritetet doganore të vendit importues duhet t'ia kthejnë certifikatën e qarkullimit të mallrave EUR.1 si dhe deklaratën faturë, në rast se është paraqitur ose një kopje të këtyre dokumenteve, autoriteteve doganore të vendit eksportues, duke u dhënë, atëherë kur është e nevojshme, arsyet për verifikimin. Çdo

dokument dhe informacion i marrë, i cili sugjeron se informacioni i dhënë mbi vërtetimin e origjinës është jokorrekt, duhet t'i bashkëngjitet kërkesës për verifikim.

3. Verifikimi kryhet nga autoritetet doganore të vendit eksportues. Për këtë qëllim, ato kanë të drejtë të kërkojnë çfarëdo dokumenti dhe të kryejnë çfarëdo inspektimi të llogarive të eksportuesit ose çdo lloj kontrolli që konsiderohet i nevojshëm.

4. Në rast se autoritetet doganore të vendit importues vendosin ta pezullojnë përkohësisht dhënien e trajtimit preferencial për produktet përkatëse, ndërkohë që presin rezultatet e verifikimit, importuesit duhet t'i ofrohet mundësia për të mos i bllokuar produktet, vetëm në rastet e marrjes së ndonjë mase sigurie, kur gjykohet e nevojshme.

5. Autoritetet doganore që kërkojnë verifikimin duhet të informohen për rezultatet e këtij verifikimi sa më shpejt të jetë e mundur. Këto rezultate duhet të tregojnë qartë nëse dokumentet janë origjinale dhe nëse produktet përkatëse mund të konsiderohen si produkte origjinuese në Shqipëri, në Turqi apo në ndonjë vend apo territor tjetër referuar në nenet 3 dhe 4 dhe që plotësojnë kërkesat e tjera të këtij protokollit.

6. Në rast se për një dyshim të arsyeshëm, nuk vjen përgjigje brenda dhjetë muajve nga data e kërkesës së verifikimit, ose në qoftë se përgjigja nuk përmban informacion të mjaftueshëm për të përcaktuar origjinalitetin e dokumentit në fjalë ose origjinën e vërtetë të produkteve, autoritetet doganore kërkuese të verifikimit, me përjashtim të rrethanave të jashtëzakonshme, refuzojnë dhënien e trajtimit preferencial.

Neni 34

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Kur ka mosmarrëveshje lidhur me procedurat verifikuese të nenit 33, të cilat nuk mund të zgjidhen mes autoriteteve doganore që kërkojnë verifikimin dhe autoriteteve doganore përgjegjëse për kryerjen e këtij verifikimi, ose kur ato ngrenë një çështje lidhur me interpretimin e këtij protokollit, këto mosmarrëveshje duhet t'i paraqiten Komitetit të Përbashkët.

Në të gjitha rastet, zgjidhjet e mosmarrëveshjeve ndërmjet importuesit dhe autoriteteve doganore të vendit importues bëhet në bazë të legjislacionin të vendit importues.

Neni 35

Gjobat

Gjobat do të vendosen për çdo person që plotëson ose shkakton plotësimin e një dokumenti që përmban informacion jokorrekt, me qëllimin për të përfituar trajtim preferencial për produktet.

Neni 36

Zonat e lira

1. Shqipëria dhe Turqia marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që produktet e tregtuara që janë objekt i vërtetimit të origjinës, të cilat gjatë transportit përdorin një zonë të lirë që është në territorin e tyre, të mos zëvendësohen nga mallra të tjera dhe të mos pësojnë trajtim tjetër veç veprimeve normale që parandalojnë përkeqësimin e gjendjes së mallrave.

2. Në kuptimin e një përjashtimi nga dispozitat që përmban paragrafi 1, kur produktet origjinuese në Shqipëri ose Turqi, importohen në një zonë të lirë me një dëshmi origjine dhe pësojnë trajtim ose përpunim, autoritetet përkatëse duhet të lëshojnë një certifikate të re EUR.1 me kërkesë të eksportuesit, në rast se trajtimi dhe përpunimi i pësuar është në përputhje me dispozitat e këtij protokollit.

TITULLI VII

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 37

Amendimet e protokollit

Komiteti i Përbashkët mund të vendosë të ndryshojë dispozitat e këtij protokollit.

ANEKSI I

SHËNIME PREZANTUESE PËR LISTËN NË ANEKSIN II

Shënimi 1

Lista vendos kushtet e kërkuara për të gjitha produktet që të konsiderohen si të punuara ose përpunuara mjaftueshëm brenda kuptimit të nenit 6 të këtij protokollit.

Shënimi 2

2.1 Dy kolonat e para në listë përshkruajnë produktin e përftuar. Kolona e parë jep numrin e kreut ose numrin e kapitullit, të përdorur në sistemin e harmonizuar dhe kolona e dytë jep përshkrimin e mallrave të përdorura në atë sistem për atë kre apo kapitull. Për secilën hyrje në dy kolonat e para, specifikohet një rregull në kolonën 3 ose 4. Kur, në disa raste, hyrja në

kolonën e parë parapritet nga një “ex” kjo nënkupton se rregullat në kolonën 3 ose 4 zbatohen vetëm për pjesën e atij kreu, sikurse është përshkruar në kolonën 2.

2.2 Kur shumë numra krerësh grupohen së bashku në kolonën 1 ose një numër kapitulli jepet dhe përshkrimi i produkteve në kolonën 2 prej këtej jepet në terma të përgjithshëm, rregullat e afërta në kolonën 3 ose 4 zbatohen për të gjitha produktet, të cilat nën sistemin e harmonizuar klasifikohen në krerë të kapitullit ose në çfarëdo kre të grupuar së bashku në kolonën 1.

2.3 Kur rregulla të ndryshme në listë zbatohen për produkte të ndryshme brenda një kreu, secila pikë përmban përshkrimin e asaj pjese të kreut të mbuluar nga rregullat e afërta në kolonën 3 ose 4.

2.4 Kur për një hyrje në dy kolonat e para, një rregull specifikohet në të dy kolonat 3 dhe 4, eksportuesi mund të zgjedhë vetë se cilën alternativë të aplikojë: rregullin e vendosur në kolonën 3 ose atë të vendosur në kolonën 4. Në rast se nuk jepet ndonjë rregull origjine në kolonën 4, duhet të zbatohet rregulli i vendosur në kolonën 3.

Shënimi 3

3.1 Duhet të zbatohen dispozitat e nenit 6 të protokollit, përsa i përket produkteve që kanë marrë statusin origjinues dhe të cilat janë përdorur në prodhimin e produkteve të tjera pavarësisht nëse ky status është marrë brenda në fabrikën ku këto produkte po përdoren ose në një tjetër fabrikë në njërin nga palët kontraktuese.

Shembull:

Një motor i kreut 8407 për të cilin rregulli thotë se vlera e materialeve joorigjinuese të cilat mund të përfshihen në të nuk duhet të kalojë 40% të çmimit *ex-works*, është bërë nga “Aliazh tjetër prej çeliku i formatuar për kudhër” të kreut ex 7224.

Në rast se temperimi është bërë në Shqipëri nga një lingotë joorigjinuese, ky çelik ka marrë tashmë statusin origjinues sipas rregullit për kreun ex 7224 në listë. Temperimi mund të llogaritet atëherë si origjinues në llogaritjen e vlerës së motorit, pavarësisht nëse çeliku u prodhua në të njëjtën fabrikë apo në një tjetër fabrikë në Shqipëri. Vlera e lingotës joorigjinuese në këtë mënyrë nuk merret parasysh kur mbledhet vlera e materialeve joorigjinuese të përdorura..

3.2 Rregulli në listë përfaqëson sasinë minimale të kërkuar të punimit ose të përpunimit, si dhe kryerja e më shumë punimi apo përpunimi, gjithashtu i jep statusin origjinues; në të kundërt, kryerja e më pak punimi apo përpunimi, nuk mund t’i japë statusin origjinues. Kështu, në rast se një rregull thotë se një material joorigjinues, në një nivel të dhënë të prodhimit mund të përdoret, atëherë përdorimi i këtij materiali në një stad të hershëm të prodhimit lejohet dhe përdorimi i tij në një stad të mëvonshëm nuk lejohet.

3.3 Pa cenuar shënimin 3.2, kur një rregull shprehet kështu: “Prodhime prej materialeve të çfarëdo kreu”, atëherë mund të përdoren materialet e cilitdo kre (madje edhe materiale të të njëjtit përshkrim dhe në të njëjtin kre me produktin), por që sidoqoftë i nënshtrohen ndonjë kufizimi specifik, i cili gjithashtu mund të përmbahet në rregull.

Megjithatë, shprehja “Prodhime prej materialeve të çfarëdo kreu, përfshi ato të kreut...” ose "Prodhime prej materialeve të çfarëdo kreu, përfshi materiale të tjera të të njëjtit kre me produktin" do të thotë që materialet e cilitdo kre mund të përdoren, përveç atyre me të njëjtin përshkrim si produkti siç jepet në kolonën 2 të listës.

3.4. Kur një rregull në listë specifikon se një produkt mund të prodhohet nga më shumë se një material, kjo do të thotë që një ose më shumë materiale mund të përdoren; pra, nuk kërkon që të gjitha materialet të përdoren.

Shembull:

Rregulli për pëlhurat e krerëve 5208 deri 5212 parashikon që fibrat natyrale mund të përdoren, po ashtu edhe materialet kimike, midis materialeve të tjera, mund të përdoren. Kjo nuk do të thotë që të dy duhet të përdoren; mjafton të përdoren njëri apo tjetri, ose që të dy.

3.5. Kur një rregull në listë specifikon se një produkt duhet të prodhohet nga një material i veçantë, ky kusht natyrisht nuk parandalon përdorimin e materialeve të tjera, të cilat për shkak të natyrës së tyre, nuk mund të përmbushin rregullin. (Shiko gjithashtu shënimin 6.2 më poshtë në lidhje me tekstilet).

Shembull:

Rregulli për ushqimet e përgatitura të kreut 1904, i cili në mënyrë specifike përjashton përdorimin e drithërave dhe derivateve të tyre, nuk parandalon përdorimin e kripërave minerale, e kimikateve dhe shtesave të tjera, të cilat nuk janë prodhime nga drithërat.

Megjithatë, kjo nuk zbatohet te produktet të cilat edhe pse nuk mund të prodhohen nga materiale të veçanta të specifikuara në listë, mund të prodhohen nga një material i së njëjtës natyrë në një stad më të hershëm të prodhimit.

Shembull:

Në rastin e një artikulli veshjeje të ex kapitullit 62, i përbërë nga materiale jo të thurura, nëse përdorimi i vetëm një filli joorigjinues lejohet për këtë lloj artikulli, nuk është e mundur të fillosh nga copë jo e thurur - edhe nëse copat jo të thurura normalisht nuk mund të bëhen prej filli.

Në raste të tilla, materiali fillestar duhet të jetë në një stad përpara të qenit fill, pra në gjendjen fibër.

3.6. Kur në një rregull në listë jepen dy përqindje për vlerën maksimale të materialeve joorigjinuese, atëherë këto përqindje nuk mund të mbliidhen bashkë. E thënë ndryshe, vlera maksimale e të gjitha materialeve joorigjinuese të përdorura nuk mund të kalojë përqindjen më të lartë. Për më tepër, nuk duhet të tejkalohen as përqindjet përkatëse për materialet të cilave u zbatohen.

Shënimi 4

4.1 Termi "fibra natyrale" përdoret në listë për t'iu referuar fibrave të tjera nga ato artificiale ose sintetike. Kufizohet për statet përpara se të ndodhë tjerja, duke përfshirë mbetjet dhe, nëse nuk specifikohet ndryshe, përfshin fibrat të cilat janë përdredhur, krehur ose përpunuar ndryshe, por që nuk janë tjerë.

4.2 Termi "fibra natyrale" përfshin qimen e kalit të kreut nr.0503, mëndafshin e krerëve nr. 5002 dhe nr.5003, po ashtu si dhe fibrat e leshit dhe qime të imët ose të ashpër kafshe të krerëve nr. 5101 deri nr.5105, fibra pambuku të krerëve nr. 5201 deri nr. 5203, si dhe fibra të tjera vegjetale të krerëve nr. 5301 deri nr. 5305.

4.3 Termet "pulpë tekstili", "materiale kimike" dhe "materiale për prodhim letre" përdoren në listë për të përshkruar materialet, e paklasifikuara, në kapitujt 50 deri 63, të cilat mund të përdoren për të prodhuar fibra ose fije artificiale, sintetike ose letre.

4.4 Termi "fibra kryesore të bëra nga njerëzit" përdoret në listë për t'iu referuar filamenteve sintetike apo artificiale, fibrave kryesore apo mbetjeve, të krerëve 5501 deri 5507.

Shënimi 5

5.1 Kur për një produkt të dhënë në listë merret për referencë ky shënim, kushtet e vendosura në kolonën 3 nuk zbatohen për materiale me bazë tekstili të përdorur në prodhimin e këtij produkti dhe të cilat, të marra së bashku, përfaqësojnë 10% ose më pak të peshës së përgjithshme të të gjitha materialeve tekstile bazë të përdorura. (Shiko edhe shënimet 5.3 dhe 5.4 me poshtë.).

5.2 Megjithatë, toleranca e përmendur në shënimin 5.1 mund të zbatohet vetëm te produktet e përziera, të cilat janë bërë nga dy ose më shumë materiale tekstile bazë.

Materialet tekstile bazë jepen si më poshtë:

- mëndafshi,
- leshi,
- qime e ashpër kafshe,
- qime e hollë kafshe,
- qime kali,
- pambuku,
- materialet për prodhim letre dhe letra,
- liri,
- kërp i pastër,
- jute dhe fibra të tjera tekstili,
- sizal dhe fibra të tjera të gjinisë agave,

- fibra nga arra kokosi, abaka, ramie dhe fibra të tjera vegjetale tekstile,
- filamente sintetike të bëra nga njerëzit,
- filamente artificiale të bëra nga njerëzit,
- filamente përcjellëse rryme,
- fibra kryesore sintetike prej polipropileni të bëra nga njerëzit,
- fibra kryesore sintetike prej poliesteri të bëra nga njerëzit,
- fibra kryesore sintetike prej poliamidi të bëra nga njerëzit,
- fibra kryesore sintetike prej poliakrilonitrili të bëra nga njerëzit,
- fibra kryesore sintetike prej poliamidi të bëra nga njerëzit,
- fibra kryesore sintetike prej politetrafluoroetileni të bëra nga njerëzit,
- fibra kryesore sintetike prej poli(fenileni sulfiti) të bëra nga njerëzit,
- fibra kryesore sintetike prej poli(vinil kloridi) të bëra nga njerëzit,
- fibra të tjera kryesore sintetike të bëra nga njerëzit,
- fibra kryesore artificiale prej viskoze, të bëra nga njerëzit,
- fibra të tjera kryesore artificiale të bëra nga njerëzit,
- fill i bërë nga poliuretani, i segmentuar me segmente fleksibël prej polieteri, i përdredhur ose jo,
- fill i bërë nga poliuretani, i segmentuar me segmente fleksibël prej poliesteri, i përdredhur ose jo,
- produkte të kreut nr.5605 (fill i metalizuar), që përmban një shirit të përbërë prej shtrese alumini ose një mbulese prej filmi plastik, mbuluar ose jo prej pluhuri alumini, me gjerësi jo më shumë se 5 mm, i palosur nëpërmjet një ngjitësi me ngjyra ndërmjet dy shtresave të një filmi plastik,
- Produkte të tjera të kreut 5605.

Shembull:

Një pëlhurë leshi e kreut 5112 e bërë prej fill leshi të kreut 5107 dhe prej filli sintetik të fibrave kryesore të kreut 5509, është pëlhurë e përzier. Kështu që filli sintetik që nuk përmbush rregullat e origjinës (të cilat kërkojnë që produkti të jetë prodhuar prej materialeve kimike ose prej pulpë tekstili), ose filli i leshit që nuk përmbush rregullat e origjinës (të cilat kërkojnë që produkti të jetë prodhuar prej fibrash natyrale, jo i krehur apo i gërhanuar apo i

përgatitur ndryshe për tjerje), ose mund të kombinohen të dyja me kusht që pesha e tyre e përgjithshme të mos kalojë 10 % të peshës së pëlhurës.

Shembull:

Pëlhurat tekstile me xhufka, të kreut 5802, të bëra prej filli pambuku të kreut 5205 dhe pëlhure pambuku të kreut 5210, është produkt i përzier vetëm nëse pëlhura e pambuktë është vetë pëlhurë e përzier e bërë nga fillet të klasifikuara në dy krerë të ndryshëm, ose nëse fillet e pambukut të përdorur janë vetë përzierje.

Shembull:

Nëse pëlhura tekstile me xhufka në fjalë është bërë nga fill pambuku i kreut 5205 dhe nga pëlhurë sintetike e kreut 5407, atëherë normalisht fillet e përdorura janë dy materiale tekstile bazë të ndryshme dhe rrjedhimisht pëlhura tekstile me xhufka është produkt i përzier.

5.3 Në rastin e produkteve që përfshijnë “fill të bërë nga poliuretani i segmentuar me segmente fleksibël të polieterit, të përdredhur ose jo”, kjo tolerancë është 20% në lidhje me këtë fill.

5.4 Në rastin e produkteve që përfshijnë “shirit të përbërë prej shtrese alumini ose një mbulose prej filmi plastik, mbuluar ose jo prej pluhuri alumini, me gjerësi jo më shumë se 5 mm, i palosur nëpërmjet një ngjitësi me ngjyra ndërmjet dy shtresave të një filmi plastik“, kjo tolerancë është 30% në lidhje me këtë shirit.

Shënimi 6

6.1 Kur në listë merret për referencë ky shënim, materialet tekstile (me përjashtim të linjave dhe interlinjave), të cilat nuk përmbushin rregullin e listës në kolonën 3 për produktet e përbëra, mund të përdoren me kusht që ato të jenë të klasifikuara në një kre të ndryshëm nga ai i produktit dhe që vlera e tyre të mos kalojë 8% të çmimit ex-works të produktit.

6.2 Pa cenuar shënimin 6.3, materialet të cilat nuk janë klasifikuar brenda kapitujve 50 deri 63, mund të përdoren lirshëm në prodhimin e produkteve tekstile, nëse përmbajnë apo jo tekstile.

Shembull:

Nëse një rregull në listë thotë që për një artikull të veçantë tekstili (të tillë si pantallonat) duhet përdorur fill, kjo nuk ndalon përdorimin e artikujve metalike të tilla, si butonat për arsye se butonat nuk janë të klasifikuar në kapitujt 50 deri 63. Për të njëjtën arsye, nuk ndalohet përdorimi i zinxhirëve, edhe pse zinxhirët normalisht përmbajnë tekstil.

6.3 Në rastet e aplikimit të rregullit të përqindjes, vlera e materialeve që nuk janë të klasifikuara brenda kapitujve 50 deri 63 duhet të merret parasysh kur llogaritet vlera e materialeve joorigjinuese të inkuorporuara në të.

Shënimi 7

7.1 Për qëllime të krerëve ex 2707, 2713 deri 2715, ex 2901, ex 2902 dhe ex 3403, “proceset specifike” quhen këto më poshtë:

- a) distilim në vakum;
- b) ridistilimi nëpërmjet një procesi fraksionues tejet tërësor;
- c) krekimi;
- d) riformimi;
- e) ekstraktimi me mënyrën e tretësve selektive;
- f) procesi që përbëhet nga të gjitha operacionet e mëposhtme : procesimi me acid sulfurik të përqendruar, oleum apo anhidrid sulfurik; neutralizimi me agjente alkaline; dekolorizimi dhe pastrimi me baltë aktive natyrale, baltë të aktivizuar, boksit apo qymyr të aktivizuar;
- g) polimerizimi;
- h) alkilizimi;
- i) izomerizimi.

7.2 Për qëllime të krerëve 2710, 2711 dhe 2712 “proceset specifike” quhen këto më poshtë:

- a) distilim në vakum;
- b) ridistilimi nëpërmjet një procesi fraksionues tejet tërësor;
- c) krekimi;
- d) riformimi;
- e) ekstraktimi me mënyrën e tretësve selektivë;
- f) procesi që përbëhet nga të gjitha operacionet e mëposhtme: përpunimi me acid sulfurik të përqendruar, oleum apo anhidrid sulfurik; neutralizimi me agjente alkaline; dekolorizimi dhe pastrimi me balte aktive natyrale, balte të aktivizuar, boksit apo qymyr të aktivizuar;
- g) polimerizimi;
- h) alkilizimi;
- i) izomerizimi;
- j) për sa i përket vetëm produkteve të kreut 2710, desulfurizimi me hidrogjen që rezulton në një reduktim të paktën 85 % të përmbajtjes së sulfurit në produktin e përpunuar (metoda ASTM D 1266-59 T);
- k) për sa i përket vetëm produkteve të kreut 2710, deparafinizimi nëpërmjet një procesi ndryshe nga filtrimi;

l) për sa i përket vetëm vajrave të rënda të kreut ex 2710, trajtimi me hidrogjen në një presion më shumë se 20 bar dhe një temperaturë prej më shumë se 250°C, me përdorimin e një katalizatori, ndryshe nga procesi që të ndikojë desulfurizimin, kur hidrogjeni përbën një element aktiv në një reaksion kimik. Trajtimi i mëtejshëm me hidrogjen i vajrave lubrifikante të kreut 2710, (p.sh. hidropërfundim apo dekolozim) me qëllim që, me specifikisht, të përmirësojë ngjyrën apo stabilitetin, megjithatë nuk do të konsiderohen sikur janë një proces specifik;

m) për sa i përket vetëm vajrave të karburanteve të kreut ex 2710, distilimi atmosferik, me kusht që më pak se 30% e këtyre produkteve të distilohet, ndaj volumit, duke përfshirë humbjet, në 300 °C, nëpërmjet metodës ASTM D 86;

n) për sa i përket vetëm vajrave të rënda të ndryshme nga vajrat e gazrave apo të karburanteve të kreut ex 2710, trajtimi me anë të një furçe shkarkimi elektrike me frekuencë të lartë;

o) për sa i përket vetëm produkteve të papërpunuara bruto (të ndryshme nga xhelatina e naftës, ozokeriti, dyllë linjiti ose dylli torfe, dyllë parafine që përmbajnë ndaj peshës më pak se 0.75% vaj) vetëm të kreut ex 2712, të zhvajosura nëpërmjet kristalizimit të fraksionuar.

7.3 Për qëllime të krerëve ex 2707, 2713 deri 2715, ex 2901, ex 2902 dhe ex 3403, nuk japin statusin e origjinës operacionet e thjeshta, si: pastrimi, kullimi, shkripëzimi, heqja e ujit, filtrimi, ngjyrosja, shënimi, përfitim i një përmbajtjeje sulfuri si rezultat i përzierjes së produkteve me përmbajtje të ndryshme sulfuri, ose çfarëdo kombinimi i këtyre operacioneve apo operacioneve të tjera të ngjashme.

ANEKSI III

KOPJA E CERTFIKATËS SË QARKULLIMIT TË MALLRAVE EUR.1 DHE APLIKIMI PËR NJË CERTIFIKATË LËVIZJEJE EUR.1 UDHËZIME PËR SHTYPJEN E FORMULARIT TË APLIKIMIT

Secili formular duhet të ketë përmasa 210 x 297 mm; janë të tolerueshme 5 mm më pak ose 8 mm më shumë në gjatësi. Letra e përdorur duhet të jetë e bardhë, e madhësisë për shkrim, të mos përmbajë material letre mekanik dhe pesha të mos jetë nën 25g/m². Duhet të ketë në sfond një model të shtypur në ngjyrë të gjelbër duke e bërë të dallueshme me sy çdo lloj falsifikimi me mjete kimike ose mekanike.

Autoritetet kompetente të palëve kontraktuese rezervojnë të drejtën për t'i shtypur vetë këta formularë ose mund të shtypen për ta nga printera të aprovuar. Në rastin e fundit, çdo formular duhet të përmbajë një referencë për një miratim të tillë. Secili formular duhet të mbajë emrin dhe adresën e printerit ose një shenjë dalluese me anë të së cilës printeri mund të identifikohet. Ajo duhet të ketë gjithashtu një numër serie, të shtypur ose jo, me anë të cilit mund të identifikohet.

CERTIFIKATA E QARKULLIMIT TË MALLRAVE

1. Eksportuesi (Emri, adresa e plotë, shteti)	EUR.1 Nr. A 000.000		
	Para se të plotësoni këtë formular, shikoni shënimet mbrapa.		
3. Marrësi i ngarkesës (Emri, adresa e plotë, shteti) (Fakultative)	2. Certifikata përdoret në tregtinë preferenciale ndërmjet		
	Dhe		
	(Vendosni shtetin përkatës, grupin e shteteve apo të territoreve)		
6. Detajet e transportimit (Fakultative)	4. Shteti, grupi i shteteve ose territori në të cilin produktet konsiderohen origjinuese	5. Shteti, grupi i shteteve ose territori i destinacionit	
	7. Vërejtje		
8. Numri i artikujve; Markat dhe numrat; Numri dhe lloji i paketimit (1); Përshkrimi i mallit	9. Pesha bruto (kg) ose njësi të tjera matëse (litra, m ³ ., etj.)	10. Faturat (Fakultative)	
11. NËNSHKRIM I DOGANËS Deklarate e vërtetuar Dokumenti i eksportimit (2) FormulariNr. Nga Zyra e doganës Shteti që bë lëshimin Vula Vendi dhe data (Firma)	12. DEKLARATË NGA EKSPORTUESI Unë, nënshkruesi, deklaroj se mallrat e përshkruara më sipër i përmbushin kushtet e kërkuara për lëshimin e kësaj certifikate. Vendi dhe data Firma)		
13. KËRKESË PËR VERIFIKIM, ndaj	14. REZULTATI I VERIFIKIMIT		
	Verifikimet e kryera treguan që kjo certifikatë (1) ishte lëshuar nga zyra doganore e përcaktuar dhe informacioni që përmbahej aty ishte i saktë. nuk plotëson kërkesat si vërtetësia dhe saktësia (shiko vërejtjet bashkëngjitur). (Vendi dhe data) Vula (Firma)		
Kërkohet verifikimi i vërtetësisë dhe saktësisë i kësaj certifikate. (Vendi dhe data) Vula (Firma)	(1) Vendosni X në kutinë përkatëse.		

(1) Nëse mallrat nuk janë të paketuara, tregoni numrin e artikujve apo gjendjen e mallit

(2) Plotësoni vetëm nëse kërkohet nga aktet normative të vendit eksportues apo territorit.

SHËNIME

1. Certifikata nuk duhet të përmbaje vende të fshira apo fjalë të shkruara njëra mbi tjetrën.

Çfarëdo modifikimi duhet të bëhet duke fshirë të dhënat e gabuara dhe duke shtuar çfarëdo korigjimi të nevojshëm. Çfarëdo modifikim i tillë duhet të siglohet nga personi, i cili e ka plotësuar certifikatën dhe të nënshkruhet nga autoritetet doganore të vendit që e ka lëshuar.

2. Nuk duhet të ketë asnjë hapësirë midis fjalive që shkruhen në certifikatë dhe çfarëdo pikë duhet të paraprihet nga një numër përkatës. Duhet të hiqet një vizë horizontale menjëherë poshtë fjalisë së fundit. Në çdo hapësirë të përdorur, duhet të hiqen viza të tjera në mënyrë të tillë që të jetë e pamundur të bëhen shtesa të tjera.

3. Mallrat duhet të përshkruhen në përputhje me praktikën tregtare dhe me detaje të mjaftueshme që të jetë i mundur identifikimi i tyre.

	EUR.1 Nr. A 000.000		
1. Eksportuesi (Emri, adresa e plotë, shteti)	Para se të plotësoni këtë formular, shikoni shënimet mbrapa.		
3. Marrësi i ngarkesës (Emri, adresa e plotë, shteti) (Fakultative)	2. Aplikim për certifikatë që të përdoret në tregtinë preferenciale ndërmjet dhe (Vendosni shtet e duhura ose grupin e shteteve apo territoreve)		
	4. Shteti, grupi i shteteve ose territori në të cilin produktet konsiderohen origjinuese	5. Shteti, grupi i shteteve ose territori i destinacionit	
6. Detajet e transportimit (Fakultative)	7. Vërejtje		
8. Numri i artikujve; Markat dhe numrat; Numri dhe lloji i paketimit (1) Përshkrimi i mallit	9. Masa bruto (kg) ose njësi të tjera matëse (litra, m ³ ., etj.)	10. Faturat (Fakultative)	

(1) Nëse mallrat nuk janë të paketuara, tregoni numrin e artikujve dhe gjendjen

DEKLARATA E EKSPORTUESIT

Unë, nënshkruesi, eksportues i mallrave të përshkruara në pjesën e pasme,

DEKLAROJ se mallrat plotësojnë kushtet e kërkuara për lëshimin e certifikatës bashkëngjitur;

SPECIFIKOJ si më poshtë rrethanat që mundësuan përmbushjen e kushteve të mësipërme për mallin:

.....
.....
.....
.....
.....
.....

DORËZOJ dokumentet mbështetëse si vijon (1):

.....
.....
.....
.....

MARR PËRSIPËR të dorëzoj, me kërkesë të autoriteteve përgjegjëse, çfarëdo vërtetimi mbështetës që kërkohet nga autoritetet për qëllime të lëshimit të certifikatës bashkëngjitur, dhe marr përsipër, nëse kërkohet, të pranoj çfarëdo inspektimi të llogarive të mia dhe çfarëdo kontrolli në procesin e prodhimit të mallrave të sipërpërmendura, të kryera nga autoritetet në fjalë;

KËRKOJ lëshimin e certifikatës bashkëngjitur për këto mallra.

.....

(Vendi dhe data)

.....

(Firma)

1 Për shembull: dokumentet e importit, certifikatat e qarkullimit, faturat, deklaratat e prodhues,ve etj., duke iu referuar produkteve të përdorur në prodhimin ose mallrave të eksportuese në të njëjtën gjendje.

ANEKSI IV

TEKSTI I DEKLARATËS FATURË

Deklarata faturë, teksti i të cilës është dhënë më poshtë, duhet të bëhet në përputhje me shënimet e bëra në fund. Megjithatë, nuk është e nevojshme që shënimet të riprodhohen.

Versioni shqip

Eksportuesi i produkteve të përfshira në këtë dokument (autorizim doganor Nr. ... (1)) deklaron që, përveç rasteve kur tregohet qartësisht ndryshe, këto produkte janë me origjinë preferenciale (2)

Versioni turqisht

İşbu belge (gümrük onay No: ... (1)) kapsamındaki maddelerin ihracatçısı aksi açıkça belirtilmedikçe, bu maddelerin ... menşeli ve tercihli (2) maddeler olduğunu beyan eder.

Versioni anglisht:

The exporter of the products covered by this document (customs authorization No ... (1)) declares that, except where otherwise clearly indicated, these products are of preferential origin (2).

.....3

(Vendi dhe data)

.....4

(Firma e eksportuesit, si edhe emri i personit që nënshkruan deklaratën duhet të paraqiten me germa shtypi të qarta)

Kodi HS	Përshkrimi
1704 90 99	Ëmbëlsira të tjera prej sheqerit, që nuk përmbajnë kakao
1806 10 30 1806 10 90	Çokolllatat dhe përgatitje të tjera ushqimore që përmbajnë kakao -pluhur kakao, që përmban sheqer apo lende të tjera embelsuese shtese: -- që përmbajnë sukroze 65% apo me shumë por me pak se 80% ndaj peshës (duke përfshirë sheqerin e konvertuar të shprehur si saharoze) apo izoglucoze të shprehur si saharoze -- që përmbajnë saharoze 80 % apo me shumë ndaj peshës (duke përfshirë sheqerin e konvertuar të shprehur si saharoze) apo izoglucoze të shprehur si saharoze
1806 20 95	- Përgatitje të tjera ushqimore që përmbajnë kakao në bllok, pllaka apo shufra që peshojnë me shumë se 2 kg ose në gjendje të lëngët, brumi, pluhuri apo të granular apo në formë të tjera në tufë, në kontejnerë apo në paketa të çastit, me një përmbajtje me tepër se 2 kg -- Te tjera --- Te tjera
1901 90 99	Ekstrakt malti; përgatitjet ushqimore prej miellit, kokrrizave, niseshtesë apo ekstraktit të maltit, që nuk përmbajnë kakao apo që përmbajnë kakao ndaj peshës me pak se 40 % të llogaritur mbi një bazë totalisht të c'nydyrosur, të paspecifikuara dhe të papërfshira diku tjetër, përgatitje ushqimore të mallrave të krerëve 0401 deri 0404, preparate ushqimore të mallrave të krerëve 0401 deri 0404, që nuk përmbajnë kakao apo që përmbajnë kakao ndaj peshës me pak se 5 % të llogaritur mbi një bazë totalisht të c'nydyrosur, të paspecifikuara apo të përfshira diku tjetër - Te tjera -- Te tjera (përveç ekstrakt malti) --- Te tjera
2101 12 98	Përgatitje të tjera me bazë kafeje.
2101 20 98	Përgatitje të tjera me bazë çaji apo kafeje.
2106 90 59	Përgatitje ushqimore të papërfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër - Te tjera -- Te tjera
2106 90 98	Përgatitje ushqimore të papërfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër: -Te tjera (përveç koncentrateve të proteinave dhe substancave proteinike të strukturuar) -- Te tjera --- Te tjera
3302 10 29	Përzierjet e substancave aromatike dhe përzierjet (përfshirë solucionet alkoolike) me bazë të një apo me shumë të këtyre substancave, të një lloji të përdorur si lende e pare në industri; preparatet e tjera të bazuara në substancat aromatike, të një lloji të përdorur në industrinë e pijeve: -Te një lloji të përdorur në industrinë ushqimore apo atë të pijeve -- Te një lloji të përdorur në industrinë e pijeve --- Preparatet që përmbajnë të gjithë agjentet aromatizues që karakterizojnë një pije: ---- Me një forcë alkoolike aktuale me shumë se 0,5% ndaj volumit ----Te tjera: ----Që nuk përmban yndyra të qumështit, saharoze, izoglucoze, glucoze apo niseshte apo që përmbajnë, ndaj peshës, me pak se 1,5 % yndyre qumështi, 5 % saharoze apo izoglucoze, 5% glucoze apo niseshte -----Te tjera

¹ Kur deklarata faturë bëhet nga eksportuesi i aprovuar, numri i autorizimit të eksportuesit të aprovuar duhet të përfshihet në këtë hapësirë. Kur deklarata faturë nuk është bërë nga një eksportues i aprovuar, fjalët në kllapa hiqen ose hapësira lihet bosh.

² Të tregohet origjina e produkteve. Kur deklarata faturë i përket tërësisht apo pjesërisht produkteve origjinuese në Ceuta dhe Mellila, eksportuesi duhet t'i përcaktojë qartë në dokumentin mbi të cilin bëhet deklarata me anë të simbolit "CM".

³ Këto të dhëna mund të mos vihen nëse informacionet gjenden në vetë dokumentin.

⁴ Në rastet kur nuk kërkohet firma e eksportuesit, përjashtimi nga firmosja gjithashtu nënkupton përjashtimin edhe të emrit të nënshkruesit.

ANEKSI V

PRODUKTET E PËRJASHTUARA NGA KUMULIMI QË JAPIN NENET 3 DHE 4

DEKLARATË E PËRBASHKËT

Palët do të bëjnë ndryshimet e nevojshme në protokollin II të rregullave të origjinës në përputhje me këtë protokoll të rregullave të origjinës në zbatim të masave të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë.

ANEKSI II

LISTA E OPERACIONEVE TË PUNIMIT OSE PROCESIVE QË KËRKOHEM T'IU NËNSHTROHEN MALLRAT JOORIGJINUESE, NË MËNYRË QË PRODUKTI PËRFUNDIMTAR TË PËRFITOJË STATUSIN E ORIGJINËS

Produktet e përfshira në këtë listë ndoshta jo të gjitha janë të mbuluara nga kjo Marrëveshje.

Kjo e bën të domosdoshme konsultimin me pjesët e tjera të Marrëveshjes.

Kreu HS	Përshkrimi i produktit	Punimi ose përpunimi i kryer mbi materialet jo-origjinuese, i cili u jep statusin e origjinës	
(1)	(2)	(3) ose (4)	
Kapitulli 1	Kafshët e gjalla	Të gjitha kafshët e kapitullit 1 të përdorura janë tërësisht origjinuese	
Kapitulli 2	Mishi dhe të brendshmet e ngrënshme të mishit	Prodhime në të cilat të gjitha materialet e Kapitujve 1 dhe 2 të përdorur janë tërësisht origjinuese	
Kapitulli 3	Peshku e kafshët guaskore të nënujshme, molusqet e kafshët e tjera jovertebrore ujore	Prodhime në të cilat të gjitha materialet e Kapitullit 3 të përdorur janë tërësisht origjinuese	
ex Kapitulli 4	Produktet bulmetore; vezët e zogjve; mjaltë natyral; produkte të ngrënshme me origjinë prej kafshëve, të papërfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër, përveç:	Prodhime në të cilat të gjitha materialet e Kapitullit 4 të përdorur janë tërësisht origjinuese	
0403	Dhallë, qumësht dhe krem i prerë, kos, kefir dhe qumësht dhe krem tjetër të fermentuara apo të acidifikuara, nëse janë apo jo të koncentruara apo që përmbajnë sheqer shtesë apo lende të tjera embelsuese apo lende aromatizuese apo që përmbajnë fruta, arra apo kakao shtesë	Prodhime në të cilat: - të gjitha materialet e Kapitullit 4 të përdorur janë tërësisht origjinuese, - Të gjitha lëngjet e frutave (përfshirë ato të ananasit, qitros ose greipfrutit) të kreut 2009 të përdorur janë origjinuese, dhe - vlera e çdo materiali të përdorur të Kapitullit 17 nuk kalon vlerën prej 30% të çmimit ex-works të produktit	
ex Kapitulli 5	Produktet me origjinë prej kafshëve, të papërfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër; përveç:	Prodhime në të cilat të gjitha materialet e Kapitullit 5 të përdorur janë tërësisht origjinuese	
ex 0502	Qimet dhe kreshtat e përgatitura të derrave të butë, derrave të egër dhe baldosave	Pastrimi, dezinfektimi, ndarja dhe drejtimi i qimeve dhe kreshtave	
Kapitulli 6	Pemët dhe bimët e tjera, të gjalla; zhardhokët, rrënjët dhe të ngjashmet me to; lulet e prera dhe gjetnajat zbukuruese	Prodhime në të cilat: - të gjitha materialet e Kapitullit 6 të përdorur janë tërësisht origjinuese, dhe - vlera e të gjitha materialeve të përdorura nuk kalon vlerën 50 % të çmimit "ex-works" të produktit	
Kapitulli 7	Zarzatet e ngrënshme dhe rrënjët dhe tuberët te caktuar	Prodhime në të cilat të gjitha materialet e Kapitullit 7 të përdorur janë tërësisht origjinuese	
Kreu HS	Përshkrimi i produktit	Punimi ose përpunimi i kryer mbi materialet jo-origjinuese, i cili u jep statusin e origjinës	
(1)	(2)	(3) ose (4)	
Kapitulli 8	Frutat dhe arrat e ngrënshme; lëkurat e agrumeve ose të pjeprave	Prodhime në të cilat: - të gjitha frutat dhe arrat të përdorur janë tërësisht origjinuese, dhe - vlera e të gjithë materialeve të Kapitullit 17 të përdorur nuk kalon vlerën prej 30%	

		të çmimit ex-works të produktit	
ex Kapitulli 9	Kafe, çaj, mate dhe erëza, përveç:	Prodime në të cilat të gjitha materialet e Kapitullit 9 të përdorur janë tërësisht origjinuese	
0901	Kafe, nëse është apo jo e pjekur apo e dekafeinizuar; lëvoret dhe lëkurat e kafesë; zëvendësuesit e kafesë që përmbajnë kafe në çdo porcion	Prodime prej materialeve të çfarëdo kreu	
0902	Çaj, nëse është apo jo i aromatizuar:	Prodime prej materialeve të çfarëdo kreu	
ex 0910	Përzierje të erëzave	Prodime prej materialeve të çfarëdo kreu	
Kapitulli 10	Drithërat	Prodime në të cilat të gjitha materialet e Kapitullit 10 të përdorur janë tërësisht origjinuese	
ex Kapitulli 11	Produktet e industrisë bluajtëse; malt; niseshtesë; insuline; gluteni i grurit, përveç:	Prodime në të cilat të gjitha drithërat, zarzavatet e ngrëshme, rrënjët e tuberët e kreut 0714 ose fruta të përdorur janë tërësisht origjinuese	
ex 1106	Miell, kokrriza dhe pluhur i perimeve të thara leguminoze pa lëvozhge të kreut Nr. 0713	Tharja dhe bluarja e zarzavateve leguminoze të kreut 0708	
Kapitulli 12	Farat vajore e frutat me përmbajtje vajore; kokrra, fara e fruta të përziera; bimët industriale ose medicinale; kashta e tagjia	Prodime në të cilat të gjitha materialet e Kapitullit 12 të përdorur janë tërësisht origjinuese	
1301	Lac; gomë natyrale, rrëshirat, gomërrëshirat e oleo-rrëshirat (për shembull, balsamet)	Prodime në të cilat vlera e të gjitha materialeve të kreut 1301 të përdorura nuk kalon 50% të çmimit ex-works të produktit	
1302	Lëngje dhe ekstrakte vegjetale; substanca pektike, pektinatet dhe pektatet; agar-agar dhe lende të tjera ngjitëse dhe trashese, nëse janë apo jo të modifikuara, të rrjedhura nga produktet vegjetale:		
	- Ngjitëse dhe trashës, të modifikuara, të rrjedhura nga produktet vegjetale	Prodime nga ngjitëset dhe trashësat e pamodifikuar	
	- Te tjera	Prodime në të cilat vlera e të gjitha materialeve të përdorur nuk kalon 50% të çmimit ex-works të produktit	
Kreu HS	Përshkrimi i produktit	Punimi ose përpunimi i kryer mbi materialet jo-origjinuese, i cili u jep statusin e origjinës	
(1)	(2)	(3) ose (4)	
Kapitulli 14	Materialet vegjetale që përdoren për thurje; produktet vegjetale të papërfshira e të paspecifikuara diku tjetër	Prodime në të cilat të gjitha materialet të Kapitullit 14 të përdorur janë tërësisht origjinuese	
ex Kapitulli 15	Vajra e dhjamëra prej kafshëve ose vegjetale dhe produktet e ndarjes së tyre; yndyra të përgatitura të ngrëshme; dyllet prej kafshëve apo vegjetale, përveç:	Prodime prej materialeve të çfarëdo kreu, përveç atij të produktit	
1501	Dhjam derri (përfshirë sallon) dhe dhjami i shpendëve, ndryshe nga ai i kreut Nr. 0209		

	apo 1503:		
	- Dhjamëra prej kockave ose mbetjeve	Prodhime prej materialeve të çfarëdo kreu përveç atyre të krerëve 0203, 0206 ose 0207 ose kockave të kreut 0506	
	- Te tjera	Prodhime prej mishi ose të brendshmeve të ngrënshme të derrit të kreut 0203 ose 0206 ose mishit ose të brendshmeve të ngrënshme të shpendë ve të kreut 0207	
1502	Dhjami i gjedheve, deleve apo dhive, ndryshe nga ato te kreut Nr. 15 03		
	- Dhjamëra prej kockave ose mbetjeve	Prodhime prej materialeve të çfarëdo kreu përveç atyre të krerëve 0201, 0202, 0204 ose 0206 ose kockave të kreut 0506	
	- Te tjera	Prodhime në të cilat të gjitha materialet e Kapitullit 2 të përdorura janë tërësisht origjinuese	
1504	Dhjamëra dhe vajra dhe fraksionet e tyre, te peshkut apo te sisorëve detare, nëse janë apo jo te rafinuara, por jo te modifikuara kimikisht:		
	- Fraksione solide	Prodhime nga materiale të çfarëdo kreu, përfshirë materiale të tjera të kreut 1504	
	- Te tjera	Prodhime në të cilat të gjithë materialet e Kapitujve 2 dhe 3 të përdorur janë tërësisht origjinuese	
ex 1505	Lanolinë e rafinuar	Prodhime prej vajrave të leshit të papërpunuar të kreut 1505	
1506	Dhjamëra dhe vajra te tjera me origjine prej kafshëve dhe fraksionet e tyre, nëse janë apo jo te rafinuara, por jo te modifikuara kimikisht		
	- Fraksione solide	Prodhime nga materiale të çfarëdo kreu, përfshirë materiale të tjera të kreut 1506	
Kreu HS	Përshkrimi i produktit	Punimi ose përpunimi i kryer mbi materialet jo-origjinuese, i cili u jep statusin e origjinës	
(1)	(2)	(3) ose (4)	
	- Te tjera	Prodhime në të cilat të gjithë materialet e Kapitullit 2 të përdorur janë tërësisht origjinuese	
1507 deri 1515	Vajra vegjetale e fraksionet e tyre:		
	- Soje, kikiriku, palme, kopre, thelb palme, babasu, vaj tungu e oitika, dyllë mërsinë e japonez, fraksionet e vajit të jobjobës e vajra për përdorime teknike e industriale të ndryshme nga prodhimet e ushqimit për konsum njerëzor	Prodhime prej materialeve të çfarëdo kreu, përveç atij të produktit	
	-Fraksione solide, përjashtuar ato të vajit jajoba	Prodhime prej materialeve të tjera të kreut nga 1507 deri 1515	

	- Te tjera	Prodhime në të cilat të gjitha materialet vegjetale të përdorura janë tërësisht origjinuese	
1516	Yndyra me origjine prej kafshëve apo vegjetale dhe fraksionet e tyre, tërësisht apo pjesërisht të hidrogjenizuara, të ndërsterifikuara, të riesterifikuara apo të elaidinifikuara (të gliceridifikuara), nëse janë apo jo të rafinuara, por jo me tejtë përgatitura	Prodhime në të cilat: - të gjitha materialet e Kapitullit 2 të përdorura janë tërësisht origjinuese, dhe - të gjithë materialet vegjetale të përdorura janë tërësisht origjinuese. Megjithatë, mund të përdoren materiale të krerëve 1507, 1508, 1511 dhe 1513	
1517	Margarine; përzierjet apo përgatitjet e ngrënshme të vajrave dhe dhjamërave vegjetale apo prej kafshëve apo të fraksioneve të yndyrave të ndryshme të këtij Kapitulli, përveç yndyrave të ngrënshme apo të fraksioneve të tyre të kreut Nr. 1516	Prodhime në të cilat: - të gjitha materialet e Kapitullit 2 dhe 4 të përdorura janë tërësisht origjinuese, dhe - të gjithë materialet vegjetale të përdorura janë tërësisht origjinuese. Megjithatë, mund të përdoren materiale të krerëve 1507, 1508, 1511 dhe 1513	
Kapitulli 16	Ushqimet e përgatitura prej mishit, prej peshkut ose prej krustaceve, prej molusqeve ose prej kafshëve të tjera jovertebrore ujore	Prodhime: - prej kafshëve të Kapitullit 1, dhe/ose - në të cilat të gjitha materialet e Kapitullit 3 të përdorur janë tërësisht origjinuese	
ex Kapitulli 17	Sheqernat dhe ëmbëlsirat prej sheqeri, përveç:	Prodhime prej materialeve të çdo kreu, përveç atij të produktit	
ex 1701	Sheqer i prodhuar nga kallam sheqeri ose nga panxhar sheqeri dhe saharoza kimikisht e pastër, në gjendje të ngurtë, me lëndë aromatizuese ose ngjyuese	Prodhime në të cilat vlera e të gjitha materialeve të Kapitullit 17 të përdorura nuk kalon 30% të çmimit ex-works të produktit	
Kreu HS	Përshkrimi i produktit	Punimi ose përpunimi i kryer mbi materialet jo-origjinuese, i cili u jep statusin e origjinës	
(1)	(2)	(3) ose (4)	
1702	Sheqerna të tjerë, duke përfshirë laktozen, maltozën, glukozën dhe fruktozën kimikisht të pastra, në gjendje të ngurtë; shurupet e sheqerit që nuk përmbajnë lende aromatizuese dhe ngjyuese shtese; mjaltë artificial, nëse është apo jo i përzier me mjaltë natyral; karamel:		
	- Maltoza dhe fruktoza të pastra kimikisht	Prodhime prej materialeve të çfarëdo kreu përfshirë materialet e tjera të kreut 1702	
	- Sheqerna të tjera në formë të ngurta, që përmbajnë lëndë aromatizuese apo ngjyuese	Prodhime në të cilat vlera e të gjitha materialeve të Kapitullit 17 të përdorur nuk kalon 30% të çmimit ex-works të produktit	
	- Te tjera	Prodhime në të cilat të gjithë materialet e përdorur janë origjinuese	
ex 1703	Melasat e rezultuara nga ekstragimi apo rafinimi i sheqerit, që përmbajnë aromatizues shtese ose lëndë ngjyuese	Prodhime në të cilat vlera e të gjitha materialeve të Kapitullit 17 të përdorur nuk kalon 30% të çmimit ex-works të produktit	

1704	Ëmbëlsirat prej sheqerit (përfshirë çokolatën e bardhe), qe nuk përmbajnë kakao	Prodhime: - prej materialeve të çfarëdo kreu përveç atij të produktit, dhe - në të cilat vlera e të gjitha materialeve të Kapitullit 17 të përdorur nuk kalon 30% të çmimit ex-works të produktit	
Kapitulli 18	Kakao dhe përgatitjet prej kakaos	Prodhime: - prej materialeve të çfarëdo kreu përveç atij të produktit, dhe - në të cilat vlera e të gjitha materialeve të Kapitullit 17 të përdorur nuk kalon 30% të çmimit ex-works të produktit	
Kreu HS	Përshkrimi i produktit	Punimi ose përpunimi i kryer mbi materialet jo-origjinuese, i cili u jep statusin e origjinës	
(1)	(2)	(3) ose (4)	
1901	Ekstrakt malti; përgatitjet ushqimore prej miellit, kokrrizave, niseshtesë apo ekstraktit të maltit, qe nuk përmbajnë kakao apo qe përmbajnë kakao ndaj peshës me pak se 40 % të llogaritur mbi një bazë totalisht të çyndyrosur, të paspecifikuara e të papërfshira diku tjetër; përgatitjet ushqimore të mallrave të krerëve Nr.0401 deri 0404, që nuk përmbajnë kakao ose që përmbajnë kakao ndaj peshës më pak se 5 % të llogaritur mbi një bazë totalisht të çyndyrosur, të papërfshira e të paspecifikuara diku tjetër:		
	- Ekstrakt malti	Prodhime nga drithërat e Kapitullit 10	
	- Te tjera	Prodhime: - prej materialeve të çdo kreu përveç atij të produktit , dhe - në të cilat vlera e të gjitha materialeve të Kapitullit 17 të përdorur nuk kalon 30% të çmimit ex-works të produktit	
1902	Brumërat nëse janë apo jo të gatuar apo të mbushur (me mish apo me substanca të tjera) apo të përgatitur ndryshe, të tilla si spageti, makarona, makarona pete, lazanje, gnocchi, ravioli, kaneloni; couscous nëse janë apo jo të përgatitur:		
	- Me përmbajtje 20% apo më pak ndaj peshës së mishit, të të brendshmeve të mishit, peshkut, krustaceve ose molusqeve	Prodhime në të cilat: të gjithë drithërat e nënproduktet e tyre (përfshirë miellin durum e nënproduktet e tij) të përdorur janë tërësisht origjinuese	
	- Me përmbajtje më tepër se 20% ndaj peshës së mishit, të të brendshmeve të mishit, peshkut, krustaceve ose molusqeve	Prodhime në të cilat: - të gjitha drithërat dhe nënprodukteve (përveç miellit durum dhe nënprodukteve të tij) të përdorura janë tërësisht	

		origjinuese, dhe - të gjitha materialet e Kapitujve 2 dhe 3 të përdorur janë tërësisht origjinuese	
1903	Tapioka dhe zëvendësuesit e tij përgatitur nga niseshteja, ne formën e fetezave, kokrrave, margaritarëve, toptash apo ne forma te ngjashme	Prodhime prej materialeve të çfarëdo kapitulli, përveç niseshtesë së patates të kreut 1108	
Kreu HS	Përshkrimi i produktit	Punimi ose përpunimi i kryer mbi materialet jo-origjinuese, i cili u jep statusin e origjinës	
(1)	(2)	(3) ose (4)	
1904	Ushqimet e përgatitura fituar prej bymimit apo pjekjes se drithërave apo te produkteve te tyre (për shembull, feteza drithi); drithërat (ndryshe nga misri (si drithë) ne forme kokrra apo ne forme fetezash apo kokrra te punuara ndryshe (përveç miellit e kokrrizave të miellit), të paragatuara ose të përgatitura ndryshe, të papërfshira ose të paspecifikuara diku tjetër	Prodhime: - prej materialeve të çfarëdo kreu, përveç atyre të kreut 1806, - në të cilat të gjithë drithërat e miellrat (përveç miellit durum dhe misrit zea indurate, dhe derivative te tyre) të përdorur janë tërësisht origjinuese, dhe - në të cilat vlera e të gjitha materialeve të Kapitullit 17 të përdorur nuk kalon 30% të çmimit ex-works të produktit	
1905	Buke, torta, kek, biskotat dhe produkte te tjera te furrtarit, nëse përmbajnë apo jo kakao; nafore, hapet (kapsulat) bosh te një lloji te përshtatshëm për qëllime farmaceutike, vaferet me shtresa, letër orizi dhe produkte te ngjashme	Prodhime nga materiale të çfarëdo kreu përveç atyre të Kapitullit 11	
ex Kapitulli 20	Përgatitje prej zarzavateve, frutave, arrave apo pjesëve te tjera te bimëve, përveç:	Prodhime në të cilat të gjitha frutat, arrat apo zarzavatet e përdorura janë tërësisht origjinuese	
ex 2001	Yams, patate te ëmbla dhe pjese te ngjashme te ngrënshme te bimëve qe përmbajnë 5 % apo me shume ndaj peshës niseshte, te përgatitura apo te ruajtura ne uthull apo ne acid acetik	Prodhime prej materialeve të çfarëdo kreu, përveç atij të produktit	
ex 2004 dhe ex 2005	Patate ne forme ne forme mielli, bollguri apo fetezash, te përgatitura apo te ruajtura ndryshe nga ne uthull apo ne acid acetik	Prodhime prej materialeve të çfarëdo kreu, përveç atij të produktit	
2006	Zarzavate, fruta, arra, lëkura frutash dhe pjese te tjera te bimëve, te ruajtura ne sheqer (te thara, te sheqerosura apo te kristalizuara):	Prodhime në të cilat vlera e të gjitha materialeve të Kapitullit 17 të përdorur nuk kalon 30% të çmimit ex-works të produktit	
2007	Reçelet, peltet e frutave, marmelatat, pure frutash ose arrash e brumë frutash ose arra, që janë përgatitje të gatuar, nëse përmbajnë ose jo sheqer ose lëndë të tjera ëmbëltuese shtesë	Prodhime: - prej materialeve të çfarëdo kreu përveç atij të produktit, dhe - në të cilat vlera e të gjitha materialeve të Kapitullit 17 të përdorur nuk kalon 30% të çmimit ex-works të produktit	

ex 2008	- Arra, që nuk përmbajnë sheqer ose aromatikë shtesë	Prodhime në të cilat vlera e të gjitha arrave dhe vajrave bimore origjinuese të kreut 0801, 0802 dhe 1202 deri 1207 të përdorur, e kalon 60% të çmimit ex-works të produktit	
	- Gjalpë kikiriku; përzierje të bazuara në drithëra; zemra palme; misër (drithë)	Prodhime prej materialeve të çfarëdo kreu, përveç atij të produktit	
Kreu HS	Përshkrimi i produktit	Punimi ose përpunimi i kryer mbi materialet jo-origjinuese, i cili u jep statusin e origjinës	
(1)	(2)	(3) ose (4)	
	- Të tjera, përveç frutave dhe arrave të gatuar ndryshe nga me avull ose vlim me ujë, duke mos përmbajtur sheqer shtesë, të ngrira	Prodhime: - prej materialeve të çfarëdo kreu përveç atij të produktit, dhe - në të cilat vlera e të gjitha materialeve të Kapitullit 17 të përdorur nuk kalon 30% të çmimit ex-works të produktit	
2009	Lëngje frutash (përfshirë mushtin e rrushit) dhe lëngje zarzavatesh, te pafermentuara dhe që nuk përmbajnë lende alkoolike shtese, nëse përmbajnë sheqer apo lende te tjera embelsuese shtese	Prodhime: - prej materialeve të çfarëdo kreu përveç atij të produktit, dhe - në të cilat vlera e të gjitha materialeve të Kapitullit 17 të përdorur nuk kalon 30% të çmimit ex-works të produktit	
ex Kapitulli 21	Përgatitje të ndryshme të ngrënshme, përveç:	Prodhime prej materialeve të çfarëdo kreu përveç atij të produktit	
2101	Ekstrakte, esenca dhe koncentre, te kafesë, çajit apo matëse dhe përgatitjet me baze te këtyre produkteve apo me baze te kafesë, çajit apo matëse; çikore e pjekur dhe zëvendësuesit e tjerë te pjekur te kafesë, dhe ekstraktet, esencat dhe koncentratet prej tyre	Prodhime: - prej materialeve të çfarëdo kreu përveç atij të produktit, dhe - në të cilat të gjitha cikoret e përdorura janë tërësisht origjinuese	
2103	Salcat dhe përgatitjet prej tyre; erëza te përziera dhe aromatizues te përzier; miell dhe kokrriza mielli mustarde dhe mustarde te përgatitur:		
	- Salcat e përgatitjet prej tyre; erëza të përziera e aromatizues të përzier	Prodhime prej materialeve të çfarëdo kreu, përveç atij të produktit. Megjithatë mielli e kokrriza mielli mustarde dhe mustardë e përgatitur mund të përdoren	
	- Miell mustarde dhe kokrriza mielli mustarde dhe mustardë e përgatitur	Prodhime prej materialeve të çfarëdo kreu	
ex 2104	Supat dhe lëngjet e mishit si dhe përgatitjet prej tyre	Prodhime prej materialeve të çfarëdo kreu përveç zarzavateve të përgatitura ose të ruajtura të krerëve nga 2002 deri 2005	
(1)	(2)	(3) ose	(4)
2106	Përgatitje ushqimore te papërfshira dhe te paspecifikuara diku tjetër	Prodhime: - prej materialeve të çfarëdo kreu përveç atij	

		të produktit, dhe - në të cilat vlera e të gjitha materialeve të Kapitullit 17 të përdorur nuk kalon 30% të çmimit ex-works të produktit	
ex Kapitulli 22	Pijet, alkoolet dhe uthulla, përveç:	Prodhime: - prej materialeve të çfarëdo kreu përveç atij të produktit, dhe - në të cilat i gjithë rrushi ose çfarëdo nënprodukt rrushi i përdorur janë origjinuese	
2202	Ujërat, përfshirë ujërat minerale dhe ujërat e gazuar, qe përmbajnë sheqer apo lende te tjera embelsuese apo aromatizuese shtese, dhe pije te tjera jo-alkoolike, pa përfshirë lëngun e frutave apo te zarzavateve te kreut Nr. 2009	Prodhime: - prej materialeve të çfarëdo kreu përveç atij të produktit, dhe - në të cilat vlera e të gjitha materialeve të Kapitullit 17 të përdorur nuk kalon 30% të çmimit ex-works të produktit, dhe - në të cilat çfarëdo lëng frutash të përdorur (përveç lëngjeve të ananasit, qitros dhe greip-frutit) janë origjinuese	
2207	Alkool etilik jo i denaturuar i një force alkoolike ndaj volumit prej 80 % vol apo me e larte; alkool etilik dhe alkoolet te tjera, te denaturuara, te çdo lloji force	Prodhimi: - prej materialeve të çfarëdo kreu përveç kreut 2207 ose 2208, dhe - ne te cilat te gjithë llojet e rusheve ose materialet e përdorura qe rrjedhin nga rrushi përftohen tërësisht ose nëse te gjitha materialet e tjera te përdorura janë origjinuese, arrack mund te përdoret deri ne një kufi deri 5 % sipas volumit	
2208	Alkool etilik jo i denaturuar i një force alkoolike ndaj volumit prej me pak se 80 % vol; pije alkoolike, likere dhe alkoolet te tjera	Prodhime: - prej materialeve të çfarëdo kreu, përveç kreut 2207 ose 2208 , dhe - në të cilët i gjithë rrushi ose nënprodukt nga rrushi të përdorur janë tërësisht origjinues ose në qoftë se të gjitha materialet e tjera të përdorura janë tashmë origjinuese, pije alkoolike mund të përdoren në një kufi deri 5% sipas volumit	
ex Kapitulli 23	Mbetjet e kthimet nga industritë ushqimore; tagjia e përgatitur për kafshët; përveç:	Prodhime prej materialeve të çfarëdo kreu, përveç atij të produktit	
(1)	(2)	(3) ose	(4)
ex 2301	Ushqim balene, miell, ushqim dhe topta prej peshku ose krustacesh, molusqesh e kafshëve të tjera jovertebrore ujore, të papërshtatshme për konsum njerëzor	Prodhime në të cilat të gjitha materialet e Kapitujve 2 dhe 3 të përdorur janë tërësisht origjinuese	
ex 2303	Mbetjet prej prodhimeve të niseshtesë së misrit (përfshirë lëngjet e koncentruar së tepërmi), me përmbajtje proteine të llogaritur ndaj produktit të thatë që kalon 40% ndaj peshës	Prodhime në të cilat të gjitha misrat e përdorur janë tërësisht origjinues	

ex 2306	Bërsitë dhe mbetje të tjera të forta, të përfuara nga ekstraktimi i vajit të ullirit, që përmban më shumë se 3% vaj ulliri	Prodhime në të cilat të gjithë ullinjët e përdorur janë tërësisht origjinues	
2309	Përgatitjet e një lloji të përdorur në ushqimin e kafshëve	Prodhime në të cilat: - të gjithë drithërat, sheqeri ose melasat, mishi ose qumështi i përdorur janë tashmë origjinues, dhe - të gjitha materialet e Kapitullit 3 të përdorur janë tërësisht origjinues	
ex Kapitulli 24	Duhani dhe zëvendësuesit e përpunuar të duhanit, përveç:	Prodhime në të cilat të gjithë materialet e Kapitullit 24 të përdorur janë tërësisht origjinues	
2402	Puro, cigare dhe cigarilo, prej duhanit apo prej zëvendësuesve të duhanit	Prodhime në të cilat të paktën 70% sipas peshës së duhanit të papërpunuar ose mbetjeve të duhanit të kreut 2401 të përdorur janë origjinues	
ex 2403	Duhan llulle	Prodhime në të cilat të paktën 70% sipas peshës së duhanit të papërpunuar ose mbetjeve të duhanit të kreut 2401 të përdorur janë origjinues	
ex Kapitulli 25	Kripërat; sulfuret; oksidet dhe gurët; materialet suvatuese, gëlqere dhe çimento, përveç:	Prodhime me materiale të çfarëdo kreu, përveç atij të produktit	
ex 2504	Grafit natyral kristalin, me përmbajtje karbon të pasuruar, pastruar dhe të bluar	Pasurimi i karbonit në grafit, pastrimi e bluarja e grafitëve kristalin të papërpunuar	
ex 2515	Mermer, e prerë thjesht, nga sharrimi apo ndryshe, në blloqe apo pllaka në forme drejtkëndëshe (përfshirë edhe katrorin), të një trashësie me pak se 25 cm	Prerje me sharrë ose ndryshe, e mermerit (edhe nëse është sharruar më parë) të një trashësie më tepër se 25 cm	
(1)	(2)	(3) ose	(4)
ex 2516	Granit, porfir, bazalt, shkëmbinj të ranore dhe gurë të tjerë monumentale ndërtimore, nëse janë apo jo të punuar trashë apo të prera thjesht, nga sharrimi apo ndryshe, në blloqe apo pllaka në forme drejtkëndëshe (përfshirë edhe katrorin), me trashësi që nuk kalon 25 cm	Prerje, me sharrë ose ndryshe, të mermerit (edhe nëse tashmë është i prerë) me një trashësi që kalon 25 cm	
ex 2518	Dolomit të kalcinuara	Kalcinimi i dolomitëve të pakalcinuar	
ex 2519	Karbonet magnezi natyral i bluar (magnezite), në kontejnerë hermetikë të mbyllur, dhe okside magnezi, nëse janë ose jo të pastra, të ndryshëm nga magnezi i shkrirë ose magnezi i vjetruar (sintered)	Prodhime prej materiale të çfarëdo kreu, përveç atij të produktit Megjithatë, karbonati i magnezit natyral (magnezitet) mund të përdoret	
ex 2520	Gipse në mënyrë speciale përgatitur për dentiste	Prodhime në të cilat vlera e të gjitha materialeve të përdorura nuk kalon 50% të çmimit ex-works të produktit	
ex 2524	Fibra natyrale asbesti	Prodhime prej koncentratit asbesti	
ex 2525	Pluhur mike	Bluarje të mikes ose të mbetjeve të mikes	
ex 2530	Bojëra dheu, të kalcinuara ose pluhëruara	Kalcinimi ose bluarja e bojërave të dheut	

Kapitulli 26	Xehërorët, zgjyrat dhe hiri	Prodhime prej materialeve të çfarëdo kreu, përveç atij të produktit	
ex Kapitulli 27	lendet djegëse minerale, vajrat minerale dhe produktet e distilimit të tyre; substancat bituminoze; dyllet minerale, përveç:	Prodhime prej materialeve të çfarëdo kreu, përveç atij të produktit	
ex 2707	Vajra në të cilat pesha e përbërësve aromatike kalon ato joaromatike, duke qenë vajra të ngjashëm me ato vajra minerale përfshirë nga distilimi në temperatura të larta të katranit të qymyrit, prej të cilës më shumë se 65% të volumit distilohet në një temperaturë deri në 250°C (përfshi përzjerjet e naftës spirit e benzolit), për përdorim si lëndë djegëse për energji ose për ngrohje	Operacione të rafinimit dhe/ose një ose më shumë procese specifike (5) ose Operacione të tjera në të cilat të gjitha materialet e përdorur janë klasifikuar brenda një kreu të ndryshëm nga ai i produktit. Megjithatë, materialet e klasifikuara në të njëjtin kre me atë të produktit mund të përdoren me kusht që vlera e tyre e përgjithshme të mos kalojë 50% të çmimit ex-works të produktit	
(1)	(2)	(3) ose	(4)
ex 2709	Vajra të papërpunuara të përfituara prej mineraleve bituminoze	Distilim shkatërrues i materialeve bituminoze	
2710	Vajrat e naftës dhe vajra të fituara prej mineraleve bituminoze, ndryshe nga vajrat bruto; përgatitje të paspecifikuara dhe të papërfshira diku tjetër, që përbajnë ndaj peshës 70 % apo më shumë vajra naftë apo vajra të fituara nga mineralet bituminoze, këto vajra duhet të jenë përbërësit baze të preparatit; mbetje vajrash	Operacione të rafinimit dhe/ose një ose më shumë procese specifike (6) ose Operacione të tjera në të cilat të gjitha materialet e përdorur janë klasifikuar brenda një kreu të ndryshëm nga ai i produktit. Megjithatë, materialet e klasifikuara në të njëjtin kre me atë të produktit mund të përdoren me kusht që vlera e tyre e përgjithshme të mos kalojë 50% të çmimit ex-works të produktit	
2711	Gazet e naftës dhe hidrokarbure të tjera gazoike	Operacione të rafinimit dhe/ose një ose më shumë procese specifike (7) ose Operacione të tjera në të cilat të gjitha materialet e përdorur janë klasifikuar brenda një kreu të ndryshëm nga ai i produktit. Megjithatë, materialet e klasifikuara në të njëjtin kre me atë të produktit mund të përdoren me kusht që vlera e tyre e përgjithshme të mos kalojë 50% të çmimit ex-works të produktit	
2712	Vazeline; dyllë parafine, dyllë mikrokristalin prej naftës, dyllë i lëngshëm (i lëshuar), ozokerit, dyllë linjiti, dyllë torfe, dyllë të tjera minerale, dhe produkte të ngjashme fituar nga sinteza apo nga procese të tjera, nëse janë apo jo të ngjyrosur	Operacione të rafinimit dhe/ose një ose më shumë procese specifike(8) ose Operacione të tjera në të cilat të gjitha materialet e përdorur janë klasifikuar brenda një kreu të ndryshëm nga ai i produktit. Megjithatë, materialet e klasifikuara në të njëjtin kre me atë të produktit mund të përdoren me kusht që vlera e tyre e përgjithshme të mos kalojë 50% të çmimit ex-works të produktit	
(1)	(2)	(3) ose	(4)
2713	Koks naftë, bitum naftë dhe mbetje të tjera të vajrave të naftës apo të vajrave të fituar prej mineraleve bituminoze	Operacione të rafinimit dhe/ose një ose më shumë procese specifike (9) ose Operacione të tjera në të cilat të gjitha materialet e përdorura janë klasifikuar brenda një kreu të ndryshëm nga ai i produktit. Megjithatë, materialet e klasifikuara në të njëjtin kre me atë të produktit mund të përdoren me kusht që vlera e tyre e përgjithshme të mos kalojë 50% të çmimit ex-works të produktit	

2714	Bitum dhe asfalt, natyral; rreshpe bituminoze apo rreshpe nafte dhe rërë bituminoze; asfaltimet dhe gurët asfaltik	Operacione të rafinimit dhe/ose një ose më shumë procese specifike (10) ose Operacione të tjera në të cilat të gjitha materialet e përdorura janë klasifikuar brenda një kreu të ndryshëm nga ai i produktit. Megjithatë, materialet e klasifikuara në të njëjtin kre me atë të produktit mund të përdoren me kusht që vlera e tyre e përgjithshme të mos kalojë 50% të çmimit ex-works të produktit	
2715	Përzierje bituminoze të bazuara në asfaltin natyral, në bitumin natyral, në bitumin e naftës, në katranin mineral apo në terpeninën e katranit mineral (p.sh, masticet bituminoze, "cut-backs")	Operacione të rafinimit dhe/ose një ose më shumë procese specifike (11) ose Operacione të tjera në të cilat të gjitha materialet e përdorur janë klasifikuar brenda një kreu të ndryshëm nga ai i produktit. Megjithatë, materialet e klasifikuara në të njëjtin kre me atë të produktit mund të përdoren me kusht që vlera e tyre e përgjithshme të mos kalojë 50% të çmimit ex-works të produktit	
(a) të gjitha produktet e klasifikuara në Kreun 25 deri në 97 tek Përshkrimi i Harmonizuar i Mallrave dhe Sistemi i Kodimit (SH), duke përfshirë dhe produktet e renditura në Shtojcën I;

(b) produktet bujqësore të përpunuara, të specifikuara në Protokollin A, në lidhje me rregullimet e parashikuara në atë Protokoll; dhe

(c) peshkun dhe të gjitha produktet e tjera detare të parashikuara në Shtojcën II.

2. Shqipëria dhe çdo Shtet i EFTA-s ka nënshkruar marrëveshje dypalëshe për tregtinë për produktet bujqësore. Këto marrëveshje janë pjesë e instrumenteve që krijojnë një zonë të tregtisë së lirë ndërmjet Shqipërisë dhe Shteteve të EFTA-s.

Neni 7

Rregullat e origjinës dhe metodat e bashkëpunimit administrativ

1. Dispozitat për rregullat e origjinës dhe metodat e bashkëpunimit administrativ parashikohen në Protokollin B.

2. Palët bien dakord të shqyrtojnë në mënyrë të favorshme kërkesa për negocime për të nënshkruar Marrëveshje dypalëshe për Ndihmë të Ndërsjellë Administrative për Çështjet Doganore.

Neni 8

Tarifat doganore

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Palët i heqin të gjitha tarifat doganore për importet dhe eksportet e produkteve që e kanë origjinën në Shqipëri ose në një Shtet të EFTA-s të mbuluar nga paragrafi 1 i Nenit 6, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në Shtojcat dhe në Protokollat përkatëse. Nuk do të ndërfiten tarifa të reja doganore, dhe nga hyrja në fuqi e kësaj marrëveshjeje, as ato që zbatohen në atë moment nuk rriten për tregtinë ndërmjet Palëve, me përjashtim të rastit të parashikuar në Nenin 1 të Protokollit A.

2. Një tarifë doganore përfshin çdo tarifë ose taksë të çdo lloji që vihet në lidhje me importimin ose eksportimin e një produkti, duke përfshirë çdo formë mbitarife ose mbitatimi, por nuk përfshin asnjë tarifë të vendosur në përputhje me Nenet III dhe VIII të GATT-it të vitit 1994.

Neni 9

Kufizimet e importit dhe eksportit

Të drejtat dhe detyrimet e Palëve në lidhje me kufizimet e eksportit dhe importit rregullohen nga Neni XI i GATT-it të vitit 1994, i cili është përfshirë dhe është bërë pjesë e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 10

Tatimi dhe Rregulloret e Brendshme

1. Palët angazhohen të zbatojnë çdo taksë dhe çdo tatim tjetër të brendshëm dhe rregulloret në përputhje me Nenin III të GATT-it të vitit 1994 dhe me marrëveshjet e tjera përkatëse të OBT-së.

2. Eksportuesit mund të mos përfitojnë nga shlyerja e taksave të brendshme që shkojnë përtej shumës së tatimit të tërthortë të vendosur për produktet e eksportuara në territorin e një pale.

Neni 11

Masat sanitare dhe fitosanitare

1. Të drejtat dhe detyrimet e Palëve në lidhje me masat sanitare dhe fitosanitare trajtohen nga Marrëveshja e OBT-së për Zbatimin e Masave Sanitare dhe Fitosanitare.

2. Palët shkëmbejnë emra dhe adresa të pikave të kontaktit me përvojë sanitare dhe fitosanitare, në mënyrë që të lehtësohet komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit.

Neni 12

Rregulloret teknike

1. Detyrat dhe detyrimet e Palëve në lidhje me rregulloret teknike, standardet dhe vlerësimin e përputhshmërisë mbulohen nga Marrëveshja e OBT-së për Pengesat Teknike për Tregtinë.

2. Palët do të rrisin bashkëpunimin e tyre në fushën e rregulloreve teknike, standardeve dhe vlerësimit të përputhshmërisë, me synim rritjen e të kuptuarit të ndërsjellë të sistemeve të tyre përkatëse dhe lehtësimit të aksesit në tregjet e tyre përkatëse.

Neni 13

Lehtësimi i tregtisë

Palët, në përputhje me dispozitat e parashikuara në Shtojcën III, me qëllimin e lehtësimit të tregtisë ndërmjet Shqipërisë dhe Shteteve të EFTA-s, do të:

- (a) thjeshtojnë, sa më shumë të jetë e mundur, procedurat për tregtimin e mallrave dhe shërbimet e tjera përkatëse;
- (b) nxisin bashkëpunimin ndërmjet tyre në mënyrë që të rritet pjesëmarrja e tyre në zhvillimin dhe zbatimin e konventave dhe rekomandimeve ndërkombëtare për lehtësimin e tregtisë; dhe
- (c) bashkëpunojnë për lehtësimin e tregtisë brenda kuadrit të Komitetit të Përbashkët.

Neni 14

Nënkomiteti për rregullat e origjinës, procedurat doganore dhe lehtësimin e tregtisë

1. Duke iu referuar Neneve 7, 8 dhe 13, krijohet një nënkomitet i Komisionit të Përbashkët për Rregullat e Origjinës, Procedurat Doganore dhe Lehtësimin e Tregtisë (më poshtë i referuar si "nënkomiteti").

2. Mandati i nënkomitetit parashikohet në Shtojcën IV.

Neni 15

Ndërmarrjet shtetërore të tregtisë

Të drejtat dhe detyrimet e Palëve në lidhje me ndërmarrjet shtetërore të tregtisë mbulohen nga Neni XVII i GATT-it të vitit 1994 dhe nga Kuptimi i Interpretimit të Neneve XVII të GATT-it të vitit 1994", të cilat janë përfshirë dhe janë bërë pjesë e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 16

Subvencionet dhe masat kompensuese

1. Të drejtat dhe detyrimet e Palëve në lidhje me subvencionet dhe masat kompensuese do të trajtohen nga Nenet VI dhe XVI të GATT-it 1994 dhe Marrëveshja e Organizatës Botërore të Tregtisë për Subvencionimet dhe Masat Kompensuese, me përjashtim të sa parashikohet në paragrafin 2.

2. Para se Shqipëria ose një Shtet i EFTA-s, sipas rastit, të fillojë një hetim për të përcaktuar ekzistencën, shkallën dhe efektin e subvencioneve të pretenduara në Shqipëri ose në një Shtet tjetër të EFTA-s, siç parashikohet në Nenin 11 të Marrëveshjes së OBT-së për Subvencionime dhe Masa Kompensuese, pala që dëshiron të fillojë hetimin do të njoftojë me shkrim Palën mallrat e së cilës janë objekt hetimi dhe jep një afat 45 ditor, me qëllimin e gjetjes së një zgjidhjeje të përbashkët të pranueshme. Konsultimet do të mbahen në Komisionin e Përbashkët, nëse kërkohet nga ndonjëra prej Palëve, brenda 20 ditësh nga marrja e njoftimit.

Neni 17

Antidumping

1. Një Palë nuk do të zbatojë masa antidumping, siç parashikohet në Nenin VI të GATT-it të vitit 1994 dhe Marrëveshjen e OBT-së për Zbatimin e Nenet VI të GATT-it 1994 në lidhje me produkte që e kanë origjinën në një tjetër Palë.

2. Palët pohojnë se zbatimi konkret i rregullave të konkurrencës mund të trajtojë shkaqe ekonomike që çojnë në dumping.

Neni 18

Rregullat e konkurrencës në lidhje me ndërmarrjet

1. Pikat e mëposhtme nuk janë në përputhje me funksionimin e duhur të kësaj Marrëveshjeje për sa kohë që ato kanë ndikim mbi tregtinë ndërmjet Shqipërisë dhe Shteteve të EFTA-s:

(a) të gjitha marrëveshjet ndërmjet ndërmarrjeve, vendimet për bashkime të ndërmarrjeve dhe praktikat e përbashkëta ndërmjet ndërmarrjeve që kanë si objekt ose efekt parandalimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës; dhe

(b) abuzimin nga një ose më shumë ndërmarrje me pozicion mbizotërues në territorin e një pale në tërësi ose në një pjesë thelbësore të saj.

2. Dispozitat e paragrafit 1 do të zbatohen për veprimtaritë e ndërmarrjeve publike dhe ndërmarrjet për të cilat Palët ofrojnë detyra të posaçme ose ekskluzive që atyre u janë caktuar, për aq kohë sa zbatimi i këtyre dispozitave nuk pengon kryerjen, si në ligj ashtu dhe në praktikë.

3. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk do të konsiderohet se krijojnë detyrime të drejtpërdrejta për këto ndërmarrje.

4. Nëse një Palë çmon se një praktikë e caktuar nuk është e përputhshme me dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2, Palët e përfshira do i japin Komitetit të Përbashkët të gjithë ndihmën e kërkuar në mënyrë që të shqyrtohet çështja, dhe kur është e nevojshme, të eliminohet praktika e lidhur me të. Nëse Pala e përfshirë nuk arrin të përfundojë praktikën brenda periudhës së caktuar nga Komiteti i Përbashkët, ose nëse Komiteti i Përbashkët dështon në arritjen e një marrëveshjeje pas konsultimeve, ose pas tridhjetë ditësh pas referencës në këto konsultime, pala tjetër mund të ndërmarrë masat e nevojshme për të zgjidhur vështirësitë që rrjedhin nga praktika në fjalë.

Neni 19

Masa mbrojtëse të përgjithshme

Të drejtat dhe detyrimet e Palëve në lidhje me masat mbrojtëse të përgjithshme mbulohen nga Neni XIX i GATT-it të vitit 1994 dhe Marrëveshja e OBT-së për Mbrojtjen. Në marrjen e masave sipas këtyre dispozitave të OBT-së, një Palë përjashton importet e një produkti origjinal nga një ose disa Palë nëse këto importe nuk shkaktojnë ose kërcënojnë shkaktimin e dëmtimeve serioze. Pala që i merr masat demonstroi se një përjashtim i tillë është në përputhje me jurisprudencën e OBT-së.

Neni 20

Masat mbrojtëse dypalëshe

1. Kur, si rezultat i uljes ose heqjes së tarifave doganore sipas kësaj Marrëveshjeje, një produkt që e ka origjinën në një Palë importohet në territorin e një Pale tjetër në sasi të tilla të mëdha, në kushte absolute ose relative me prodhimin e brendshëm, dhe në kushte të tilla që përbëjnë një shkak thelbësor për shkaktimin e dëmeve serioze ose kërcënim të industrisë së brendshme për të njëjtin produkt ose që ka ndikim mbi produktet e drejtpërdrejta konkurruese në territorin e Palës importuese, Pala importuese mund të marrë masa mbrojtëse dypalëshe në nivelin minimal të nevojshëm për të ndrequr ose për të parandaluar dëmin, sipas dispozitave të paragrafëve 2 deri në 10.

2.Masat mbrojtëse dypalëshe merren vetëm kur ka prova të qarta se rritja e importeve ka shkaktuar ose po kërcënon shkaktimin e një dëmi serioz, sipas një hetimi, në përputhje me procedurat e parashikuara në Marrëveshjen e OBT-së për Mbrojtjen.

3.Pala që synon të marrë një masë mbrojtëse dypalëshe sipas këtij Neni, menjëherë, dhe në çdo rast, para marrjes së masës, do të njoftojë Palën tjetër dhe Komisionin e Përbashkët. Njoftimi do të përmbajë të gjithë informacionin e nevojshëm, i cili përfshin prova të dëmit ose kërcënimit serioz ose kërcënimit të shkaktuar nga rritjet e importeve, një përshkrim të saktë të produktit të përfshirë dhe të masës së propozuar, si dhe datën e propozuar të ndërfitjes së saj, kohëzgjatjen e pritshme dhe afatin kohor për heqjen e përshkallëzuar të masës. Një Pale, e cila mund të preket nga masa i ofrohet dëmshpërblim në formën e liberalizimit kryesisht ekuivalent tregtar në lidhje me importet e kësaj Pale.

4.Nëse kushtet e parashikuara në paragrafin 1 plotësohen, Pala importuese mund të marrë masa që përbëhen nga rritja e shkallës së tarifave doganore për produktin në një nivel që nuk është më i lartë se:

(a) Niveli i tarifës së MFN-së i zbatuar në kohën e ndërmarrjes së veprimit; ose

(b) Niveli i tarifës së MFN-së i zbatuar menjëherë në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

5.Masat mbrojtëse dypalëshe merren për një periudhë që nuk e kalon një vit. Në rrethana shumë përjashtimore, pas rishikimit nga një Komision i Përbashkët, masat mund të merren për një periudhë maksimale kohe prej tre vitesh. Nuk zbatohet asnjë masë për importimin e një produkti i cili më parë ka qenë objekt i një mase të tillë.

6.Komiteti i Përbashkët, brenda 30 ditësh nga data e njoftimit, shqyrton informacionin e parashikuar në paragrafin 3, në mënyrë që të lehtësohet një rezolutë bashkërisht e pranueshme në këtë fushë. Në mungesë të një zgjidhjeje të tillë, Pala importuese mund të miratojë një masë sipas paragrafit 4 për të zgjidhur problemin, dhe, në mungesë të një kompensimi për të cilin bihet dakord bashkërisht, Pala kundër së cilës është marrë masa mund të ndërmarrë veprime dëmshpërblyese. Masa e mbrojtëse dypalëshe dhe veprimi dëmshpërblyes do t'u njoftohen menjëherë Palëve të tjera dhe Komitetit të Përbashkët. Në përzgjedhjen e masave mbrojtëse dypalëshe dhe të veprimit dëmshpërblyes, i duhet dhënë përparësi masës që cenon më pak funksionimin e kësaj Marrëveshjeje. Veprimi dëmshpërblyes do të përbëhet, si rregull, nga pezullimi i koncesioneve që kanë efekte kryesisht ekuivalente tregtie ose koncesioneve që janë kryesisht ekuivalente me vlerën e tatimeve shtesë që pritet të rrjedhin nga masa mbrojtëse dypalëshe. Pala që merr veprime dëmshpërblyese do të zbatojë veprimin vetëm për periudhën minimale të kohës së nevojshme për të arritur efekte kryesisht ekuivalente të tregtisë, dhe në çdo rast, vetëm gjatë zbatimit të masës së marrë sipas paragrafit 4.

7.Pas përfundimit të masës, niveli i tarifës doganore është niveli i tarifës doganore që përdoret nëse nuk është marrë kjo masë.

8. Në rrethana kritike, ku vonesa shkakton dëm dhe është e vështirë të ndreqet, një Palë do të merrte një masë emergjente të përkohshme në bazë të një përcaktimi paraprak se ka prova të qarta që dëshmojnë se rritja e importeve përbën shkak të mjaftueshëm për dëm serioz, ose për cenimin e industrisë së brendshme. Pala që mendohet të marrë një masë të tillë njofton menjëherë Palën tjetër dhe Komitetin e Përbashkët. Brenda 30 ditësh nga data e njoftimit fillojnë procedurat e parashikuara në paragrafët 2 deri në 6, duke përfshirë dhe veprimin dëmshpërblyes. Çdo dëmshpërblym bazohet në periudhën e përgjithshme të përdorimit të masave të përkohshme të emergjencës dhe të masave të emergjencës.

9. Çdo masë e përkohshme nuk zgjat më shumë se 200 ditë. Periudha e zbatimit të çdo mase të tillë numërohet si pjesë e kohëzgjatjes së masës së parashikuar në paragrafin 5 dhe çdo shtrirje të tij. Çdo rritje tarife rimbursohet menjëherë nëse hetimi i përshkruar në paragrafin 2 nuk çon në identifikimin nëse janë plotësuar kushtet e paragrafit 1.

10. Pesë vjet pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Palët rishikojnë në Komitetin e Përbashkët nëse ekziston nevoja e lënies së mundësisë së marrjes së masave mbrojtëse ndërmjet tyre. Nëse vendoset prej Palëve, pas rishikimit të parë, për të pasur këtë mundësi, ato bëjnë dy herë në vit rishikime për këtë çështje në Komitetin e Përbashkët.

Neni 21

Përfshirje të përgjithshme

Të drejtat dhe detyrimet e Palëve në lidhje me përfshirjet e përgjithshme mbulohen nga Neni XX i GATT-it i vitit 1994, i cili është përfshirë dhe është bërë pjesë e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 22

Përfshirjet e sigurimit

Të drejtat dhe detyrimet e Palëve në lidhje me përfshirjet e sigurimit mbulohen nga Neni XXI i GATT-it i vitit 1994, i cili është përfshirë dhe është bërë pjesë e kësaj Marrëveshjeje.

KREU 3

MBROJTJA E PRONËSISË INTELEKTUALE

Neni 23

Mbrojtja e pronësisë intelektuale

1. Palët japin dhe sigurojnë mbrojtje të përshtatshme, efektive dhe jodiskriminuese të të drejtave të pronësisë intelektuale dhe parashikojnë masa për zbatimin e këtyre të drejtave kundër shkeljes, falsifikimit dhe piraterisë, në përputhje me dispozitat e këtij Neni, Shtojcës V dhe Marrëveshjeve ndërkombëtare të referuara në të.

2. Palët u japin nënshtetasve të njëra-tjetrës trajtim që nuk është më pak i favorshëm se trajtimi i nënshtetasve të tyre. Përjashtimet nga ky detyrim duhet të jenë në përputhje me dispozitat kryesore të Nenit 3 dhe 5 të Marrëveshjes së OBT-së për Aspekte të të Drejtave të Pronësisë Intelektuale të Lidhura me Tregtinë (më poshtë "Marrëveshja TRIPS").

3. Palët u japin nënshtetasve të njëra-tjetrës trajtim jo më pak të favorshëm se trajtimi që u jepet nënshtetasve të çdo Shteti tjetër. Përjashtimet nga ky detyrim duhet të jenë në përputhje me dispozitat kryesore të Marrëveshjes TRIPS, në veçanti me Nenet 4 dhe 5 të saj.

4. Palët bien dakord, pas kërkesës së secilës Pale në Komitetin e Përbashkët, të rishikojnë dispozitat për mbrojtjen e pronësisë intelektuale që përmbahen në këtë Nen dhe në Shtojcën V, me qëllimin e përmirësimit të mëtejshëm të nivelit të mbrojtjes që ata ofrojnë dhe mënjanimit ose ndreqjes së prishjeve tregtare të shkaktuara nga nivelet aktuale të mbrojtjes së të drejtave të pronësisë intelektuale.

KREU 4

INVESTIMET, SHËRBIMET DHE PROKURIMET QEVERITARE

Neni 24

Investimi

1. Palët përpiqen të ofrojnë në territoret e tyre kushte të qëndrueshme, të barabarta dhe transparente investimi për investitorët e Palëve të tjera që bëjnë ose kërkojnë të bëjnë investime në territoret e tyre.

2. Palët pranojnë investime nga investitorët e Palëve të tjera në përputhje me ligjet dhe rregulloret e tyre. Ato pohojnë se është e papërshtatshme të nxiten investime nëpërmjet bërjes së standardeve shëndetësore, të sigurisë ose mjedisore më pak të rrepta.

3. Palët njohin rëndësinë e nxitjes së investimit dhe flukseve të teknologjisë si mjet për të arritur rritje dhe zhvillim ekonomik. Bashkëpunimi në këtë aspekt mund të përfshijë:

(a) mjete të përshtatshme për gjetjen e mundësive për investim dhe të kanaleve të informacionit për rregullimet e investimit;

(b) shkëmbimin e informacionit për masat në nxitje të biznesit jashtë vendit; dhe

(c) zgjerimin e një mjedisi ligjor të përshtatshëm për rritjen e flukseve të investimeve.

4. Palët e afirmojnë angazhimin e tyre për të rishikuar çështje që lidhen me investimin pranë Komitetit të Përbashkët jo më vonë se pesë vjet nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje, duke përfshirë të drejtën e vendosjes së investitorëve të një Pale në territorin e një Pale tjetër.

5. Shqipëria, nga njëra anë, dhe Republika e Islandës, Principata e Lihtenshtejnit, Konfederata Zvicerane, nga ana tjetër, tërhiqen nga masat arbitrare ose diskriminuese në lidhje me investimet nga një investitor i një pale tjetër të përmendur në këtë paragraf dhe respekton çdo detyrim që kanë ndërmarrë ato në lidhje me një investim specifik nga një investitor ose Palë tjetër, përmendur në këtë paragraf.

Neni 25

Tregtia në shërbime

1. Palët do të synojnë në arritjen e liberalizimit gradual dhe hapjen e tregjeve të tyre në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes së Përgjithshme për Tregtinë në shërbime (më poshtë "GATS"), duke marrë parasysh punën në vijim nën drejtimin e OBT-së.

2. Nëse, pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, një Palë i jep një shteti jo Palë përfitime shtesë në lidhje me aksesin në tregjet e saj të shërbimit, ajo ofron mundësi të përshtatshme për negociata me synimin e shtrirjes së këtyre përfitimeve për një Palë tjetër mbi një bazë reciproke.

3. Palët marrin përsipër të rishikojnë paragrafin 1 dhe 2 me synimin e krijimit të një marrëveshjeje për liberalizimin e tregtisë në shërbime, në përputhje me Nenin V të GATS.

Neni 26

Prokurimi qeveritar

1. Palët rrisin mirëkuptimin e tyre të ndërsjellë për ligjet dhe rregulloret e prokurimeve të qeverive të tyre, me synimin e liberalizimit gjithnjë e më të madh të tregjeve të tyre përkatëse të prokurimeve mbi bazën e mosdiskriminimit dhe reciprocitetit.

2.Në mënyrë që të përmirësojnë transparencën, Palët botojnë ligjet, rregulloret dhe vendimet administrative të tyre të një zbatimi të përgjithshëm, si dhe marrëveshjet përkatëse ndërkombëtare që mund të prekin tregjet e tyre të prokurimeve, ose i bëjnë ato publikisht të disponueshme në një mënyrë tjetër. Palët u përgjigjen menjëherë pyetjeve specifike dhe i japin njëra- tjetrës, pas një kërkesë paraprake, informacion për çështjet të cilat i referohen këtij paragrafi.

3.Nëse, pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, një Palë i jep një shteti tjetër jo Palë përfitime shtesë në lidhje me aksesin në tregjet e prokurimit, ajo bie dakord të hyjë në negociata me synimin e shtrirjes së këtyre përfitimeve për një Palë tjetër mbi bazë reciproke.

KREU 5

PAGESAT DHE LËVIZJET E KAPITALIT

Neni 27

Pagesat për transaksionet korrente

Sipas dispozitave të Nenit 29, Palët marrin përsipër të lejojnë të gjitha pagesat për transaksionet korrente të cilat do bëhen në një monedhë lehtësisht të konvertueshme.

Neni 28

Lëvizjet e kapitalit

1.Palët sigurojnë që kapitali për investime i bërë në shoqëritë e krijuara në përputhje me ligjet e tyre, dhe çdo fitim i nxjerrë prej tyre si dhe shumat që dalin nga likuidimi i investimeve janë lehtësisht të transferueshme.

2.Palët bëjnë konsultime me synimin e lehtësimit të kapitalit ndërmjet Shqipërisë dhe shteteve të EFTA-s dhe për të arritur liberalizimin e plotë sapo të lejojnë kushtet.

Neni 29

Vështirësitë në bilancin e pagesave

Kur Shqipëria ose një Shtet i EFTA-s është në vështirësi serioze në bilancin e pagesave, ose nën kërcënimin e sa më sipër, Shqipëria ose Shteti i EFTA-s, përkatësisht, në përputhje me kushtet e parashikuara brenda kuadrit të GATT-it dhe në Nenet VIII dhe XIV të statuteve të Fondit Monetar Ndërkombëtar, mund të marrin masa kufizuese në lidhje me këto pagesa korrente nëse këto masa janë domosdoshmërisht të nevojshme. Shqipëria ose Shteti përkatës i EFTA-s, sipas rastit, informojnë Palën tjetër menjëherë për një masë të tillë dhe sapo të jetë e mundur japin një afat kohor për heqjen e tyre.

Neni 30

Qartësimet

Kuptohet se detyrimet e parashikuara në këtë Kapitull nuk cenojnë zbatimin e barabartë, jodiskriminues dhe në mirëbesim të masave në përputhje me urdhrat ose vendimet e gjykatës ose procedimet administrative. Kuptohet gjithashtu se e drejta e një investitori për të transferuar lirisht shuma në lidhje me investimin e tij nuk cenon asnjë detyrim fiskal që mund të ketë ky investitor.

KREU 6

DISPOZITAT INSTITUCIONALE

Neni 31

Komiteti i përbashkët

1. Palët krijojnë Komitetin e Përbashkët të Shqipërisë dhe EFTA-s. Ai përbëhet nga përfaqësues të Palëve, të cilat drejtohen nga Ministra ose nga zyrtarë të lartë të deleguar nga ministria për këtë qëllim.

2. Komiteti i Përbashkët:

(a) mbikëqyr dhe rishikon zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, ndër të tjera, nëpërmjet një rishikimi të plotë të zbatimit të dispozitave të kësaj marrëveshjeje, duke pasur parasysh rishikime specifike që përmbahen në këtë Marrëveshje;

(b) mban nën shqyrtim mundësinë e heqjes së mëtejshme të pengesave për tregtinë dhe masa të tjera kufizuese që lidhen me tregtinë ndërmjet Shqipërisë dhe Shteteve të EFTA-s;

(c) mbikëqyr zhvillimin e mëtejshëm të kësaj Marrëveshjeje;

(d) mbikëqyr punën e të gjitha nën-komiteteve dhe të grupeve të punës të krijuara sipas kësaj Marrëveshjeje;

(e) merr përsipër të zgjidhë mosmarrëveshjet që mund të dalin në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje;

(f) mbikëqyr zbatimin e Nenit 5; dhe

(g) shqyrton çdo çështje tjetër që ka ndikim mbi funksionimin e kësaj Marrëveshjeje.

3.Komisioni i Përbashkët mund të vendosë të krijojë nën-komisione dhe grupe pune kur i çmon të nevojshme për ta ndihmuar atë të kryejë detyrat e tij. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshje, nën-komitetet dhe grupet e punës punojnë sipas mandatit të përcaktuar nga Komiteti i Përbashkët.

4.Komiteti i Përbashkët merr vendime siç parashikohet në këtë Marrëveshje, dhe mund të bëjë rekomandime me konsensus.

5.Komiteti i Përbashkët mblidhet brenda një viti nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje. Më pas, ai mblidhet kurdo që çmohet e nevojshme me marrëveshje të përbashkët, por si rregull mblidhet një herë në dy vjet. Takimet e tij do të drejtohen bashkërisht nga Shqipëria dhe nga një prej Shteteve të EFTA-s. Komitetit i përbashkët krijon rregulloren e tij.

6.Çdo Palë, në çdo kohë, mund të kërkojë, nëpërmjet një njoftimi me shkrim për Palët e tjera, mbajtjen e një takimi të posaçëm të Komitetit të Përbashkët. Një takim i tillë do të zhvillohet brenda 30 ditësh nga marrja e kërkesës, me përjashtim të rasteve kur Palët bien dakord ndryshe.

7.Komiteti i Përbashkët mund të vendosë të amendojë Shtojcat dhe Protokollet e kësaj Marrëveshjeje. Sipas paragrafit 8, ai mund të caktojë një datë për hyrjen në fuqi të këtyre vendimeve.

8. Nëse një përfaqësues i një Pale në Komitetin e Përbashkët ka pranuar një vendim, i cili është subjekt i plotësimit të kërkesave kushtetuese, vendimi hyn në fuqi datën e fundit në të cilën Palët njoftojnë realizimin e kërkesave të brendshme, me përjashtim të rasteve kur vetë vendimi përcakton një datë të mëvonshme. Komiteti i Përbashkët mund të vendosë që vendimi të hyjë në fuqi për ato Palë që kanë plotësuar kërkesat e tyre të brendshme, me kusht që Shqipëria të jetë një ndër këto Palë. Një Palë mund të zbatojë një vendim të Komitetit të Përbashkët në mënyrë të përkohshme deri sa një vendim i tillë të hyjë në fuqi për atë Palë, nëse lejohet nga kërkesat e saj kushtetuese.

KREU 7

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 32

Konsultimet

1.Nëse lind ndonjë mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e kësaj marrëveshjeje, Palët e interesuara marrin çdo masë me anë të bashkëpunimit dhe

konsultimeve, nëse është e nevojshme me Komitetin e Përbashkët, për të arritur një zgjidhje reciprokisht të pranueshme.

2.Çdo Palë mund t'i kërkojë me shkrim konsultime një Pale tjetër në lidhje me një masë ekzistuese ose të propozuar apo çdo çështje tjetër që gjykon se ndikon në zbatimin e kësaj marrëveshjeje. Pala që kërkon konsultime në të njëjtën kohë njofton me shkrim për këtë Palët e tjera dhe jep të gjithë informacionin e duhur.

3.Konsultimet organizohen në Komitetin e Përbashkët nëse kërkohet prej njëres nga Palët, brenda 20 ditëve kalendarike pas marrjes së kërkesës me shkrim të cilës i referohet paragrafi 2, me qëllimin e gjetjes së një zgjidhjeje të pranueshme reciprokisht. Nëse Pala të cilës i është bërë kërkesa në përputhje me paragrafin 2 ose këtë paragraf nuk përgjigjet brenda 10 ditësh ose nuk hyn në konsultime brenda 20 ditësh pas marrjes së kërkesës, Pala që bën kërkesën ka të drejtë të drejtë të kërkojë një trup gjykues arbitrazhi në përputhje me Nenin 33.

Neni 33

Arbitrazhi

1.Mosmarrëveshjet ndërmjet Palëve në lidhje me interpretimin ose zbatimin e të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga kjo Marrëveshje, të cilat nuk janë zgjidhur me anë të konsultimeve të drejtpërdrejta në Komitetin e Përbashkët brenda 60 ditëve kalendarike nga data e marrjes së kërkesës për konsultime, mund t'i nënshtrohen procedurave të arbitrazhit, nga njëra prej Palëve në mosmarrëveshje me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar Palës tjetër në mosmarrëveshje. Një kopje e këtij njoftimi u komunikohet të gjitha Palëve të kësaj marrëveshjeje, në mënyrë që secila Palë të vendosë për të marrë ose jo pjesë në mosmarrëveshje.

2.Nëse ngritjen e një trupi gjykues arbitrazhi e kërkon më shumë se një Palë në lidhje me të njëjtën çështje, mund të ngrihet një trup gjykues arbitrazhi i vetëm për të shqyrtuar këto mosmarrëveshje, kurdoherë që është e mundur.¹

3.Një Palë që nuk është Palë në mosmarrëveshje, pas marrjes së kërkesës me shkrim nga Palët në mosmarrëveshje ka të drejtë të bëjë depozitime me shkrim për trupin gjykues të arbitrazhit, të marrë depozitime me shkrim, duke përfshirë dhe shtojcat nga Palët në mosmarrëveshje, të marrë pjesë në seancat gjyqësore ose të bëjë deklarata me gojë.

4.Trupi gjykuesi arbitrazhit përbëhet prej tre anëtarësh. Pas një njoftimi me shkrim, në përputhje me paragrafin 1 të këtij Neni, duke iu referuar mosmarrëveshjes për arbitrazh, Pala cakton një anëtar që mund të jetë nënshtetas ose banor i atij vendi. Brenda 30 ditësh nga marrja e njoftimit të cilit i referohet paragrafi 1 i këtij neni, pala të cilës i drejtohet ai, nga ana e saj, cakton një anëtar, i cili mund të jetë nënshtetas ose rezident i saj.

5.Brenda 60 ditësh nga marrja e njoftimit të cilit i referohet paragrafi 1 i këtij neni, të dy anëtarët e caktuar bien dakord për caktimin e një anëtari të tretë. Anëtari i tretë nuk është

nënshtetas i asnjërës Palë në mosmarrëveshje, dhe as nuk duhet të jetë rezident i përhershëm në territorin e ndonjërës nga Palët. Anëtarë i caktuar në këtë mënyrë është Kryetari i trupit gjykues të arbitrazhit.

6. Nëse asnjë nga të tre anëtarët as nuk është caktuar dhe as nuk është emëruar brenda 60 ditësh nga marrja e njoftimit të cilit i referohet paragrafi 1, secila Palë në mosmarrëveshje mund t'i kërkojë Sekretarit të Përgjithshëm të Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit në Hagë të caktojë një organ për të zgjedhur anëtarët.

7. Trupi gjykues i arbitrazhit e shqyrton çështjen që i tregohet në kërkesën për krijimin e një trupi gjykues arbitrazhi duke marrë parasysh dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, të zbatuara dhe të interpretuara në përputhje me rregullat e interpretimit të së drejtës ndërkombëtare publike. Vendimi i trupit gjykues të arbitrazhit është përfundimtar dhe detyrues për Palët në mosmarrëveshje.

8. Me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe në këtë marrëveshje ose kur bihet dakord ndërmjet Palëve në mosmarrëveshje, zbatohen Rregullat Opsionale për Mosmarrëveshjet e Arbitrazhit ndërmjet dy shteteve, të Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit (PCA), të cilat janë të zbatueshme që prej 20 tetorit 1992.

¹ Për qëllime të këtij Kreu, termat "Palë" dhe "palë në mosmarrëveshje" përdoren pavarësisht nëse në një mosmarrëveshje përfshihen dy ose më shumë palë.

Neni 34

Zbatimi i Vendimit

1.Pala në fjalë pajtohet menjëherë me vendimin e trupit gjykues të arbitrazhit. Nëse nuk është e mundur të zbatohet menjëherë vendimi, Palët në mosmarrëveshje përpiqen të bien dakord për këtë brenda një periudhe të arsyeshme. Në mungesë të një marrëveshjeje të tillë, brenda 30 ditësh nga data e vendimit, secila Palë në mosmarrëveshje, brenda 10 ditësh nga përfundimi i kësaj periudhe, mund t'i kërkojë trupit fillestar gjykues të arbitrazhit të përcaktojë kohëzgjatjen e periudhës së arsyeshme kohore.

2.Pala përkatëse njofton Palën tjetër në mosmarrëveshje për masën e vendosur për të zbatuar vendimin.

3.Nëse Pala në fjalë nuk e zbaton vendimin brenda një periudhe të arsyeshme kohe dhe kur Palët në mosmarrëveshje nuk kanë rënë dakord për ndonjë dëmshpërblim, Pala tjetër, deri sa të zbatohet plotësisht vendimi ose të zgjidhet mosmarrëveshja në një tjetër mënyrë, pas një njoftimi paraprak prej 30 ditësh, mund të pezullojë përfitimet e dhëna nga kjo Marrëveshje, por të cilat janë të barazvlefshme me masat e përcaktuara nga trupi gjykues i arbitrazhit si shkelje të kësaj Marrëveshjeje.

4.Çdo mosmarrëveshje që lidhet me zbatimin e vendimit ose njoftimin e pezullimit vendoset nga trupi gjykues i arbitrazhit me kërkesë të ndonjërës nga Palët në mosmarrëveshje para se të kërkohet dëmshpërblimi ose të zbatohen pezullimet e përfitimeve. Trupi gjykues i arbitrazhit mund të vendosë gjithashtu për përputhshmërinë me vendimin të çdo mase zbatuese të miratuar pas pezullimit të përfitimeve dhe mund të vendosë nëse pezullimi i përfitimeve duhet të përfundojë apo të amendohet. Vendimi i trupit të arbitrazhit sipas këtij paragrafi jepet si rregull brenda 45 ditësh nga data e marrjes së kësaj kërkesë.

KREU 8

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 35

Plotësimi i Detyrimeve

Palët marrin masat e përgjithshme dhe specifike të nevojshme për të plotësuar detyrimet që rrjedhin nga kjo Marrëveshje.

Neni 36

Shtojcat dhe Protokollet

Shtojcat dhe Protokollet e kësaj Marrëveshjeje, duke përfshirë dhe Shtojcat e tyre, janë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 37

Klauzolë zhvilluese

1.Palët bien dakord të rishikojnë këtë Marrëveshje duke marrë parasysh zhvillimet e mëtejshme në marrëdhëniet ekonomike ndërkombëtare, ndër të tjera, në kuadër të OBT-së, dhe të shqyrtojnë në këtë kuadër dhe në kontekstin e faktorëve përkatës mundësinë e zhvillimit dhe thellimit të mëtejshëm të bashkëpunimit sipas kësaj Marrëveshjeje dhe ta shtrijnë atë në fushat që nuk janë mbuluar deri tani. Komiteti i Përbashkët mund të shqyrtojë këtë mundësi, dhe kur është e nevojshme, u bën rekomandime Palëve, në veçanti në lidhje me çeljen e negociatave.

2.Marrëveshjet që rrjedhin nga procedura të cilës i referohet paragrafi 1 janë subjekt ratifikimi, pranimit ose miratimit nga Palët në përputhje me procedurën e tyre.

Neni 38

Amendimet

1.Palët bien dakord për ndryshimet e kësaj Marrëveshjeje. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga Palët, ndryshimet hyjnë në fuqi në ditën e parë të muajit të tretë pas depozitimit të instrumentit të fundit të ratifikimit, pranimit ose miratimit.

2.Teksti i amendimeve si dhe instrumentet e ratifikimit, pranimit ose miratimit depozitohen tek Depozitari.

Neni 39

Marrëdhënia me marrëveshje të tjera ndërkombëtare

1.Dispozitat e këtij Neni nuk cenojnë të drejtat dhe detyrimet e Palëve të Marrëveshjes së OBT-së dhe marrëveshjeve të tjera të negociuara më pas, për të cilat ato janë Palë, si dhe asnjë marrëveshje ndërkombëtare në të cilat janë Palë.

2.Kjo Marrëveshje nuk përjashton mbajtjen ose krijimin e bashkimeve doganore, zonave të tregtisë së lirë, rregullimet për tregtinë kufitare dhe marrëveshje të tjera preferenciale për aq

kohë sa ato nuk kanë ndikim në tjetërsimin e rregullimeve tregtare të parashikuara në këtë Marrëveshje.

3. Kur një Palë hyn në një bashkim doganor ose në një marrëveshje të tregtisë së lirë me një Palë të tretë, me kërkesë nga një Palë tjetër, ajo është e përgatitur të hyjë në konsultime me Palën kërkuese.

Neni 40

Aderimi

1. Çdo Shtet, që bëhet Anëtar i Shoqatës së Tregtisë së Lirë Evropiane mund të bëhet Palë e kësaj Marrëveshjeje, me kusht që Komiteti i Përbashkët të miratojë aderimin e saj, sipas kushteve për të cilat do të bihet dakord nga Palët. Instrumenti i aderimit depozitohet tek Depozitari.

2. Në lidhje me Shtetin pranues, kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën e parë të muajit të tretë pas depozitimit të instrumentit të saj të aderimit, ose miratimit të kushteve të aderimit nga Palët ekzistuese, në bazë të datës më të vonë.

Neni 41

Tërheqja dhe përfundimi i afatit

1. Çdo Palë mund të tërhiqet nga kjo Marrëveshje me anë të një njoftimi me shkrim tek Depozitari. Tërheqja hyn në fuqi gjashtë muaj nga data e marrjes së njoftimit nga Depozitari.

2. Nëse Shqipëria tërhiqet, kjo Marrëveshje përfundon kur kjo tërheqje bëhet efektive.

3. Çdo shtet i EFTA-s i cili tërhiqet nga Konventa që krijon Shoqatën e Tregtisë së Lirë Evropiane, ipso facto, në të njëjtën ditë kur tërheqja hyn në fuqi, pushon së qeni Palë në këtë Marrëveshje.

Neni 42

Hyrja në Fuqi

1. Kjo Marrëveshje është objekt ratifikimi, pranimi ose miratimi, në përputhje me kërkesat kushtetuese të Palëve. Instrumentet e ratifikimit, pranimit dhe miratimit depozitohen tek Depozitari.

2. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi më [1 prill 2010] në lidhje me ato Palë që kanë depozituar instrumentet e tyre të ratifikimit, pranimit ose miratimit ose kanë njoftuar zbatimin e përkohshëm tek depozitari të paktën dy muaj para asaj date, dhe me kusht që Shqipëria të jetë ndërmjet tyre.

3. Në rast se kjo Marrëveshje nuk hyn në fuqi më [1 prill 2010] ajo hyn në fuqi ditën e parë të muajit të tretë pasi Shqipëria dhe të paktën një shtet tjetër i EFTA-s i kanë depozituar instrumentet e tyre të ratifikimit, pranimit ose miratimit, ose i kanë njoftuar zbatim të përkohshëm Depozitarit.

4. Në lidhje me një shtet EFTA që depoziton instrumentin e saj të ratifikimit, pranimit ose miratimit pasi kjo Marrëveshje ka hyrë në fuqi, kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën e parë të muajit të tretë pas depozitimit të instrumentit të saj të ratifikimit, pranimit ose miratimit.

5. Nëse e lejojnë kërkesat kushtetuese, Shqipëria ose çdo Shtet i EFTA-s mund të zbatojnë këtë Marrëveshje në mënyrë të përkohshme, në pritje të ratifikimit, pranimit ose miratimit nga kjo Palë. Zbatimi i përkohshëm i kësaj Marrëveshjeje i njoftohet Depozitarit.

6. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ose zbatohet përkohësisht ndërmjet Shqipërisë dhe shteteve të EFTA-s, me përjashtim të rasteve kur marrëveshja plotësuese për tregtimin e produkteve bujqësore ndërmjet Shqipërisë dhe shteteve të EFTA-s hyn në fuqi ose në të njëjtën kohë zbatohet përkohësisht. Ajo mbetet në fuqi ndërmjet Shqipërisë dhe shtetit të EFTA-s për aq kohë sa marrëveshja plotësuese mbetet në fuqi ndërmjet tyre.

Neni 43

Depozitari

Qeveria e Norvegjisë shërben si depozitare.

Në prani të nënshkruesve, të autorizuar zyrtarisht, nënshkruhet Marrëveshja;

Nënshkruar më [], sot [] më [], në një kopje origjinale. Depozitari u përcjell të gjitha Palëve kopjet e noterizuara.

Për Republikën e Shqipërisë

Për Republikën e Islandës

.....

.....

Për Principatën e Lihtenshtejnit

.....

Për Mbretërinë e Norvegjisë

.....

Për Konfederatën Zvicerane

.....

SHTOJCA I

E REFERUAR NËNPARAGRAFIN 1 (A) TË NENIT 6 MBI PRODUKTET E NDALUARA

Produktet e renditura në tabelën më poshtë janë përjashtuar nga zbatimi i nënparagrafit 1 (a) të nenit 6 të kësaj Marrëveshjeje.

Tabela 1 - Për shtetet e EFTA-s

Kodi HS	Përshkrimi i produkteve	Përjashtohen kur importohen në:
35.01	Kazeina, Kazeinatet dhe derivate të tjera të kazeinës; precipitues kazeine.	Norvegji Lihtenshtejni/ Zvicra
35.02	Albumina (përfshirë këtu koncentrate të dy ose më tepër proteinave të hirrës, që përbëjnë mbi 80% të proteinave të hirrës, e llogaritur në bazë të peshës së thatë, albuminate dhe derivate të tjera të albuminës.	
	- Albumina e vezës:	
3502.11	-- E thatë	Norvegjia Lihtenshtejni/ Zvicra
3502.19	-- Të tjera	Norvegjia Lihtenshtejni/ Zvicra
3502.20	- Albumina e qumështit, përfshirë këtu koncentrate të dy ose më tepër proteinave të hirrës.	Norvegjia
3502.90	- Të tjera	Norvegjia

Kodi HS	Përshkrimi i produkteve	Përjashtohen kur importohen në:
35.05	Dekstrina dhe të tjera amidone të modifikuara (për shembull, të prexhelatinuar ose amidone të esterifikuara); koagulantë me bazë amidone, ose dekstrina, ose në amidone të modifikuara.	
3505.10	- Dekstrina dhe të tjera amidone të modifikuara	Norvegjia Lihtenshteini/ Zvicra
ex 3505.20	- Koagulantë, për ushqim kafshësh	Lihtenshtejni/ Zvicra
38.09	Agjentët ndihmues, fiksuesit e ngjyrave të cilët përshpejtojnë ngjyrosjen ose fiksimin e ngjyruessve dhe produkteve të tjera dhe përgatitjeve (për shembull, mbushësit dhe fiksuesit) e grupit të përdorur në industrinë e tekstilit, letër ose të ngjashme me këto, askund tjetër specifikuar ose përfshirë.	

ex 3809.10	- Me bazë substancat amilace, për ushqyerjen e kafshëve	Lihtenshtejni/ Zvicra
38.23	Acidet yndyrore monokarboksilike industrialë; vajrat acide nga rafinimi; alkoolet yndyrore industrial.	
	- Acidet yndyrore monokarboksilikë industrialë; vajrat acide nga rafinimi:	
ex 3823.11	-- Acidi stearik, për ushqyerjen e kafshëve	Norvegjia Lihtenshtejni/ Zvicra
ex 3823.12	-- Acidi oleik, për ushqyerjen e kafshëve	Norvegjia Lihtenshtejni/ Zvicra
ex 3823.13	-- Acidet yndyrore me varg të gjatë të vajit, për ushqyerjen e kafshëve	Norvegjia
ex 3823.19	-- Të tjera acide yndyrore për ushqyerjen e kafshëve	Norvegjia Lihtenshtejni/ Zvicra
ex 3823.70	- Alkoole yndyrore industriale, për ushqyerjen e kafshëve	Norvegjia

Tabela 2

Për Shqipërinë

Tarifa doganore shqiptare	Përshkrimi i produkteve
2905.43.00	MAMTOL
2905.44.11	PERMBAN 2 % OSE ME PAK NE PESHE D-MANMTOL, I PERLLOGARITUR NE PERMBAJTJE D-GLUCITOLI
2905.44.19	TE TJERE
2905.44.91	PERMBAN 2 % OSE ME PAK NE PESHE D-MANNITOL, I PERLLOGARITUR NE PERMBAJTJE D-GLUCITOLI
2905.44.99	TE TJERE
2905.45.00	GLICEROL
3301.11.10	VAJRAT TERPENOIKE TE BERGAMOTIT, PERFSHIRE BETONET DHE ABSOLUTES
3301.11.90	VAJRAT JOTERPENOIKE TE BERGAMOTIT, PERFSHIRE BETONET DHE ABSOLUTES
3301.12.10	VAJRAT TERPENOIKE TE EMBELSIRAVE DHE PORTOKALLIT TE HIDHET, PERFSHIRE BETONET DHE ABSOLUTES (PËRJASHTOHEN VAJI I LULES SË PORTOKALLIT)
3301.12.90	VAJRAT JOTERPENOIKE TE EMBELSIRAVE DHE PORTOKALLIT TE HIDHET, PERFSHIRE BETONET DHE ABSOLUTES (PËRJASHTOHEN VAJI I LULES SË PORTOKALLIT)
3301.13.10	VAJRATA ESENCIALE TERPENOIKE TE LIMONIT, PERFSHIRE BETONET DHE ABSOLUTES

3301.13.90	VAJRATA JOTERPENOIKE TE LIMONIT, PERFSHIRE BETONET DHE ABSOLUTES
3301.14.10	VAJRAT TERPENOIKE TE LIMONIT TE ATHET, PERFSHIRE BETONE DHE ABSOLUTES
3301.14.90	VAJRAT JOTERPENOIKE TE LIMONIT TE ATHET, PERFSHIRE BETONE DHE ABSOLUTES
3301.19.10	VAJRAT ESENCIALE TERPENOIKE TE FRUTAVE TE AGRUMEVE, PERFSHIRE BETONET DHE ABSOLUTES (PËRJASHTUAR ATO TË BERGAMOTIT, PORTOKALLIT TË ËMBËL DHE TË HIDHËT, LIMONIT DHE LIMONI I ATHËT)
3301.19.90	VAJRAT ESENCIALE JOTERPENOIKE TE FRUTAVE TE AGRUMEVE, PERFSHIRE BETONET DHE ABSOLUTES (PËRJASHTUAR ATO TË BERGAMOTIT, PORTOKALLIT TË ËMBËL DHE TË HIDHËT, LIMONIT DHE LIMONI I ATHËT)
3301.21.10	VAJRAT TERPENOIKE TE GERANIUMIT, PERFSHIRE BETONET DHE ABSOLUTES
3301.21.90	VAJRAT JOTERPENOIKE TE GERANIUMIT, PERFSHIRE BETONET DHE ABSOLUTES
3301.22.10	VAJRAT TERPENOIKE TE JASMINIT, PERFSHIRE BETONET DHE ABSOLUTES
3301.22.90	VAJRAT JOTERPENOIKE TE JASMINIT, PERFSHIRE BETONET DHE ABSOLUTES
3301.23.10	VAJRAT TERPENOIKE TE TRUMZES SE BUTE OSE TE LAVANDINIT, PERFSHIRE BETONET DHE ABSOLUTES
3301.23.90	VAJRAT JOTERPENOIKE TE TRUMZES SE BUTE OSE TE LAVANDINIT, PERFSHIRE BETONET DHE ABSOLUTES
3301.24.10	VAJRAT TERPENOIKE TE MENDRES "MENTHA PIPERITA", PERFSHIRE BETONET DHE ABSOLUTES
3301.24.90	VAJRAT JOTERPENOIKE TE MENDRES "MENTHA PIPERITA", PERFSHIRE BETONET DHE ABSOLUTES
3301.25.10	VAJRAT TERPENOIKE TE MENEXHIKUT, MINTS, PERFSHIRE BETONET DHE ABSOLUTES (PERJASHTUAR ATO TË MENDRËS "MENTHA PIPERITA")
3301.25.90	VAJRAT JOTERPENOIKE TE MENEXHIKUT, MINTS, PERFSHIRE BETONET DHE ABSOLUTES (PERJASHTUAR ATO TË MENDRËS "MENTHA PIPERITA")
3301.26.10	VAJRAT TERPENOIKE TE VETIVER, PERFSHIRE BETONET DHE ABSOLUTES
3301.26.90	VAJRAT JOTERPENOIKE TE VETIVER, PERFSHIRE BETONET DHE ABSOLUTES
3301.29.11	VAJRAT TERPENOIKE TE KARAFILIT, NIAOULI DHE YLANG. YLANG, PERFSHIRE BETONET DHE ABSOLUTES
3301.29.31	VAJRAT JOTERPENOIKE TE KARAFILIT, NIAOULI DHE YLANG.YLANG, PERFSHIRE BETONET DHE ABSOLUTES
3301.29.61	VAJRAT ESENCIALE, JO TE DETERPENUAR, PERFSHIRE BETONET DHE ABSOLUTES (PERVECC FRUTAVE TE AGRUMEVE, GERANIUMIT, JASMINËS, TRUMZËS SË BUTË, MENDRËS, VETIVER, KARAFILIT, NIAOULI DHE YLANG. YLANG)
3301.29.91	VAJRAT ESENCIALE JOTERPENOIKE PERFSHIRE BETONE DHE ABSOLUTES (PERJASHTOHEN. 3301.11.10 DERI NË 3301.29.59)
3301.30.00	RESINOIDE
3301.90.10	NENPRODUKTET TERPENOIKE TE DETERPENIMIT TE VAJRAVE ESENCIALE
3301.90.21	TE KANELLES DHE HUMULUS LUPULUS

3301.90.30	TE TJERE
3301.90.90	TE TJERE
3302.10.10	TE NJE FORTESI ALKOLIKE AKTUALE ME VELLIM ME TE MADH SE 0,5 %
3302.10.21	QE NUK PERMBAN YNDYRNA QUMESHTI, SUKROZE, IZOGLUKOZE, GLUKOZE OSE AMIDON OSE PERMBAN, NË MASË, MË PAK SE 1,5 % YNDYRNA QUMËSHTI, 5 % SUKROZË OSE IZOGLUKOZË, 5 % GLUKOZË OSE AMIDON
3302.10.29	TE TJERE
3302.10.40	PERZIERJE TE SUBSTANCIVE AROMATIKE DHE PERZIERJE, PERFSHIRE TRETESIRA ALKOLIKE, ME NJE BAZE TË NJË OSE MË TEPËR PREJ SUBSTANCIVE TË MËSIPËRME, TË TILLA TË PËRDORURA SI LËNDË E PARË NË INDUSTRIJË E PIJEVE, DHE PËRGATITJE TË BAZUARA NË SUBSTANCAT AROMATIKE
3302.10.90	PERZIERJET E SUBSTANCIVE ODORIFEROUS DHE PERZIERJE, PERFSHIRE NE TRETESIRAT ALKOLIKE, ME BAZË TË NJË OSE MË TEPËR SUBSTANCA TË MËSIPËRME, TË PËRDORURA SI LËNDË TË PARA NË DEGË TË NDRYSHME TË INDUSTRIJËSË USHQIMORE
3501.10.10	PER PRODHIMIN E FIBRAVE TEKSTILE TE RIGJENERUARA
3501.10.50	PER PERDORIME INDUSTRIALE ME TEPER SE PRODHIMIN E BAZES USHQIMORE OSE FARAGJEREVE
3501.10.90	TE TJERA
3501.90.10	KOAGULANT KAZEINE
3501.90.90	TE TJERE
3502.11.10	ALBUMINE VEZE, E THARE P.SH. NE SHITRESA, KOKRIZORE, PETEZA, PUDER', I PAPERSHTATSHEM OSE TE SHNDËRROHET NË TË PAPËRSHTATSHËM PËR KONSUM NJERËZOR
3502.11.90	ALBUMINE VEZE, E THARE P.SH. NE SHITRESA, KOKRIZORE, PETEZA, PUDER', I PAPERSHTATSHEM OSE TE SHNDËRROHET NË TË PAPËRSHTATSHËM PËR KONSUM NJERËZOR
3502.19.10	ALBUMINE VEZE, E THARE, I PAPERSHTATSHEM OSE TE SHNDERROHET NE TE PAPERSHTATSHEM PER KONSUM NJERËZOR (PËRJASHTUAR E THATRË [NË SHITRESA, KOKRIZORE, PETËZA, PUDËR])
3502.19.90	ALBUMINE VEZE, E PERSHTATSHME PER KONSUM NJEREZOR (PERJASHTUAR E THARE [NE SHITRESA, KOKRIZORE, PETËZA, PUDËR])

3502.20.10	ALBUMINË QUMESHTI 'LAKTALBUMINË', PERSHIRË KONCENTRATE TE DY OSE ME TEPER PROTEINA HIRRE, QË PËRMBAJNË > 80% NË PESHË PROTEINA HIRRE, E LOGARITUR NE MASE TE THATE, I PAPERSHTATSHEM OSE TË SHNDËRROHET NE TË PAPËRSHTATSHËM PËR KONSUM NJEREZOR
3502.20.91	ALBUMINE QUMESHTI 'LAKTALBUMINË', PERSHIRE KONCENTRATE TE DY OSE ME TEPER PROTEINA HIRRE, QE PERMBAJNE > 80% NE PESHE PROTEINA HIRRE, E LOGARITUR NE MASE TE THATE, I PAPERSHTATSHEM OSE TË SHNDËRROHET NE TË PAPËRSHTATSHËM PËR KONSUM NJEREZOR, E THARE 'P.SH. NE SHITRESA, KOKRIZORE, PETEZA, PUDER'
3502.20.99	ALBUMINE QUMESHTI 'LAKTALBUMINË', PERSHIRE KONCENTRATE TE DY OSE ME TEPER PROTEINA HIRRE, QË PËRMBAJNË > 80% NE PESHË PROTEINA HIRRE, E LOGARITUR NE MASË TË THATË, E PËRSHTATSHME PËR KONSUM NJEREZOR (PEJASHTUAR E THARE [P. SH. NE SHITRESA, PETEZA, KRISTALE, PUDER])

3502.90.20	ALBUMINA, TE PAPERSHTATSHME, OSE TE SHNDERRUARA NE TE PAPERSHTATSHME (PERJASHTUAR ALBUMINEN E VEZES DHE ALBUMINEN E QUMESHTIT [PERSHIRE KONCENTRATE TE DY OSE ME TEPER PROTEINAVE QE PERMBAJNE NE PESHE > 80% PROTEINA HIRRE, LLOGARITUR NE MASE TE THATE])
3502.90.70	ALBUMINA, TE PERSHTATSHME PER KONSUM NJEREZO (PERJASHTUAR ALBUMINEN E VEZES DHE ALBUMINEN E QUMESHTIT 'LAKTALBUMIN)
3502.90.90	ALBUMINATE DHE DERIVATE TE TJERA TE ALBUMINES
3503.00.10	XHELATINA, PAVARESISHT SE ESHTJE NE SIPERFAQE KATRORE OSE DREJTKENDORE, ME OSE TE PAPUNUAR SIPERFAQEN APO TË NGJYROSUR,DHE DERIVATE TË SAJ (PËRJASHTUAR XHELATINAT E PAPANASTËRT)
3503.00.80	ISINGLASS; KOAGULANTE TE TJERE ME ORIGJINE NGA KAFSHET (PERJASHTO KOAGULANTET E KAZEINES TE KREUT 3501)
3504.00.00	PEPTONET DHE DERIVATET E TYRE; SUBSTANCA TE TJERA PROTEINIKE DHE DERIVTE TE TYRE OTHER PROTEIN SUBSTANCES AND THEIR DERIVATIVES N.E.S.; PUDER E FSHEHUR E NGJYROSUR OSE JO
3505.10.10	DEKSTRINAT
3505.10.50	AMIDONE, TE ESTERIFIKUAR OSE ETERIFIKUAR
3505.10.90	TE TJERA
3505.20.10	QE PERMBAJNE ME PAK SE 25 % TE AMIDONIT OSE DEKSTRINAVE, OSE AMIDONEVE TE MODIFIKUARA TE TJERA, NE PESHE
3505.20.30	QE PERMBAJNE 25 % OSE ME TEPER, POR ME PAK SE 55% TE AMIDONIT OSE DEKSTRINAVE, OSE AMIDONEVE TË MODIFIKUARA TË TJERA, NE PESHË
3505.20.50	QE PERMBAJNE 55 % OSE ME TEPER, POR ME PAK SE 80% TE AMIDONIT OSE DEKSTRINAVE, OSE AMIDONEVE TË MODIFIKUARA TË TJERA, NE PESHË
3505.20.90	QE PERMBAJNE 80 % OSE ME TEPER NE PESHE TE AMIDONIT OSE DEKSTRINAVE, OSE AMIDONEVE TE MODIFIKUARA TE TJERA
3809.10.30	QE PERMBAJNE NE PESHE 55% OSE ME TEPER POR ME PAK SE 70% TE KETYRE SUBSTANCAVE
3809.10.50	QE PERMBAJNE NE PESHE 70% OSE ME TEPER POR ME PAK SE 83% TE KETYRE SUBSTANCAVE
3809.10.90	QE PERMBAJNE NE PESHE 83% OSE ME TEPER TE KETYRE SUBSTANCAVE
3823.11.00	ACID STEARIK
3823.12.00	ACID OLEIK
3823.13.00	ACIDE YNDYRORE ME VARG TE GJATE
3823.19.10	ACIDE YNDYRORE TE DISTILUARA
3823.19.30	DISTILAT ACIDESH YNDYRORE
3823.19.90	TE TJERA
3823.70.00	ALKOLE YNDYRORE INDUSTRIALE
3824.60.11	QE PERMBAJNE 2 % OSE ME PAK NE PESHE D-MANNITOL, I PERLLOGARITUR NE PERMBAJTJE D-GLUCITOLI

3824.60.19	TE TJERE
3824.60.91	QE PERMBAJNE 2 % OSE ME PAK NE PESHE D-MANNITOL, I PERLLOGARITUR NE PERMBAJTJE D-GLUCITOLI
3824.60.99	TE TJERE
4101.20.10	LEKURA DHE GEZOFE TE PLOTA TE PAPERPUNUAR TE GJEDHEVE "PERFSHI. DEMAT" OSE KAFSHET NJËTHUNDRAKE, TË HEQUR APO JO QIMET OSE COPËTUARA, ME NJE PESHË PËR LËKURË < 16 KG, E FRESKET'
4101.20.30	LEKURA DHE GEZOFE TE PLOTA TE PAPERPUNUAR TE GJEDHEVE "PERFSHI. DEMAT" OSE KAFSHET NJETHUNDRAKE, TE HEQUR APO JO QIMET OSE COPETUARA, ME NJE PESHE PER LEKURE < 16 KG, E KRIPOSUR E LAGESHT'
4101.20.50	LEKURA DHE GEZOFE TE PLOTA TE PAPERPUNUAR TE GJEDHEVE "PERFSHI. DEMAT" OSE KAFSHET NJETHUNDRAKE, TE HEQUR APO JO QIMET OSE COPETUARA, ME NJE PESHE PER LEKURE < 8 KG ATEHERE KUR ESHTË THJESHT E THATE OSE < 10 KG KUR ESHTË E KRIPOSUR DHE E THATE'
4101.20.90	LEKURA DHE GEZOFE TE PLOTA TE PAPERPUNUAR TE GJEDHEVE "PERFSHI. DEMAT" OSE KAFSHET NJETHUNDRAKE, TE HEQUR APO JO QIMET OSE COPETUARA, ME NJE PESHE PER LEKURE < 16 KG, E GELQEROSUR, MBAJTUR NE SHELLIRE OSE ME METODA TE TJERA RUAJTJEJE (PERJASHTUAR KRIPOSJEN E FRESKËT OSE TË LAGËSHT, THARJE E THJESHTË OSE E THARE ME KRIPOSJE, E TYMOSUR OSE REGJUR
4101.50.10	LEKURA OSE GEZOFE TE PAPERPUNUAR TE GJEDHEVE 'PERFSHIRE. DEMAT" OSE KAFSHET NJETHUNDRAKE, TE HEQUR APO JO QIMET APO TE COPETUAR ME NJE PESHE PER LEKURE > 16 KG, E FRESKET'
4101.50.30	LEKURA DHE GEZOFE TE PLOTA TE PAPERPUNUAR TE GJEDHEVE "PERFSHI. DEMAT" OSE KAFSHET NJETHUNDRAKE, TE HEQUR APO JO QIMET OSE COPETUARA, ME NJE PESHE PER LEKURE > 16 KG, E KRIPOSUR E LAGESHT'
4101.50.50	LEKURA DHE GEZOFE TE PLOTA TE PAPERPUNUAR TE GJEDHEVE "PERFSHI. DEMAT" OSE KAFSHET NJETHUNDRAKE, TE HEQUR APO JO QIMET OSE COPETUARA, ME NJE PESHE PER LEKURE > 16 KG E THATE OSE E THARE ME KRIPOSJE'
4101.50.90	LEKURA DHE GEZOFE TE PLOTA TE PAPERPUNUAR TE GJEDHEVE "PERFSHI. DEMAT" OSE KAFSHET NJETHUNDRAKE, TE HEQUR APO JO QIMET OSE COPETUARA, ME NJE PESHE PER LEKURE > 16 KG, E GELQEROSUR, MBAJTUR NE SHELLIRE OSE ME METODA TE TJERA RUAJTJEJE (PERJASHTUAR KRIPOSJEN E FRESKËT OSE TË LAGËSHT, THARJE E THJESHTË OSE E THARE ME KRIPOSJE, E TYMOSUR OSE REGJUR
4101.90.00	BUTTS, BENDS, BELLIES DHE LEKURA TE PAPERPUNUAR TE GJEDHEVE "PERFSHIRE, DEMAT" OSE KAFSHET NJETHUNDRAKE, TE HEQUR OSE JO QIMET, E FRESKET OSE E KRIPOSUR, E THARE, E GELQEROSUR, NE SHËLLIRË OSE E RUAJTUR NDRYSHE, DHE LËKURA TË PLOTE ME NJE PESHË PËR LËKURË > 8 KG BUT
4102.10.10	LEKURA TE QINGJAVE, ME LESH, TE FRESKETA OSE TE KRIPOSUAR, TE THARA, TE GELQEROSURA, TE VENDOSURA NE SHELLIRE OSE TE RUAJTURA ME METODA TE TJERA (PERJASHTUAR, ATO TE SHQERRAVE TE ASTRAKHANIT, KARAKULIT, PERSIANE, BROADTAIL APO TE NGJASHME, OSE INDIANE, KINEZE, MONGOLE TIBETIANE)
4102.10.90	LEKURA TE QINGJAVE, ME LESH, TE FRESKETA OSE TE KRIPOSUAR, TE THARA, TE GELQEROSURA, TE VENDOSURA NE SHELLIRE OSE TE RUAJTURA ME METODA TE TJERA (PERJASHTUAR, ATO TE SHQERRAVE)
4102.21.00	LEKURA TE SHQERRAVE DHE DHENJVE, PA LESH, TE MBAJTURA NE SHELLIRE, TE COPETUARA OSE JO
4102.29.00	LEKURA TE QINGJAVE DHE DHENJVE, PA LESH, TE FRESKETA OSE TE KRIPOSURS, TE THARA, TE GELQEROSURA OSE TE RUAJTURA NE MENYRA TE TJERA, TE NDARA OSE JO (PERJASHTUAR MBAJTJEN NE

	SHELLIRE OSE REGJEN)
4103.10.20	LEKURA TE DHIVE OSE KECAVE, TE FRESKETA, TE HEQUR QIMET OSE JO OSE TE NDARE (PERJASHTUAR LËKURAT NGA DHI DHE KECA ME ORIGJINE NGA JEMENI, MONGOLIA OSE TIBETI ME LESH NE LËKURË)
4103.10.50	LEKURA TE DHIVE OSE KECAVE, TE KRIPOSURA OSE TE THARA, TE HEQUR QIMET OSE JO OSE TE NDARE (PËRJASHTUAR LËKURAT NGA DHI DHE KECA ME ORIGJINE NGA JEMENI, MONGOLIA OSE TIBETI ME LESH NE LEKURE)
4103.10.90	LEKURA TE DHIVE OSE KECAVE, TE GELQEROSURA OSE TE TRAJTUARA NDRYSHE, TE HEQUR QIMET OSE JO OSE TË NDARE (PËRJASHTUAR LËKURAT NGA DHI DHE KECA ME ORIGJINE NGA JEMENI, MONGOLIA OSE TIBETI ME LESH NE LEKURE QE JANE TE FRESKETA, KRIPOSURA, TE THARA, TE REGJURA)
4103.20.00	GEZOFE DHE LEKURA TE REPTILEVE, TE FRESKETA OSE TE KRIPOSURA, TE THARA, TE GELQEROSURA, TRAJTUAR ME SHELLIRE OSE MENYRA TE TJERA TRAJTIMI, (PERJASHTUAR PARCHMENT DRESSED)
4103.30.00	LEKURE DERRI E PAPERPUNUAR, E FRESKET, OSE E KRIPOSUR, E THARE, E GELQEROSUR, E TRAJTUAR NE SHËLLIRË OSE E RUAJTUR NE MËNYRË TJETËR TË HEQUR QIMET OSE JO APO TE NDARE (PERJASHTUAR PARCHMENT DRESSED)
4103.90.00	LEKURE OSE GEZOF I PAPERPUNUAR, E FRESKET, OSE E KRIPOSUR, E THARE, E GELQEROSUR, E TRAJTUAR NE SHËLLIRË OSE E RUAJTUR NE MËNYRË TJETËR TË HEQUR QIMET OSE JO, PËRFSHIRË ZOGJTË ME OSE PA PUPLA (PERJASHTUAR PARCHMENT DRESSED, LËKURA DHE GËZOFË TË DEMAVE 'PERFSHI DEMT KAFSHËT, KAFSHËT NJETHU^DR^KE
4301.10.00	RAW FURSKINS QELBESI, E TERE, APO ME OSE PA KOKE, BISHT OSE KEMBE
4301.30.00	RAW FURSKINS E LLOJEVE TE MEPOSHEM TE QINGJAVE: TE ASTRAXHANIT, KARAKULIT, PERSIANE, BROADTAIL APO TE NGJASHME, SI EDHE INDIANE, KINEZE, MONGOLE TIBETIANE DHE TE NGJASHME, TE PLOTË, APO ME OSE PA KOKË, BISHT OSE KËMBË
4301.60.00	RAW FURSKINS DHELPRE, E TERE, APO ME OSE PA KOKE, BISHT OSE KEMBE
4301.70.10	RAE FURSKINS OF KELYSHEVE ME GEZOF TE BARDHE TE FOKAVE HARP OSE KELYSHEVE ME KURRIZ BLU TË FOKAVE ME KAPUCC, TË PLOTA, ME OSE PA KOKË, BISHT OSE KËMBË SIPAS RASTIT
4301.70.90	RAE FURSKINS OF TRUE AND EARED SEALS, I PLOTE, ME OSE PA KOKE, BISHT, PUTRA (PERJASHTUAR ATO TË KËLYSHËVE TË BARDHË TË FOKAVE HARP OSE PUPAVE BLUEBACK TË FOKAVE HOODED)
4301.80.10	RAE FURSKINS E VIDRES SE DETIT OSE COYPU, E PLOTE, ME OSE PA KOKE, BISHT OSE KEMBE
4301.80.30	RAE FURSKINS TE MARMOTES, E PLOTE, ME OSE PA KOK, BISHTA OSE KEMBE
4301.80.50	RAE FURSKINS OF MACEVE TE EGRA TE TE GJITHA LLOJEVE, ME OSE PA KOKE, BISHTA OSE KEMBE
4301.80.80	RAE FURSKINS, TE PLOTE, ME OSE PA KOKE, BISHT, OSE PUTRA (PERJASHTO ATO TE VIZONIT, QENGJIT, ASTRAXHANIT, KARAKULIT, PERSIANE, BROADTAIL DHE TE NGJASHME, INDIANE, KINEZE, MONGOLE OSE TIBETIANE, DHELPR, FOKA, VIDRA E DETIT, NUTRIA "COYPLT, MARMOTA DHE FELINET E EGER)
4301.80.95	RAE FURSKINS, TE PLOTA, ME OSE PA KOKE, BISHTA OSE PUTRA (PERJASHTO ATO TE VIZONIT, QENGJIT, ASTRAXHANIT, KARAKULIT, PERSIANE, BROADTAIL DHE TE NGJASHME, INDIANE, KINEZE, MONGOLE OSE TIBETIANE, DHELPR, FOKA, VIDRA E DETIT, NUTRIA "COYPU", MARMOTA DHE FELINET E EGER)
4301.90.00	KOKE, BISHTA, KEMBE DHE PJESE TE TJERA OSE PRERJE TE FURSKINS TE PERSHTATSHME PER PERDORIM NE GOZOFTARI

5001.00.00	FSHIKEZA MENDAFSHI TE PERSHTAT SHME PER BOBINA
5002.00.00	MENDAFSH I PAPERPUNUAR, AS I SPUN AS I HEDHUR
5003.10.00	METJE MENDAFSHI, PERFSHIRE FSHIKEZA TE PAPERSHTATSHME PER BOBINA, MBETJE FIJESH DHE STOK I KUQERREMTEN AS I PASTRUAR POR AS EDHE I KREHUR
5003.90.00	METURINA MENDAFSHI, PERFSHIRE FSHIKEZA TE PAPERDORSHME PER BOBINA, MBETURINA FIJESH DHE STOK I KUQËRREMTË, PASTRIM APO KREHJE
5101.11.00	LESH I SHKURTER I YNDYRSHEM, PERFSHIRE LESH I PARE, I PAPASTRUAR ME FURCE APO I PAKREHUR
5101.19.00	LESH I YNDYRSHEM, PERFSHIRE LESHIN E LARE, I PA PASTRUAR ME FURCE APO I PAKREHUR (PERJASHTO LESHI I SHKRUTER)
5101.21.00	LESH I SHKRUTE, I Ç'YNDYROSUR, I PAKARBONIZUAR), I PAPASTRUAR ME FURCCE DHE I PAKREHUR
5101.29.00	LESHI I Ç' YNDYROSUR, I PAKARBONIZUAR, I PAPASTRUAR ME FURCCE APO I PAKREHUR (PERJASHTOHET LESHI I SHKRUTER)
5101.30.00	LESH I KARBONIZUAR, AO I PASTRUAR ME FURCCE AS I KREPHUR
5102.11.00	QIMJA E DHIVE TE KASHMIRIT "CASHMERE", AS TE PASTROHET ME FURCCE AS TE KRIHET'
5102.19.10	QIMJA E BREJTESIT TE ANGORES AS TE PASTROHET ME FURCCE AS TE KREHET
5102.19.30	QIMJA E ALPACA, LAMES OSE VICUNES, AS TE PASTROHET AS TE KREHET
5102.19.40	QIMJA E GAMILES OSE JAKUT, OSE E DHIVE TE ANGORES, DHIVE TE TIBETIT AS TE PASTRUAR AS TE KREHUR
5102.19.90	QIMJA E BREJTESVE, LEPURIT, KASTORIT, NUTRIA "COYPU" OSE BREJTESIT MUSK. AS TE KREHURA AS TE PASTRUEA (PERJASHTO BREJTESI I ANGLOES)'
5102.20.00	FIJE TE ASHPRA KAFSHES, AS TE PASTRUARA AS TE KREHURA (PERJASHTO LESHI, FLOKU DHE QIMET E FORTA TË PËRDORURA NE PRODHIMIN E FHESAVE DHE FURCAVE DHE QIMET E KALIT TË MARRA NGA BISHIT OSE KRIFA)
5103.10.10	FIJE LESHI TE SHKURTRA OSE FIJE TE IMTA KAFSHESH, TE PAKARBONIZUARA (PERJASHTO STOQET E KUQERREMTE)
5103.10.90	FIJE LESHI TE SHKURTRA OSE FIJE TE IMTA KAFSHESH, TE KARBONIZUARA (PERJASHTO STOQET E KUQERREMTE)
5103.20.10	MBETURINA FIJESH LESHI OSE FIJE TE IMTA KAFSHESH
5103.20.91	MBETJE TE LESHIT OSE FIJE TE IMTA KAFSHESH , TE PAKARBONIZUARA (PERJASHTO MBETURINA FIJESH TE SHKURTRA DHE FIJESH TE IMTA)
5103.20.99	MBETURINA LESHI OSE FIJE TE IMETA KAFSHESH, TE KARBONIZUARA (PERJASHTUAR. MBETJE FIJE, YARN EASTE, NOILS DHE STOQE TË KUQËRREMTE)
5103.30.00	MBETURINA QIMESH JO CILESORE TE KAFSHEVE, PERFSHIRE MBEJTE FIJESH (PERJASHTUAR STOQE TE KUQËRREMTE, MBETURINA TË FLOKËVE OSE QIMEVE TË FORTA PËRDORURA NE PRODHIMIN E FURCAVE DHE FSHESAVE DHE TE QIMEVE TE KALIT NGA BISHIT DHE KRIFA)
5201.00.10	PAMBUK, JO I PASTRUAR DHE I KREHUR, THITHES OSE I ZBARDHUAR

5201.00.90	PAMBUK, JO I PASTRUAR DHE I KREHUR (PERJASHTO EXCL. THITHES OSE I ZBARDHUAR)
5202.10.00	MBETURINA FIJESH PAMBUKU
5202.91.00	STOK I KUQERREMTE I PAMBUKUT
5202.99.00	MBETURINA PAMBUKU (PERJASHTUAR MBETURINA TE LIDHURA DHE STOK I KUQERREMTE)
5203.00.00	PAMBUK, I PASTRUAR DHE KREHUR

5301.10.00	LIRI, I PAPERPUNUAR OSE I NJOME
5301.21.00	LIRI, I COPETUAR OSE I ZHVESHUR
5301.29.00	LIRI, I PACOPETUAR SAKTE OSE PERPUNUAR NDREYSE (PERJASHTUAR LIRI I THYER, ZHVESHUR DHE I NJOMË)
5301.30.10	FIJE LIRI TE KEPUTURA
5301.30.90	MBETURINA LIRI, PERFSHIRE METURINA TE HEDHURA DHE STOK I KUQERREMTE
5302.10.00	KERP 'CANNABIS SATIVA', I PAPERPUNUAR OSE I NJOME
5302.90.00	KERP 'CANNABIS SATIVA', PERPUNUAR PO JO I TJERRUR; FIBRA TE KEPUTURA DHE MBETURINA KERPI, PËRFSHIRË MBETURINAT E LIDHURA DHE METURINAT E KUQERREMTE (PËRJASHTUAR KËRPIN E NJOMË)

SHTOJCA II

E REFERUAR NË NËNPARAGRAFIN 1 (C) TË NENIT 6 PESHKU DHE PRODUKTE TË TJERA DETARE

Neni 1

Peshku dhe produktet e tjera detare të dhëna në listën e tabelës 1 mbulohen nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë shtojcë.

Tabela 1

Zëri nr.	Kodi SH	Përshkrimi i produkteve
02.08	ex 0208.40	Mishra të tjerë dhe organe të brendshme, i freskët, i kriposur ose i ngrirë. - Të balenave, delfinëve dhe derr deti (gjitarë të rendit Cetacea); të manateve dhe dugongëve (gjitarë të rendit Sirenia): - prej balenave ¹
Kreu 3		Peshk dhe krustace, molusqe dhe invertebrorë të tjerë akuatikë.

05.11		Produkte shtazore të paspecifikuar ose përfshirë diku tjetër; kafshë të ngordhura të Kapitullit 1 ose 3, të papërshtatshëm për konsum human. - Të tjerë:
	0511.91	- - Produkte peshku dhe krustacesh, molusqesh ose invertebrorë të tjerë akuatikë; kafshë të ngordhura të Kapitullit 3
15.04		Yndyrna dhe vajra dhe fraksionet e tyre, të peshqve ose gjitarëve të detit, por jo kimikisht të modifikuara. ²
15.16		Vajrat dhe yndyrnat me origjinë bimore dhe shtazore dhe funksionet e tyre, pjesërisht ose plotësisht të hidrogjenuar, ri- esterifikuar ose elaidinizuar, të rafinuara ose jo, por jo të përpunuara në stad tjetër.

¹ Një kufizim importi për produktet nga balena është zbatuar në Shqipëri, Lihtenshtejni dhe Zvicra në bazë të Konventës për Tregtinë Ndërkombëtare mbi Speciet në Rrezik të Faunës dhe Florës së Egër (Konventa CITES).

² Shih shënimin 1.

Zëri nr.	Kodi SH	Përshkrimi i produkteve
16.03	ex 1516.10	- yndyrnat dhe vajrat me origjinë shtazore dhe funksionet e tyre: - - të përfutuara plotësisht nga peshku ose gjitarë deti ³ Ekstrakte dhe lëngje mishi, peshku, krustacesh ose invertebrorë të tjera ujorë.
16.04	ex 1603.00	- Ekstrakte dhe lëngje mishi, peshku, krustacesh ose invertebrorë të tjera ujorë ⁴ Peshk i përpunuar ose i konservuar; haviar ose surrogato haviari të përgatitur nga vezë peshku.
16.05		Krustace, molusqe dhe invertebrorë të tjerë ujorë të përpunuar ose konservuar.
23.01		Miell, mbetje të thata ose peleta mishi ose mbeturina mishi nga peshku ose krustace, molusqe dhe invertebrorë të tjerë ujorë, të papërshtatshëm për konsum njerëzor; mbetje kockore.
	ex 2301.10	- Miell, mbetje të thata ose peleta mishi ose mbeturina mishi; mbetje kockore: - - prej balenave ⁵
	2301.20	- Miell, dhe peleta mishi të krustaceve, molusqeve apo invertebrorëve të tjerë akustikë Miell, ushqim dhe toptha prej peshku ose krustacesh, molusqesh e kafshëve të tjera
23.09		Preparate të përdorura për ushqime kafshësh.
	ex 2309.90	- Të tjerë: - - Tretësira peshku

Neni 2

Me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Shqipëria dhe Shtetet e EFTA-s heqin tarifat doganore për importimin dhe tatimin me efekt të barazvlefshëm për produktet e dhëna në listën e Tabelës 1 që e kanë origjinën në Shqipëri ose në një Shtet të EFTA-s, me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe në Nenin 3.

³ Shih shënimin 1

⁴ Shih shënimin 1.

⁵ Shih shënimin 1.

Neni 3

Zvicra, duke përfshirë dhe territorin e Lihtenshtejnit, mund të vendosë tarifa doganore për produktet që e kanë origjinën në Shqipëri dhe përfshihen në Tabelën 2.

Tabela 2

Kodi SH	Përshkrimi i produkteve
ex 0511.91	Ushqime për kafshët prodhuese
ex 15.04 dhe ex 1516.10	Dhjamra dhe vajra për konsum njerëzor
ex 2301.10 dhe ex 2301.20	Ushqime për kafshët prodhuese
ex 2309.90	Ushqime për kafshët prodhuese

SHTOJCA III

E REFERUAR NË NENIN 13 LEHTËSIMI I TREGTISË

Neni 1

Të përgjithshme

Palët, me qëllim që t'u shërbejnë interesave të komuniteteve të tyre të biznesit dhe të krijojnë një mjedis tregtar që u lejon atyre të përfitojnë nga mundësitë që u ofrohen nga Marrëveshja, bien dakord që parimet e mëposhtme, në veçanti, janë baza për zhvillimin dhe administrimin, nga autoritetet kompetente, të masave të lehtësimit të tregtisë:

(a) transparenca, efikasiteti, thjeshtësia, harmonizimi dhe përputhshmëria e procedurave

tregtare;

(b) promovimi i standardeve ndërkombëtare;

(c) përputhshmëria me instrumentet shumëpalëshe;

(d) përdorimi më i mirë i mundshëm i teknologjisë së informacionit;

(e) standardet e larta të shërbimit publik;

(f) kontrollet qeveritare bazuar në menaxhimin e rrezikut;

(g) bashkëpunimi brenda secilës Palë ndërmjet doganave dhe autoriteteve të tjera kufitare;

dhe

(h) konsultimet ndërmjet Palëve dhe komuniteteve të tyre përkatëse të biznesit.

Neni 2

Transparenca

1.Çdo Palë boton menjëherë, dhe në internet, në gjuhën angleze, të gjitha ligjet dhe rregulloret e një zbatimi të përgjithshëm që lidhen me tregtimin e mallrave dhe shërbimeve të tjera përkatëse ndërmjet Shqipërisë dhe Shteteve të EFTA-s.

2.Çdo Palë përcakton pika kontakti për çështje doganore, të cilët mund të kontaktohen në gjuhën angleze, me anë të internetit.

3.Secila Palë konsultohet me komunitetin e saj përkatës së biznesit për nevojat e saj në lidhje me zhvillimin dhe zbatimin e masave të lehtësimit të tregtisë, duke theksuar se një vëmendje e veçantë u duhet dhënë interesave të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Neni 3

Bashkëpunimi në lehtësimin e tregtisë

1.Palët identifikojnë dhe paraqesin para Komisionit të Përbashkët, masa të mëtejshme me qëllimin e lehtësimit të tregtisë ndërmjet Palëve, sipas nevojës.

2.Palët nxisin bashkëpunimin ndërkombëtar në forumet përkatëse shumëpalëshe që rregullojnë lehtësimin e tregtisë. Palët rishikojnë iniciativat përkatëse tregtare në mënyrë që të identifikojnë dhe t'i dërgojnë Komitetit të Përbashkët për shqyrtim, fusha të tjera në të cilat veprimi i përbashkët mund të kontribuojë për arritjen e objektivave të tyre të përbashkëta.

Neni 4

Vendimet paraprake

1. Secila Palë, në përputhje me legjislacionin e saj të brendshëm, nxjerr një vendim paraprak me shkrim pas marrjes së kërkesës me shkrim, i cili përmban të gjithë informacionin e nevojshëm të një importuesi, prodhuesi ose eksportuesi në territorin e tij, ose të një eksportuesi ose prodhuesi në territorin e një Palë tjetër në lidhje me:

(a) klasifikimin tarifor të një produkti dhe nivelin tarifor të zbatuar për produktin, ose, kur nevojitet, mënyrën sesi një nivel tarifor përlllogaritet për një produkt; dhe

(b) çështje të tjera për të cilat mund të bien dakord Palët.

2.Palët angazhohen të zhvillojnë procedura me anë të të cilave çdo Palë, pas kërkesës me shkrim dhe para eksportimit të një produkti tek një Palë tjetër, i japin një eksportuesi ose prodhuesi në territorin e vet një vendim paraprak me shkrim për statusin origjinues të atij produkti.

3.Një Palë që nuk jep vendimin paraprak e njofton menjëherë me shkrim personin që kërkon vendimin paraprak, duke parashtruar bazën e vendimit të tij për të mos nxjerrë një informacion paraprak.

4.Secila Palë parashikon se vendimi paraprak hyn në fuqi në datën e nxjerrjes së vendimit ose në një datë tjetër të specifikuar në vendim, me kusht që faktet dhe rrethanat në të cilat bazohet vendimi të mbeten të pandryshuara.

5.Palët kufizojnë vlefshmërinë e vendimeve paraprake në një periudhë të përcaktuar nga legjislacioni i brendshëm.

6.Secila Palë angazhohet të bëjë publikisht të njohur informacionin për vendimet paraprake të cilin ajo e çmon të një interesi të madh për tregtarët e tjerë, duke marrë parasysh nevojën e mbrojtjes së informacionit konfidencial.

Neni 5

Thjeshtimi i procedurave të tregtisë ndërkombëtare

1. Palët synojnë të kufizojnë kontrollet dhe formalitetet qeveritare në kuadrin e tregtimit të mallrave dhe të shërbimeve të lidhura ndërmjet Palëve në kontrolle dhe formalitete që janë të nevojshme për të siguruar përputhshmërinë me kërkesat ligjore, duke thjeshtuar procedurat përkatëse deri në masën më të madhe të mundshme.

2. Palët synojnë të përdorin procedura efikase tregtare, të bazuara, sipas nevojës, në standardet ndërkombëtare, me synimin e uljes së kostove dhe të vonesave të panevojshme në tregtinë ndërmjet tyre, në veçanti standarde dhe praktika të rekomanduara nga Organizata Botërore e Doganave (më poshtë "OBD"), duke përfshirë parimet e Konventës Ndërkombëtare të rishikuar për Thjeshtimin dhe Harmonizimin e Procedurave Doganore (Konventa e Rishikuar e Kiotos).

3. Çdo Palë synon të miratojë ose të ketë procedura të thjeshtuara doganore për lëvizjen e mallrave të deklaruara nga operatorët ekonomikë të cilët kanë provuar se janë të besueshëm.

4. Çdo Palë synon të miratojë ose ketë procedura që:

(a) kryejnë dërgimin e avancuar elektronik dhe përpunimin e informacionit para arritjes fizike të mallrave, në mënyrë që të përshpejtohet zhdoganimi i tyre; dhe

(b) në përputhje me legjislacionin përkatës, i lejon importuesit të marrë mallrat para plotësimit të të gjitha kërkesave për import të asaj Pale, nëse importuesi ofron garanci të mjaftueshme. Një Pale nuk i kërkohet të lëshojë mallrat kur nuk plotësohen kërkesat legjitime të Palëve për import.

Neni 6

Menaxhimi i rrezikut

1. Të angazhuar në zgjerimin e lehtësimit të tregtisë ndërsa ruhet kontrolli qeveritar i tregtisë ndërmjet Palëve, Palët përcaktojnë se cilët persona, mallra ose mjete transporti shqyrtohen dhe deri në çfarë mase, bazuar në menaxhimin e rrezikut.

2. Menaxhimi i rrezikut përfshin vlerësimin sistematik të rreziqeve të lidhura me cenimin e legjislacionit doganor ose ndonjë legjislacion tjetër për tregtinë ndërkombëtare në mallra ose shërbime të lidhura me to. Palët përdorin masat e përputhshmërisë për të mbështetur vlerësimin e rrezikut.

3. Palët mund të bëjnë kontrolle me bazë auditimi, të tilla si kontrolli i cilësisë dhe rishikimet e përputhshmërisë, të cilat mund të kërkojnë shqyrtime më të zgjeruara të operatorëve ekonomikë gjatë një periudhe të caktuar kohore.

Neni 7

Sistemi i operatorëve ekonomikë të autorizuar

1. Një Palë që ndërfut ose shtrin një Sistem Operatori Ekonomik të autorizuar ose masa sigurie që kanë ndikim mbi zhvillimet ndërkombëtare të tregtisë:

(a) i jep një Pale tjetër mundësinë të negociojë njohjen e ndërsjellë të autorizimit dhe masave të sigurisë për qëllim të lehtësimit të tregtisë ndërkombëtare ndërsa sigurohet një kontroll efektiv doganor; dhe

(b) bazohet në standardet dhe praktikatat përkatëse ndërkombëtare, në veçanti në Kuadrin e standardeve të OBD-së.

Neni 8

Agjentët doganorë

1. Asnjë Palë nuk ndërfut detyrime të reja për të përdorur vetëm agjentë doganorë.

2. Secila Palë angazhohet të zhvillojë sisteme ose procedura doganore që u bëjnë të mundur eksportuesve dhe importuesve të dorëzojnë deklaratat e tyre doganore pa u detyruar t'u drejtohen agjentëve doganorë.

Neni 9

Tarifat dhe taksat

1. Tarifat dhe taksat e vendosura në lidhje me importet dhe eksportet nga autoritetet doganore ose autoritete të tjera kufitare të një Pale, duke përfshirë dhe lidhjen me detyrat e marra në emër të këtyre autoriteteve, nuk e tejkalojnë koston mesatare të shërbimit të ofruar.

2. Tarifat dhe taksat të cilave u referohet paragrafi 1 nuk përlogariten mbi bazën ad valorem.
3. Çdo Palë boton zyrtarisht informacion për tarifat dhe taksat. Një informacion i tillë përfshin objektivin e tarifës ose taksës për shërbimin e ofruar, autoritetin përgjegjës, tarifat dhe taksat që do të aplikohen dhe mënyrën e llogaritjes së tyre, si dhe kohën dhe mënyrën si do të bëhen këto pagesa. Ky informacion botohet në internet në gjuhën angleze.
4. Pas marrjes së një kërkesë, autoritetet doganore ose çdo autoritet tjetër kufitar i një Pale jep informacion mbi nivelin e taksës, tarifës që zbatohet për importimin e mallrave në atë Palë, duke përfshirë dhe metodat e përlogaritjes.
5. Secila Palë rishikon periodikisht taksat e tarifat për t'u siguruar se ato janë në përputhje me angazhimet e OBT-së dhe me qëllim konsolidimin dhe uljen e numrit dhe të shumëllojshmërisë së tyre.

Neni 10

Transaksionet konsullore

Nuk kërkohet asnjë transaksion konsullor ose ndonjë ekuivalent i tij për bërjen e faturës tregtare, certifikatës së origjinës, manifestit të transportuesve, deklaratës së eksportit ose ndonjë dokumenti tjetër të nevojshëm për zhdoganim në një Palë.

Neni 11

Apelimi

Secila Palë siguron se importuesit, eksportuesit dhe prodhuesit kanë të drejtën e të paktën një niveli të apelimit administrativ ose gjyqësor, në përputhje me legjislacionin e brendshëm.

Neni 12

Konfidencialiteti

I gjithë informacioni i dhënë në lidhje me importimin, eksportimin, vendimet paraprake ose tranzitimin e mallrave konsiderohet si informacion konfidencial nga Palët dhe mbulohet nga detyrimi i sekretit profesional, në përputhje me ligjet përkatëse të Palës. Ai nuk duhet të zbulohet nga autoritetet e një Pale pa lejen e shprehur të personit ose autoritetit që e ofron atë.

E REFERUAR NË PARAGRAFIN 2 TË NENIT 14 MANDATI I NËNKOMITETIT TË
RREGULLAVE TË ORIGINËS, PROCEDURAVE DOGANORE DHE LEHTËSIMT TË
TREGTISË

1. Funksionet e Nënkomitetit do të jenë: shkëmbimi i informacionit, shqyrtimi i zhvillimeve, përgatitja e bashkërendimit të pozicioneve të Palëve, përgatitja e ndryshimeve teknike dhe ndihma për Komitetin e Përbashkët lidhur me:

(a) rregullat e origjinës dhe bashkëpunimin administrativ, sipas parashikimeve të Nenit 7 dhe Protokollit B;

(b) çështjet e përcaktuara në Nenin 13 dhe Shtojcën III;

(c) çështjet e përcaktuara në Nenet 6, 8 dhe 9 dhe

(d) çështje të tjera lidhur me tregtimin e mallrave që i referohen Nënkomitetit nga Komiteti i Përbashkët.

2. Nënkomiteti i raporton Komitetit të Përbashkët. Nënkomiteti mund t'i japë rekomandime për çështjet që kanë të bëjnë me funksionet e tij.

3. Çdo Palë ka të drejtë të përfaqësohet në Nënkomitet. Nënkomiteti do të veprojë me konsensus.

4. Nënkomiteti mblidhet sa herë të kërkohet. Ai thirret nga Komiteti i Përbashkët, nga kryetari/ja i/e Nënkomitetit me nismën e tij/saj ose me kërkesën e një Pale. Vendi i mbledhjes ndërkëmbehet midis Shqipërisë dhe Shteteve të EFTA-s.

5. Kryetari i Nënkomitetit do të përgatitë një program provizor punimesh në konsultim me Palët dhe, si rregull i përgjithshëm, ua përcjell atyre jo më vonë se dy javë përpara mbledhjes. Mbledhjet e Nënkomitetit do të kryesohen nga një përfaqësues i Shqipërisë ose një Shteti të EFTA-s për një periudhë kohe për të cilën është rënë dakord.

6. Nënkomiteti do të përgatitë një raport mbi rezultatet e secilit prej takimeve të tij dhe, kur kërkohet, i raporton në takim Komitetit të Përbashkët.

SHTOJCA V

REFERUAR NË NENIN 23 MBROJTJA E PRONËSISË INTELEKTUALE

TITULLI I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Përkufizimi i pronësisë intelektuale

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, "pronësia intelektuale" përfshin, veçanërisht, të drejtat e autorit, përfshirë mbrojtjen e programeve kompjuterike dhe përpilimin e të dhënave, si edhe të drejta fqinje, markave të tregtimit për mallrat dhe shërbimet, treguesit gjeografikë për mallrat, përfshirë emërtimin e origjinës së mallrave dhe tregues të burimeve për shërbimet, dizenjo industriale, patenta, llojet e bimëve, topografitë e qarqeve të integruara, si edhe informacioni i pazbuluar.

Neni 2

Konventat ndërkombëtare

1. Palët pohojnë sërish detyrimet e parashtruara në marrëveshjet shumëpalëshe si vijon:

(a) Konventa e Parisit e datës 20 mars 1883 për Mbrojtjen e Pronës Industriale, rishikuar nëpërmjet Aktit të Stokholmit të vitit 1967 (më poshtë referuar si "Konventa e Parisit");

(b) Konventa e Bernës e datës 9 shtator 1886, për Mbrojtjen e Veprave Letrare e Artistike, rishikuar nga Akti i Parisit i vitit 1971;

(c) Marrëveshja e OBT-së e datës 15 prill 1994, për Aspektet Tregtare të së Drejtës së Pronësisë Intelektuale (më poshtë referuar si "Marrëveshja TRIPS"); dhe

(d) Konventa Ndërkombëtare e datës 26 tetorit 1961 për Mbrojtjen e Performuesve, Producentëve të Fonogrameve dhe Organizatave të Transmetimit (Konventa e Romës).

2. Palët, të cilat nuk janë palë në një apo më shumë prej marrëveshjeve të renditura në këtë paragraf, do t'i ratifikojnë apo aderojnë në to deri më 31 dhjetor 2010:

(a) Akti i Gjenevës i vitit 1999 i Marrëveshjes së Hagës në lidhje me Regjistrimin Ndërkombëtar të Dizenjove Industriale;

(b) Traktati i OBPI-së për Traktatin e të Drejtës së Autorit i datës 20 dhjetor 1996;

(c) Traktati i OBPI-së për Performancat / Shfaqjet dhe Fonogramën i datës 20 dhjetor 1996:

dhe

(d) Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e Llojeve të Reja të Bimëve e vitit 1978 ("Konventa UPOV 1978") ose Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e Llojeve të Reja të Bimëve e vitit 1991 ("Konventa UPOV 1991").

3. Palët, me kërkesë të secilës prej tyre, bien dakord të zhvillojnë menjëherë takime ekspertësh mbi veprimtaritë në lidhje me konventat e përmendura në këtë Nen ose me konventat e

ardhshme për harmonizimin, administrimin dhe ekzekutimin e të drejtës së pronësisë intelektuale dhe me veprimtaritë në organizatat ndërkombëtare si OBT-ja dhe Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale (përmendur si OBPI në këtë shtojcë"), si edhe për marrëdhëniet e Palëve me vende të treta mbi çështje që kanë të bëjnë me pronësinë intelektuale.

TITULLI II

STANDARDET NË LIDHJE ME VLEFSHMËRINË, OBJEKTIN DHE PËRDORIMIN E TË DREJTAVE TË PRONËSISË INTELEKTUALE

Neni 3

Markat tregtare

1. Palët i japin mbrojtje të mjaftueshme dhe efektive mbajtësve të së drejtës së markës tregtare të mallrave dhe shërbimeve. Çdo shenjë ose kombinim shenjash që bën të mundur dallimin e mallrave apo shërbimeve të një ndërmarrjeje nga ato të një ndërmarrjeje tjetër, mund të përbëjë markë tregtare. Shenja të tilla, veçanërisht, fjalët, përfshirë kombinimin e fjalëve, emrat personalë, shkronjat, numrat, elementet figurative, format e mallrave, tingujt dhe kombinimi i ngjyrave, si dhe çdo kombinim i këtyre shenjave klasifikohen për t'u regjistruar si marka tregtare. Kur shenjat nuk janë qenësisht në gjendje të dallojnë mallrat apo shërbimet përkatëse, Palët mund të bëjnë regjistrimin në varësi të dallimit të përfuar nëpërmjet përdorimit. Palët mund të kërkojnë, si kusht për regjistrimin, që shenjat të jenë të perceptueshme nga ana pamore.

2. Palët pohojnë sërish rëndësinë dhe udhëhiqen nga parimet e përfshira në Rekomandimet e Përbashkëta të OBPI-së në lidhje me Dispozitat e Mbrojtjes së Markave të Njohura, miratuar nga Asambleja e Unionit së Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale dhe Asambleja e Përgjithshme e OBPI-së në vitin 1999 dhe Rekomandimet e Përbashkëta të OBPI-së në lidhje me Dispozitat e Mbrojtjes së Markave dhe të Drejtave të tjera të Pronësisë Industriale në Shenja, në Internet, miratuar nga Asambleja e Unionit së Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale dhe Asambleja e Përgjithshme e OBPI-së në vitin 2001.

Neni 4

Patentat

Palët sigurojnë në ligjet e tyre kombëtare të paktën sa vijon:

(a) mbrojtje të mjaftueshme dhe efektive të patentave për shpikjet në të gjitha fushat e teknologjisë, në përputhje me nivelin e mbrojtjes së parashikuar në Konventën Evropiane për Patentat (KRP); dhe

(b) një afat dëmshpërblimi për mbrojtjen e barnave dhe produkteve të mbrojtjes së bimëve, që llogaritet nga skadimi i afatit maksimal të patentës prej 20 vjetësh për një periudhë të barabartë me periudhën që kalon nga data e dorëzimit të kërkesës për patentën dhe data e autorizimit të produktit për tregtim, minus një periudhë prej 5 vjetësh. Kjo mbrojtje kompensuese mbulon një periudhë maksimale prej pesë vjetësh dhe jepet në bazë të kushteve vijuese:

(i) produkti mbrohet nga një patentë në fuqi;

(ii) është lëshuar një autorizim zyrtar për tregtimin e produktit të mbrojtjes së barnave ose

bimëve;

(iii) e drejta e dhënë nga patenta është shtyrë nga procedura administrative në lidhje me autorizimin e hyrjes në treg, në mënyrë që përdorimi efektiv i patentës të zgjatë jo më pak sesa 15 vjet dhe

(iv) mbrojtja efektive e dhënë nga patenta dhe mbrojtja kompensuese së bashku të mos jenë më shumë se 15 vjet.

Neni 5

Informacioni i fshehtë

1. Palët mbrojnë informacionin e fshehtë në përputhje me Nenin 39 të Marrëveshjes TRIPS.

2. Palët parandalojnë që aplikuesit e miratimit për tregtim të produkteve farmaceutike dhe kimike bujqësore të mbështeten apo t'i referohen të dhënave të pashpërndara të analizave ose të dhënave të tjera që i dërgohen autoritetit kompetent nga aplikuesi i parë për një periudhë, e llogaritur nga data e miratimit për tregtim, prej të paktën tetë vjetësh për barnat dhe prej të paktën 10 vjetësh për produktet agrokimike.

3. Mbështetja apo referimi ndaj këtyre të dhënave mund të lejohet:

(a) kur kërkohet miratim për ri-importimin e produkteve që janë miratuar tashmë përpara eksportimit; ose

(b) me qëllim shmangien e dublimit të panevojshëm të analizave të produkteve agrokimike që përfshijnë kafshët vertebrorë, me kusht që aplikuesi i parë të kompensohet në mënyrë të mjaftueshme.

Neni 6

Dizenjot

Palët sigurojnë mbrojtje të mjaftueshme dhe efektive të dizenjove industriale në legjislacionin e tyre kombëtar, duke përcaktuar, në veçanti, një periudhë mbrojtjeje prej të paktën 25 vjetësh gjithsej. Palët mund të përcaktojnë një periudhë më të shkurtër mbrojtjeje për dizenjot e pjesëve përbërëse që përdoren për qëllime riparimi të një produkti.

Neni 7

Treguesit gjeografikë dhe treguesit e burimit

1. Palët sigurojnë mjete të mjaftueshme dhe efektive në legjislacionin e tyre kombëtar për të mbrojtur treguesit gjeografikë në lidhje me të gjitha produktet, si dhe treguesit e burimit në lidhje me të gjitha produktet dhe shërbimet.

2. Për qëllime të kësaj Marrëveshjeje, "treguesit gjeografikë" janë tregues, të cilët identifikojnë mallrat si origjinues nga territori i një Pale ose rajoni, ose lokalitetit në atë territor, ku një cilësi, emër ose tipar i dhënë i këtyre mallrave i atribuohet kryesisht origjinës së tyre gjeografike.

3. Treguesit e burimit janë referime të drejtpërdrejta ose të tërthorta ndaj origjinës së mallrave ose shërbimeve. Asgjë në këtë marrëveshje nuk kërkon që një Palë të ndryshojë legjislacionin nëse, në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, ajo e kufizon në legjislacionin e vet kombëtar mbrojtjen e treguesve të burimit në rastet kur një cilësi, emër ose tipar tjetër i dhënë i mallrave ose shërbimeve i atribuohet kryesisht origjinës së tyre gjeografike.

4. Pa cenuar Nenin 23 të Marrëveshjes TRIPS, Palët sigurojnë mjetet ligjore për palët e interesuara për të parandaluar përdorimin e një treguesi gjeografik apo një treguesi të burimit për mallrat që nuk e kanë origjinën nga vendi i treguar në etiketë, në një mënyrë që keqinformon publikun lidhur me origjinën gjeografike të atyre mallrave apo që përbën një veprim konkurrence të pandershme, në kuptim të Nenit 10bis të Konventës së Parisit.

5. Palët sigurojnë mjete ligjore për palët e interesuara për të parandaluar përdorimin e një treguesi gjeografik të produkteve bujqësore dhe artikujve ushqimorë për produkte të njëjta ose të ngjashme që nuk e kanë origjinën nga vendi i treguar në etiketën në fjalë.

6. Palët sigurojnë mjete ligjore për palët e interesuara për të parandaluar përdorimin e një treguesi burimi në një mënyrë që keqinformon publikun lidhur me vendin e vërtetë të origjinës apo përbën një veprim konkurrence të pandershme.

7. Palët parandalojnë çdo përdorim ose regjistrim të pasaktë ose keqinformues të emrave të vendit të një Pale si markë tregtare, dizenjo ose çdo emërtim tjetër të mbrojtur, si emri i shoqërisë apo emrat e shoqatave.

8. Palët, në përputhje me detyrimet e tyre në bazë të Nenit 6ter të Konventës së Parisit, ndalon përdorimin ose regjistrimin e stemave, flamujve dhe emblemave e tjera shtetërore ose rajonale të një Pale si marka tregtare, dizenjo ose çdo titull tjetër i mbrojtur, pa qenë në

përputhje me kushtet e parashtruara në ligjet dhe rregulloret e asaj Pale. Kjo mbrojtje vlen edhe për shenjat që mund të ngatërrohen me emblemat, flamujt dhe emblema të tjera shtetërore apo rajonale të Palëve.

TITULLI III

BLERJA DHE RUAJTJA E TË DREJTËS SË PRONËSISË INTELEKTKUALE

Neni 8

Kur blerja e një të drejte të pronësisë intelektuale është subjekt i dhënies ose regjistrimit të së drejtës, Palët sigurojnë që procedurat për dhënien ose regjistrimin të jenë të të njëjtit nivel me atë që përcakton Marrëveshja TRIPS, veçanërisht, Neni 62.

TITULLI IV

ZBATIMI I TË DREJTAVE TË PRONËSISË INTELEKTKUALE

Neni 9

Të përgjithshme

Palët sigurojnë në ligjet e tyre kombëtare dispozita për zbatimin e të drejtave të parashikuara nga Neni 1 që janë në nivel të njëjtë me atë që parashikohet në Marrëveshjen TRIPS, në veçanti nga Nenet 41 deri në 61.

Neni 10

Pezullimi i nxjerrjes nga autoritetet kompetente

1.Palët miratojnë procedura për të bërë të mundur që mbajtësi i së drejtës, i cili ka arsye të vlefshme të dyshojë se mund të ndodhë importi ose eksporti i mallrave që shkelin të drejtat e pronësisë, të depozitojë një kërkesë me shkrim tek autoritetet kompetente, administrative ose gjyqësore, për pezullimin nga autoritetet doganore të hedhjes në qarkullim të lirë të këtyre mallrave.

2.Është e kuptueshme se nuk ka asnjë detyrim për zbatimin e procedurave të parashikuara në paragrafin e parë të pezullimit të hedhjes në qarkullim të lirë të mallrave të nxjerra në treg në një vend tjetër nga ose me pëlqimin e mbajtësit të së drejtës.

Neni 11

E drejta e inspektimit

1. Autoritetet kompetente i japin depozituesit të kërkesës për pezullimin e mallrave dhe personave të tjerë të përfshirë në pezullim mundësinë për të inspektuar mallrat, hedhja në qarkullim e të cilave është pezulluar ose ndaluar.

2. Gjatë shqyrtimit të mallrave, autoritetet kompetente mund të marrin kampione dhe, në përputhje me rregullat në fuqi në Palën e përfshirë, t'ia dorëzojnë ose t'ia dërgojnë ato mbajtësit të së drejtës, me kërkesën e tij/saj të shprehur, vetëm për qëllime analize dhe lehtësimi të procedurave vijuese. Kur e lejojnë rrethanat, kampionet duhet të kthehen pas përfundimit të analizës teknike dhe, kur është e nevojshme, përpara sesa mallrat të hidhen në qarkullim ose të hiqet bllokimi i tyre. Çdo analizë e këtyre kampionëve kryhet nën përgjegjësinë e vetme të mbajtësit të së drejtës.

Neni 12

Deklarimi i përgjegjësive, garancia ose sigurimi i barazvlefshëm

Autoritetet kompetente kanë autoritetin për t'i kërkuar depozituesit të kërkesës të deklarojë se pranon përgjegjësinë ndaj personave të përfshirë dhe, në raste të bazuara, t'i ofrojë një garanci apo siguri të barazvlefshme, të mjaftueshme për të mbrojtur të pandehurin dhe autoritetet kompetente dhe për të parandaluar shpërdorimin. Kjo garanci apo siguri nuk ndalon në mënyrë të paarsyeshme prapësimin e këtyre procedurave.

TITULLI V

BASHKËPUNIMI TEKNIK

Neni 13

Bashkëpunimi në fushën e pronësisë intelektuale

Palët, duke pranuar rëndësinë në rritje të së drejtës së pronësisë intelektuale si një faktor i zhvillimit social, ekonomik dhe kulturor, do të rritin bashkëpunimin e tyre në fushën e të drejtave të pronësisë intelektuale.

PROTOKOLLI A
I REFERUAR NË NËNPARAGRAFIN 1 (B) TË NENIT 6
PRODUKTET BUJQËSORE TË PËRPUNUARA

Neni 1

Masat për kompensimin e çmimit

1. Në mënyrë që të merren parasysh dallimet në kosto të lëndëve të para bujqësore të përfshira në produktet të cilave u referohet neni 3, Kjo Marrëveshje nuk përjashton:

- (a) vënien e një tarife, pas importimit; dhe
- (b) zbatimin e masave të miratuara gjatë eksportit.

2. Tarifat e importit bazohen por nuk tejkalojnë, diferencat ndërmjet çmimit të brendshëm dhe çmimit në tregun botëror të lëndëve të para të përfshira në produktet përkatëse.

Neni 2

Koncesionet tarifore, Shqipëri

Për produktet e treguara në Tabelën 1, të cilat e kanë origjinën në një shtet të EFTA-s, Shqipëria ofron trajtim jo më pak të favorshëm se trajtimi i dhënë nga Komuniteti Evropian.

Neni 3

Koncesionet tarifore, EFTA

Duke pasur parasysh dispozitat e parashikuara në Nenin 1, shtetet e EFTA-s për produktet e Tabelës 2 që e kanë origjinën në Shqipëri, ofrojnë trajtim jo më pak të favorshëm se trajtimi i dhënë për Komunitetin Evropian.

Neni 4

Njoftimi

1.Shtetet e EFTA-s e njoftojnë Shqipërinë për të gjitha ndryshimet në masat e zbatuara sipas Nenit 1, në një fazë të hershme para hyrjes së tyre në fuqi.

2.Shqipëria dhe shtetet e EFTA-s informojnë njëra-tjetrën për ndryshimet në trajtim të dhëna për Komunitetin Evropian.

Neni 5

Konsultimet

Shqipëria dhe shtetet e EFTA-s rishikojnë në mënyrë periodike zhvillimin e tregtisë së tyre në produkte të mbuluara nga ky Protokoll. Duke marrë parasysh këto rishikime dhe rregullimet ndërmjet Palëve dhe Komunitetit Evropian dhe OBT-së, Shqipëria dhe shtetet e EFTA-s vendosin për ndryshimet e mundshme për mbulimin e produktit në këtë Protokoll, si dhe për një zhvillim të mundshëm të masave të zbatuara sipas nenit 1.

TABELA 1 E PROTOKOLLIT A -KONCESIONET TARIFORE, SHQIPËRIA

Për produktet e përpunuara bujqësore të renditura në këtë tabelë, tarifat doganore zbatohen në përputhje me këtë tabelë, nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Kodi tarifor shqiptar	Përshkrimi i produkteve	Trajtimi
0403	Dhallë, qumësht e krem i prerë, kos, kefir e qumësht e krem tjetër të fermentuara ose të acidifikuara, të përqendruara ose jo apo që përmbajnë sheqer të shtuar ose lëndë të tjera ëmbëltuese ose lëndë aromatizuese, ose që përmbajnë fruta, arra ose kakao shtesë:	
0403 10	-Kos:	
	-- I aromatizuar ose që përmban fruta, arra ose kakao shtesë:	
	---Pluhur, kokriza ose forma të tjera të ngurta të përmbajtjes së yndyrës së qumështit me peshë:	
0403 10 51	—Jo më e madhe sesa 1,5%	MFN
0403 10 53	—Më e madhe sesa 1,5%, por jo më e madhe sesa 27 %	MFN

0403 10 59	—Më e madhe sesa 27%	MFN
	—Të tjera, me përmbajtje yndyre të qumështit me peshë:	
0403 10 91	—Jo më e madhe sesa 3 %	MFN
0403 10 93	—Më e madhe sesa 3% , por jo më të madhe sesa 6%	MFN
0403 10 99	---- Më e madhe sesa 6%	MFN
0403 90	-Të tjera:	
	--Të aromatizuara ose që përmbajnë fruta, arra ose kakao shtesë:	
	—Pluhur, kokrrizë ose në forma të tjera të ngurta, përmbajtje yndyrore e qumështit, me peshë:	
0403 90 71	— Jo më e madhe sesa 1,5%	MFN
0403 90 73	—Më e madhe sesa 1,5%, por jo më e madhe sesa 27 %	MFN
0403 90 79	—Më e madhe sesa 27%	MFN
	—Të tjera, me përmbajtje yndyre qumështi, ndaj peshës:	
0403 90 91	—Jo më e madhe sesa 3 %	MFN
0403 90 93	—Më e madhe sesa 3% , por jo më të madhe sesa 6%	MFN
0403 90 99	—Më e madhe sesa 6%	MFN
0405	Gjalpë dhe yndyrna e vajra të tjera që rrjedhin prej qumështit; krem bulmeti:	
0405 20	-Kremra bulmeti:	
0405 20 10	--Të një përmbajtje yndyre, sipas peshës, prej 39 % apo më të madhe, por më të vogël se 60 %	MFN
0405 20 30	--Të një përmbajtje yndyre, sipas peshës, prej 60 % apo më të madhe, por më të vogël se 75 %	MFN
0501	Flokët e njerëzve, të papunuara, nëse janë apo jo të lara apo të pastruara; mbetje të flokëve të njerëzve;	I lirë
0502	Qimet dhe kreshtat e derrave të butë, të derrave të egër; qimet e baldosave dhe qime të tjera për bërjen e furçave; mbetjet e qimeve apo kreshtave të tillë:	I lirë
0505	Lëkurët dhe pjesë të tjera të zogjve, me puplat ose pushin e tyre, puplat e pjesët e puplave (me anë të zbukuruara ose jo) dhe pushi, jo të punuara më tej, përveçse të pastruara, dezinfektuara ose përgatitura për ruajtje; pluhur dhe mbetje e puplave ose pjesëve të puplave:	I lirë

Kodi tarifor shqiptar	Përshkrimi i produkteve	Trajtimi
-----------------------	-------------------------	----------

0506	Kockat dhe palca e brirëve, të papunuara, I pa yndyrë, thjeshtë të përgatitura (por jo të prera në forma), të trajtuara me acid apo të dexhelatinuara; pluhura dhe mbetje të këtyre produkteve:	I lirë
0507	Fildish, zhgualli i breshkave, lapat e balenave dhe mustaqet e lapave të balenave, brirët, thundrat, thonjtë, kthetrat, sqepat, të papunuara ose thjesht të përgatitura, por jo të prera në forma; pluhuri dhe mbetjet e këtyre produkteve:	I lirë
0508	Korali idhe lëndë të ngjashme të papunuara ose thjesht të përgatitura, por jo të punuara në mënyrë tjetër; guaskat e molusqeve, kafshëve nënujore guaskore, ekinodermat apo gjilpërat e lëkurëve, të papunuara ose thjesht të përgatitura por jo të prera në forma, pluhuri dhe mbetjet e tyre	I lirë
0510	Qelibar i hirtë, vaj ricini, zibet dhe myshk; cantharides; vreri, i tharë ose jo; gjëndrat dhe produkte të tjera shtazore të përdorura për përgatitjen e produkteve farmaceutike, të freskëta, të ftohta, të ngrira ose të ruajtura përkohësisht në mënyra të tjera	I lirë
0710 40 00	- Misër i ëmbël	I lirë
0711 90 30	--- Misër i ëmbël	I lirë
0903 00 00	Mate	I lirë
1302 12 00	-- Prej jamballi	I lirë
1302 13 00	-- Prej kulprës së butë	I lirë
1302 14 00	-- Prej pirethrumit të rrënjëve të bimëve që përmbajnë rotenone	I lirë
1302 19 80	--- Të tjera	I lirë
1302 20 10	-- Të thara	I lirë
1302 20 90	-- Të tjera	I lirë
1302 31 00	-- Agar-agar	I lirë
1302 32 10	--- Të kokrrave të akacies së bardhë apo farave të kokrrës së akacies së bardhë	I lirë
1401	Lëndë vegjetale të një lloji që përdoret kryesisht për thurje (për shembull, bambutë, palma indiane, kallamat shelgu, gjethet e drurit të palmës, kashtë drithi, e pastruar, e zbardhur apo e lyer dhe lëvorja e blirit):	I lirë
1404	Produktet vegjetale të paspecifikuara apo përfshira diku tjetër:	I lirë
1505	Yndyrë leshi dhe substanca yndyrore që rrjedhin prej tyre (përfshi lanolinën):	I lirë
1506	Dhjamëra dhe yndyrna të tjera shtazore dhe fraksionet e tyre, qofshin të rafinuara ose jo, por jo të ndryshuara kimikisht	I lirë
1516 20 10	--Vaj ricini i hidrogjenizuar ose i ashtuquajtimi dyllë opak"	I lirë
1517	Margarinë; përzierje apo përgatesa të dhjamërave ose vajrave vegjetale ose shtazore ose të fraksioneve të dhjamërave ose vajrave të ndryshme të këtij Kapitulli, pa përfshirë dhjamërat ose vajrat e ngrënshme ose fraksionet e tyre të kreut 1516	I lirë
1518	Dhjamëra dhe vajra vegjetale e shtazore dhe fraksionet e tyre,të ziera,të oksiduar, dehidratuara, të sulfurizuara, të shkriara, të polimerizuara nga nxehtësia në vakum ose në	I lirë

	gaz inert, apo të modifikuara ndryshe kimikisht, duke përjashtuar ato të kreut Nr.1516; përzierjet apo gatitjet e pangrënshme të vajrave dhe dhjamërave vegjetale ose shtazore, apo të fraksioneve të yndyrave të ndryshme të këtij Kapitulli, të papërfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër:	
1520	Glicerina, bruto; ujërat e glicerinës dhe finjat e glicerinës	I lirë
1521	Dyllet vegjetale (përveç triglicerideve), dyllë blete, dyllë nga insekte	I lirë

Kodi tarifar shqiptar	Përshkrimi i produkteve	Trajtimi
	të tjera, dhe spermaceti, të rafmuara ose të ngjyrosura apo jo:	
1522 00 10	-Degras	I lirë
1702 50 00	-- Fruktozë e pastër kimikisht	I lirë
1702 90 10	-- Maltozë e pastër kimikisht	I lirë
1704 10	- Çamçakëz, I mbuluar ose jo me sheqer:	I lirë
1704 90	-Të tjera:	I lirë
1803	Brumë kakaoje, I çyndyrosur ose jo:	I lirë
1804	Gjalpë kakaoje, yndyrë dhe vaj	I lirë
1805	Kakao pluhur, që nuk përmban sheqer ose lëndë ëmbëltuese të shtuara	I lirë
1806	Çokollatë dhe gatitje të tjera ushqimore që përmbajnë kakao:	I lirë
1901	Ekstrakt malti; gatitjet ushqimore prej miellit, drithit të zhveshur, niseshtesë ose ekstraktit të maltit, që nuk përmbajnë kakao ose që përmbajnë me pak së 40% kakao të peshës të llogaritur mbi një bazë tërësisht të çyndyrosur, të paspecifikuara dhe të papërfshira gjetkë; përgatesa ushqimore prej mallrave të krerëve nga 0401 deri në 0404, që nuk përmbajnë kakao ose që përmbajnë me pak së 5% kakao ndaj peshës të llogaritur mbi një bazë tërësisht të çyndyrosur, të paspecifikuara dhe të papërfshira:	I lirë
1902	Brumëra, të gatuar ose jo apo të mbushura ose jo (me mish ose me substanca të tjera) apo të përgatitura ndryshe, të tilla si spageti, makarona, makarona petë, lazanja, njoki, ravioli, kaneloni; makarona oriz, të përgatitura ose jo:	
1902 11 00	Me përmbajtje veze	I lirë
1902 19 10	Pa përmbajtje mielli gruri ose bollguri të zakonshëm	I lirë
1902 19 90	Të tjera	I lirë
1902 20 10	Me përmbajtje më të madhe se 20 % në bazë të peshës së peshkut, kafshëve nënujore guaskore, molusqeve ose kafshëve të tjera ujore jovertebrore	MFN
1902 20 30	Me përmbajtje më të madhe sesa 20 % të peshës së sallamërave dhe lëndëve të ngjashme, të mishit dhe të brendshmeve të mishit të çdo lloji apo origjine	MFN

1902 20 91	Të gatuar	I lirë
1902 20 99	Të tjera	I lirë
1902 30 10	Të thara	I lirë
1902 30 90	Të tjera	I lirë
1902 40 10	Të pagatitura	I lirë
1902 40 90	Të tjera	I lirë
1903	Tapioka dhe zëvendësuesit e saj përgatitur nga niseshteja, në formën e fetëzave, kokrrave, margaritarëve, tophave ose në forma të ngjashme	I lirë
1904	Ushqime të përgatitura nëpërmjet bymimit ose pjekjes së drithërave apo produkteve të tyre (p.sh. fetëza drithi); drithëra (pa përfshirë misrin) në formë kokrrë ose në formë fetëzash ose kokrrash të punuara ndryshe (përveç miellit dhe drithit të zhveshur), gjysmë të gatshme ose të përgatitura ndryshe, të papërfshira ose të paspecifikuara diku tjetër:	I lirë

Kodi tarifor shqiptar	Përshkrimi i produkteve	Trajtimi
1905	Bukë, pasta, torta, biskota dhe prodhime të tjera të furrës, me ose pa kakao; kulaç kungimi, naforë, kapsula të pambushura për përdorim farmaceutik, vafer për mbylljen e zarfeve, letër orizi dhe produkte të ngjashme:	I lirë
2001 90 30	--Misër i ëmbël (Zea mays var. saccharata)	I lirë
2001 90 40	--Zhardhokë të ngrënsëm, patate të ëmbla dhe pjesë të ngjashme të ngrënshme të bimëve, që përmbajnë niseshte 5% ose më shumë sipas peshës	I lirë
2001 90 60	--Zemër palme	I lirë
2004 10 91	—Në formën e miellit, bollgurit ose petëzave	I lirë
2004 90 10	--Misër i ëmbël (Zea mays var. saccharata)	I lirë
2005 20 10	--Në formë mielli, bollguri ose petëzash	I lirë
2005 80 00	-Misër i ëmbël (Zea mays var. saccharata)	I lirë
2008 11 10	—Gjalpë kikiriku	I lirë
2008 91 00	--Zemër palme	I lirë
2008 99 85	----- Misër (drithë), përveç misrit të ëmbël (Zea mays var. saccharata)	I lirë
2008 99 91	----- Zhardhokë të ngrënsëm, patate të ëmbla dhe pjesë të ngjashme të ngrënshme, që përmbajnë 5 % niseshte ose më shumë, sipas peshës	I lirë
2101	Ekstrakteve, esencave dhe koncentrateve të kafesë, çajit ose matesë dhe përgatesave me bazë të këtyre produkteve ose me bazë të kafesë, çajit ose matesë; çikores së pjekur dhe zëvendësuesve të tjerë të kafesë të pjekur, dhe ekstrakteve, esencave dhe koncentrateve	

	të saj:	
2101 11	--Ekstrakte, esenca ose koncentre:	I lirë
2101 12 92	—Gatitje me bazë këto ekstrakte, esenca ose koncentre kafeje	I lirë
2101 12 98	—Të tjera	I lirë
2101 20 92	—Me bazë ekstraktesh, esencash ose koncentratesh çaji apo mateje	I lirë
2101 20 98	—Të tjera	I lirë
2101 30	- Çikore e pjekur dhe zëvendësues të tjerë të kafesë të pjekur, dhe ekstrakteve, esencave dhe koncentreve të saj:	I lirë
2102	Maja (aktive ose joaktive); mikroorganizma të tjera njëqelizore, të ngordhura (por që nuk përfshijnë vaksinat e kreut 3002); pluhura të përgatitura për ardhjen e brumërave:	I lirë
2103	Salcat dhe gatitjet me to; erëzat e përziera dhe aromatizuesit e përzier; mielli i mustardës dhe mustarda e përpunuar:	
2103 10 00	Salcë soje	I lirë
2103 20 00	Salcë e kuqe domateje dhe salca të tjera të domates	MFN
2103 30 10	Miell dhe kokrriza mustarde	I lirë
2103 30 90	Mustardë e përgatitur	I lirë
2103 90 10	Çatni prej mangos, lëng	I lirë
2103 90 30	Bitera aromatike me forcë alkooolike në raport me vëllimin prej 44,2 deri në 49,2 % vol, që përmban nga 1,5 deri në 6 % të peshës gentian, erëza dhe përbërës të ndryshëm dhe nga 4 deri në 10 % sheqer, në kontienierë që përmbajnë 0,5 litra ose më pak	I lirë
2103 90 90	Të tjera	I lirë
2104	Supa dhe lëngje dhe përgatesat prej tyre; përgatesa të përbëra ushqimore të homogjenizuara:	I lirë
2105	Akulllore dhe akull tjetër I ngrënëshëm, që përmbajnë[kakao ose jo:	
2105 00 10	Pa përmbajtje yndyrnash të qumështit ose me në përmbajtje të këtyre yndyrnave prej 31 % të peshës	I lirë

Kodi tarifor shqiptar	Përshkrimi i produkteve	Trajtimi
2105 00 91	3 % ose më shumë, por më pak sesa 7 %	I lirë
2105 00 99	7 % ose më shumë	I lirë
2106 10 20	--Pa përmbajtje yndyrnash qumështi, saharoze, izoglukoze, glukoze apo niseshteje, ose me përmbajtje në raport me peshën, prej më pak se 1,5 % yndyre qumështi, 5 %	I lirë

	saharoze apo izoglukoze, 5 % glukoze ose niseshte	
2106 10 80	--Të tjera	I lirë
2106 90 20	--Përgatesa të përbëra alkoolike, përveç atyre të bazuara në substancat aromatike, të një lloji që përdoret për prodhimin e pijeve	I lirë
2106 90 92	—Pa përmbajtje yndyrnash qumështi, saharozes, glukoze ose niseshteje ose me përmbajtje, në raport me peshën, prej më pak 1,5% yndyrë qumështi, 5% saharozë ose izoglukoze, 5% glukozë ose niseshte:	I lirë
2106 90 98	—Të tjera	I lirë
2201	Ujërat, përfshirë ujërat natyrale ose minerale artificiale dhe ujërat e gazuara, pa përmbajtje sheqeri të shtuar apo lëndësh ëmbëltuese ose të paaromatizuara; akull dhe dëborë:	I lirë
2202	Ujërat, përfshirë ujërat minerale dhe ujërat e gazuara, që përmbajnë sheqer apo lënde të tjera ëmbëltuese apo aromatizuese shtesë, dhe pije të tjera joalkoolike, pa përfshirë lëngun e frutave apo të zarzavateve të kreut nr.2009:	I lirë
2203	Birrë e prodhuar nga malti	I lirë
2205	Vermut dhe verëra të tjera prej rrushit të freskët aromatizuar me bimë apo me substanca aromatizuese:	I lirë
2207	Alkoolit etilik jo i denaturuar i një force alkoolike ndaj vëllimit prej 80% vol ose më e lartë; alkoolit etilik dhe alkoole të tjera, të denaturuara, të çdo lloji force:	I lirë
2208	Alkool etilik jo i denaturuar i një force alkoolike ndaj volumit prej më pak se 80 % vol; pije alkoolike, likere dhe alkoole të tjera:	I lirë
2402	Puro, çeruto, sigarilo dhe cigare, prej duhani apo zëvendësuesve të duhanit:	I lirë
2403	Duhan tjetër i përpunuar dhe zëvendësuesit e përpunuar të duhanit; duhan i "homogjenizuar" apo i "rindërtuar"; ekstrakte dhe esenca prej duhanit:	I lirë
2905	Alkoole aciklike dhe derivatet e tyre të halogjenizuara, sulfonatizuara, nitratuara apo nitrosatuara: -Alkoole të tjera polihidrike:	
2905 43 00	--Manitol	I lirë
2905 44	--D-glucitol (sorbitol):	
	—Në solucione ujore:	
2905 44 11	—Me përmbajtje prej 2% ose më pak të peshës së D-manitolit, llogaritur në bazë të përmbajtjes së D-glucitolit	I lirë
2905 44 19	—Të tjera	I lirë
	—Të tjera:	
2905 44 91	—Me përmbajtje prej 2% ose më pak ndaj peshës të D-manitolit, të llogaritura në bazë të përmbajtjes së D-glucitolit	I lirë
2905 44 99	—Të tjera	I lirë

Kodi tarifar shqiptar	Përshkrimi i produkteve	Trajtimi
2905 45 00	--Glicerinë	I lirë
3301	Vajra për esencë (me ose pa tarpinë), përfshirë vajrat konkrete dhe absolute; rrëshirave; ekstrakteve të rrëshirave vajore; koncentrateve të vajrave eterike në yndyrna, në vajra të fiksuara, në dylle apo të ngjashme me këto, të përfuara përmes enflorazhit apo macerimit; nënprodukteve terpenike të deterpenimit të vajrave eterike; distilateve të ujshme dhe solucioneve të ujshme të vajrave eterike:	
3301 90	-Të tjera:	I lirë
3302	Përzierjet e substancave aromatike dhe përzierjet (përfshirë solucionet alkoolike) me bazë të një apo me shumë të këtyre substancave, të një lloji të përdorur si lëndë e parë në industri; preparatet e tjera të bazuara në substancat aromatike, të një lloji të përdorur për prodhimin e pijeve:	
3302 10	-Të një lloji të përdorur në industrinë ushqimore apo atë të Pijeve	
	--Të llojit që përdoret në industrinë e pijeve:	
	—Preparatet që përmbajnë të gjithë agjentët aromatizues që karakterizojnë një pije:	
3302 10 10	—Me një forcë alkoolike aktuale më shumë se 0,5% ndaj volumit	I lirë
	—Të tjera:	
3302 10 21	----- Pa përmbajtje yndyrnash qumështi, saharozem izoglukoze ose niseshteje ose me përmbajtje, në raport me peshën, prej më pak se 1,5% yndyrë qumështi, 5% shurup ose izoglukoze, 5% glukozë ose niseshte	I lirë
3302 10 29	----- Të tjera	I lirë
3501	Kaseinë, kaseinate dhe derivate të tjera kaseine; tutkall kaseine:	
3501 10 10	Për prodhimin e fibrave tekstile të rigjeneruara	I lirë
3501 10 50	Për përdorime industriale, përveç atyre të prodhimit të artikujve ushqimorë ose tagjisë	I lirë
3501 10 90	Të tjera	I lirë
3501 90 10	Tutkall kaseine	MFN
3501 90 90	Të tjera	I lirë
3505	Deksktrinën dhe niseshte të tjera të modifikuara (për shembull, niseshtetë e paraxhelatinuara ose të esterifikuara); ngjitësat me bazë niseshteje ose me bazë dekstrinash ose niseshte të tjera të modifikuara:	
3505 10 10	Dextrina	I lirë
3505 10 50	Niseshte, të esterifikuara ose eterifikuara	MFN
3505 10 90	Të tjera	I lirë

3505 20 10	Me përmbajtje, në raport me peshën, prej më pak se 25 % niseshte ose dekstrina, ose niseshte të tjera të modifikuara	I lirë
3505 20 30	Me përmbajtje, sipas peshës, prej 25 % ose më shumë, por më pak se 55 % të niseshteve ose dekstrinave, ose niseshteve të tjera të modifikuara	I lirë
3505 20 50	Me përmbajtje, në raport me peshën, prej 55 % ose më shumë, por më pak sesa 80 % e niseshteve ose dekstrinave, ose niseshteve të tjera të modifikuara	I lirë
3505 20 90	Me përmbajtje, në raport me peshën, prej 80 % ose më shumë e niseshteve ose dekstrinave, ose niseshteve të tjera të modifikuara	I lirë

Kodi tarifar shqiptar	Përshkrimi i produkteve	Trajtimi
3809 10 30	--Me përmbajtje të këtyre substancave në raport me peshën prej 55% ose më shumë, por më pak sesa 70%	I lirë
3809 10 50	--Me përmbajtje të këtyre substancave në raport me peshën prej 70% ose më shumë, por më pak sesa 83 %	I lirë
3809 10 90	--Me përmbajtje të këtyre substancave, në raport me peshën, prej 83% ose më shumë	I lirë
3823	Acidet yndyrore monokarboksilike industriale; vajrat acide nga rafinimi; alkoolët industriale yndyrore:	I lirë
3824 60	-Sorbitol përveçse atij të nënkreut 2905 44:	I lirë

TABELA 2 E PROTOKOLLIT A - KONCESIONET TARIFORE EFTA

Kodi SH	Përshkrimi i produkteve	Islandë	Norvegji	Zvicër/ Lihtenshtain
04.03	Dhallë, qumësht e krem i prerë, kos, kefir e qumësht e krem tjetër të fermentuara ose të acidifikuara, të përqendruara ose jo apo që përmbajnë sheqer të shtuar ose lëndë të tjera ëmbëlsuese ose lëndë aromatizuese, ose që përmbajnë fruta, arra ose kakao shtesë			
ex 0403.10	- Kos:			
	-- I aromatizuar ose që përmban fruta, arra ose kakao shtesë	*	*	*
ex 0403.90	- Të tjera:			
	-- Të aromatizuara ose që përmbajnë fruta, arra ose kakao shtesë	*	*	*
05.01	Flokë njeriu, të papunuara, të lara ose të pastruara; mbetje të flokëve të njeriut.	I LIRË	I LIRË	I LIRË
05.02	Qimet dhe kreshtat e derrave të butë, derrave të tredhur, derrave të egër; qimet e baldosave e qime të tjera për bërjen e furçave; mbetjet e këtyre qimeve apo kreshtave.	I LIRË	I LIRË	I LIRË

05.05	Lëkurët dhe pjesë të tjera të zogjve, me puplat ose pushin e tyre, puplat e pjesët e puplave (me anë të zbukuruara ose jo) dhe pushi, jo të punuara më tej, përveçse të pastruara, dizinfektuara ose përgatitura për ruajtje; pluhur dhe mbetje e puplave ose pjesëve të puplave.	I LIRË	I LIRË	I LIRË ¹
05.07	Fildish, guackë breshke, lapat e balenave dhe mustaqet e lapave të balenave, brirët, thundrat, thonjtë, kthetrat dhe sqepat, të papunuara ose thjesht të përgatitura, por të paprera në forma; pluhuri dhe mbetjet e këtyre produkteve.	I LIRË	I LIRË	I LIRË

Kodi SH	Përshkrimi i produkteve	Islandë	Norvegji	Zvicër/ Lihtenshtain
05.08	Koralet dhe lendë të ngjashme, të papunuara ose thjesht të përgatitura, por të papunuara në mënyrë tjetër; guackat e molusqeve, kafshëve guackore të ujit, ekinodermat dhe kocka të tjera të tyre, të papunuara ose thjesht të përgatitura, por të paprera në forma, pluhuri dhe mbetjet e tyre.	I LIRË	I LIRË	I LIRË ¹
05.10	Qelibar i hirtë, kastor, zibet dhe myshk; brumbull cantharides; vreri, i tharë ose jo; gjendrat e produktet e tjera shtazore të përdorura për përgatitjen e produkteve farmaceutike, të freskëta, të ftohta, të ngrira ose të ruajtura ndryshe në mënyrë të përkohshme.	I LIRË	I LIRË	I LIRË
07.10	Perime (të pagatuara ose të gatuar me avull ose të ziera në ujë"), të ngrira.			
0710.40	- Sweet corn	I LIRË	I LIRË ¹	I LIRË
07.11	Zarzavate të ruajtura në mënyrë të përkohshme (për shembull, nëpërmjet gazit të dioksidit të sulfurit, në shëllirë, në ujë sulfurik ose në solucione të tjera konservuese), por të papërshtatshme në atë gjendje për konsum të menjëhershëm.			
ex 0711.90	- Zarzavate të tjera; përzierje zarzavatesh:			
	-- Misër i ëmbël (Zea mays var. saccharata)	I LIRË	I LIRË ¹	I LIRË
09.01	Kafe, e pjekur ose jo apo e dekafeinuar; lëvoret dhe lëkurat e kafes, në çdo masë.	I LIRË	I LIRË	I LIRË ¹
09.02	Çaj, i aromatizuar ose jo.	I LIRË	I LIRË	I LIRË
13.02	Lëngjet dhe esencat vegjetale; substanca pektike, pektinatet e pektaket; agar-agar dhe lëndë të tjera ngjitëse dhe trashëse, të modifikuara ose jo, që nxirren nga produktet vegjetale.			
	- Lëngje dhe esenca vegjetale:			
1302.12	-- Prej jamballi	ILIRË	ILIRË	I LIRË
1302.13	-- Prej kulprës së buë	ILIRË	ILIRË	I LIRË
ex 1302.19	-- Të tjera:			
	--- Prej pirethrumit apo rrënjëve të bimëve që përmbajnë rotenone	ILIRË	ILIRË	I LIRË
	--- Përzierje e ekstrakteve vegjetale për prodhimin e pijeve apo përgatitjet e ushqimeve	ILIRË	ILIRË	I LIRË
	--- Barna, të ndryshme nga përzierjet e ekstrakteve vegjetale për prodhimin	ILIRË	ILIRË	I LIRË

	e pijeve ose preparateve ushqimore ose rrëshirë vajore e vaniljes			
1302.20	- Substanca pektike, pektinatet dhe pektatet	I LIRË	I LIRË	I LIRË

	- Lëndë të tjera ngjitëse dhe trashëse, të modifikuara ose jo, që nxirren nga produktet vegjetale:			
1302.31	-- Agar-agar	I LIRË	I LIRË	I LIRË
1302.32	-- Lëndë të tjera ngjitëse dhe trashëse, të modifikuara ose jo, që kokrrat e akacies së bardhë, farat e akacies së bardhë ose farat e nxirren nga farat guar	I LIRË	I LIRË	I LIRË
1302.39	-- Të tjera	I LIRË	I LIRË	I LIRË
14.01	Lëndë vegjetale të një lloji të përdorur kryesisht për thurje (për shembull, bambu, palmë indiane, kallamat, shelgu, gjethet e drurit të palmës, kashtë drithi e pastruar, e zbardhur ose e lyer dhe lëvore liri).	I LIRË	I LIRË	I LIRË
14.04	Produkte vegjetale që nuk janë specifikuar ose përfshirë askund tjetër.	I LIRË	I LIRË	I LIRË ¹⁻¹
15.16	Yndyrna shtazore ose vegjetale dhe fraksionet e tyre, tërësisht ose pjesërisht të hidrogjenizuara, të interesterifikuara, riesterifikuara ose elaidinifikuara, pavarësisht nëse janë të rafinuara ose jo, por jo të përgatitura më tepër.			
ex 1516.20	- Dhjamra dhe yndyrna vegjetale dhe fraksionet e tyre:			
	-- Vaj ricini i hidrogjenizuar, i ashtuquajtur "dyllë opak "	I LIRË	I LIRË	I LIRË
15.17	Margarinë; përzierje ose përgatesa të ngrënshme të dhjamrave ose yndyrnave vegjetale ose shtazore ose fraksione të dhjamrave ose yndyrnave të ndryshme të këtij kapitulli, përveç dhjamrave ose yndyrnave të ngrënshme apo fraksionet e tyre të kreut 15.16.			
ex 1517.10	- Margarinë, përjashtojë margarinen e lëngshme:			
	-- Me përmbajtje më të lartë sesa 10 %, por jo më shumë sesa 15 %, në bazë të peshës së yndyrnave të qumshtit	*	*	*
ex 1517.90	- Të tjera:			
	-- Me përmbajtje më të lartë sesa 10 %, por jo më shumë sesa 15 %, të peshës së yndyrnave të qumshtit	*	(*)	*
	-- Përzierje ose gatitje të ngrënshme ose preparate që përdoren për çlirimin nga kallëpi n.e.s.i	I LIRË	I LIRË	I LIRË
15.18	Vajra dhe yndyrna bimore ose shtazore dhe fraksionet e tyre, të ziera, të oksiduar, dehidratuar, sulfurizuar, të shkrira, të polimerizuara me nxehtësi në vakum ose në gaz inert apo, ndryshe, të ndryshuara kimikisht, përjashtojë ato që bëjnë pjesë në kreun 15.16; përzierje ose gatitje të dhjamrave ose yndyrnave shtazore ose bimore, ose të fraksioneve të dhjamrave apo yndyrnave të ndryshme të këtij kapitulli, që nuk specifikohen apo përfshihen askund tjetër.			
ex 1518.00	Linoksin	I LIRË	I LIRË	I LIRË
15.20	Glicerinë, bruto; ujëra glicerine dhe finja glicerine.	I LIRË	I LIRË ¹⁻¹	I LIRË

15.21	Dyllëra bimore (përveç triglicerideve), dyllë blete, dyllë i insekteve të tjera dhe spermaceti, qofshin të rafinuara apo të ngjyrosura.	I LIRË	I LIRË	I LIRË
15.22	Degras; mbetjet që shkaktohen nga trajtimi i substancave yndyrore nga dyllet bimore ose shtazore.	I LIRË	I LIRË ¹⁻¹	I LIRË
17.02	Sheqerna të tjera, përfshi laktozën kimikisht të pastër, maltozën, glukozën dhe fruktozën, në gjendje të ngurtë; shurube sheqeri që nuk përmbajnë lëndë aromatike dhe ngjyuese shtesë; mjaltë artificial, qoftë i përzier ose jo me mjaltë natyror; karamel.			
1702.50	- Fruktozë kimikisht e pastër,	I LIRË	I LIRË ¹⁻¹	I LIRË
ex 1702.90	- Të tjera, përfshi sheqer invert dhe përzieje të tjera sheqeri dhe shurupi fruktoze që përmban në gjendje të thatë 50 % të peshës fruktozë:			
	-- Maltozë e pastër kimikisht	I LIRË	I LIRË ¹⁻¹	I LIRË ¹⁻¹
17.04	Ëmbëlsirat prej sheqerit (përfshirë çokollatën e bardhë), që nuk përmbajnë kakao.	I LIRË	*	*
18.03	Brumë kakaoje, e çyndyrosur ose jo.	I LIRË	I LIRË	I LIRË
18.04	Gjalpë kakaoje, në formë të ngurtë dhe vajore.	I LIRË	I LIRË	I LIRË
18.05	Kakao pluhur, që nuk përmban sheqerna të shtuara apo lëndë të tjera ëmbëltuese.	I LIRË	I LIRË	I LIRË
18.06	Çokollatë dhe gatitje të tjera ushqimore që përmbajnë kakao.			
1806.10	- Kakao pluhur, që përmban sheqerna të shtuara ose lëndë të tjera ëmbëltuese	I LIRË	I LIRË	*
1806.20	- Gatitje të tjera në bllok, pllaka apo shufra që peshojnë më shumë se 2 kg apo në gjendje të lëngët, brumi, pluhuri apo kokrrizash, ose në forma të tjera neto në kontenierë apo në ambalazhe të çastit, me një përmbajtje më të madhe se 2 kg:	(*)	*	*
	- Të tjera, në bllok, pllaka ose shufra:			
1806.31	-- Të mbushura	*	*	*
1806.32	-- Të pambushura	(*)	*	*
1806.90	- Të tjera	(*)	*	*
19.01	Ekstrakt malti; gatitje ushqimore prej mielli, kokrrizash, mielli misri, niseshteje apo prej ekstraktit të maltit, që nuk përmbajnë kakao apo që përmbajnë kakao më pak se 40 % të peshës së llogarit mbi një bazë tërësisht pa yndyrë, të paspecifikuara dhe të papërfshira askund tjetër; përgatitjet ushqimore të mallrave të krerëve Nr.0401 deri në 0404, që nuk përmbajnë kakao apo që përmbajnë kakao me peshë më pak se 5 % të llogarit mbi një bazë tërësisht pa yndyrë, të papërfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër			
1901.10	- Gatitje për përdorim për fëmijët, të përgatitura për shitje me pakicë	I LIRË	*	*
1901.20	- Përzierje dhe brumëra për përgatitjen e artikujve të pastičerisë të kreut	(*)	*	*

	19.05			
1901.90	- Të tjera	I LIRË	(*)	(*)
19.02	Brumëra, qofshin të gatuar apo të mbushura ose jo (me mish ose lëndë të tjera) ose të përgatitura në mënyrë të ndryshme, si spageti, makarona, makarona, makarona petë, lazanje, njoki, ravioli, kaneloni; kus-kus, të përgatitura ose jo:			
	- Makarona të pagatuara, të pambushura apo të papërgatitura në asnjë lloj mënyre tjetër:			
1902.11	-- Me vezë në përmbajtje	*	*	*
1902.19	-- Të tjera	I LIRË	*	*
ex 1902.20	- Makarona të mbushura, qofshin të gatuar ose jo, apo të përgatitura në tjetër mënyrë:			
	-- Të tjera përveç produkteve që përmbajnë më shumë se 20 % të peshës sallam, mish, të brendshme apo gjaku, ose çdo kombinim që rrjedh prej këtyre	(*)	*	*
1902.30	- Brumëra të tjera	(*)	*	*
1902.40	- Couscous	(*)	*	*
19.03	Tapioka dhe zëvendësuesit e tij përgatitur nga niseshteja, në formën e fetëzave, kokrrizave, margaritarëve, tophave apo forma të ngjashme	I LIRË	*	I LIRË
19.04	Ushqimet e përgatitura të përfuara prej bymimit apo pjekjes së drithërave apo të produkteve të drithërave (për shembull, fetëza drithi); drithrat (ndryshe nga misri (drithë)) në formë kokre apo në formë fetëzash apo kokra të punuara (përveç miellit, kokrrizave të miellit dhe), gjysmë të gatshme apo të përgatitura në mënyrë tjetër, të papërfshira apo të paspecifikuara diku tjetër.			
1904.10	- Ushqime të përgatitura që përftohen nga bymimi apo pjekja e drithërave apo produkteve të drithërave	I LIRË	I LIRË ¹¹⁾	*
1904.20	- Ushqime të përgatitura, që përftohen nga fetëzat e papjekura të drithërave ose prej përzierjes së fetëzave të drithërave të papjekura ose drithërave të bymyera	I LIRË	*	*
1904.30	- Bollgur gruri	(*)	*	*
1904.90	- Të tjera	(*)	(*)	*
19.05	Bukë, ëmbëlsira, torta, biskota dhe artikuj të tjerë ëmbëlsirash, që përmbajnë ose jo kakao; biskota kungimi, kapsulat bosh të llojit të përshtatshëm për përdorim farmaceutik, vafera me shtresa, letër orizi dhe produkte të ngjashme.			
1905.10	- Bukë e thekur	I LIRË	*	*
1905.20	- Bukë me xhenxhefil dhe të tjera të ngjashme	*	*	*
	- Biskota të ëmbla; kuleç të hollë dhe vafera:			
1905.31	-- Biskota të ëmbla	*	*	*

1905.32	-- Kuleç të hollë dhe vafera	*	*	*
1905.40	- Peksimadhe, bukë e thekur dhe produkte të ngjashme të thekura	*	*	*
1905.90	- Të tjera	(*)	*	(*) ¹⁾
20.01	Zarzavate, fruta, arra dhe pjesë të tjera të ngrënshme të bimëve, të përgatitura ose të ruajtura në uthull apo acid acetik.			
ex 2001.90	- Të tjera:			
	-- Misër i ëmbël (Zea mays var. saccharata); zemër palme; rrepa, panxhar dhe pjesë të ngjashme të ngrënshme të bimëve, që përmbajnë niseshte në 5 % ose më shumë të peshës	I LIRË	(*)	I LIRË
20.02	Domate të përgatitura ose të konservuara në mënyra të tjera, përveç atyre me uthull ose acid acetik.			
2002.90	- Të tjera	I LIRË	I LIRË	I LIRË
20.04	Zarzavate të tjera të përgatitura apo të konservuara në mënyra të tjera, përveç asaj me uthull ose acid acetik, të ngrira, përveç atyre produkteve që renditen në kreun 20.06.			
ex 2004.10	- Patate:			
	-- Gatitje të ngrënshme të përbëra nga mielli, kokrrat ose fetëzat me bazë patatet	I LIRË	*	*
ex 2004.90	- Zarzavate të tjera dhe përzierje zarzavatesh:			
	-- Misër i ëmbël (Zea mays var. saccharata)	I LIRË	I LIRË ¹⁾	I LIRË
20.05	Zarzavate të tjera të përgatitura apo konservuara në mënyrë tjetër nga ajo me uthull ose acid acetik, jo të ngrira, të ndryshme nga produktet e kreut 20.06.			
ex 2005.20	- Patatet:			
	-- Gatitje të ngrënshme të përbëra nga mielli, kokrrizat ose fetëzat e patates	I LIRË	*	*
2005.80	- Misër i ëmbël (Zea mays var. saccharata)	I LIRË	I LIRË ¹⁾	I LIRË
20.06	Zarzavate, fruta, arra, lëkura frutash dhe pjesë të tjera të bimëve, të konservuara në sheqer (të thara, të sheqerosura ose të kristalizuara).			
ex 2006.00	- Misër i ëmbël (Zea mays var. saccharata)	I LIRË	*	I LIRË
20.07	Reçelra, peltet e frutave, marmelata, pure frutash ose arra dhe ëmbëlsira me fruta ose arra, të përfuara prej gatimit, pavarësisht nëse përmbajnë pse jo sheqerna të shtuara ose lëndë të tjera ëmbëltuese.			

2007.10	- Preparate të homogjenizuara	I LIRË	*	*
	- Të tjera:			
2007.91	-- Agrumet	I LIRË	I LIRË	(*)
2007.99	-- Të tjera	I LIRË	(*)	(*)

20.08	Fruta, atta dhe pjesë të tjera të ngrënshme të bimëve, të përgatitura ose konservuara ndryshe, pavarësisht nëse përmbajnë ose jo sheqerna të shtuara apo lëndë të tjera ëmbëltuese, që nuk janë specifikuar ose përfshirë diku tjetër.			
	- Arra, kikirikë dhe fara të tjera, të përziera ose jo:			
ex 2008.11	-- Kikirikë:			
	— Gjalpë kikiriku	I LIRË	I LIRË	*
	— Kikirikë, të pjekura	I LIRË	*	I LIRË
	- Të tjera, përfshi përzierje të tjera, përveç atyre të nënkreut 2008.19:			
2008.91	-- Zemër palme	I LIRË	I LIRË ¹⁾	I LIRË
ex 2008.99	-- Të tjera:			
	— Misër (drithë), përveç misrit të ëmbël (Zea mays var. saccharata)	I LIRË	*	I LIRË
21.01	Ektrakte, esenca dhe koncentre të kafesë, çajit ose matesë dhe gatitjet që kanë për bazë këto produkte apo kanë për bazë kafënë, çajin ose matenë; çikore e pjekur dhe zëvendësues të tjerë të pjekur të kafesë dhe ekstraktet, esencat dhe koncentratet prej tyre.			
	- Ekstraktet, esencat dhe koncentratet e kafesë dhe gatitjet me bazë të këtyre ekstrakteve, esencave ose koncentreve, ose me bazë kafeje:			
2101.11	-- Ektrakte, esenca dhe koncentre	I LIRË	I LIRË	I LIRË
2101.12	-- Gatitjet me bazë ekstraktesh, esencash ose koncentratësh, apo me bazë kafeje	I LIRË	I LIRË	*
2101.20	- Ekstraktet, esencat dhe koncentratet e çajit ose matesë dhe gatitjet me bazë prej këtyre ekstrakteve, esencave ose koncentreve, apo me bazë çaji ose mateje	I LIRË	I LIRË	*
2101.30	- Çikore e pjekur ose zëvendësues të tjerë të pjekur të kafesë dhe ekstraktet, esencat dhe koncentratet e tyre	I LIRË	I LIRË	I LIRË
21.02	Tharme (aktive ose joaktive); mikroorganizmat e tjera njëqelizore, të ngordhura (por që nuk përfshijnë vaksinat e kreut 30.02); pluhura të tjera të përgatitura për ardhjen e brumërave.			
2102.10	- Tharme aktive	I LIRË	I LIRË	I LIRË ²⁾

2102.20	- Tharme joaktive; mikroorganizma të tjera njëqelizore, të ngordhura	I LIRË	I LIRË ¹⁾	I LIRË ¹⁾
2102.30	- Pluhura të përgatitura për ardhjen e brumit	I LIRË	I LIRË	I LIRË
21.03	Salca e gatitjet e tyre; erëza të përziera dhe aromatizues të përzierë; miell dhe kokrriza mielli mustarde dhe mustardë e përgatitur.			
2103.10	- Salcë soje	I LIRË	I LIRË	I LIRË
2103.20	- Salcë e kuqe domateje dhe salca të tjera domatesh	I LIRË	(*)	I LIRË
2103.30	- Miell dhe kokrriza mielli mustarde dhe mustardë e përgatitur	I LIRË	I LIRË	I LIRË ¹⁾

2103.90	- Të tjera	(*)	(*)	I LIRË
21.04	Supa dhe lëngjet e mishit si edhe gatitjet prej tyre; gatitje të përbëra ushqimore të homogjenizuara.	*	(*)	(*)
21.05	Akullore dhe akull tjetër i ngrënë, që përmban ose jo.	E NDALUAR	(*)	*
21.06	Gatitje ushqimore të paspecifikuara apo përfshira diku tjetër.			
2106.10	- Koncentratet e proteinave dhe substancat e strukturuar proteinike	I LIRË	*	(*)
ex 2106.90	- Të tjera:			
	-- Të tjera, përveç shurupit të sheqerit të aromatizuar apo të ngjyrosur	E NDALUAR	(*)	(*)
22.01	Ujëra, përfshi ujërat minerale natyrore ose artificial dhe ujërat e gazuara, që nuk përmbajnë sheqerna të shtuara ose lëndë të tjera ëmbëltuese apo aromatizuese; akulli dhe bora.	I LIRË	I LIRË	I LIRË
22.02	Ujërat, përfshi ujërat minerale dhe të gazuara, që përmbajnë sheqerna ose lëndë të tjera ëmbëltuese ose aromatizuese shtesë, si edhe pije të tjera joalkoolike, pa përfshirë lëngjet e frutave ose të zarzavateve të kreut 20.09.			
2202.10	- Ujëra, përfshi ujërat minerale dhe ujërat e gazuara, që përmbajnë sheqer ose lëndë të tjera ëmbëltuese ose aromatizuese shtesë	I LIRË	I LIRË	I LIRË
2202.90	- Të tjera	(*)	(*)	*
22.03	Birra e prodhuar nga malti.	I LIRË	I LIRË	I LIRË
22.05	Vermuth dhe verëra të tjera prej rrushit të freskët aromatizuar me bimë ose lëndë aromatizuese.	I LIRË	I LIRË	I LIRË
22.07	Alkool etilik jo i çnatyruar me gradë alkoolike në raport me vëllimin prej 80 % të vëllimit apo më shumë; alkool etilik dhe alkoole të tjera, të çnatyruara, të çdo grade.			
2207.20	- Alkool etilik dhe alkoole të tjera, të çnatyruara, të çdo grade	I LIRË	I LIRË	I LIRË

22.08	Alkool etilik jo i çnatyruar me forcë alkoolike në raport me vëllimin prej më pak 80 % të vëllimit; alkoole, likeret dhe pije të tjera alkoolike.			
2208.20	- Alkoole të përfuara nga distilimi i verës së rrushit ose bërsive të rrushit	I LIRË	I LIRË	I LIRË
2208.30	- Uiskit	I LIRË	I LIRË	I LIRË
2208.40	- Rumi dhe alkoole të tjera të përfuara nga distilimi i produkteve të fermentuara të kallamit të sheqerit	I LIRË	I LIRË	I LIRË
2208.50	- Xhin dhe Geneva	I LIRË	I LIRË	I LIRË
2208.60	- Vodka	I LIRË	I LIRË	I LIRË
2208.70	- Likere dhe tonikë	I LIRË	I LIRË	I LIRË
2208.90	- Të tjera	I LIRË	I LIRË	*
22.09	Uthull dhe zëvendësues i uthullit, përfuor nga acidi acetik.	I LIRË	I LIRË	I LIRË

* = Tarifë në përputhje me Nenin 1 dhe 3 të Protokollit.

I LIRE = Asnjë tarifë doganore, në përputhje me Nenin 8 të kësaj Marrëveshjeje. (*) = Përmban edhe linja tarifore që janë "I LIRË".

1)= Produkte për qëllime ushqyerje: Norvegjia: Lëshime pjesore. Zvicra: Asnjë koncesion.

2)= Nuk jepen lëshime për majanë e brumërave dhe për produktet me qëllim ushqyerjen.

PROTOKOLLI B

I REFERUAR NË NENIN 7 KONCEPTI I "PRODUKTEVE ORIGJINUESE" DHE
METODAVE TË BASHKËPUNIMIT ADMINISTRATIV

PASQYRA E LËNDËS

TITULLI I DISPOZITA TE PERGJITHSHME

- Neni 1 Përkufizimet

TITULLI II PËRKUFIZIMI I KONCEPTIT TË "PRODUKTEVE ORIGJINUESE"

- Neni 2 Kërkesa të përgjithshme

- Neni 3 Kumulimi në një shtet të EFTA-s

- Neni 4 Kumulimi në Republikën e Shqipërisë

- Neni 5 Produkte të përftuara plotësisht
- Neni 6 Produkte që i janë nënshtruar procesit të punimeve dhe përpunimit të mjaftueshëm
- Neni 7 Punimet ose përpunimet e pamjaftueshme
- Neni 8 Njësia e Kualifikimit
- Neni 9 Pajisje shtesë, pjesët e këmbimit dhe veglat
- Neni 10 Kompletet
- Neni 11 Elementët neutralë

TITULLI III KËRKESAT TERRITORIALE

- Neni 12 Parimi i territorialitetit
- Neni 13 Transporti i drejtpërdrejtë
- Neni 14 Ekspozitat

TITULLI IV RIKTHIMI OSE PËRJASHTIMET

- Neni 15 Ndalimi i Rikthimit të Pagesës ose Përrjashtimit nga Tarifat Doganore

TITULLI V CERTIFIKATA E ORIGJINËS

- Neni 16 Kërkesa të përgjithshme
- Neni 17 Procedura për lëshimin e një certifikate të qarkullimit të produktit EUR. 1 ose EUR-MED
- Neni 18 Certifikatat e qarkullimit të produktit EUR.1 ose EUR-MED të lëshuara retrospektivisht
- Neni 19 Lëshimi i dublikatës të certifikatës së qarkullimit të produktit EUR. 1 ose EUR-MED
- Neni 20 Lëshimi i certifikatave të qarkullimit EUR. 1 ose EUR-MED mbi bazën e Certifikatës së Origjinës të lëshuar apo plotësuar më parë
- Neni 21 Likuidimi i llogarive
- Neni 22 Kushtet për Plotësimin e një deklarate fature ose një deklarate fature EUR-MED

- Neni 23 Eksportues i miratuar
- Neni 24 Vlefshmëria e Certifikatës së Origjinës
- Neni 25 Paraqitja e Certifikatës së Origjinës
- Neni 26 Importimi me këste
- Neni 27 Përjashtime nga Certifikata e Origjinës
- Neni 28 Dokumente Mbështetëse
- Neni 29 Ruajtja e Certifikatës së Origjinës dhe Dokumenteve Mbështetëse
- Neni 30 Mospërputhjet dhe Gabimet Formale
- Neni 31 Shumat e shprehura në Euro

TITULLI VI

MARRËVESHJET PËR BASHKËPUNIMIN ADMINISTRATIV

- Neni 32 Asistenca Reciproke
- Neni 33 Verifikimi i Certifikatës së Origjinës
- Neni 34 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve
- Neni 35 Penalitetet
- Neni 36 Zonat e Lira

TITULLI VII

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

- Neni 37 Dispozitat e përkohshme për Produktet në transit ose magazina
- Neni 38 Shtojcat

LISTA E SHTOJCAVE

- Shtojca 1 Shënime hyrëse në listën e Shtojcës nr. 2
- Shtojca 2 Lista e Punimeve ose Proceseve të domosdoshme për t'u kryer mbi lëndët jo-origjinuese me qëllim që produkti i prodhuar të mund të përfitojë statusin Origjinues
- Shtojca 3a Kopja e certifikatës të qarkullimit të produktit EUR.1 dhe aplikimit për një certifikatë qarkullimi të produktit EUR.1
- Shtojca 3b Kopja e certifikatës së qarkullimit të produktit EUR.1 dhe aplikimit për një certifikatë qarkullimi të produktit EUR -MED
- Shtojca 4a Tekst i Deklaratës Faturë

- Shtojca 4b Tekst i Deklaratës Faturë EUR-MED
- Shtojca 5 Lista e vendeve ose territoreve pjesëmarrëse në Partneritetin Euro-Mesdhetar bazuar në Deklaratën e Barcelonës

TITULLI I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Përkufizimet

Për qëllimet e këtij Protokolli:

- (a) "Fabrikim" nënkupton çdo lloj procesi trajtimi apo përpunimi, duke përfshirë montimin apo operacione specifike;
- (b) "Material" nënkupton çdo ingredient, lëndë e parë, përbërës ose pjesë etj., i përdorur në procesin e fabrikimit;
- (c) "Produkt" nënkupton çdo produkt i fabrikuar, edhe në qoftë se përdoret më tej në një operacion tjetër fabrikimi;
- (d) "Mallra" nënkupton si lëndë, ashtu edhe produkte;
- (e) "Vlerë doganore" nënkupton vlerën siç është përcaktuar në përputhje me Marrëveshjen për zbatimin të nenit VII të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tarifat dhe Tregtinë e vitit 1994 (Marrëveshja e Organizatës Botërore të Tregtisë - OBT mbi Vlerën Doganore);
- (f) "Çmimi ex-works" nënkupton çmimin që i paguhet për produktin e fabrikës një prodhuesi në Shqipëri ose në një shtet të EFTA-s, në të cilin është kryer punimi ose përpunimi përfundimtar, me kusht që çmimi të përfshijë vlerën e çdo materiali të përdorur, minus çdo takse të brendshme që është rimbursuar ose mund të rimbursohet kur produkti i përfutur eksportohet;
- (g) "Vlera e lëndëve" është vlera doganore në kohën e importit e lëndëve jo origjinuese që janë përdorur ose, nëse kjo nuk dihet dhe nuk mund të vërtetohet, çmimi i parë i verifikueshëm për lëndët në Shqipëri ose një shtet të EFTA-s;
- (h) "Vlera e lëndëve të origjinës " ka kuptimin e vlerës së këtyre lëndëve sipas përcaktimit në pikën (g) të zbatuara mutatis mutandis;
- (i) "Vlera e shtuar" konsiderohet të jetë çmimi ex-works minus vlerën doganore të çdo lëndë të përfshirë, që e ka origjinën në vendet e tjera të referuara në Nenet 3 dhe 4 me të cilat

zbatohet kumulimi ose, në ato raste kur vlera doganore është e panjohur ose nuk mund të vërtetohet me saktësi, çmimi i parë i vërtetueshëm i paguar për lëndët në Republikën e Shqipërisë apo në vendin e EFTA-s në fjalë;

- (j) "Kapitull" dhe "kre" nënkupton kapitujt dhe krerët (me kode 4 shifrore), të përdorura në një nomenklaturë që bazohet në Sistemin e Harmonizuar të Përshkrimit dhe Kodifikimit të Mallrave, të referuar në këtë Protokoll si "Sistemi i Harmonizuar" apo "SH";
- (k) "Klasifikim" i referohet klasifikimit të një produkti ose materiali sipas kreut përkatës;
- (l) "Dërgesë" nënkupton produkte të cilat ose janë dërguar në të njëjtën kohë nga një eksportues tek një marrës i vetëm, ose paraqiten në një dokument të vetëm transporti i hartuar për dërgimin e këtyre produkteve nga eksportuesi tek marrësi, ose në mungesë të një dokumenti të tillë, me një faturë të vetme;
- (m) "Territoret" përfshijnë ujërat territoriale;
- (n) "EUR" nënkupton euro, monedha e përbashkët e Bashkimit Evropian;
- (o) "Shtet i EFTA-s" nënkupton secilin prej shteteve të poshtëshënuara: Islanda, Norvegjia apo Zvicra (duke përfshirë Lihtenshteinin)⁴, sipas rastit;

⁴ Për shkak të unionit doganor midis Zvicrës dhe Lihtenshteinit, produktet me origjinë nga Lihtenshteinit konsiderohen si me origjinë nga Zvicra.

- (p) "Palë"- në kuadrin e këtij Protokoll i referohet Shqipërisë, Islandës, Zvicrës, apo Lihtenshteinit.

TITULLI II

PËRKUFIZIMI I KONCEPTIT "PRODUKTE ORIGJINUESE "

Neni 2

Kërkesa të Përgjithshme

1. Për qëllimin e kësaj Marrëveshjeje, produktet e mëposhtme konsiderohen me origjinë nga një shtet i EFTA-s:

- (a) produkte të siguruara plotësisht nga një vend i EFTA-s në kuptimin e Nenit 5;

(b) produkte të siguruara nga një vend i EFTA-s që përfshin lëndë që nuk janë përftuar plotësisht atje, me kusht që këto lëndë t'i jenë nënshtruar një procesi të mjaftueshëm të punimeve apo përpunimit në një shtet të EFTA-s në kuptimin e Nenit 6;

(c) produktet me origjinë nga Zona Ekonomike Evropiane (EEA), në kuptimin e Protokollit nr. 4 të Marrëveshjes të Zonës Ekonomike Evropiane.

2.Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, produktet e mëposhtme konsiderohen si produkte me origjinë shqiptare:

(a) Produkte të siguruara plotësisht në Shqipëri brenda kuptimit të Nenit 5;

(b) Produkte të siguruara në Shqipëri, duke përfshirë lëndë, që nuk janë siguruar plotësisht atje, me kusht që këto lëndë t'i jenë nënshtruar një procesi të mjaftueshëm punimi ose përpunimi në Republikën e Shqipërisë, në kuptimin e Nenit 6.

3.Dispozitat e nën-paragrafit 1 (c) zbatohen vetëm në ato raste kur ekziston një marrëveshje e tregtisë së lirë midis Republikës së Shqipërisë nga njëra anë, dhe Komunitetit Evropian në anën tjetër.

Neni 3

Kumulimi në një shtet të EFTA-s

1.Pa cenuar dispozitat e paragrafit 1 të Nenit 2, produktet konsiderohen të kenë origjinë nga një shtet i EFTA-s, në rast se këto produkte janë siguruar në këto vende, duke përfshirë lëndë që e kanë origjinën nga Islanda, Norvegjia, Zvicra (duke përfshirë Lihtenshteinin)⁵, Turqia apo Komuniteti Evropian, me kusht që punimet apo përpunimi i bërë në një nga shtetet në fjalë të EFTA-s të shkojë përtej operacioneve të referuara në Nenin 7. Nuk është e nevojshme që këto lëndë t'i jene nënshtruar proceseve të punimeve apo përpunimit të mjaftueshëm.

2.Pa cenuar dispozitat e paragrafit 1 të Nenit 2, produktet konsiderohen të kenë origjinë nga një shtet i EFTA-s, në rast se këto produkte janë siguruar në këto vende, duke përfshirë lëndë me origjinë nga Republika e Shqipërisë apo cilido vend tjetër pjesëmarrës në Procesin e Stabilizim- Asociimit të Bashkimit Evropian⁶, me kusht që procesi i punimit apo përpunimit i kryer në një shtet të EFTA-s të shkojë përtej operacioneve të referuara në Nenin 7. Nuk është e nevojshme që këto lëndë t'u jenë nënshtruar proceseve të punimeve apo përpunimit të mjaftueshëm.

3.Pa cenuar dispozitat e paragrafit 1 të Nenit 2, produktet konsiderohen të kenë origjinë nga një shtet i EFTA-s, në rast se këto produkte janë siguruar në këto vende, duke përfshirë lëndët me origjinë nga Ishujt Faroe apo çdo vend tjetër anëtar i partneritetit Euro-Mesdhetar sipas Deklaratës

⁵ Principata e Lihtenshteinit, sipas Traktatit të 29 Marsit 1923, është pjesë e unionit doganor me Zvicrën dhe është Palë Kontraktuese e Marrëveshjes së datës 2 Maj 1992 për Zonën Ekonomike Evropiane.

⁶ Siç përcaktohet në konkluzionet e Këshillit të Çështjeve të Përgjithshme të mbajtur në Prill 1997 dhe Komisionit të 19 Majit 1999 mbi përcaktimin e procesit të Stabilizim-Asociimit me vendet e Ballkanit Perëndimor (Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Kroaci, Maqedoni, Mali i Zi, Serbi dhe Misioni i Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara në Kosovë) së Barcelonës të miratuar në Konferencën Euro-Mesdhetare të mbajtur më datat 27-28 Nëntor 1995⁷, me përjashtim të Turqisë, me kusht që punimet apo përpunimi i bërë në një nga shtetet në fjalë të EFTA-s të shkojë përtej operacioneve të referuara në Nenin 7. Nuk është e nevojshme që këto lëndë t'i jenë nënshtruar proceseve të punimeve apo përpunimit të mjaftueshëm

4. Kur procesi i punimeve ose përpunimit në një vend të EFTA-s nuk shkon përtej operacioneve të referuara në Nenin 7, produkti i përfutur konsiderohet me origjinë nga vendi i EFTA-s në fjalë, vetëm aty ku vlera e shtuar është më e madhe se vlera e lëndëve të përdorura që e kanë origjinën në ndonjë prej vendeve të tjera të referuara në paragrafët 1 deri 3. Në rast se nuk bëhet fjalë për këtë rast, atëherë produkti i përfutur konsiderohet me origjinë nga vendi që ka vlerën më të lartë të lëndëve origjinuese të përdorura në fabrikimin në shtetin e EFTA-s në fjalë.

5. Produktet që e kanë origjinën në një nga vendet e përmendura në paragrafët 1 - 3, të cilat nuk u janë nënshtruar përpunimit apo përpunimit në shtetin në fjalë të EFTA-s e ruajnë origjinën e tyre në rast se eksportohen në një prej këtyre vendeve.

6. Kumulimi i parashtruar në këtë Nen mund të zbatohet vetëm me kusht që:

(a) të ketë një marrëveshje preferenciale tregtie në përputhje me Nenin XXIV të GATT-it të vitit 1994 midis vendeve të përfshira në përfundimin e statusit të origjinës dhe vendit të destinacionit;

(b) lëndët dhe produktet të kenë përfutur statusin origjinues përmes zbatimit të rregullave të origjinës identike me ato të përcaktuara në këtë Protokoll; dhe

(c) njoftimet që tregojnë plotësimin e kërkesave të nevojshme për zbatimin e kumulimit të jenë publikuar në Republikën e Shqipërisë dhe në vendet e EFTA-s.

7. Kumulimi i parashtruar në këtë Nen zbatohet nga data e rënë dakord nga Palët në fjalë dhe në përputhje me njoftimin e botuar në Gazetat përkatëse Zyrtare.

8. Shtetet e EFTA-s do t'i japin Republikës së Shqipërisë, përmes Sekretariatit të EFTA-s, hollësi të marrëveshjeve, duke përfshirë datat e hyrjes në fuqi dhe rregullat e origjinës të përcaktuara në to, të cilat zbatohen në lidhje me vendet e tjera të përmendura në paragrafët 1 deri 3.

Neni 4

Kumulimi në Shqipëri

1.Pa cenuar dispozitat e paragrafit 2 të Nenit 2, produktet konsiderohen me origjinë nga Republika e Shqipërisë, në rast se këto produkte janë përftuar atje, duke përfshirë lëndët origjinuese në Islandë, Norvegji, Zvicër (duke përfshirë Lihtenshteinin)⁸, Turqi apo në Komunitetin Evropian, me kusht që punimi apo përpunimi i bërë në një nga shtetet në fjalë të EFTA-s të shkojë përtej operacioneve të referuara në Nenin 7. Nuk është e nevojshme që këto lëndë t'i jenë nënshtruar proceseve të përpunimit apo përpunimit të mjaftueshëm.

2.Pa cenuar dispozitat e paragrafit 2 të Nenit 2, produktet konsiderohen me origjinë nga Republika e Shqipërisë, në rast se këto produkte janë përftuar atje, duke përfshirë lëndët me origjinë nga Republika e Shqipërisë apo çdo vend tjetër pjesëmarrës në procesin e Stabilizim-Asociimit të Bashkimit Evropian⁹, me kusht që punimi apo përpunimi i bërë në Republikën e Shqipërisë të shkojë përtej operacioneve të referuara në Nenin 7. Nuk është e nevojshme që këto lëndë t'i jenë nënshtruar proceseve të përpunimit apo përpunimit të mjaftueshëm.

3.Pa cenuar dispozitat e paragrafit 2 të nenit 2, produktet konsiderohen si origjinuese në Republikën e Shqipërisë në rast se këto produkte janë përftuar atje, duke përfshirë lëndë origjinuese në Ishujt Faroe apo në çdo vend tjetër që është pjesëmarrës në partneritetin Euro-Mesdhetar bazuar në Deklaratën e Barcelonës, të miratuar në Konferencën Euro-Mesdhetare të mbajtur në datat 27 dhe

7Një listë e vendeve që marrin pjesë në partneritetin Euro-Mesdhetar mund të gjendet në Shtojcën 5

⁸ Principata e Lihtenshteinit, sipas Traktatit të 29 marsit 1923, është pjesë e unionit doganor me Zvicrën dhe është Palë Kontraktuale e Marrëveshjes së datës 2 maj 1992 për Zonën Ekonomike Evropiane.

⁹ Siç përcaktohet në konkluzionet e Këshillit të Çështjeve të Përgjithshme të mbajtur në Prill 1997 dhe Komisionit të 19 Majit 1999 mbi përcaktimin e procesit të Stabilizim-Asociimit me vendet e Ballkat Perëndimor (Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Kroaci, Maqedoni, Mali i Zi, Serbi dhe Misioni i Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara në Kosovë)

28 Nëntor 1995¹⁰, me përjashtim të Turqisë, me kusht që punimi apo përpunimi i bërë në një nga shtetet në fjalë të EFTA-s të shkojë përtej operacioneve të referuara në Nenin 7. Nuk është e nevojshme që këto lëndë t'i jenë nënshtruar proceseve të përpunimit apo përpunimit të mjaftueshëm.

4.Në ato raste kur procesi i punimit ose përpunimit i kryer në Republikën e Shqipërisë nuk shkon përtej operacioneve të referuara në Nenin 7, produktet e përftuara konsiderohen si origjinuese në Republikën e Shqipërisë vetëm në rast se vlera e shtuar në Republikën e Shqipërisë është më e madhe se vlera e lëndëve origjinuese të përdorura në njërin prej

vendeve të referuara në paragrafët 1 deri 3. Në rast se nuk bëhet fjalë për këtë rast, produkti i përftuar konsiderohet si origjinues në vendin që ka vlerën më të lartë të lëndëve origjinuese të përdorura në fabrikim në Republikën e Shqipërisë.

5. Produktet origjinuese në njërin prej vendeve të referuara në paragrafët 1 deri 3, të cilat nuk u janë nënshtruar punimit apo përpunimit në Republikën e Shqipërisë e ruajnë origjinën e tyre në rast se eksportohen në njërin nga këto vende.

6. Kumulimi i parashtruar në këtë Nen mund të zbatohet vetëm me kusht që:

(a) të ketë një marrëveshje preferenciale tregtie në përputhje me Nenin XXIV të GATT-it të vitit 1994 midis vendeve të përfshira në përfitim të statusit të origjinës dhe vendit të destinacionit;

(b) lëndët dhe produktet të kenë përfitur statusin origjinues përmes zbatimit të rregullave të origjinës identike me ato të përcaktuara në këtë Protokoll; dhe

(c) njoftimet që tregojnë plotësimin e kërkesave të nevojshme për zbatimin e kumulimit të jenë publikuar në Republikën e Shqipërisë dhe në vendet e EFTA-s.

7. Kumulimi i parashtruar në këtë Nen zbatohet nga data e rënë dakord nga Palët në fjalë dhe në përputhje me njoftimin e botuar në Gazetat përkatëse Zyrtare.

8. Republika e Shqipërisë do të japë vendeve të EFTA-s, përmes Sekretariatit të EFTA-s, hollësi të marrëveshjeve, duke përfshirë datat e hyrjes në fuqi dhe rregullat e origjinës të përcaktuara në to, të cilat zbatohen në lidhje me vendet e tjera të përmendura në paragrafët 1 deri 3.

Neni 5

Produkte të përfthuara tërësisht

1. Sa më poshtë konsiderohen si të përfthuara tërësisht në Republikën e Shqipërisë ose në një vend të EFTA-s:

(a) produktet minerare të nxjerra nga toka ose nëntoka e tyre;

(b) produktet bimore të vjela ose të korrura në atë vend;

(c) kafshët e gjalla të lindura dhe të rritura në atë vend;

(d) produktet e prejardhura nga kafshë të gjalla të rritura në atë vend;

(e) produktet e gjahut ose të peshkimit të kryer në atë vend;

(f) produktet e peshkimit dhe produkte të tjera deti të marra jashtë ujërave territoriale të Palëve nga anijet e tyre;

(g) produktet e përfuara ose të prodhuara në bordin e anijeve-fabrikë nga produktet e përmendura në nënparagrafin (f);

(h) artikujt e përdorur të mbledhur atje që përdoren vetëm për rikuperimin e lëndës së parë, duke përfshirë goma të përdorura që përdoren vetëm si mbetje;

(i) hedhurinat, mbetjet që dalin nga veprimtaria e prodhimit dhe produktet jashtë përdorimit, që janë mbledhur në atë vend;

(j) produktet e marra nga shtrati i detit ose nëntoka poshtë shtratit të detit jashtë ujërave territoriale, me kusht që ky vend të ketë të drejta ekskluzive për shfrytëzimin e shtratit të detit ose të nëntokës;

(k) produkte të prodhuara atje ekskluzivisht nga produkte të specifikuar në nënparagrafët (a) deri në (j).

¹⁰ Një listë e vendeve që marrin pjesë në partneritetin Euro-Mesdhetar mund të gjendet në Shtojcën 5.

2. Termat "anijet e tyre" dhe "anijeve-fabrikë" në nënparagrafët 1(f) dhe 1 (g) zbatohen vetëm për anijet dhe anijet fabrikë:

(a) që janë të regjistruara në Shqipëri apo në një shtet të EFTA-s;

(b) që lundrojnë nën flamurin e Shqipërisë apo të një shteti të EFTA-s;

(c) që janë në pronësi së paku 50 për qind të shtetasve shqiptar apo të shteteve të EFTA-s, ose nga një kompani me zyrat qendrore në një nga këto shtete, ku menaxheri apo menaxherët, Kryetari i Bordit të Drejtorëve apo Bordit Mbikëqyrës, si edhe shumica e anëtarëve të këtyre bordeve janë shtetas shqiptarë apo të vendeve të EFTA-s me përgjegjësi të kufizuar së paku gjysma e kapitalit i takon atyre shteteve apo organeve publike apo shtetasve të këtyre Shteteve;

(d) nga të cilët kapiteni dhe oficerët janë shtetas shqiptarë ose të vendeve të EFTA-s; dhe

(e) nga të cilat së paku 75 për qind e ekuipazhit janë shtetas shqiptarë apo të vendeve të EFTA-s.

Neni 6

Produkte që i nënshtrohen punimit apo përpunimit të mjaftueshëm

1. Për qëllimet e Nenit 2, produktet që nuk janë plotësisht të përfuara konsiderohen t'i jenë nënshtruar një punimi apo përpunimi të mjaftueshëm, kur realizohen kushtet e parashtruara në Shtojcën 2.

Kushtet e përcaktuara në Shtojcën 2 tregojnë për të gjitha produktet e mbuluara nga kjo Marrëveshje, punimin apo përpunimin të cilit duhet t'iu nënshtrohen lëndët jo-origjinuese të përdorura në fabrikim dhe që zbatohen vetëm në lidhje me këto lëndë. Rrjedhimisht, n.q.s produkti që ka përfutur statusin origjinues duke plotësuar kushtet e përcaktuara në listë përdoret në prodhimin e një produkti tjetër, kushtet e aplikueshme për produktin në të cilin është inkorporuar nuk janë të zbatueshme edhe për të dhe nuk merren në konsideratë lëndët jo-origjinuese që mund të jenë përdorur në prodhimin e tij.

2.Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1, lëndët jo-origjinuese, të cilat sipas kushteve të përcaktuara në Shtojcën 2 nuk duhet të përdoren në prodhimin e një produkti mundet gjithsesi të përdoren, me kusht që:

(a) vlera e tyre në total të mos kalojë dhjetë për qind të çmimit ex-works të produktit; dhe

(b) çdo përqindje e dhënë në Shtojcën 2 për vlerën maksimale të lëndëve jo-origjinuese të mos tejkalohet përmes zbatimit të këtij paragrafi.

Ky paragraf nuk zbatohet për produkte të përshkruara në Kapitujt 50 deri 63 të Sistemit të Harmonizuar.

3.Paragrafët 1 dhe 2 zbatohen, në varësi të dispozitave të Nenit 7.

Neni 7

Trajtim ose përpunim i pamjaftueshëm

1. Pa cenuar paragrafin 2, operacionet e mëposhtme konsiderohen si trajtim apo përpunim i pamjaftueshëm për të garantuar statusin e produkteve të origjinës, pavarësisht nëse plotësohen apo jo kërkesat e Nenit 6:

(a) operacionet e ruajtjes që kanë për qëllim të sigurojnë që produktet mbeten në gjendje të mirë gjatë transportit dhe magazinimit;

(b) çmontimi dhe montimi i pakove;

(c) larja, pastrimi; heqja e pluhurit, oksidit, vajrave, bojës apo mbulesave të tjera;

(d) hekurosja apo presimi i tekstileve;

(e) operacione të thjeshta të lyerjes dhe lustrimit;

(f) zhveshja, zbardhimi i pjesshëm ose i plotë, lustrimi ose shkëlqimi i drithërave dhe orizit;

(g) operacione të ngjyrosjes së sheqerit apo për të formuar kokrra sheqeri;

- (h) qërimi, heqja e farave dhe lëvozhgave të frutave, arrave dhe perimeve;
- (i) mprehja, grirja e thjeshtë, apo prerja e thjeshtë;
- (j) sitja, përzgjedhja klasifikimi, kategorizimi, përputhja (duke përfshirë formimin e seteve të artikujve);
- (k) vendosja e thjeshtë nëpër shishe, kanoçe, qese, kuti, arka, dhe operacione të tjera të thjeshta ambalazhimi;
- (l) printimi i markave, logove apo shenjave të tjera dalluese mbi produktet apo ambalazhin e tyre;
- (m) përzierja e thjeshtë e produkteve, pavarësisht nëse janë të llojeve të ndryshme apo jo;
- (n) montim i thjeshtë i pjesëve të artikujve për të formuar një produkt të plotë ose çmontimi i produkteve në pjesë;
- (o) një kombinim i dy apo më shumë operacioneve të specifikuara në nënparagrafët (a) deri në (n); ose
- (p) therja e kafshëve.

2. Të gjitha operacionet e kryera në Shqipëri, ose në një vend të EFTA-s për një produkt të caktuar merren në konsideratë bashkërisht gjatë përcaktimit nëse punimi apo përpunimi i produktit konsiderohet si i pamjaftueshëm në kontekstin e paragrafit 1.

Neni 8

Njësia e kualifikimit

1. Njësia e kualifikimit për zbatimin e dispozitave të këtij Protokollit është produkti i veçantë që konsiderohet si njësia bazë gjata përcaktimit të klasifikimit duke përdorur nomenklaturën e Sistemit të Harmonizuar.

Rrjedhimisht:

(a) kur një produkt i përbërë nga një grup apo gamë artikujsh kategorizohet në termat e Sistemit të Harmonizuar në një Kre të vetëm, tërësia përbën njësinë e kualifikimit;

(b) kur një dërgesë përbëhet nga një sërë produktesh identike të klasifikuara në të njëjtin Kre të Sistemit të Harmonizuar, çdo produkt duhet të merret më vete gjatë zbatimit të dispozitave të këtij Protokollit.

2.Në ato raste kur, sipas Rregullit të Përgjithshëm nr. 5 të Sistemit të Harmonizuar, paketimi përfshihet me produktin për qëllimet e klasifikimit, ai përfshihet për qëllimet e përcaktimit të origjinës.

Neni 9

Pajisjet, pjesët e këmbimit dhe veglat

Pajisjet, pjesët e këmbimit dhe veglat që vijnë bashkërisht me pjesë të pajisjes, makinerisë, aparatit apo mjetit, që janë pjesë të pajisjes normale dhe janë të përfshira në çmimin e saj apo që nuk janë me fatura të veçanta konsiderohen si një e vetme me pjesën e pajisjes, makinerisë, aparatit apo mjetit në fjalë.

Neni 10

Kompletet

Kompletet, sipas përkufizimit të Rregullit të Përgjithshëm nr. 3 të Sistemit të Harmonizuar konsiderohen si origjinuese kur të gjithë komponentët e produktit janë origjinues. Megjithatë, kur një komplet përbëhet nga produkte origjinuese dhe jo-origjinuese, seti si i tërë konsiderohet si origjinues, me kusht që vlera e produkteve jo-origjinuese të mos e tejkalojë 15 për qind të çmimit ex-works të kompletit.

Neni 11

Elementet neutrale

Për të përcaktuar nëse një produkt është produkt origjinues ose jo, nuk është e nevojshme të përcaktohet origjina e elementëve të mëposhtëm, që mund të përdoren në fabrikimin e tij:

- (a) energjia dhe lënda djegëse;
- (b) fabrika dhe pajisja;
- (c) makineritë dhe veglat; ose
- (d) produkte që nuk hyjnë dhe që nuk janë menduar të hyjnë në përbërjen përfundimtare të produktit.

TITULLI III
KËRKESAT TERRITORIALE

Neni 12

Parimi i territorialitetit

1.Me përjashtim të dispozitave të nënparagrafit (c) të Neneve 2, 3 dhe 4 dhe të paragrafit 3 të këtij Neni, kushtet për përfitimin e statusit të produkteve origjinuese të përcaktuara në TITULLIN II duhet të plotësohen pa ndërprerje në Republikën e Shqipërisë apo në një shtet të EFTA-s.

2.Me përjashtim sipas dispozitave të Neneve 3 dhe 4, kur produktet origjinuese të eksportuara nga Republika e Shqipërisë ose nga një vend i EFTA-s drejt një vendi tjetër, kthehen, ato duhet të konsiderohen si jo-origjinuese, me përjashtim kur mund tu demonstrohet autoriteteve doganore që:

(a) produktet në kthim janë të njëjta me produktet e eksportuara; dhe

(b) ato nuk u janë nënshtuar ndonjë operacioni tjetër përtej atyre që nevojiten për t'i ruajtur ato në kushte të mira gjatë kohës së qëndrimit në atë vend apo gjatë eksportimit.

3.Përfitimi i statusit origjinues, në përputhje me kushtet e përcaktuara në TITULLIN II nuk ndikohet nga punimi apo përpunimi i bërë jashtë Republikës së Shqipërisë apo nga ndonjë vend i EFTA-s për lëndë të eksportuara nga Republika e Shqipërisë apo nga ndonjë vend i EFTA-s dhe që më pas është ri-importuar atje, me kusht që:

(a) lëndët në fjalë të jenë përftuar plotësisht në Republikën e Shqipërisë apo në ndonjë shtet të EFTA-s, ose u janë nënshtuar punimit apo përpunimit përtej operacioneve të përmendura në Nenin 7, përpara eksportimit; dhe

(b) të mund tu demonstrohet autoriteteve doganore që:

(i) produktet e ri-importuara janë përftuar përmes punimit apo përpunimit të lëndëve të eksportuara; dhe

(ii) vlera totale e shtuar e përftuar jashtë Republikës së Shqipërisë apo një vendi të EFTA-s që ndikohet nga zbatimi i dispozitave të këtij Neni të mos tejkalojë shumën dhjetë për qind të çmimit ex-works të produktit përfundimtar për të cilin pretendohet statusi origjinues.

4.Për qëllimet e paragrafit 3, kushtet për përfitimin e statusit origjinues të përcaktuara në TITULLIN II nuk zbatohen për trajtimin apo përpunimin e bërë jashtë Republikës së Shqipërisë apo një vendi të EFTA-s. Por në ato raste kur, Shtojca 2, një rregull për përcaktimin e vlerës maksimale për të gjitha lëndët jo-origjinuese të përfshira për përcaktimin e statusit origjinues të produktit përfundimtar zbatohet, vlera totale e lëndëve jo-origjinuese të përfshira në territorin e Palës në fjalë, marrë së bashku me vlerën totale të shtuar të përfshirë jashtë Shqipërisë apo shtetit të EFTA-s që preket nga zbatimi i dispozitave të këtij Neni nuk do ta tejkalojë përqindjen e përcaktuar.

5.Për qëllimet e paragrafëve 3 dhe 4, "vlera totale e shtuar" nënkupton të gjitha kostot që lindin jashtë Republikës së Shqipërisë dhe shtetit përkatës të EFTA-s, duke përfshirë vlerën e lëndëve të përfshira atje.

6.Paragrafët 3 dhe 4 nuk zbatohen për produktet që nuk plotësojnë kushtet e parashtruara në Shtojcën 2, ose për produkte që mund të konsiderohen që tu jenë nënshtruar një punimi apo përpunimi të mjaftueshëm vetëm në rast të zbatimit të tolerancës së përgjithshme të përcaktuar në paragrafin 2 të Nenit 6.

7.Dispozitat e paragrafëve 3 dhe 4 nuk zbatohen për produktet e përcaktuara në Kapitujt 50 deri 63 të Sistemit të Harmonizuar.

8.Çdo punim apo përpunim i llojit që përcaktohet nga dispozitat e këtij Neni dhe që është kryer jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë apo të një vendi të EFTA-s bëhet sipas procedimit transparent apo procedurave të ngjashme.

Neni 13

Transport i drejtpërdrejtë

1.Punimi preferencial i parashtruar në këtë Marrëveshje zbatohet vetëm për ato produkte, të cilat plotësojnë kërkesat e këtij Protokolli, dhe të cilat transportohen në mënyrë të drejtpërdrejtë midis Palëve apo përmes territoreve të vendeve të tjera të përmendura në Nenet 3 dhe 4 me të cilat zbatohet kumulimi. Megjithatë, produktet që përbëjnë një dërgesë të vetme mund të transportohen përmes territoreve të tjera, në rast se lind nevoja përmes lëvizjes transit apo magazinimit të përkohshëm në këto territore, me kusht që ato të mbeten nën mbikëqyrjen e autoriteteve doganore të vendit të transitit apo magazinimit dhe të mos i nënshtrohen operacioneve të tjera me përjashtim të shkarkimit, ngarkimit apo operacioneve të tjera që kanë për qëllim ruajtjen e tyre në kushte të mira.

Produktet origjinuese mund të transportohen me tubacion përmes një territori të ndryshëm nga ai i Palëve.

2.Fakte që kushtet e përcaktuara në paragrafin 1 janë plotësuar do tu jepen autoriteteve doganore të vendit importues me anë të:

- (a) një dokumenti të vetëm transporti që mbulon kalimin nga Palë eksportuese përmes shtetit të transitit; ose
- (b) një certifikate të lëshuar nga autoritetet doganore të shtetit të transitit:
 - (i) duke bërë një përshkrim të saktë të produkteve;
 - (ii) duke përcaktuar datat e shkarkimit dhe ngarkimit sërish të produkteve dhe, në ato raste kur është e aplikueshme, emrat e anijeve apo mjeteve të tjera të përdorura të transportit; dhe
 - (iii) duke certifikuar kushtet në të cilat produktet kanë qëndruar në shtetin ku është bërë transiti; ose
- (c) në mungesë të sa më sipër, çdo dokument mbështetës.

Neni 14

Ekspozitat

1. Produktet origjinuese të dërguara për një ekspozitë në një vend të ndryshëm nga vendet e specifikuar në Nenet 3 dhe 4 me të cilat zbatohet kumulimi dhe të cilat janë shitur pas ekspozitës për t'u importuar në Republikën e Shqipërisë apo në një vend të EFTA-s përfitojnë nga importimi nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, me kusht që tu demonstronhet autoriteteve doganore që:

- (a) një eksportues i ka dërguar këto produkte nga Republika e Shqipërisë apo një vend i EFTA-s në një vend ku zhvillohet ekspozita dhe i ka ekspozuar ato atje;
- (b) produktet të jenë shitur ose kaluar nga eksportuesi tek një person në Republikën e Shqipërisë apo në një vend të EFTA-s;
- (c) produktet të jenë dërguar gjatë ekspozitës apo menjëherë pas përfundimit të saj në Shtetin në të cilin ato ishin dërguar për ekspozitë; dhe
- (d) produktet, që nga momenti që janë dërguar për ekspozitë, të mos jenë përdorur për ndonjë qëllim të ndryshëm nga demonstrimi në atë ekspozitë.

2. Dokumenti i certifikatës së origjinës duhet të lëshohet apo jepet në përputhje me dispozitat e TITULLIT V dhe t'u paraqitet autoriteteve doganore të Palës që bën importin normalisht. Emri dhe adresa e ekspozitës duhet gjithashtu të theksohet aty. Aty ku nevojitet mund të kërkohen dokumente të tjera shtesë në lidhje me kushtet sipas të cilave produktet janë ekspozuar.

3. Paragrafi 1 zbatohet për çdo ekspozitë, panair, apo shfaqje publike tregtare, industriale, bujqësore apo të zejtarisë, që nuk është e organizuar për qëllime private në dyqane apo qendra

biznesi me qëllim shitjen e produkteve të huaja dhe gjatë të cilave produktet mbeten nën kontroll doganor.

TITULLI IV

RIKTHIMI OSE PËRJASHTIMI

Neni 15

Ndalimi i rikthimit të pagesës apo përjashtimit nga tarifatat doganore

1.Lëndët jo-origjinuese të përdorura për prodhimin e produkteve origjinuese në Republikën e Shqipërisë, në një shtet të EFTA-s, apo në vendet e tjera të specifikuar në Nenet 3 dhe 4 për të cilat është lëshuar apo plotësuar një dokument i certifikatës së origjinës, në përputhje me dispozitat e TITULLIT V nuk është objekt, në Shqipëri apo në ndonjë vend të EFTA-s i rikthimit të pagesës apo përjashtimeve nga çdo detyrim doganor.

2.Paragrafi 1 zbatohet për çdo marrëveshje për rimbursim, apo mospagesë të pjeshme apo të plotë të tarifave doganore apo tarifave që kanë efekt të barasvlershëm, të zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë apo në një shtet të EFTA-s për lëndë të përdorura gjatë prodhimit, në ato raste kur ky rimbursim apo mospagesë aplikohet në mënyrë të shprehur apo është në fuqi kur produktet e përfuara nga këto lëndë eksportohen dhe jo kur ato mbahen për përdorim shtëpiak.

3.Eksportuesi i produkteve të mbuluara nga dokumenti i certifikatës së origjinës përgatitet për të paraqitur në çdo kohë, me kërkesën e autoriteteve doganore, të gjitha dokumentet e duhura që provojnë se nuk ka pasur përpunim aktiv në lidhje me lëndët jo-origjinuese të përdorura në prodhimin e produkteve në fjalë dhe se të gjitha detyrimet apo tarifatat doganore që kanë efekt të barasvlershëm të zbatueshëm për këto lëndë.

4.Gjithashtu, dispozitat e paragrafëve 1 deri 3 zbatohen në lidhje me ambalazhimin në kuptimin e paragrafit 2 të Nenet 8, në lidhje me pjesët shtesë, pjesët e këmbimit dhe veglat në kuptimin e Nenet 9, si edhe produktet në një komplet në kuptimin e Nenet 10 kur këto artikujt janë jo-origjinues.

5.Dispozitat e paragrafëve 1 deri 4 zbatohen vetëm në lidhje me ato lëndë që i përkasin llojit ndaj të cilit zbatohet kjo Marrëveshje. Për më tepër, ato nuk përjashtojnë zbatimin e një sistemi për rimbursimin e eksporteve për produktet bujqësore, të aplikueshëm për eksportet, sipas dispozitave të kësaj Marrëveshjeje.

TITULLI V

CERTIFIKATA E ORIGJINËS

Neni 16

Kërkesa të përgjithshme

1. Produktet origjinuese në Republikën e Shqipërisë, me tu importuar në një shtet të EFTA- s, si edhe produktet origjinuese në një shtet të EFTA-s me tu importuar në Republikën e Shqipërisë përfitojnë nga kjo Marrëveshje, me paraqitjen e një prej provave të mëposhtme të origjinës:

(a) një certifikatë të qarkullimit të mallit EUR.1, një kopje e së cilës jepet në Shtojcën 3a;

(b) një certifikatë transporti EUR-MED, një kopje e së cilës jepet në Shtojcën 3b; ose

(c) në rastet e specifikuar në paragrafin 1 të Nenit 22, një deklaratë, që më pas do t'i referohemi si "deklaratë fature" ose " deklaratë fature EUR-MED", që lëshohet nga eksportuesi me një faturë apo çfarëdolloj dokumenti tjetër të natyrës tregtare që përshkruan produktet në fjalë, me hollësi të mjaftueshme për të bërë të mundur identifikimin e tyre; tekstet e këtyre faturave paraqiten në Shtojcat 4a dhe 4b.

(d) Për sa kohë ky Protokoll është i zbatueshëm vetëm mbi baza dypalësh midis Republikës së Shqipërisë dhe shteteve të EFTA-s, EUR.1 dhe deklarata faturë janë të vetmet dokumente që përbëjnë provën e origjinës.

2. Pavarësisht nga paragrafi 1, produktet origjinuese në kuptimin e këtij Protokoll, në rastet e specifikuar në Nenin 27 përfitojnë nga kjo Marrëveshje pa qenë e nevojshme të paraqesin ndonjërin nga dokumentet e referuara në paragrafin 1.

Neni 17

Procedura për lëshimin e certifikatës së qarkullimit të mallit eur.1 ose eur-med

1.Një certifikatë e qarkullimit të mallit EUR.1 ose EUR-MED lëshohet nga autoritetet doganore të Palës eksportuese, pas aplikimit me shkrim nga eksportuesi, ose nën përgjegjësinë e eksportuesit nga përfaqësuesi i tij i autorizuar.

2.Për qëllimet e paragrafit 1, eksportuesi apo përfaqësuesi i tij i autorizuar plotësojnë si certifikatën e transportit EUR.1 ose EUR-MED, ashtu edhe formularin e aplikimit, mostrat e të cilit jepen në Shtojcat 3a dhe 3b. Këta formularë plotësohen në njërën nga gjuhët zyrtare të një Pale, apo në gjuhën Angleze, sipas dispozitave të legjislacionit vendas të Palës eksportuese. Në rast se formularët plotësohen me shkrim dore, ato duhet të plotësohen me bojë dhe me germa shtypi. Përshkrimi i produkteve duhet të bëhet në kutinë e rezervuar për

këtë qëllim, pa lënë rreshta bosh. Aty ku kutia nuk është plotësuar plotësisht, duhet të bëhet një vijë horizontale poshtë vijës së përshkrimit dhe vihet një kryq në hapësirën boshe.

3. Eksportuesi që aplikon për lëshimin e një certifikate qarkullimi të mallit EUR.1 ose EUR-MED është i përgatitur që në çdo kohë me kërkesë të autoriteteve doganore të Palës eksportuese ku është lëshuar certifikata e qarkullimit të produktit EUR.1 ose EUR-MED të paraqesë të gjitha dokumentet e duhura që provojnë statusin e origjinës të produkteve në fjalë, si edhe plotësimin e kërkesave të tjera të përcaktuara në këtë Protokoll.

4. Pa cenuar paragrafin 5, autoritetet doganore të Republikës së Shqipërisë apo të një shteti të EFTA-s lëshojnë një certifikatë të qarkullimit të mallit EUR.1 në një nga rastet e mëposhtme:

(a) në rast se produktet në fjalë mund të konsiderohen si produkte që e kanë origjinën nga Republika e Shqipërisë, një vend i EFTA-s, apo ndonjë nga shtetet e referuara në paragrafin 1 të Nenit 3 dhe në paragrafin 1 të Nenit 4 me të cilët është i zbatueshëm kumulimi, pa zbatimin e kumulimit me lëndët e origjinës në një nga vendet e referuara në paragrafët 2 dhe 3 të Nenit 3 dhe paragrafët 2 dhe 3 të Nenit 4, si edhe të plotësojnë kërkesat e tjera të këtij Protokoll; ose

(b) n.q.s produktet në fjalë mund të konsiderohen si produkte me origjinë nga njëri prej vendeve të referuara në paragrafët 2 dhe 3 të nenit 3 dhe paragrafët 2 dhe 3 të nenit 4 me të cilët zbatohet kumulimi, pa zbatimin e kumulimit me lëndët me origjinë nga njëri prej vendeve të referuara në Nenit 3 dhe 4, si edhe të plotësojnë kërkesat e tjera të përcaktuara në këtë Protokoll, me kusht që të jetë lëshuar një certifikatë EUR-MED ose një faturë EUR-MED nga vendi i origjinës.

5. Autoritetet doganore të Republikës së Shqipërisë apo të një vendi të EFTA-s lëshojnë një certifikatë të qarkullimit të mallit EUR-MED, në qoftë se produktet përkatëse mund të konsiderohen si produkte me origjinë nga Republika e Shqipërisë, nga një vend i EFTA-s, apo nga ndonjë shtet tjetër i referuar në Nenit 3 dhe 4 me të cilët zbatohet kumulimi dhe plotësojnë kërkesat e përcaktuara në këtë protokoll dhe:

(a) kumulimi është aplikuar me lëndët origjinuese në një nga vendet e referuar në paragrafët 2 dhe 3 të Nenit 3 dhe paragrafët 2 dhe 3 të Nenit 4;

(b) produktet mund të përdoren si lëndë në kontekstin e kumulimit për prodhimin e produkteve për t'u eksportuar në njërin prej vendeve të referuara në paragrafët 2 dhe 3 të Nenit 3 dhe paragrafët 2 dhe 3 të Nenit 4; ose

(c) produktet mund të riekportohen nga një vend i destinacionit drejt njërit prej vendeve të referuara në paragrafët 2 dhe 3 të Nenit 3 dhe paragrafët 2 dhe 3 të Nenit 4.

6. Një certifikatë e qarkullimit të mallit EUR-MED përmban deklaratat e mëposhtme në gjuhën angleze në Kutinë nr. 7:

(a) në qoftë se origjina është përftuar përmes aplikimit të kumulimit me njërin apo më shumë prej vendeve të referuara në Nenit 3 dhe 4:

"KUMULIMI I ZBATUAR ME"(emri i vendit/vendeve)

(b) në qoftë se origjina është përftuar pa zbatuar kumulimin me një apo më shumë prej shteteve të referuara në Nenet 3 dhe 4:

"NUK ËSHTË ZBATUAR KUMULIMI"

7. Autoritetet doganore që lëshojnë certifikata për qarkullimin e produktit EUR.1 ose EUR-MED ndërmarrin të gjitha hapat e nevojshëm për të verifikuar statusin origjinues të produkteve dhe për të plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara në këtë Protokoll. Për këtë qëllim, ato gëzojnë të drejtën të kërkojnë çdo evidencë dhe të kryejnë çdo inspektim të llogarive të eksportuesit apo çfarëdolloj kontrolli tjetër që konsiderohet i përshtatshëm. Gjithashtu, ato garantojnë që formularët e referuar në paragrafin 2 të plotësohen siç duhet. Në veçanti, ato kontrollojnë nëse hapësira e rezervuar për përshkrimin e produkteve është plotësuar në mënyrë të tillë që të përjashtojë çdo mundësi për falsifikime.

8. Data e lëshimit të certifikatës të qarkullimit të produktit EUR.1 ose EUR-MED tregohet në Kutinë 11 të kësaj certifikate

9. Një certifikatë transporti EUR.1 ose EUR-MED lëshohet nga autoritetet doganore dhe do t'i bëhet e disponueshme eksportuesit momentin e kryerjes apo sigurimit të veprimtarisë së eksportit.

Neni 18

Certifikatat e qarkullimit të produktit eur.1 apo eur-med të lëshuara retrospektivisht

1. Pavarësisht nga paragrafi 9 i Nenit 17, një certifikatë për qarkullimin e produktit EUR.1 ose EUR-MED mund të lëshohet vetëm në raste të rralla, pas eksportimit të produkteve me të cilat lidhet në rast se:

(a) nuk ka qenë lëshuar momentin e eksportimit për shkak të gabimeve, pjesëve të harruara në mënyrë të pavullnetshme apo rrethanave të veçanta; ose

(b) u demonstron autoriteteve doganore që një certifikatë për qarkullimin e produktit EUR.1 ose EUR-MED është lëshuar, por nuk është pranuar momentin e importimit për arsye teknike.

2. Pavarësisht nga paragrafi 9 i Nenit 17, një certifikatë për qarkullimin e produktit EUR-MED mund të lëshohet pas eksportit të produkteve me të cilat lidhet dhe për të cilat është lëshuar një certifikatë për qarkullimin e produktit EUR.1 momentin e eksportit, me kusht që tu demonstron autoriteteve doganore që kushtet e referuara në paragrafin 5 të Nenit 17 janë përmbushur.

3.Për zbatimin e paragrafëve 1 dhe 2, eksportuesi duhet të tregojë në aplikim vendin dhe datën e eksportit të produkteve me të cilat lidhet certifikata e qarkullimit të produktit EUR.1 ose EUR-MED, si edhe arsyet për kërkesën.

4.Autoritetet doganore mund të lëshojnë një certifikatë për qarkullimin e produktit EUR.1 ose EUR-MED retrospektivisht, vetëm pasi të kenë verifikuar që informacioni i dhënë në aplikimin e eksportuesit korrespondon me atë të dosjes korrespondente.

5.Certifikatat e qarkullimit të produktit EUR.1 ose EUR-MED të lëshuara retrospektivisht në zbatim të paragrafit 1 duhet të vërtetohen me frazën e mëposhtme në gjuhën angleze:

"LËSHUAR NË MËNYRË RETROSPEKTIVE"

Certifikatat e qarkullimit të produktit EUR-MED të lëshuara në mënyrë retrospektive duke zbatuar paragrafin 2 duhet të vërtetohen me frazën e mëposhtme në gjuhën angleze:

"LËSHUAR REKTROSPEKTIVISHT (Origjinal EUR.1 nr....[data dhe vendi i lëshimit])"

6. Dokumenti i referuar në paragrafin 5 futet në Kutinë 7 të certifikatës të qarkullimit të produktit EUR.1 ose EUR-MED.

Neni 19

Lëshimi i dublikatës së certifikatës të qarkullimit të mallit EUR.1 ose EUR-MED

1.Në rast të vjedhjes, humbjes apo shkatërrimit të një certifikate të qarkullimit të mallit EUR.1 ose EUR-MED, eksportuesi mund të aplikojë tek autoritetet doganore, të cilat e kanë lëshuar atë për të kërkuar një dublikatë që plotësohet sipas dokumenteve të eksportit në zotërim të tyre.

2.Dublikata e lëshuar në përputhje me paragrafin 1 duhet të vërtetohen me fjalën e mëposhtme në gjuhën angleze:

"DUPLIKATË"

3.Dokumentet i referuar në paragrafin 2 futet në Kutinë nr. 7 të dublikatës së certifikatës së qarkullimit të produktit për EUR.1 ose EUR-MED.

4.Dublikata që duhet të mbajë datën e lëshimit të certifikatës origjinale të qarkullimit të produktit për EUR.1 ose EUR-MED ka fuqi që nga ajo datë.

Neni 20

Lëshimi i certifikatave të qarkullimit të mallit për EUR.1 ose EUR-MED sipas certifikatës së origjinës të lëshuar apo plotësuar më parë

Kur produktet origjinuese vihen nën kontrollin e një dogane në Republikën e Shqipërisë apo në një shtet të EFTA-s është i mundur zëvendësimi i certifikatës origjinale me një ose më shumë certifikata qarkullimi për EUR.1 ose EUR-MED për qëllimin e dërgimit të të gjitha apo disa prej produkteve gjatë brenda Republikës së Shqipërisë apo një shteti të EFTA-s. Certifikatat zëvendësuese për EUR.1 ose EUR-MED lëshohen nga zyra doganore nën kontrollin e të cilës janë vendosur produktet.

Neni 21

Likuidimi i llogarive

1.Në ato raste kur lindin vështirësi të konsiderueshme në lidhje me kostot apo lëndët për të mbajtur të ndara lëndët origjinuese dhe ato jo-origjinuese, të cilat janë identike dhe të shkëmbyeshme, autoritetet doganore, me kërkesën me shkrim të personave në fjalë, mund të autorizojnë të ashtuquajturin metodë të likuidimit të llogarive që përdoret për menaxhimin e tyre.

2.Metoda e likuidimit të llogarive duhet të jetë në gjendje të garantojë për një periudhë specifike reference, që numri i produkteve të përfuara që mund të konsiderohen si origjinuese të jetë i njëjtë me atë që do të kishte qenë përfuar në rast të një likuidimi fizik.

3.Autoritetet doganore mund të japin autorizimin e referuar në paragrafin 1, në varësi të çfarëdo kushti që konsiderohet si i përshtatshëm.

4.Metoda e likuidimit të llogarive regjistrohet dhe zbatohet sipas parimeve të përgjithshme të kontabilitetit të aplikueshme në vendin e Palës ku është prodhuar produkti.

5.Përfituesit e autorizimit të referuar në paragrafin 1 mund të lëshojnë apo të aplikojnë për certifikatat e origjinës, sipas rastit, për sasinë e produkteve që mund të konsiderohen si origjinuese. Me kërkesën e autoriteteve doganore, përfituesi bën një deklaratë të mënyrës sesi janë administruar këto sasi.

6.Autoritetet doganore monitorojnë përdorimin e autorizimit dhe mund ta tërheqin atë në çdo kohë nëse përfituesi e shpërdoron autorizimin në çfarëdo forme apo nuk arrin të plotësojë kushtet e parashtruara në këtë Protokoll.

Neni 22

Kushtet për plotësimin e një deklaratë fature ose një deklaratë fature EUR-MED

1.Një deklaratë fature ose një deklaratë fature EUR-MED të referuara në nënparagrafin 1 (c), Neni 16 mund të plotësohen:

- (a) nga një eksportues i miratuar në kuptimin e Nenit 23; ose

(b) nga një eksportues për çdo dërgesë që përbëhet nga një ose më shumë pako që përmbajnë produkte origjinuese vlera totale e të cilave nuk i kalon 6,000 euro.

2.Pa cenuar paragrafin 3, një deklaratë fature mund të plotësohet në rastet e mëposhtme:

(a) n.q.s produktet në fjalë mund të konsiderohen produkte me origjinë nga Republika e Shqipërisë apo nga një vend i EFTA-s ose nga ndonjë prej vendeve të tjera të referuara në paragrafin 1 të nenit 3 dhe paragrafin 1 të nenit 4 me të cilat zbatohet kumulimi, pa zbatimin e kumulimit me lëndët origjinuese në njërin prej vendeve të referuara në paragrafët 2 dhe 3 të nenit 3 dhe paragrafët 2 dhe 3 të nenit 4, dhe të plotësojnë kërkesat e tjera të përcaktuara në këtë protokoll; ose

(b) në rast se produktet në fjalë mund të konsiderohen si produkte origjinuese në njërin prej vendeve të referuara në paragrafët 2 dhe 3 të Nenit 3 dhe paragrafët 2 dhe 3 të Nenit 4 me të cilat zbatohet kumulimi, pa zbatuar kumulimin me lëndët origjinuese në njërin prej vendeve të referuara në Nenit 3 dhe 4 dhe të plotësojnë kërkesat e tjera të përcaktuara në këtë protokoll, me kusht që një certifikatë EUR-MED apo një faturë EUR-MED të jetë lëshuar në vendin e origjinës.

3.Një deklaratë fature EUR-MED plotësohet n.q.s produktet në fjalë mund të konsiderohen si produkte origjinuese në Republikën e Shqipërisë ose në një shtet të EFTA-s apo në ndonjërin prej vendeve të referuara në Nenit 3 dhe 4 me të cilat zbatohet akumulimi, plotësohen kërkesat e përcaktuara në këtë protokoll dhe:

(a) kumulimi është zbatuar me lëndët origjinuese në njërin prej vendeve të referuara në paragrafët 2 dhe 3 të Nenit 3 dhe paragrafët 2 dhe 3 të Nenit 4, ose

(b) produktet mund të përdoren si lëndë në kontekstin e kumulimit për prodhimin e produkteve për eksport drejt njërit prej vendeve të referuara në paragrafët 2 dhe 3 të Nenit 3 dhe paragrafët 2 dhe 3 të Nenit 4, ose

(c) produktet mund të riekportohen nga vendi i destinacionit drejt njërit prej vendeve të referuara në paragrafët 2 dhe 3 të nenit 3 dhe paragrafët 2 dhe 3 të nenit 4.

4.Një deklaratë fature EUR-MED përmban një nga deklaratat e mëposhtme në gjuhën angleze:

(a) n.q.s origjina është përftuar përmes zbatimit të kumulimit me një ose më shumë vende të referuara në Nenit 3 dhe 4:

"KUMULIMI I ZBATUAR ME" (emri i vendit/vendeve)

(b) n.q.s origjina është përftuar pa zbatimin e kumulimit me një ose më shumë prej vendeve të referuara në Nenit 3 dhe 4:

"NUK ËSHTË ZBATUAR KUMULIMI "

5.Eksportuesi që plotëson një deklaratë fature ose një deklaratë fature EUR-MED është i përgatitur për të paraqitur në çdo kohë, me kërkesë të autoriteteve doganore të Palës që bën

eksportimin, të gjitha dokumentet e përshtatshme që provojnë statusin origjinues të produkteve në fjalë, si edhe përmbushjen e të kërkesave të tjera të parashtruara në këtë protokoll.

6.Një deklaratë faturë, ose një deklaratë fature EUR-MED plotësohet nga eksportuesi duke shtypur, vulosur apo printuar faturën apo çdo dokument tjetër tregtar, deklaratën, teksti i së cilës paraqitet në Shtojcat 4a dhe 4b, duke përdorur një nga versionet gjuhësore të parashtruara në këto Apendikse dhe në përputhje me dispozitat e legjislacionit vendas të Palës eksportuese. Në rast se deklarata lëshohet me shkrim dore, ajo duhet të shkruhet me bojë dhe me germa të mëdha.

7.Deklaratë faturat dhe deklaratë faturat EUR-MED mbajnë me shkrim firmën origjinale të eksportuesit. Megjithatë, një eksportuesi të miratuar në kuptimin e Nenit 23 nuk do t'i kërkohet të firmosë këto deklarata, me kusht që ai tu japë autoriteteve doganore të Palës eksportuese një deklaratë me shkrim sipas të cilës ai pranon përgjegjësi të plotë për çdo faturë që e identifikon si të ketë qenë e firmosur me shkrim nga ai.

8. Një deklaratë fature ose një deklaratë fature EUR-MED mund të plotësohet nga eksportuesi kur produktet me të cilat lidhet të jenë eksportuar, apo pas eksportimit me kusht që t'i paraqitet Palës importuese jo më vonë se dy vjet pas importimit të produkteve me të cilat lidhet.

Neni 23

Eksportues i miratuar

1. Autoritetet doganore të Palës eksportuese mund të autorizojnë çdo eksportues (që më pas do tu referohemi si "eksportues i miratuar") i cili bën dërgesa të shpeshta të produkteve sipas kësaj Marrëveshjeje për të plotësuar faturën ose faturën EUR-MED, pavarësisht nga vlera e produkteve në fjalë. Një eksportues që kërkon një autorizim të tillë duhet tu paraqesë autoriteteve doganore të gjitha garancitë e nevojshme për të verifikuar statusin origjinues të produkteve, si edhe plotësimin e kërkesave të tjera të parashtruara në këtë Prookoll.

2.Autoritetet doganore mund të japin statusin "eksportues i miratuar" në varësi të kushteve që ata i konsiderojnë të përshtatshme.

3.Autoritetet doganore do t'i japin eksportuesit të miratuar një autorizim doganor që shfaqet në deklaratë faturën ose në deklaratë faturën EUR-MED.

4.Autoritetet doganore mbikëqyrin përdorimin e autorizimit nga eksportuesi i miratuar.

5.Autoritetet doganore gëzojnë të drejtën ta tërheqin autorizimin në çdo kohë. Ata do ta bëjnë një gjë të tillë kur eksportuesi i miratuar nuk ofron më garancitë e referuara në paragrafin 1, nuk plotëson më kushtet e përshkruara në paragrafin 2 ose e shpërdoron autorizimin.

Neni 24

Vlefshmëria e certifikatës së origjinës

1. Certifikata e origjinës është e vlefshme për një periudhë katër mujore nga data e lëshimit në vendin e Palës eksportuese dhe duhet të dorëzohet brenda periudhës në fjalë tek autoritetet doganore të Palës importuese.
2. Certifikatat e origjinës që u dorëzohen autoriteteve doganore të Palës importuese pas datës përfundimtare për prezantimin e specifikuar në paragrafin 1 mund të pranohen me qëllim zbatimin e punimit preferencial, ku mosparaqitja e këtyre dokumenteve deri në datën përfundimtare të përcaktuar ndodh vetëm në rrethana të jashtëzakonshme.
3. Në raste të tjera të paraqitjes me vonesë, autoritetet doganore të Palës importuese mund të pranojnë certifikatat e origjinës ku produktet janë dorëzuar përpara datës përfundimtare të përcaktuar.

Neni 25

Dorëzimi i certifikatës të origjinës

Certifikatat e origjinës do t'u paraqiten autoriteteve doganore të Palës importuese, sipas procedurave të zbatueshme në atë Palë. Autoritetet në fjalë mund të kërkojnë një përkthim të certifikatës së origjinës dhe mund të kërkojnë gjithashtu që deklarata e importimit të shoqërohet me një deklaratë nga importuesi që produktet plotësojnë kushtet e parashtruara në këtë Marrëveshje.

Neni 26

Importim me këste

Në ato raste kur me kërkesë të importuesit dhe sipas kushteve të përcaktuara nga autoritetet doganore të Palës importuese, produktet e çmontuara apo të pazbërthyer në kuptimin e Rregullit të Përgjithshëm nr. 2(a) të Sistemit të Harmonizuar të Seksioneve XVI dhe XVII apo kreut 7308 dhe 9406 të Sistemit të Harmonizuar importohen me këste, një provë e vetme origjine për këto produkte do tu dorëzohet autoriteteve doganore me importimin e dërgesës së parë.

Neni 27

Përrjashtime nga certifikata e origjinës

1. Produktet e dërguara si paketa të vogla nga persona privatë drejt personave të tjerë privatë, apo që janë pjesë e bagazhit personal të udhëtarëve pranohen si produkte origjinuese pa pasur nevojë për të paraqitur një certifikatë origjine, me kusht që këto produkte të mos importohen për qëllime tregtare dhe të jenë deklaruar pasi të kenë plotësuar kërkesat e parashtruara në këtë protokoll dhe me kusht që të mos ketë dyshime në lidhje me vërtetësinë e një deklarate të tillë. Në rastin e produkteve të dërguara me postë, kjo deklaratë mund të bëhet në deklaratën doganore CN22 / CN23 ose në një fletë që është aneks i atij dokumenti.

2. Importet që janë të rastit dhe përbëhen vetëm nga produkte për përdorim personal të përfituesve apo udhëtarëve apo familjeve të tyre nuk konsiderohen si importe për qëllime tregtare në rast se është evidente nga natyra dhe sasia e produkteve që nuk ka qëllime tregtare.

3. Për më tepër, vlera totale e këtyre produkteve nuk do ta tejkalojë shumën 500 euro në rastin e pakove të vogla, ose 1,200 euro në rastin e produkteve që janë pjesë e bagazhit personal të udhëtarëve.

Neni 28

Dokumente mbështetëse

Dokumentet e referuara në paragrafin 3 të Nenit 17 dhe paragrafin 5 të nenit 22 të përdorura për të provuar që produktet e mbuluara nga një certifikatë transporti për EUR.1, një certifikatë të qarkullimit të mallit për EUR-MED, një deklaratë fature ose një deklaratë fature EUR-MED mund të konsiderohen si produkte origjinuese në Republikën e Shqipërisë, në një shtet të EFTA-s ose në një nga vendet e tjera të referuara në Nenet 3 dhe 4 dhe plotësojnë kushtet e tjera të parashtruara në këtë protokoll mund të konsistojnë, ndër të tjera, nga sa më poshtë vijon:

(a) prova të drejtpërdrejta të proceseve të kryera nga eksportuesi ose furnitori për të përftuar produktet përkatëse, që gjenden p.sh në llogaritë apo bilancin e tij;

(b) dokumentet që provojnë statusin origjinues të lëndëve të përdorura, të lëshuara apo përfunduar në Republikën e Shqipërisë, ose në një shtet të EFTA-s ku këto dokumente janë përdorur sipas legjislacionit vendas;

(c) dokumente që provojnë punimin apo përpunimin e lëndëve në Republikën e Shqipërisë, ose në një shtet të EFTA-s, të lëshuar ose përfunduar në Republikën e Shqipërisë apo në një shtet të EFTA-s, kur këto dokumente janë përdorur sipas legjislacionit vendas;

(d) certifikatat e qarkullimit të produktit për EUR.1, certifikatat e qarkullimit për EUR-MED, faturat ose faturat EUR-MED që provojnë statusin origjinues të lëndëve të përdorura, lëshuara, apo përfunduara në Republikën e Shqipërisë apo në një shtet të EFTA-s, në përputhje me këtë Protokoll, ose në një nga vendet e tjera të referuara në Nenet 3 dhe 4, në përputhje me rregullat e origjinës që janë identike me rregullat e këtij Protokolli; ose

(e) fakte të përshtatshme në lidhje me punimin dhe përpunimin e bërë jashtë Shqipërisë, një shteti të EFTA-s, ose vendeve të tjera të referuara në Nenet 3 dhe 4 përmes zbatimit të nenit 12, që provojnë që kërkesat e parashtruara në atë Nen janë përmbushur.

Neni 29

Ruajta e certifikatës së origjinës dhe dokumenteve mbështetëse

1.Një eksportues që aplikon për lëshimin e një certifikatë për qarkullimin e produktit EUR.1 or EUR-MED do t'i ruajë dokumentet e referuara në paragrafin 3 të nenit 17 të paktën deri tre vjet.

2.Një eksportues që plotëson një deklaratë fature ose një deklaratë fature EUR-MED do ta ruajë, të patën, për tre vjet një kopje të kësaj fature, si edhe dokumentet e referuara në paragrafin 5 të nenit 22.

3.Autoritetet doganore të Palës eksportuese që lëshojnë një certifikatë për qarkullimin e produktit EUR.1 ose EUR-MED ruajnë të paktën tre vjet formularin e aplikimit të referuar në paragrafin 2 të nenit 17.

4.Autoritetet doganore të Palës importuese mbajnë të paktën tre vjet certifikatat e qarkullimit të produktit EUR.1, certifikatat e qarkullimit të produktit EUR-MED, deklaratë faturat dhe deklaratë faturat EUR-MED që u janë paraqitur atyre.

Neni 30

Mospërputhje dhe gabime formale

1.Konstatimi i mospërputhjeve të vogla midis deklaratave të bëra në dokumentin e certifikatës së origjinës dhe dokumenteve të paraqitura në zyrat doganore për qëllimet e kryerjes së formaliteteve për importimin e produkteve nuk e bën ipso facto certifikatën e origjinës të pavlefshme, n.q.s nuk përcaktohet siç duhet që ky dokument u korrespondon produkteve të paraqitura.

2.Gabimet e dukshme formale, si p.sh. gabime shtypi, në një dokument të certifikatës së origjinës nuk duhet të shkaktojnë refuzimin e tij, n.q.s këto gabime janë të tilla që nuk krijojnë dyshime në lidhje me saktësinë e deklaratës të dhënë në certifikatën e origjinës.

Neni 31

Shumat e shprehura në euro

1.Për qëllimet e paragrafit 1 (b) të Nenit 22 dhe paragrafit 3 të Nenit 27 në ato raste kur produktet janë të faturuara në një monedhë të ndryshme nga Euro, shumat në monedhat vendase të vendeve të referuara në Nenet 3 dhe 4 ekuivalente me shumat e shprehura në euro fiksohen çdo vit nga secili prej vendeve në fjalë.

2.Një dërgesë përfiton nga dispozitat e nën-paragrafit 1 (b) të Nenit 22 ose paragrafit 3 të Nenit 27 duke iu referuar monedhës në të cilën është plotësuar fatura, sipas shumës së përcaktuar nga Pala në fjalë.

3.Shumat e shprehura në çdo monedhë lokale janë të barasvlershme me shumat e shprehura në euro, që nga dita e parë e punës së muajit Tetor dhe zbatohen që nga data 1 Janar e vitit pasardhës. Palët njoftohen për shumat përkatëse.

4.Një Palë mund ta rrumbullakosë me plus, minus shumën që del nga konvertimi në monedhën vendase të një shume të shprehur në euro. Kjo shumë e rrumbullakosur mund të mos jetë e ndryshme nga shuma që del nga konvertimi me më shumë se pesë për qind.

Një vend mund ta mbajë të pandryshuar monedhën e vet vendase të barasvlershme me një shumë të shprehur në euro, n.q.s momentin e rregullimit vjetor të përcaktuar në paragrafin 3, konvertimi i asaj shume, përpara rrumbullakosjes rezulton në një rritje me më pak se 15 për qind të ekuivalentit të monedhës vendase. Ekuivalenti i monedhës vendase mund të mbahet e pandryshuar në rast se këmbimi do të rezultonte në një vlerë ekuivalente më të ulët.

5.Shumat e shprehura në euro shqyrtohen nga Komiteti i Përbashkët, me kërkesë të cilësdo Palë. Gjatë kryerjes së shqyrtimit, Komisioni i Përbashkët merr në konsideratë dëshirën për ruajtjen e efekteve të limiteve në fjalë në terma reale. Për këtë qëllim, Komiteti mund të vendosë të modifikojë shumat e shprehura në euro.

TITULLI VI

MARRËVESHJET PËR BASHKËPUNIM ADMINISTRATIV

Neni 32

Asistenca reciproke

1. Autoritetet doganore të Republikës së Shqipërisë dhe ato të vendeve të EFTA-s do t'i sigurojnë njëra-tjetrës përmes Sekretariatit të EFTA-s kopje të vulave të përdorura në zyrat e tyre doganore për lëshimin e certifikatave të qarkullimit për EUR.1 dhe EUR-MED, si edhe adresat e autoriteteve doganore përgjegjëse për verifikimin e atyre certifikatave, faturave dhe faturave EUR- MED.

2. Për të garantuar zbatimin e duhur të këtij Protokolli, Republika e Shqipërisë dhe vendet e EFTA-s do t'i vijnë në ndihmë njëra-tjetrës, përmes administrative kompetente doganore, për të kontrolluar vërtetësinë e certifikatave të qarkullimit për EUR.1, EUR-MED, deklaratë faturave dhe deklaratë faturave EUR-MED, si edhe për të kontrolluar saktësinë e informacionit të dhënë në këto dokumente.

Neni 33

Verifikimi i certifikatës së origjinës

1. Verifikimet e mëposhme të certifikatës së origjinës bëhen pa ndonjë rend specifik ose kurdoherë që autoritetet doganore të Palës importuese kanë dyshime të mjaftueshme në lidhje me vërtetësinë e këtyre dokumenteve, statusin origjinues të produkteve në fjalë apo plotësimin e kërkesave të tjera të parashtruara në këtë protokoll.

2. Për qëllimet e paragrafit 1, autoritetet doganore të Palës importuese do t'ia kthejnë certifikatën e qarkullimit të produktit për EUR.1 ose EUR-MED, si edhe deklaratë faturën, në rast së është lëshuar, deklaratë faturën ose deklaratë faturën EUR-MED, ose një kopje të këtyre dokumenteve, autoriteteve doganore të Palës eksportuese duke dhënë, sipas rastit, arsyet për këtë kërkesë. Çdo dokument dhe informacion i marrë që sugjeron se informacioni i dhënë në certifikatën e origjinës është i pasaktë dërgohet në mbështetje të kërkesës për verifikim.

3. Verifikimi bëhet nga autoritetet doganore të Palës eksportuese. Për këtë qëllim, ato autoritete gëzojnë të drejtën të kërkojnë çdo provë, si edhe të bëjnë çdo inspektim të llogarive të eksportuesit apo çdo lloji kontrolli tjetër që konsiderohet si i përshtatshëm.

4. N.q.s autoritetet doganore të Palës importuese vendosin të pezullojnë dhënien e trajtimit preferencial për produktet në fjalë, ndërsa priten rezultatet e verifikimit, importuesi ka të drejtën të marrë produktet në dorëzim në varësi të masave parandaluese që konsiderohen si të nevojshme.

5. Autoritetet doganore të cilat kanë kërkuar verifikim informohen në lidhje me rezultatet e këtij verifikimi sa më shpejt të jetë e mundur. Rezultatet tregojnë qartazi nëse dokumentet janë origjinalë dhe nëse produktet në fjalë mund të konsiderohen si produkte që e kanë origjinën nga Republika e Shqipërisë, një vend i EFTA-s, apo ndonjë nga vendet e referuara në Nenet 3 dhe 4 dhe plotësojnë kërkesat e tjera të parashtruara në këtë protokoll.

6.N.q.s në rastet kur ka vend për dyshim nuk merret përgjigje brenda një periudhe dhjetë mujore që nga data e verifikimit ose n.q.s përgjigja nuk përmban informacion të mjaftueshëm për të përcaktuar vërtetësinë e dokumentit në fjalë, apo të origjinës reale të produkteve, autoritetet doganore që kanë bërë kërkesën, me përjashtim të rrethanave të veçanta do ta refuzojnë të drejtën për të përfituar nga punimi me tarifë preferenciale.

Neni 34

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

1.Mosmarrëveshjet që lindin në lidhje me procedurat e verifikimit, sipas Nenit 33, të cilat nuk mund të zgjidhen midis autoriteteve doganore që kërkojnë një verifikim dhe autoriteteve doganore që përgjigjen për kryerjen e këtij verifikimi, apo që ngrenë një problem në lidhje me interpretimin e këtij Protokollit do t'i referohen Komitetit të Përbashkët të Republikës së Shqipërisë dhe EFTA-s.

2.Në të gjitha rastet, zgjidhja e mosmarrëveshjeve midis importuesit dhe autoriteteve doganore të Palës importuese bëhet sipas legjislacionit të kësaj Pale.

Neni 35

Penalitetet

Çdo person që plotëson ose mundëson plotësimin e një dokumenti që përmban informacion të pasaktë për qëllimin e përfitimit nga punimi tarifor preferencial gjobitet.

Neni 36

Zonat e lira

1.Republika e Shqipërisë dhe vendet e EFTA-s ndërmarrin të gjitha hapat e nevojshme për tu siguruar që produktet që tregtohen me certifikatën e origjinës të cilat gjatë rrugës së transportit përdorin një zonë të lirë që gjendet në territorin e tyre, të mos zëvendësohen me produkte të tjera dhe t'u nënshtrohen vetëm operacioneve normale që kanë për qëllim parandalimin e përkeqësimit të tyre.

2.Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1, në rastet kur produktet që e kanë origjinën nga Republika e Shqipërisë apo nga ndonjë vend i EFTA-s importohen në një zonë të tregtisë së lirë me certifikatën e origjinës dhe u nënshtrohen proceseve të punimit apo përpunimit, autoritetet në fjalë lëshojnë një certifikatë të re të qarkullimit EUR.1 ose EUR-MED më kërkesën e eksportuesit, në rast se procesi i punimit apo përpunimit është në përputhje me dispozitat e këtij Protokollit.

TITULLI VII

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 37

Dispozita provizore për produktet në transit apo magazinim

Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje mund të zbatohen për produkte që përputhen me dispozitat e këtij Protokollit dhe të cilat në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje janë në transit ose në një zonë magazinimi të përkohshëm në magazinat doganore apo në zonat e lira në Republikën e Shqipërisë ose në një vend të EFTA-s, në varësi të paraqitjes tek autoritetet doganore të vendit importues, brenda katër muajve nga data në fjalë e një certifikate qarkullimi EUR.1 ose EUR-MED të lëshuar retrospektivisht nga autoritetet doganore të vendit të palës eksportuese bashkë me dokumentet që tregojnë se produktet janë transportuar në përputhje me dispozitat e Nenit 13.

Neni 38

Shtojcat

Shtojcat e këtij Protokollit janë pjesë integrale tij.

SHTOJCA 1 E PROTOKOLLIT B

SHËNIME HYRËSE PËR LISTËN E SHTOJCËS 2

Shënim 1.

Lista përcakton kushtet e kërkuara që të gjitha produktet të konsiderohen të punuara ose të përpunuara mjaftueshëm, në kuptim të Nenit 6 të Protokollit B.

Shënim 2.

2.1 Dy kolonat e para të listës përshkruajnë produktet e përfuara. Kolona e parë përmban numrin e kreut ose numrin e kapitullit që përdoret në Sistemin e Harmonizuar dhe kolona e dytë përmban përshkrimin e mallrave të përdorura në këtë sistem për atë kre apo kapitull. Për çdo zë në dy kolonat e para, përcaktohet një rregull në kolonën 3 ose 4. Kur, në ndonjë rast, zërat në kolonën e parë paraprihen nga simboli 'ex', kjo nënkupton që rregullat në kolonën 3 ose 4 gjejnë zbatim vetëm për atë pjesë të kreut që përshkruhet në kolonën 2.

2.2 Nëse disa numra kapitujsh janë të grupuar bashkë në kolonën 1 ose kur jepet numri i një kapitulli dhe, për rrjedhojë, përshkrimi i produkteve në kolonën 2 jepet në terma të përgjithshme, rregullat vijuese në kolonën 3 dhe 4 gjejnë zbatim për të gjitha produktet, të cilat, sipas Sistemit të Harmonizuar, klasifikohen në krahë e kapituj apo në çdo kre tjetër që gjendet i grupuar në kolonën 1.

2.3 Kur lista përmban rregulla të ndryshme që gjejnë zbatim për produkte të ndryshme në një kre, çdo indent përmban përshkrimin e asaj pjese të kreut që përfshihet në rregullat vijuese të kolonës 3 dhe 4.

2.4 Nëse, për një zë të dy kolonave të para ka një rregull të përcaktuar si në kolonën 3, ashtu edhe në kolonën 4, eksportuesi mund të zgjedhë, si alternativë, ose të zbatojë rregullin e përcaktuar në kolonën 3, ose atë që përcaktohet në kolonën 4. Nëse kolona 4 nuk ka asnjë rregull origjine, duhet të zbatohet rregulli i parashikuar në kolonën 3.

Shënim 3.

3.1 Dispozitat e Nenit 6 të Protokollit B lidhur me produktet që kanë përfutur statusin e origjinës, të cilat janë përdorur në prodhimin e produkteve të tjera, zbatohen pavarësisht nëse ky status është marrë brenda fabrikës ku janë përdorur këto produkte ose në një fabrikë tjetër të një Pale.

Shembull.

Një motor që renditet në kreun 8407, për të cilin rregulli përcakton se vlera e lëndëve që nuk janë origjinuese, të cilat mund të përfshihen në të, nuk mund të tejkalojë 40 për qind të çmimit të fabrikës ex-works, përbëhet nga "aliazhe të tjera çeliku të formësuara nga farkëtimi " të kreut ex 7224.

Nëse ky farkëtim është kryer në Palën e përfshirë nga lingotës jo-origjinuese, ai e ka marrë tashmë statusin origjinues në bazë të rregullit të kreut ex 7224 në listë. Farkëtimi mund të konsiderohet, më tej, si me origjinë në llogaritjen e vlerës së motorit, pavarësisht nëse ishte prodhuar në të njëjtën fabrikë apo në një fabrikë tjetër të Palës së përfshirë. Vlera e lingotës jo-origjinuese merret, kështu, në konsideratë kur shtohet vlera e materialeve jo-origjinuese që janë përdorur.

3.2 Rregulli në listë përfaqëson sasinë minimale të punimit ose përpunimit të kërkuar dhe kryerja e punimeve ose përpunimeve të tjera jep, gjithashtu, statusin origjinues; nga ana tjetër, kryerja e një punimi ose përpunimi më të pakët nuk mund të japë statusin origjinues. Kështu, nëse një rregull përcakton se materiali jo-origjinues mund të përdoret deri në një

nivel të caktuar prodhimi, përdorimi i këtij materiali lejohet në një fazë më të hershme të prodhimit dhe përdorimi i këtij materiali nuk lejohet në një fazë më të vonshme.

3.3 Pa cenuar Shënimin 3.2, kur një rregull parashikon se "mund të përdoren lëndët e çdo kreu, edhe lëndët nën të njëjtin kre me produktin mund të përdoren, duke qenë, sidoqoftë, subjekt i kufizimeve konkrete të parashikuara në rregull. Megjithatë, shprehja "prodhimi nga lëndë të çdo kreu, përfshirë materialet e tjera të kreut ..." nënkupton se mund të përdoren vetëm materialet e klasifikuara nën atë kre si produktet me një përshkrim të ndryshëm nga ai i produktit të parashikuar në kolonën 2 të listës.

3.4 Kur një rregull në listë përcakton se një produkt mund të prodhohet nga më shumë se një lëndë, kjo do të thotë se mund të përdoret secila apo më shumë lëndë. Kjo nuk kërkon që të përdoren të gjitha lëndët.

Shembull.

Rregulli për pëlhura të krerëve 5208 deri në 5212 përcakton se fibrat natyrore mund të përdoren dhe se, mes lëndëve të tjera, mund të përdoren edhe lëndët kimike. Kjo nuk nënkupton se duhet të përdoren të dyja; mund të përdoret njëra ose tjetra apo të dyja bashkë.

3.5 Kur rregulli në listë përcakton se produkti duhet të prodhohet me një lëndë të caktuar, kushti nuk ndalon përdorimin e lëndëve të tjera, që, për shkak të natyrës së tyre të brendshme, nuk mund ta përmbushin rregullin. (Shih, gjithashtu, Shënimin 6.2 lidhur me tekstilet).

Shembull.

Rregulli për ushqimet e përpunuara të kreut 1904, i cili përjashton konkretisht përdorimin e drithërave dhe nënprodukteve të tyre nuk parandalon përdorimin e kripërave minerale, substancave kimike dhe aditivëve të tjerë, të cilët nuk janë produkte nga drithërat.

Sidoqoftë, kjo nuk vlen për ato produkte, të cilat, edhe pse nuk mund të prodhohen nga lëndë e caktuar që parashikohet në listë, mund të prodhohen nga një lëndë e një natyre të ngjashme në një faze më të hershme të prodhimit.

Shembull.

Në rastin kur një artikull veshmbathjeje i ex Kapitulli 62 që përbëhet nga lëndë të pathurura, nëse për këtë kategori artikujsh lejohet vetëm përdorimi i fillit jo-origjinues, nuk mund të fillojmë nga copat e pathurura - edhe pse, normalisht, copat e pathurura nuk mund të përbëhen nga filli. Në këto raste, materiali fillestar, zakonisht, do të ishte një faze përpara filli - që është faza e fibrës.

3.6 Nëse, në një rregull në listë, jepen dy përqindje për vlerën maksimale të materialeve jo-origjinuese që mund të përdoret, atëherë, këto përqindje nuk mund të mblidhen me njëra tjetrën. Me fjalë të tjera, vlera maksimale e të gjitha materialeve jo-origjinuese që përdoren nuk mund ta kalojë asnjëherë përqindjen më të lartë se ajo e dhënë. Për më tepër, përqindja individuale nuk duhet të tejkalojë në raport me lëndët e veçanta ku aplikohen.

Shënim 4.

4.1 Termi "fibra natyrore" përdoret në listë për t'iu referuar fibrave që nuk janë fibra artificiale ose sintetike. Kjo kufizohet në fazat përpara kryerjes së tjerrjes, përfshirë mbetjet, dhe, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe, përfshihen edhe fibrat që janë gërrhatur, krehur ose përpunuar, por që nuk janë tjerrur.

4.2 Termi "fibra natyrore" përfshin qimet e kalit nën kreun 0511, mëndafshin nën kreun 5002 dhe 5003, si dhe fibrat e leshit, qimet e buta ose të ashpra të kafshëve nën kreun 5101 deri në 5105, fibrat e pambukut nën grupet 5201 deri në 5203 dhe fibra të tjera vegetale nën kreun 5301 deri në 5305.

4.3 Termet "pulp tekstili", "materiale kimike" dhe "lëndët për prodhimin e letrës" përdoren në listë për të përshkruar lëndët që nuk kategorizohen në Krrerët 50 deri në 63, të cilat mund të përdoren për prodhimin e fibrave ose fijeve artificiale, sintetike ose prej letre.

4.4 Termi "fibra kryesore të bëra nga njeriu" përdoret në listë për t'iu referuar filamentëve artificiale ose sintetike, fibrave zëvendësuese ose mbetjeve, nën krrerët 5501 to 5507.

Shënim 5.

5.1 Nëse për një produkt të dhënë në listë i referohemi këtij Shënimi, kushtet e parashikuara në kolonën 3 nuk vlejnë për asnjë prej lëndëve tekstile bazë, që janë përdorur për prodhimin e këtij produkti, që, të marra së bashku, përfaqësojnë 10 për qind ose më pak të peshës së përgjithshme të të gjitha lëndëve tekstile bazë që janë përdorur. (Shih, gjithashtu Shënimet 5.3 dhe 5.4).

5.2 Sidoqoftë, toleranca e përmendur në Shënimin 5.1 mund të gjejë zbatim vetëm për produktet e përziera të cilat janë bërë prej dy ose më shumë lëndëve tekstile bazë.

Lëndët tekstile bazë të përmendura në këtë Shënim janë si vijon:

- mëndafsh;
- lesh;
- qime e ashpër kafshësh;
- qime e hollë kafshësh;
- qime kali;
- pambuk;
- lëndë për prodhimin e letrës dhe letër;
- fije liri;
- fije kërpi;

- jute dhe fibra të tjera tekstile;
- sisal dhe fibra të tjera tekstile të llojit Agave;
- fibra nga arra kokosi, abaka, ramie dhe fibra të tjera tekstile vegjetale;
- filamente sintetike të bëra me dorë;
- filamente artificiale të bëra me dorë;
- filamente të përcjelljes së rrymës;
- fibra sintetike të bëra nga njeriu prej polipropileni
- fibra sintetike të bëra nga njeriu, prej puliestre
- fibra sintetike të bëra nga njeriu prej poliamidi,
- fibra sintetike të bëra nga njeriu prej poliakrilonitrili,
- fibra sintetike të bëra nga njeriu prej poliimidi,
- fibra sintetike të bëra nga njeriu prej politetrafluoroetileni,
- fibra sintetike të bëra nga njeriu prej sulfit polifenileni,
- fibra sintetike të bëra nga njeriu prej polivinilkloridi,
- fibra të tjera sintetike të bëra nga njeriu
- fibra artificiale të bëra nga njeriu prej viskoze,
- fibra të tjera artificiale të bëra nga njeriu,
- fill i bërë nga poliuretani, i segmentuar me segmente fleksibel prej polieteri, i përdredhur ose jo,
- fill i bërë nga poliuretani, i segmentuar me segmente fleksibel prej poliesteri, i përdredhur ose jo,
- produkte të kreut 5605 (fill i metalizuar), që përmban një rrip të përbërë prej shtrese alumini ose një mbulose prej filmi plastik, mbuluar ose jo prej pluhuri alumini, me një gjerësi që nuk kalon 5 mm, i palosur nëpërmjet një adezivi me ngjyra ose transparent ndërmjet dy shtresave të një filmi plastik,
- produkte të tjera të kreut 5605.

Shembull.

Një fill i kreut 5205 që përbëhet nga fibra pambuku të kreut 5203 dhe fibra sintetike të kreut 5506 është një fill i përzier. Për rrjedhojë, fibrat sintetike, të cilat nuk përmbushin rregullat e origjinës (të cilat kërkojnë prodhimin nga lëndët kimike ose pulp tekstil) mund të përdoren deri në një peshë prej 10 % të fillit.

Shembull.

Një pëlhurë e leshtë në kreun 5112, e përbërë nga fill prej leshti të kreut 5107 dhe fill sintetik i fibrave të kreut 5509 është pëlhurë e përzier. Për rrjedhojë, një fill sintetik që nuk përmbush rregullat e origjinës (që kërkojnë prodhimin nga lëndë kimike apo pulp tekstili) ose fill i leshtë që nuk përmbush rregullat e origjinës (që kërkojnë prodhimin nga fibra natyrore, që nuk janë të gërhatura ose të krehura apo të përgatitura në një mënyrë tjetër për tjerje) ose mund të përdoret një kombinim i të dyjave, me kusht që pesha e tyre e përgjithshme të mos jetë më e madhe se 10 për qind e peshës së pëlhurës.

Shembull.

Pëlhurë tekstile me xhufkë e kreut 5802, e përbërë prej fillit të pambukut të kreut 5205 dhe pëlhurës së pambukut të kreut 5210 është një produkt i përzier, vetëm nëse pëlhura prej pambuku është vetë një pëlhurë e përzier, e përbërë prej fijeve të klasifikuara në dy krerë të ndryshëm ose nëse vetë fijet e pambukut që janë përdorur janë vetë të përziera.

Shembull.

Në qoftë se pëlhura tekstile xhufkë në fjalë do të ishte e përbërë prej fillit të pambukut të kreut 5205 dhe pëlhurë sintetike të kreut 5407, atëherë, sigurisht, fijet e përdorura janë dy lëndë të veçuara bazë tekstile dhe pëlhura tekstile xhufkë është, për rrjedhojë, një produkt i përzier.

5.3 Në rast se produktet që përmbajnë "fill të përbërë prej poliuretani të ndarë me segmente elastike polieteri, të përdredhur ose jo", toleranca e përmendur në Shënimin 5.1 është 20 për qind lidhur me këtë fill.

5.4 Në rastin e produkteve që përmbajnë "një shirit të përbërë prej një shtresë alumini ose shtresë filmi plastik, e veshur ose jo me pluhur alumini, me gjerësi jo më të madhe se 5 mm, e vendosur në mes të dy filmave të filmit plastik nëpërmjet një ngjitësi", toleranca e përmendur në Shënimin 5.1 është 30 për qind lidhur me këtë shirit.

Shënimi 6.

6.1 Në rastin e produkteve tekstile, të cilat shënohen në listë me një shënim fundor që i referohet këtij shënimi, lëndë tekstile, me përjashtim të linjave dhe ndërlinjave, të cilat nuk përmbushin rregullat e parashtruara në kolonën 3 për produktin e përbërë për të cilin bëhet fjalë mund të përdoret, me kusht që ato të klasifikohen në një kre të ndryshëm nga ai i produktit dhe që vlera e tyre të mos e kalojë 8 përqindëshin e kostos së punës të produktit në fabrikë.

6.2 Pa cenuar Shënimin 6.3, lëndët që nuk klasifikohen në Kapitujt 50 deri në 63 mund të përdoren lirisht në prodhimin e produkteve tekstile, pavarësisht nëse përmbajnë tekstile ose jo.

Shembull.

Nëse një rregull i listës përcakton se, për një artikull të veçantë tekstili, si pantallonat, duhet të përdoret filli, kjo nuk parandalon përdorimin e artikujve metalikë, si kopsat, pasi kopsat nuk klasifikohen në Kapitujt 50 deri në 63. Për të njëjtën arsye, kjo nuk parandalon përdorimin e zinxhirëve, edhe zinxhiri përmban, normalisht, tekstile.

6.3 Kur gjen zbatim një rregull përqindjeje, vlera e lëndëve të cilat nuk klasifikohen në Kapitujt 50 deri në 63 duhet të merret parasysht në llogaritjen e vlerës së lëndëve të përfshira jo- origjinuese.

Shënim 7.

7.1 Për qëllimet e kërërve ex 2707, 2713 deri në 2715, ex 2901, ex 2902 dhe ex 3403, "proceset specifike" janë si vijon:

- (a) distilim në vakum;
- (b) ridistilim nëpërmjet një procesi tërësor fraksionimi;
- (c) ndarje;
- (d) riformimi;
- (e) përftimi me anë të tretësve të zgjedhur;
- (f) procesi që përfshin të gjitha veprimet vijuese: përpunimi me acid sulfurik të përqendruar, me oleum dhe anhidrid oleumi; neutralizimi me agjentë alkalinë; çngjyrosja dhe pastrimi me dhe natyror aktiv, dhe të aktivizuar, qymyr ose boksid aktiv;
- (g) polimerizimi;
- (h) alkilimi dhe
- (i) izomerizimi.

7.2 Për qëllimet e kërërve 2710, 2711 dhe 2712, "proceset" specifike janë si vijon:

- (a) distilim në vakum;
- (b) ridistilim nëpërmjet një procesi të plotë fraksionimi;
- (c) ndarje;
- (d) riformim;
- (e) përftimi me anë të tretësve të përzgjedhur;
- (f) procesi që përfshin të gjitha veprimet vijuese: përpunimi me acid sulfurik, oleum ose anhidrid sulfurik; neutralizimi me agjentë alkalinë; çngjyrosje dhe pastrim me dhe aktiv, dhe i aktivizuar, qymyr ose boksid aktiv;
- (g) polimerizim;

- (h) alkilim;
- (ij) izomerizimi;
- (k) sa u përket vajrave të rënda që renditen vetëm në kreun ex 2710, desulfurizimi me hidrogjen që sjell si rezultat një ulje prej të paktën 85 për qind të përmbajtjes së sulfurit të produkteve të përpunuara (metoda ASTM D 1266-59 T);
- (l) lidhur vetëm me produktet që renditen në kreun 2710, deparafinizimi nga një proces tjetër nga ai i filtrimit;
- (m) lidhur me vajrat e rënda që renditen vetëm në kreun ex 2710, trajtimi me hidrogjen nën trysni më të madhe sesa 20 bar dhe temperaturë më të lartë sesa 250°C me përdorimin e një katalizatori, për të kryer procese të ndryshme nga desulfurizimi, kur hidrogjeni përbën element aktiv në një reaksion kimik. Trajtimi i mëtejshëm me hidrogjen i vajrave lubrifikante të kreut ex 2710 (p.sh. hidrombarimi ose çngjyrosja), më veçanërisht, me qëllim përmirësimin e ngjyrës ose qëndrueshmërinë, nuk do të konsiderohet, sidoqoftë, proces specifik;
- (n) lidhur vetëm me vajrat për karburante që renditen në kreun ex 2710, distilim atmosferik, me kusht që të distilohet më pak se 30 për qind e këtyre produkteve, sipas vëllimit, përfshirë humbjet, në 300°C me metodën ASTM D 86;
- (o) lidhur me vajërat e rënda, përveç vajrave të karburanteve dhe vajrave të naftës që përfshihen vetëm në kreun ex 2710, trajtimi me anë të shkarkesave fshirëse elektrike me frekuencë të lartë dhe
- (p) lidhur vetëm me produktet bruto (përveç xhelatinës së naftës, ozokeritit, dyllit të linjtit ose dyllit të torfës, dyllit të parafinës, që mbajnë në peshë më pak sesa 0,75 për qind vaj) të kreut ex 2712, ç'vajosja me kristalizim të pjesshëm.

7.3 Për qëllimet e kërëve ex 2707, 2713 në 2715, ex 2901, ex 2902 dhe ex 3403, veprime të thjeshta, si pastrimi, dekantimi, çkripëzimi, ndarja e ujit, filtrimi, ngjyrosja, vendosja e markës, përftimi i përmbajtjes së sqfurit, si rezultat i përzierjes së produkteve me përmbajtje të ndryshme sqfuri, si edhe çdo kombinim i këtyre veprimeve apo veprimeve të ngjashme, nuk i japin origjinën.

SHTOJCA 2 E PROTOKOLLIT B

LISTA E PUNIMEVE OSE PËRPUNIMIT QË DUHEN REALIZUAR ME LËNDËT JO ORIGJINUESE NË MËNYRË QË PRODUKTI I PRODHUAR TË MUND TË FITOJË STATUSIN E PRODUKTIT TË ORIGJINËS

Produktet e përmendura në këtë listë mund të mos mbulohen të gjitha nga kjo Marrëveshje. Rrjedhimisht, është e nevojshme të shikohen pjesët e tjera të kësaj Marrëveshjeje.

Kreu SH	Përshkrimi i produktit	Punimi ose përpunimi i kryer mbi lëndët jo origjinuese, i cili u jep statusin e origjinës	
(1)	(2)	(3) ose (4)	
Kapitulli 1	Kafshët e gjalla	Të gjitha kafshët, si në Kapitullin 1, përftohen në tërësinë e tyre	
Kapitulli 2	Mishi dhe të brendshmet e ngrënshme të kafshëve	Prodhime në të cilat të gjitha lëndët e përdorura, si në Kapitujt 1 dhe 2, janë tërësisht origjinuese	
Kapitulli 3	Peshku e kafshët guaskore të nënujshme, molusqet e kafshët e tjera jovertebrore ujore	Prodhime në të cilat të gjitha lëndët e përdorura, si në Kapitullin 3, janë tërësisht origjinuese	
ex Kapitulli 4	Prodhimet e bulmetit; vezët e shpendëve; mjalti natyral; produktet e ngrënshme me origjinë shtazore, jo të përfshira apo specifikuar diku tjetër; me përjashtim të:	Prodhime në të cilat të gjitha lëndët e përdorura, si në Kapitullin 4, janë tërësisht origjinuese	
0403	Dhallës, qumështit e ajkës së prerë, kosit, kefirrit dhe qumështit dhe ajkave të tjera të fermentuara ose të acidifikuara, të koncentruar ose jo, ose që përmbajnë sheqer shtesë ose lëndë të tjera ëmbëltuese ose lëndë aromatizuese ose që përmbajnë fruta, fruta me lëvozhgë të fortë ose kakao shtesë	Prodhime në të cilat : - të gjitha lëndët e përdorura, si në Kapitullin 4, janë tërësisht origjinuese - të gjitha lëngjet e frutave të përdorura (përjashtuar ato të ananasit, qitros ose grejpfritit), si në kreun 2009, janë origjinuese, dhe - vlera e çdo lënde të përdorur të kapitullit 17 nuk e kalon vlerën prej 30% të çmimit në fabrikë të produktit	
“Aparatura materiale”, pajisje teknike dhe transporti, municione të grupit të shpëtimit dhe vegla individuale për anëtarët e tij.

“Mjetet e shpëtimit”, materiale rezervë të shpërndara falas dhe pa taksë e këtyre materialeve ndër popullsinë e prekur nga fatkeqësia.

“Informacion personal”, të gjitha llojet e informacioneve të personit fizik, i cili ka lidhje me situatën e pashmangshme emergjente, subjekt i kësaj marrëveshjeje.

“Pala kërkuese”, pala e cila kërkon ndihmë.

“Aktivitete studimore dhe shpëtuese”, aktivitete me qëllim shpëtimin e njerëzve dhe mbrojtjen e vlerave materiale, kulturore dhe ambientale në zonat e emergjencës, duke qenë se këto janë caktuar nga organet kompetente ndërkombëtare.

“Shtete transit”, çdo shtet, qeveria e të cilit është pjesë, ndryshe nga pala kërkuese apo pala asistuese, nëpërmjet territorit të të cilit, duke përfshirë hapësirën ajrore dhe/ose territorin ujor, grupi i ndihmës transporton pajisjet dhe gjërat e nevojshme për ndihmë.

Neni 3 Parimet

1. Palët do të bashkëpunojnë, në përputhje me dispozitat ligjore të kësaj Marrëveshjeje, si dhe me rregulloret dhe parimet ndërkombëtare të njohura, me qëllim për të siguruar informacionin përkatës dhe të shpejtë dhe ndihmën në rast katastrofash natyrore dhe ato të shkaktuara nga dora e njeriut dhe/ose gjasat që ato mund të ndodhin.

2. Nëse një palë kërkon ndihmë në rast katastrofash natyrore dhe ato të shkaktuara nga dora e njeriut, që kanë ndodhur në territorin e shtetit të kësaj pale, ajo mund të kërkojë ndihmë nga pala (palët) e tjera duke dërguar kërkesë kombëtare. Pala asistuese do të ndihmojë palën kërkuese me mjete dhe masat që kanë për qëllim parandalimin dhe/ose eliminimin e pasojave nga katastrofat.

3. Palët do t'i japin ndihmë njëra-tjetrës sipas mundësive që kanë. Ndihma do të jepet falas në rast se nuk bihet dakord ndryshe nga palët.

4. Pala kërkuese do të sigurojë marrjen dhe shpërndarjen ekskluzivisht të ndihmës të popullsisë e prekur. Ndihma do të shpërndahet pa diskriminim race, besimi, gjuhe, faktorëve politikë dhe faktorëve të tjerë.

Neni 4 Kërkesa për ndihmë dhe shkëmbim informacioni

1. Palët do të jenë organet e autorizuara për të kërkuar ndihmë në rast të një situatë emergjente.

2. Ndihma do të jepet pas marrjes së kërkesës, ku pala kërkuese specifikon:

- vendin, kohën, llojin dhe shkallën e katastrofës dhe gjendjen aktuale të situatës emergjente në vendin e prekur;
 - veprimet e ndërmarra, specifikimin e ndihmës së kërkuar, përcaktimin e prioritetëve të ndihmës së kërkuar si pasojë e katastrofës.
3. Pala asistuese do të marrë menjëherë një vendim për të dhënë ndihmë dhe të informojë palën kërkuese mbi mundësinë, masën dhe kushtet e dhënies së ndihmës.
 4. Informacioni i përmendur në pikën 2 të këtij neni do të rifreskohet sipas zhvillimit të situatës.

Neni 5 Transiti

Me kërkesë të palës kërkuese, qeveria e vendit transit do të sigurojë të gjithë mbështetjen e nevojshme gjatë kalimit të ndihmës në territorin e shtetit të saj sipas legjislacionit të saj kombëtar, të drejtën dhe praktikën ndërkombëtare.

Neni 6 Organet kompetente dhe pikat e kontaktit

1. Palët do të caktojnë (ose vendosin) një ose disa organe kompetente të referuara si organe kompetente për të koordinuar punën lidhur me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.
2. Pa cenuar marrëveshjet e tjera ekzistuese dy dhe shumëpalëshe, palët do të caktojnë ose vendosin një ose disa pika kontakti kombëtare për të njoftuar dhe për të dhënë ndihmë në rast situatash emergjente.
3. Palët do të njoftojnë njëra-tjetrën me shkrim, nëpërmjet kanaleve diplomatike, për përcaktimin ose ndonjë ndryshim lidhur me organin (organet) kompetent, si edhe mbi pikën (pikat) e kontaktit.
4. Palët do të sigurojnë funksionim të vazhdueshëm të organit (organeve) kompetent dhe pikës (pikave) të kontaktit.

Neni 7 Grupi i punës (komiteti) mbi situatat emergjente

Për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, autoritetet kombëtare kompetente do të caktojnë përfaqësuesit e tyre të një organ përkatës të përbashkët (Komiteti i Grupit të Punës mbi emergjencat) që ngrihet brenda kuadrit të BEDZ-it.

Neni 8 Koordinimi dhe menaxhimi i ndihmës në rast situatash emergjente

1. Organi kompetent i palës kërkuese do të koordinojë, menaxhojë dhe mbikëqyrë aktivitetet e ekipeve të ndihmës nëpërmjet drejtuesve të tyre.
2. Pala kërkuese do të informojë drejtuesit e ekipit të palës asistuese mbi zhvillimin e situatës në zonën emergjente dhe mbi kryerjen e të gjitha aktiviteteve dhe nëse është e mundur, do t'i sigurojë këto ekipe me përkthyes dhe mjete komunikimi.
3. Pala kërkuese do të informojë drejtuesit e ekipit të ndihmës të palës asistuese rreth ndryshimeve të situatës në zonën ku ndodh situata emergjente dhe do të përcaktojë vazhdimësinë e veprimeve dhe nëse është e nevojshme, do të sigurojë përkthyes dhe të tjera mjete komunikimi me zyrën kryesore, që drejton të gjithë aktivitetet e kërkim-shpëtimit dhe aktivitete të tjera urgjente.

4. Ekipet e ndihmës duhet të jenë të vetëpajisura mjaftueshëm për të funksionuar në zonën e situatës emergjente për së paku 72 orë prej momentit të mbërritjes së tyre. Kur kalon ky afat, pala kërkuese, me kërkesën që merr nga ekipet, do të rifurnizojë këto ekipe me të gjitha mjetet e nevojshme.

5. Pala kërkuese do të kujdeset për sigurinë e ekipeve të ndihmës apo individëve-ekspertëve dhe sipas rastit, do të sigurojë përkujdesje mjekësore emergjente, ushqim, akomodim, si edhe produkte bazë për ekipet dhe ekspertët, nëse ata harxhojnë furnizimet e tyre.

Neni 9 Procedura

Procedurat për kalimin në kufi dhe rregullat e qëndrimit për skuadrën asistuese

1. Procesi për kalimin e kufijve shtetërorë të palës së kërkuar ose të shtetit transit nga pjesëtarët e ekipeve të ndihmës duhet të vendoset nga legjislacioni i tyre kombëtar, e drejta ndërkombëtare dhe marrëveshjet dypalëshe të shtetit kërkuar dhe/ose shtetit transit.

2. Urdhri për procedurën e kalimit nëpërmjet kufijve shtetërorë të palës së kërkuar të grupeve të qenve të kërkimit dhe qëndrimin e tyre në territorin e shtetit të palës kërkuese do të përcaktohet në çdo rast në përputhje me rregullat në fuqi mbi karantinën, të territorit të shtetit të palës së kërkuar.

3. Anëtarët e ekipit të ndihmës janë të detyruar të ndjekin ligjet dhe rregullat e shtetit të palës kërkuese dhe/ose shtetit transit. Në të njëjtën kohë ata ndodhen nën juridiksionin e palës asistuese lidhur me legjislacionin e punës dhe legjislacione të tjera përkatëse. Në rast se ekipet e ndihmës përfshijnë personelin paraushtarak të mbrojtjes ushtarake dhe civile, qëndrimi i tyre, siç bihet dakord paraprakisht, si dhe aktivitetet do të bien në legjislacionin e palës asistuese duke rregulluar statusin e çdo personeli.

4. Për qëllime të transportimit të ekipeve të ndihmës, pajisjet dhe ushqimet e tyre të ndihmës, si dhe automjetet e përshtatshme mund të përdoren me qëllim për të mbërritur në destinacion sa më shpejt të jetë e mundur. Urdhri për përdorimin e mjeteve të specifikuar të transportit për mundësimin e ndihmës do të përcaktohet nga organet kompetente të palëve.

Neni 10

Eksporti, importi dhe kalimi transit i aparaturave dhe mjeteve të shpëtimit

1. Aparaturat dhe mjetet e shpëtimit të eksportuara dhe të importuara për ndihmë në përputhje me këtë Marrëveshje do të përjashtohen nga taksat doganore, si dhe nga taksa dhe pagesa të tjera.

2. Inspektimi doganor dhe kontrolli i aparaturave dhe i mjeteve të shpëtimit do të kryhet në një mënyrë të thjeshtëzuar mbi baza prioritare, pas njoftimeve të dhëna nga organet kompetente të palëve, ku specifikohet një strukturë mbi ekipet e ndihmës dhe një listë me aparaturat dhe mjetet e eksportuara ose të importuara për ndihmën.

3. Përbërësit narkotikë dhe substancat psikotrope mund të importohen vetëm në sasi të nevojshme për qëllime të ndihmës mjekësore dhe të përdoren vetëm nga personeli i kualifikuar mjekësor. Në këtë rast drejtuesi i ekipit të ndihmës do t'u dorëzojë organeve të kontrollit doganor një deklaratë, ku përfshihet një listë me përbërësit narkotikë dhe substancat psikotrope, duke treguar nomenklaturën dhe sasinë e tyre. Autoritetet përkatëse të palës së kërkuar mund të kontrollojnë përdorimin dhe ruajtjen e përbërësve narkotikë dhe substancave psikotrope të përmendura sa më lart. Lëndët narkotike dhe substancat psikotrope që nuk përdoren gjatë misionit, do të merren nga territori i shtetit të palës së kërkuar. Pas përfundimit të misionit, organeve të kontrollit doganor do t'u dorëzohet certifikata mbi përbërësit narkotikë dhe substancave psikotrope të përdorura, nënshkruar

nga drejtuesi dhe farmacisti i skuadrës së asistencës dhe certifikuar nga përfaqësuesi i organit kompetent të palës së kërkuar.

Neni 11 Mjetet ajrore

1. Transportimi i ekipeve, aparaturave dhe mjeteve të ndihmës mund të kryhet nëpërmjet mjeteve ajrore.
2. Organi kompetent i palës asistuese do të informojë organin kompetent të palës kërkuese mbi vendimin për të përdorur mjetin ajror për të mundësuar ndihmën duke treguar edhe zonën e hedhjes ajrore, rrugën e flurimeve, llojin dhe shenjat përkatëse të mjeteve ajrore, numrin e anëtarëve të ekuipazhit, llojin e ngarkesës, orarin e fluturimeve dhe listën e pasagjerëve (personeli, stafi teknik, gazetarë etj.).
3. Fluturimet e mjetit të lundrimit ajror, civil ose shtetëror do të kryhen në përputhje me Organizatën Ndërkombëtare të Aviacionit Civil dhe rregulloret e palëve. Për mjetet e lundrimit ajror shtetëror, kërkohet leja diplomatike.
4. Pala asistuese përjashtohet nga detyrimi për të paguar për fluturimin, uljen në tokë, parkimin, ngritjen për fluturim dhe shërbimet e pilotimit, që mundëson ndihmë për situatën emergjente, subjekt i kësaj Marrëveshjeje.
5. Për fluturimin që kryhet për të siguruar ndihmë për ngjarjen emergjente, rimbursimi për karburantin, shërbimet e mirëmbajtjes së mjetit të lundrimit ajror do të vendosen veçmas sipas çdo rasti të veçantë.

Neni 12 Ndihma

1. Dhënia e ndihmës do të kryhet sipas parimeve të përshkruara në nenin 3 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 13 Rimbursimi i shpenzimeve të ndihmës në rast të një situatë emergjente e siguruar në baza kompensimi

1. Pala kërkuese mund të anulojë kërkesën e saj për ndihmë në çdo kohë. Pala kërkuese njofton palën asistuese menjëherë mbi vendimin e saj dhe pala asistuese mund të kërkojë rimbursimin e shpenzimeve që janë bërë deri në atë moment.
2. Pala asistuese do të sigurojë kontratë sigurimi për anëtarët e ekipeve të ndihmës dhe këto shpenzime do të përfshihen në faturën totale për ndihmën.
3. Me përfundimin e operacionit, organi kompetent i palës asistuese do të informojë menjëherë me shkrim organin kompetent të palës kërkuese mbi masën e ndihmës së dhënë.
4. Organi kompetent i palës kërkuese do t'i sigurojë organit kompetent të palës asistuese informacionin përfundimtar mbi karakteristikat dhe shkaqet e situatës emergjente, formën dhe masën totale të asistencës të dhënë dhe rezultatet e punës së kryer.

Neni 14 Rimbursimi për dëmtimet

1. Pala kërkuese do të mbulojë të gjitha shpenzimet lidhur me dëmtimin ose vdekjen e pjesëtarëve të ekipeve të ndihmës, që ndodh gjatë aktiviteteve lidhur me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Palët e interesuara do të bien dakord mbi shumën që do të rimbursohet.

2. Nëse një pjesëtar i ekipit të ndihmës i shkakton dëmtim një entiteti ligjor ose personi fizik në territorin e palës kërkuese gjatë aktiviteteve lidhur me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, dëmtimi do të rimbursohet nga pala kërkuese sipas rregulloreve ligjore në fuqi, duke qenë se ky dëmtim është shkaktuar nga shtetasit e saj gjatë kohës që sigurojnë ndihmën.

3. Dëmtimi i shkaktuar nga një pjesëtar i ekipit të ndihmës, me qëllim ose neglizhencë të rëndë, do të rimbursohet nga pala kërkuese, nëse fakti mbi dëmtimin provohet nga një gjykatë kombëtare e palës kërkuese.

Neni 15

Transferimi i të dhënave personale

Transferimi i të dhënave personale të palët e tjera brenda kuadrit të kësaj Marrëveshjeje do të kryhet sipas shtojcës 1, e cila është pjesë integrale e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 16

Bashkëpunimi me organizata/institucione ndërkombëtare dhe kombëtare

1. Bazuar në marrëveshjen e ndërsjellë, palët përkatëse mund të ftojnë organizatat/institucionet e interesuara ndërkombëtare dhe kombëtare për t'iu bashkuar aktiviteteve, lidhur me implementimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 17

Nënshkrimi

Kjo Marrëveshje është e hapur për nënshkrim nga çdo shtet i BEDZ-it.

Neni 18

Ratifikimi, pranimi, aderimi, aprovimi ose aderimi

1. Marrëveshja do të jetë subjekt i ratifikimit, pranimit, aderimit, aprovimit ose aderimit. Instrumentet e ratifikimit, pranimit, aderimit, aprovimit ose hyrjes do të depozitohen tek depozituesi i kësaj Marrëveshjeje.

2. Depozituesi i kësaj Marrëveshjeje do të jetë Qeveria e Federatës Ruse, e cila do të dërgojë te palët kopje të certifikuara të sa më sipër.

Neni 19

Hyrja në fuqi dhe periudha e vlefshmërisë

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi kur instrumentet e ratifikimit, pranimit, afirmimit, aprovimit ose aderimit janë depozituar nga së paku 6 shtete dhe përfshihet për një periudhë të pacaktuar kohore.

2. Për secilin shtet që ratifikon, pranon, afirmon, pranon ose aderon në këtë Marrëveshje pas depozitimit të instrumentit të gjashtë të ratifikimit, pranimit, afirmimit, aprovimit ose aderimit, kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi ditën kur shteti depoziton instrumentin e saj të ratifikimit, pranimit, afirmimit, aprovimit ose aderimit.

Neni 20

Tërheqja nga kjo Marrëveshje

1. Palët mund të tërhiqen nga kjo Marrëveshje duke i dërguar një njoftim me shkrim depozituesit, i cili informon palët e tjera mbi këtë fakt.

2. Tërheqja nga Marrëveshja do të bëhet e efektshme në ditën e 90-të pas datës së marrjes së një njoftimi të tillë nga depozituesi.

3. Pala që dëshiron të tërheqë daljen nga kjo Marrëveshje, do të njoftojë depozituesin me shkrim. Njoftimi do të bëhet jo më vonë se 30 ditë pas dorëzimit të aplikimit për tërheqje nga kjo Marrëveshje.

Neni 21 Ndryshimet në Marrëveshje

1. Palët mund të propozojnë ndryshime në këtë Marrëveshje.
2. Propozimi për ndryshime do t'i komunikohet Grupit të Punës (Komitetit) të Emergjencave në formë të shkruar, i përmendur në nenin 7 të kësaj Marrëveshjeje, i cili më pas informon palët mbi këtë qëllim. Në rast se do të ndërmerren veprime të mëtejshme kjo do të specifikohet nga Grupi i Punës (Komiteti) i Emergjencave sipas mandatit të saj të përcaktuar nga palët.

Neni 22 Marrëdhëniet me marrëveshje të tjera ndërkombëtare

Kjo Marrëveshje nuk do të prekë të drejtat dhe detyrimet e palëve të përcaktuara në marrëveshje të tjera ndërkombëtare.

Neni 23 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Në rast mosmarrëveshjeje ndërmjet dy ose më shumë palëve lidhur me interpretimin ose aplikimin e kësaj Marrëveshjeje, palët në fjalë do të zgjidhin mosmarrëveshjen nëpërmjet negociatave dhe, nëse është e nevojshme, nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 24 Gjuha e Marrëveshjes

Teksti origjinal i kësaj Marrëveshjeje është hartuar në gjuhën angleze. Nënshkruar në Sochi, 15 prill 1998.

Për vërtetimin e sa më sipër, kjo Marrëveshje nënshkruhet nga organet e autorizuara si më poshtë vijon:

Për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë
Për Qeverinë e Republikës së Armenisë
Për Qeverinë e Republikës së Azerbajxhanit
Për Qeverinë e Republikës së Bullgarisë
Për Qeverinë e Republikës së Gjeorgjisë
Për Qeverinë e Republikës së Helenike
Për Qeverinë e Republikës së Moldavisë
Për Qeverinë e Rumanisë
Për Qeverinë e Federatës Ruse
Për Qeverinë e Serbisë
Për Qeverinë e Republikës së Turqisë
Për Qeverinë e Ukrainës

ANEKSI I

Rregullat për shkëmbimin e të dhënave personale në kuadër të kësaj Marrëveshjeje dhe sipas legjislacionit në shtetet e palëve janë si më poshtë vijon:

1. Përdorimi i të dhënave nga pala marrëse lejohet sipas kushteve dhe për qëllimet e përshkruara nga pala dërguese.
2. Pala marrëse do të informojë palën dërguese sipas kërkesës së marrë, duke cituar se si janë përdorur të dhënat personale dhe për rezultatet që janë arritur.
3. Marrësi i të dhënave personale është vetëm organi kompetent. Rishkëmbimi i të dhënave personale mundësohet pas një lejeje me shkrim të palës dërguese.
4. Pala dërguese duhet të transferojë të dhëna korrekte, në përputhje me qëllimet e transferimit të saj, duke marrë parasysh rregulloret kombëtare përkatëse. Kur pala marrëse informohet në rast transferimi të të dhënave jokorrekte ose të klasifikuara, do të korrigjojë gabimet ose do të shkatërrojë të gjitha të dhënat.
5. Personat që pësojnë dëmtim për shkak se këto të dhëna i përkasin atij, ka të drejtë të aplikojë për një certifikatë mbi të pas prezantimit të qëllimeve për përdorimin e tyre. Nëse interesat publikë predominojnë interesat e personave të prekur, këto të fundit e humbin të drejtën e përmendur sa më lart. Në raste të tjera, personi ka të drejtë të marrë certifikatën në përputhje me legjislacionin kombëtar në shtetin, territori i të cilit ka qenë vendi i kërkesës.
6. Nëse transferimi i informacionit brenda kuadrit të kësaj Marrëveshjeje shkakton dëmtim fizik ose moral, pala marrëse do të jetë përgjegjëse për të njëjtin faj në përputhje me legjislacionin e saj kombëtar. Në trajtimin e personit (personave) që kanë pësuar një plagosje ose dëmtim të tillë, pala marrëse nuk ka të drejtë të largojë nga vetja përgjegjësinë dhe t'ia kalojë palës dërguese.
7. Periudha e vlefshmërisë së të dhënave personale duhet të njoftohet nga pala dërguese në përputhje me legjislacionin e saj kombëtar.
8. Palët detyrohen të regjistrojnë të dhënat personale hyrëse dhe dalëse si dokumente zyrtare.
9. Palët detyrohen të mbrojnë të dhënat personale sipas klasifikimit të tyre kombëtar, ngjyrja, përdorimi, ndryshimet dhe zbulimi i paautorizuar.

PROTOKOLL SHITESË

I MARRËVESHJES MIDIS QEVERIVE TË VENDEVE PJESËMARRËSE TË BASHKËPUNIMIT EKONOMIK TË DETIT TË ZI (BEDZ) MBI BASHKËPUNIMIN NË NDIHMËN DHE PËRGJIGJEN NDAJ SITUATAVE EMERGJENTE NË FUSHËN E FATKEQËSIVE NATYRORE DHE ATO TË SHKAKTUARA NGA DORA E NJERIUT

Preambul

Qeveritë e vendeve anëtare të Organizatës së Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi (BEDZ) - palë në këtë protokoll shtesë, në vijim referuar si "Palët"; Bazuar mbi dispozitat e neneve 3, 4, 5, 7 dhe 8 të Marrëveshjes ndërmjet qeverive të vendeve pjesëmarrëse në Organizatën e Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi mbi bashkëpunimin në ndihmën dhe përgjigjen ndaj situatave emergjente si pasojë e fatkeqësive natyrore dhe ato të shkaktuara nga dora e njeriut, nënshkruar në Sochi më 15 prill 1998, në vijim referuar si "Marrëveshja BEDZ"; të vetëdijshëm mbi rolin në rritje dhe rëndësinë që kanë strategjitë efektive parandaluese në lidhje me bashkëpunimin në fushën e ndihmës ndaj situatave emergjente; duke theksuar rëndësinë e një politike më efektive, si përgjigje ndaj fatkeqësive dhe kërkesës për bashkëpunim praktik në zvogëlimin e rreziqeve të mëdha dhe parandalimit të fatkeqësive, si dhe në rritjen e veprimit në situatat emergjente;

duke përsëritur vendosmërinë e tyre për të arritur, përmes përpjekjeve të përbashkëta, përmirësimin e zbatimit të dispozitave të marrëveshjes BEDZ;
me qëllimin për të siguruar nivelin e duhur të koordinimit të bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve të palëve;
kanë rënë dakord sa më poshtë vijon:

Neni 1

Vendosja e një rrjeti oficerësh kontakti

Palët do të vendosin një rrjet oficerësh kontakti të BEDZ-it mbi asistencën emergjente, në vijim referuar si “Rrjeti”, që konsiston në oficerë kontakti të caktuar nga palët si përfaqësues të tyre.

Neni 2

Objektivat

Objektivat e rrjetit janë siç vijon: 1. Të rrisë bashkëpunimin në fushën e ndihmës në situatat emergjente dhe të sigurojë koordinimin dhe ndërveprimin ndërmjet autoriteteve kompetente të palëve;

2. Të vendosë një rrjet shkëmbimi informacioni ndërmjet organeve të rëndësishme të palëve për të bashkëpunuar në mënyrë efektshme në ndihmën dhe përgjigjen ndaj situatave emergjente në përputhje me marrëveshjen BEDZ.

Neni 3

Detyrat dhe funksionet

Oficerët e kontaktit të rrjetit kanë detyrat dhe funksionet e mëposhtme:

1. Të dërgojnë kërkesat që u vijnë nga oficerë të tjerë kontakti drejt vendeve të tyre respektive për raste urgjente, brenda ditës dhe për raste të tjera, brenda tri ditëve, në përputhje me dispozitat e neneve 4 dhe 5 të marrëveshjes BEDZ;

2. T’u dërgojnë palëve informacionin e kërkuar sipas kërkesës, në përputhje me dispozitat e nenit 4 të marrëveshjes BEDZ;

3. Të takohen periodikisht për të vlerësuar tendencat e asistencës ndaj situatave emergjente dhe përgjigjen ndaj situatave emergjente në rajon, me qëllim për të identifikuar forma të reja bashkëpunimi mes organeve përkatëse të vendeve anëtare të BEDZ-it;

4. T’u raportojnë dhe propozojnë organeve respektive mënyrat për të rritur më tej bashkëpunimin;

5. Të lehtësojnë shkëmbimin e eksperiencës praktike mes organeve përkatëse të palëve në fushën e asistencës dhe përgjigjes ndaj situatave emergjente.

Neni 4

Statusi i rrjetit brenda BEDZ

Rrjeti është një grup bashkëpunimi në sferën e asistencës ndaj situatave emergjente, i krijuar në përputhje me dispozitat e nenit 7 të marrëveshjes BEDZ.

Neni 5

Vendi i takimeve të rrjetit

Rrjeti do t’i mbajë takimet në zyrat e përhershme të Sekretariatit Ndërkombëtar të BEDZ-it, nëse nuk vendoset ndryshe me iniciativën e drejtuesit të BEDZ-it ose me vendim të ministrave të punëve të jashtme.

Neni 6 Organizimi dhe funksionimi

1. Rrjeti do të funksionojë në përputhje me kartën dhe rregullat e procedurës së BEDZ-it, si dhe dispozitat e marrëveshjes BEDZ.
2. Secila palë në këtë protokoll shtesë do të caktojë një oficer kontakti dhe alternatin e tij/saj në rrjet.
3. Pas caktimit ose tërheqjes së oficerëve të kontaktit në rrjet, palët do të njoftojnë Sekretariatën e Përhershëm Ndërkombëtar të BEDZ-it në mënyrë që të informohen të gjitha vendet anëtare.
4. Rrjeti do të mblidhet periodikisht të paktën një herë në vit.
5. Rrjeti do të kryejë detyrat e tij nën autoritetin e grupit të punës për bashkëpunim në ndihmën ndaj situatave emergjente dhe do t'i raportojë atij.

Neni 7 Shpenzimet

Të gjitha shpenzimet e oficerit të kontaktit që lidhen me implementimin e dispozitave të këtij protokollit shtesë do të përballohen nga pala dërguese.

Neni 8 Pikat kombëtare të kontaktit

Palët do të caktojnë një pikë kombëtare kontakti brenda organizmave të tyre kompetente, preferohen ata që merren me bashkëpunimin ndërkombëtar.

Neni 9 Vëzhguesit dhe të ftuarit

1. Përfaqësuesit e shteteve vëzhguese të BEDZ-it mund të marrin pjesë në punën e rrjetit, në përputhje me kartën dhe rregullat e procedurës të BEDZ-it.
2. Në mbledhjen e rrjetit mund të ftohen të marrin pjesë edhe institucione ose agjenci ndërkombëtare përkatëse.

Neni 10 Dispozitat përfundimtare

1. Ky protokoll shtesë është i hapur për nënshkrim ose pjesëmarrje nga çdo vend anëtar i BEDZ-it.
2. Sekretariati Ndërkombëtar i Përhershëm i BEDZ-it do të jetë depozituesi i këtij protokollit shtesë.
Originali i këtij protokollit shtesë, i përbërë nga një kopje teke në gjuhën angleze, do të depozitohet në Sekretariatën Ndërkombëtar të Përhershëm, i cili do t'i dëgjë çdo palë një kopje të certifikuar.
3. Ky protokoll shtesë do të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë pas datës, në të cilin dokumenti i tretë i ratifikimit ose miratimit depozitohet në Sekretariatën Ndërkombëtar të Përhershëm të BEDZ-it.
4. Për secilën palë, që ratifikon, miraton ose merr pjesë në këtë protokoll shtesë, pas depozitimit të dokumentit të tretë të ratifikimit, miratimit ose pjesëmarrjes, ky protokoll shtesë do të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë pas datës së depozitimit të dokumentit të ratifikimit aprovimit ose pjesëmarrjes nga kjo palë.

5. Çdo palë mund të heqë dorë nga ky protokoll shtesë me një njoftim me shkrim dërguar Sekretariatit Ndërkombëtar të Përhershëm të BEDZ-it. Heqja dorë do të hyjë në fuqi tre muaj pas datës në të cilën merret njoftimi i heqjes dorë nga Sekretariati Ndërkombëtar i Përhershëm.

6. Çdo palë mund të propozojë amendime për këtë protokoll shtesë. Amendimet do të pranohen me miratimin e të gjitha palëve dhe do të hyjnë në fuqi në përputhje me paragrafët 3 dhe 4 të këtij neni.

7. Dy vjet nga hyrja në fuqi e këtij protokoll shtesë, palët do të procedojnë me një analizë të rezultateve të zbatimit të dispozitave të këtij protokoll shtesë. Një vlerësim final do të bëhet katër vjet pas hyrjes në fuqi, me qëllimin për të arritur të bihet dakord për masat e nevojshme për përmirësimin e mëtejshëm të bashkëpunimit.

Për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë Për Qeverinë e Republikës së Armenisë Për Qeverinë e Republikës së Azerbajxhanit Për Qeverinë e Republikës së Bullgarisë Për Qeverinë e Republikës së Gjeorgjisë Për Qeverinë e Republikës Helenike

Për Qeverinë e Republikës së Moldavisë

Për Qeverinë e Rumanisë

Për Qeverinë e Federatës Ruse

Për Qeverinë e Serbisë

Për Qeverinë e Republikës së Turqisë

Për Qeverinë e Ukrainës

I. MARREVESHJE BILATERALE

Vendim Nr. 331, datë 09.07.1993	Për miratimin e Marrëveshjes “Për bashkëpunimin e administratave doganore”, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Greqisë.	785
Vendim Nr. 6 datë 5.1.1998	Për miratimin në parim të "Projekt marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Shqipërisë dhe Qeverisë Maqedonase për ndihmën e ndërsjelltë ndërmjet Administratave të tyre Doganore".	792
L igj Nr.8555, datë 22.12.1999	Për ratifikimin e Marrëveshjes së asistencës administrative për parandalimin, zbulimin dhe ndëshkimin e shkeljeve doganore, ndërmjet qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Italisë.	800
Vendim Nr. 744, datë 6.11.2003	Per miratimin e Marreveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Bullgarisë “Për asistencën e ndërsjelltë administrative në çështjet doganore” .	811
VKM Nr.783, datë 26.11.2003	Për miratimin e Marrëveshjes “Për bashkëpunim dhe asistencën e ndërsjelltë në çështjet doganore”, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kroacisë.	819
Vendim Nr.497, datë 23.7.2004	Për miratimin e Marreveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Moldavisë, për asistencë të ndërsjelltë në çështjet doganore.	829
Vendim Nr .10, datë 14.1.2004	Për miratimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Polonisë “Për bashkëpunim dhe asistencë të ndërsjelltë në çështjet doganore.	838
Vendim Nr. 9, datë 14.01.2004	Per miratimin e marreveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Rumanisë, “Për bashkëpunim dhe asistencë të ndërsjelltë administrative në çështjet doganore.	843
Vendim Nr.154, datë 09.03.2005	Për miratimin e Marrëveshjes “Për bashkëpunim dhe asistencë të ndërsjelltë në çështjet doganore”, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Sllovakisë.	851
Vendim Nr.7, Datë 13.1.2006	Për miratimin e Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Qipros, për asistencën e ndërsjelltë administrative, për zbatimin e saktë të legjislacionit doganor dhe për parandalimin, hetimin dhe luftën ndaj shkeljeve doganore.	861
Vendim Nr. 150, datë 15.03.2006	Për miratimin e Marrëveshjes “Për bashkëpunim dhe asistencë të ndërsjelltë në çështjet doganore”, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Malit të Zi.	871

Vendim Nr. 188, datë 11.04.2007	Për miratimin e marrëveshjes “Per bashkëpunim dhe asistencë të ndërsjelltë në çështjet doganore”, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqiperise dhe Republikes se Austrisë.	883
Vendim Nr. 959, datë 11.06.2009	Për miratimin e Marreveshjes “Për bashkëpunim dhe asistencë të ndërsjelltë në çështjet doganore”, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqiperisë dhe Qeverisë se Mbretërisë së Spanjës”.	888
Vendim Nr. 851, datë 05.08.2009	Për miratimin në parim të Marreveshjes “Për bashkëpunim dhe ndihmë të ndërsjelltë në çështjet doganore”, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës”.	897



VENDIM
NR. 331, DATE 09.07.1993

**PER MIRATIMIN E “MARREVESHJES NDERMJET QEVERISE SE REPUBLIKES
SE SHQIPERISE DHE QEVERISE SE REPUBLIKES SE GREQISE PER
BASHKEPUNIMIN ADMINISTRATIVE DOGANORE”**

Me propozimin e Ministrise se Ekonomise dhe Fianancave dhe te Ministrise se Puneve te Jashtme, Keshilli i Ministrave:

VENDOSI:

Miratimin e marreveshjes ndermjet Republikes se Shqiperise dhe Qeverise se Republikes se Greqise per bashkepunimin e administrative doganore”, e cila u nenshkrua ne Athine me 17 maj 1993.

Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

KRYETARI I KESHILLIT TE MINISTRAVE

Aleksander Meksi

Nr. 1866/1 Prot. Date 13.07.1993

**PRESIDENCES
KUVENDIT POPULLOR
GJYKATES KUSHTETUESE
GJYKATA E KASACIONIT
PROKURORISE SE PERGJITHSHME
MINISTRISE SE FINANCAVE E EKONOMISE
MINISTRISE SE PUNEVE TE JASHTME
SHERBIMIT TE KONTROLLIT TE SHTETIT
DREJTORISE SE PERGJITHSHME TE DOGANAVE**

SEKRETAR I PERGJITHSHEM

Vullnet ADEMI

MARREVEESHJE
MIDIS REPUBLIKES SE SHQIPERISE DHE QEVERISE SE REPUBLIKES SE
GREQISE PER BASHKEPUNIMIN E ADMINISTARTAVE TE TYRE DOGANORE

Qeveria e Republikes se Shqiperise dhe Qeveria e Republikes se Greqise.

Duke njohur se shkeljet e ligjeve dhe rregullave doganore demtojne interes ekonomike, tatimore, sociale dhe interesa te tjera te vendeve te tyre;

Duke konsideruar te rendesishme per llogaritjen e sakte te taksave doganore, tatimeve dhe detyrimeve te tjera qe merren gjate import-eksportit te mallrave dhe sendeve te tjera, si dhe duke zbatuar me korrektesi ndalimet, kufizimet dhe kontrollet;

Te bindura qe bashkepunimi midis administrative te tyre Doganore ne vecanti duke marre parasysh ekzistencen e kufinjve te perbashket te dy vendeve do te kontribuojne ne nje veprimtari me efektive per parandalimin, hetimin dhe ndalimin e shkeljeve doganore, duke perfshire trafikun dhe transportimin e paligjshem ne kufi te armeve dhe te lendeve plasese dhe municineve si dhe gjithashtu te objekteve me vlera kulturore dhe trafikun e jashteligjshem te narkotikeve dhe te substancave prikotrope.

Rane dakort si me poshte:

Neni 1

Per qellimet e kesaj Marreveshje:

Me ligje dhe rregulla doganore, kuptojme teresisne e dispozitave juridike dhe rregulluese te cialt zbatohen nga Doganat dhe qe rregullojne menytrat e importit eksportit dhe tranzitimit te mallrave; levizjen e personave dhe te mejteve te tjera te transportit, vjeljen e detyrimeve doganore , taksave dhe detyrimeve te tjera si dhe sipozitave te tjera qe kane te bejne me problem doganore:

“Administrata Doganore”

-Ne Republikën e Shqiperise eshte Drejtoria e Pergjithshme e Doganave ne Ministrine e Financave dhe Ekonomise ne Republikën e Shqiperise;

-Ne Republikën e Greqise eshte Drejtoria e Pergjithshme e Doganave ne Ministrine e Financave ne Republikën e Greqise;

“Shkelje doganore”, kuptojme cdo shkelje apo tentative shkelje te Legjislacionit Doganor;

“Person”, kuptojme cdo person fizik apo juridik;

“Objekte me vlere kulturore”, kuptojme sende me karakter kulturor, fetar apo dekorativ dhe qe konsiderohen te rendesishme per shkak te vleres se tyre arkeologjike, prehistorike, letrare dhe shkencore.

Neni 2

Palet i japin njera tjetres, brenda mundesive te tyre, per problem te shkollimit profesional te personelit te Adminsitave te tyre Doganore.

Per kete qellim:

mund te pranojne, ne institucionet e tyre shkolluese ose ne zyrat doganore, personel te Administrates Doganore te Pales tjetet per shkollim dhe stervitje praktike.

Sipas kërkeses së njerës pale, Pala tjetër mund të dërgojë tek ajo personelin për të marrë pjesë në seminare ose ngjarje të tjera që kanë për qëllim përmirësimin e aftësive të tyre profesionale.

Palet do të cojnë përpara bashkëpunim teknik me qëllim:

Shkollimin e personelit të tyre për të përfunduar përvje të kualifikuar ;

Shkëmbimin e njohurive dhe të përvjeve lidhur me përdorimin e metave dhe mjeteve për parandalimin, hetimin dhe ndalimin e hkeljeve doganore;

Shkëmbimin e subjekteve që kanë një farë përvjeje dhe njohuri special në hetimin dhe ndalimin e shkeljeve doganore;

Shkëmbimin e informacionit profesional, shkencor e teknik në lishje me rregullat e procedurat Doganore.

Vendosjen e cfrido forme tjetër bashkëpunimi teknik, të cilin Palet mund ta konsiderojnë si të pershtatshme.

Neni 3

Qëllimi i ndihmës reciproke

Me anën e kësaj Marrëveshjeje, Palet vendosin bashkëpunim dhe qëllime reciproke midis Administrative të tyre Doganore.

Cdo ndihmë që parashikon nga kjo Marrëveshje, jepet nga njëra ose tjetra Pale duke respektuar legjislativin e tyre kombëtar.

Në kuadrin e kompetencave të veta, Administrata Doganore e njerës Pale nën kushtet e kësaj Marrëveshjeje do të japë Administratës Doganore të Palës tjetër, ndihmë në parandalimin, hetimin dhe ndalimin e shkeljeve doganore.

Administratat doganore të Paleve do të japin reciprocisht të gjithë informacionin e mundshëm që siguron përlogatitjen e sakte të detyrimeve të sakte të detyrimeve Doganore., taksave dhe detyrimeve të tjera gjatë importit dhe eksportit.

Neni 4

Dorezime të kontrolluara

Në bazë të legjislativin të tyre Kombëtar, Administratat Doganore të Paleve mund të bien dakort për të zbatuar metodën e dorezimit të kontrolluar të narkotikeve dhe substancave psikotropike, me qëllim zbulimin e personave që janë përfshirë në këtë trafik të jashtëligjshëm.

Dorezimet e kontrolluara mund të kenë formën ose të lenies së ngarkesës së paprekur ose e konfiskuar ngarkesën në një fazë ndërmjetesë ose duke e levizur dhe zëvendësuar ngarkesën pjesërisht.

Palet do të rregullojnë midis tyre formën dhe menyrat për zbatimin në cdo rast të metodës së dorezimit të kontrolluar, si dhe problemin e rregullimeve financiare.

Rezultatet e dorezimit të kontrolluar do të komunikohen reciprocisht sa më shpejt të jetë e mundur.

Neni 5

Ruajtja e sekretit

Informatat, dokumentet për të përfunduar në kuadrin e ndihmës reciproke, mund të përdoren nga Pala marrëse vetëm për qëllimet e përcaktuara në këtë Marrëveshjeje dhe vetëm nga organet kompetente, duke përfshirë përdorimin e tyre gjatë procedurës gjyqësore apo administrative.

Keto lloj informatash, dokumentesh dhe të dhëna të tjera mund të përdoren për qëllime të tjera (ose komunikim të mëtejshëm nga Pala marrëse për palet e treta) vetëm kur pala furnizuese shpreh qartë pelqimin e saj përkatës.

Sipas kerkeses te pales furnizuese, informatat, dokumentat dhe te dhenat e tjera te furnizuara ne baze te kesaj Marreveshje, do te konsiderohen si secret nga pala Marrese. Informatat, dokumentat dhe ted hen te tjera te furnizuara ne baze te kesaj Marrveshje do te konsiderohen tek Pala marrese ne te njejten shkalle te sekretit zyrtar qe kjo pale zbaton lidhur me informatat. Dokumentat dhe te dhenat e tjera tembledhura ne territorin e saj.

Neni 6

Perjashtime te ndihmes reciproke

Ne rastin kur pala tek e cila eshte adresuar kerkesa per ndihme, konsideron qe plotesimi i kerkeses mund te demtoje sovranitetin e saj, sigurine, rendin shoqeror ose sektore t tjetere te rendesishem te interesave te saj kombetare, ajo mund te refuzoje te jape ndihme ose kondicionoje plotesimin e kerkeses me respektimin e disa kushteve.

Neni 7

Forma dhe permbajtja e kerkesave per ndihme

Kerkesat per ndihme qe behen ne baze te kesaj marreveshje do te paraqiten me shkrim. Neqoftese kerkesa eshte e nje natyre urgjente, eshte e mundur qe ajo te paraqitet me goje, porn je konfirmim i shkruar duhet te paraqitet shkrim.

Dokumentat e kerkuara per plotesimin e saj duhet te jene bashkengjitur kerkeses.

Kerkese do te perfshije:

Autoritetin qe ben kerkesen;

Llojin e procedurave juridike, administrative etj;

Qellimin dhe arsyet e kerkesave;

Pershkrimin e shkurter te thelbit te ceshtjes dhe te karakterit te saj ligjor.

Emrat dhe adresat e njerezve qe kane lidhje me procedurat nese njihen.

Neni 8

Kanalet e komunikimit

Funksionimi i ndihmes reciproke realizohet ndermjet komunikimit te drejteperrejte midis funksionareve te caktuar prej Kryetareve te Administratave respective Doganore te Paleve. Ne rastin kur Sherbimi Doganor, i pales se ciles i eshte drejtuar kerkesam nuk eshte kompetent per tu pergjigjur kerkesesm ai ia kalon kerkesen Autoriteteve Kompetente.

Neni 9

Plotesimi i kerkeses

Administrata doganore, teke cila drejtohet kerkesa, ben perpjekjet e duhura per plotesimin e saj.

Administrata doganore e njeres pale, mundet ne vijim te kerkeses se shprehur nga Administrata doganore e pales tjetere, te beje hetimin e domosdoshem ose te grumbulloje, duke perfhsire edhe marrjen ne pyetje te eksperteve, te deshmitareve dhe te personave qe dyshohen per shkelje doganore.

Administrata Doganore e njeres Pale, ne vijim te kerkeses se shprehur nga Administrata Doganore e pales tjetere, te ebeje verifikime kontrolli dhe hetime me qellim qe te konstatoje fakte lidhur me rastet per te cilat Administrata Doganore e kerkuar eshte kompetente dhe keto perfshihen ne kete marreveshje.

Lidhur me kerkesen, Pala se ciles i eshte drejtuar kerkesa, mund te autorizoj funksionaret e Pales kerkuese te vijne ne territorin e saj dhe te japin informacion ose ndihme ne lidhje me rastin ne shqyrtim. (Keta persona gezojne ne territorin e pales tjeter mbrojtjen e garantuar, siguruar nga ligjet kombetare dhe rregulloret per funksionaret e Pales Pritese dhe i jane pershtatur asaj lidhur me pasojat penale te shkeljeve qe jane bere ndaj ose prej tyre).

Kerkesa e nje pale, qe te ndiqen disa procedura, do te duhet te plotesohet ne perputhje me legjislacionin e Pales se ciles i eshte drejtuar kerkesa.

Pala kerkuese do te informohet si per kohen dhe vendin e kryerjes se veprimit, ne perputhje me kerkesen e saj per te siguruar koordinimin e veprimit.

Ne rastin kur kerkesa nuk mund te plotesohet, Pala kerkuese do te informohet per kete si dhe per arsyet e mos plotesimit.

Plotesimi i kerkeses per plotesimi i bere ne baze te ketij neni , do te realizohet lidhur me ligjet dhe rregulloret e Pales se cilesi eshte drejtuar kerkesa.

Neni 10 Dosjet dhe dokumentat

Origjinalet e dosjeve, dokumentave dhe te dhenave te tjera, ne masen qe ato mund te behen te vlefshme nga administrate Doganore nga e cila ato jane kerkuar, mund te jepen ne rastet kur kopjet nuk jane te mjaftueshme per qellimin.

Pas nje kerkese te vecante kopjet e skedareve te tille original, te dokumentave dhe te te dhenave te tjera legalizohen.

Gjate zbatimit te ketij neni nuk mund te preken te drejtat e pales se ciles i drejtohet kerkesa ose Plave te Treta qe kane lidhje me raste te vecanta.

Neni 11 Deshmitare dhe eksperte

Administrata doganore e njeres Pale mund te autorizoj funksionaret e saj, sipas kerkeses se Administrates Doganore te pales tjeter dhe te paraqiten si deshmitare apo eksperte tne procese gjyqesore apo administrative ne territorin e pales tjeter, si dhe te jape dosjet, dokumentat ose te dhena te tjera ose kopjet e legalizuara kur keto provohen se jane te domosdoshme per procedure.

Sipas kushteve te kesaj Marreveshje, kur funksionaret e nje Plae gjenden ne territorin e Pales tjeter, mund te kene mundesine te paraqesin vertetime me shkrim mbi kompetencat e tyre zyrtare.

Njekoheshit mund te jene me uniforme e me arme.

Neni 13 Shpenzimet

Palet heqin dore nga kerkimi i rimbursimeve per shpenzimet qe ato bejne gjate zbatimit te kesaj marreveshje, me perjashtim te shpenzimeve per deshmitaret dhe ekspertet (Neni 11) si dhe shpenzimet qe jane te bejne me doresimin e kontolluar te mallrave (neni 4).

Shpenzime t per levizjen dhe qendrimin e deshmitareve dhe eksperteve do te mbulohen nga pala kerkuese.

Neni 13
Raste te vecanta te bashkepunimit

Pasi bejne kerkese Administratat Doganore te paleve, do te informojne njera tjetren ne lidhje me faktin nese mallrat apo sende te tjera te eksportuara nga territori nje Pale u importuan sipas ligjit ne territorin e nje pale tjetere. Nje informacion i tille duhet te shoqerohet.

Administrata Doganore e nje pale, me kerkesen e Administrates Doganore ten je pale tjetere, Brenda mundesive te saj mund te ushtroje kontroll vecanerisht mbi:

Listat e transporteve per te cilet dyshohet per shkelje te legjislacionit Doganor ne territorin e Pales kerkuese;

Mallrat dhe sendet e tjera te cilat Pala kerkuese I konsideron si objekte te tregtise se paligjshme dhe qe destinohen per tu futur ne territorin e kesaj pale;

Vendet e perdorura per ruajtjen e mallrave dhe te tjera ne kondita qe justifikohen ne baza te shendosha, dyshimin qe ato jane vendosur me qellim lehtesojne shkeljet doganore.

Administratat Doganore, pas kerkeses qe bejne, do te japin reciprocikisht informatat qe disponojne dhe qe kane lidhje me veprimtari te cilat mmund te sjellin shkelje doganore.

Informatat qe kane lidhje me rrezikun e shkaktimit ten je demit e konsiderueshem ne ekonomi, ne shendetin dhe sigurine publike, ose sektore te tjere te interest jetij te Pales tjetere, jepen edhe ne rastin kur per to nuk eshte bere kerkese respective.

Kjo zbatohet ne vecanti lidhur me trafikun e jashteligjshem te armeve, narkotikeve, substancave psikotropem, prekursorëve dhe sendeve te rrezikshme, si dhe gjithashtu per objektet me vlera kulturore.

Administratat doganore te Paleve, pas kerkeses qe bejne, japin reciprocikisht informatat qe disponojne mbi dokumentit e transportit dhe dergesave te mallrave dhe te sendeve te tjera, referuar vlerave te tyre, vendin nga jane ato dhe vendin e destinacionit te tyre.

Neni 14
Zbatimi i marreveshjes

Drejtoria e Pergjithshme e Doganave e Ministrise se Financave dhe Ekonomise se Republike se Shqiperise dhe Drejtoria e Perjithshme e Doganave e Ministrise se Fianacave te Republike se Greqise mund te hyjne ne lidhje te drejteperdrejta midis tyre per te rregulluar ceshtjet qe kane te bejne me kete marreveshje dhe ne qoftese eshte e nevojshme, te kene konsultime per rregullimin e ceshtjeve lidhur me zbatimin e saj.

Ato do te bejne gjithashtu cdo perpjekje, ne menyre qe me konsensus reciprok, te rregullojne ceshtjet interpretative qe mund te lindin gjate zbatimit te kesaj Marreveshje.

Neni 15
Hyrja ne fuqi dhe mbarimi i kohes se zbatimit

Kjo marreveshje do te hyje ne fuqi gjashtedhete dite pasi palet te kene shkembyer nota verbale diplomatike, me te cilat bejete te ditur se procedurat juridike kombetare, te nevojshme per te hyre ne fuqi Marreveshja jane plotesuar.

Kjo Marreveshje nenshkrhet per nje periudhe te pacaktuar kohe. Jo nder te tjera, mund te prfundoje nga te dy Palet me ane ten je note te shkruar nepermjet kanaleve diplomatike dhe pushon se qeni ne fuqi, pasi kalojne tre muaj nga koha e marrjes se nje note te tille.

U hartua ne Athine sot me dten 17 Maj 1993 ne dy ekzemplare origjinale ne gjuhen shqipe dhe greke, duke pasur te dy tekstet te njejten fuqi

Per Qeverine e Republikes se Shqiperise

Per Qeverine e Republikes se Greqise



REPUBLIKA E SHQIPERISE
Keshilli i Ministrave

VENDIM
Nr. 6 Date 5.1.1998

PER
MIRATIMIN NE PARIM TE "PROJEKTMARREVESHJES NDERMJET
QEVERISE SE SHQIPERISE DHE QEVERISE MAQEDONASE PER NDIHMEN E
NDERSJELLTE NDERMJET ADMINISTRATAVE TE TYRE DOGANORE"

Me propozim te Ministrise se Financave, Keshilli i Ministrave

VENDOSI :

Miratimin ne Parim te "Projektmarreveshjes ndermjet Qeverise se Shqiperise dhe Qeverise Maqedonase per ndihmen e ndersjelle ndermjet administratave te tyre doganore." Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI I KESHILLIT TE MINISTRAVE

FATOS NANO

MARREVESHJE

MIDIS QEVERISE SE SHQIPERISE DHE QEVERISE MAQEDONASE NE LIDHJE
ME NDIHMEN E NDERSJELLTE MIDIS ADMINISTRATAVE TE TYRE
DOGANORE

Qeveria e Shqiperise dhe Qeveria e Maqedonise, qe ketu e tutje te referuara si "Palet Kontraktuese"

Duke mbajtur parasysh se shkeljet e legjislacionit doganor jane me pasoja per intereesat ekonomike, fiskale, shoqerore, dhe tregtare te vendeve respektive;

Duke mbajtur parasysh rendesine e sigurimit te vjeljes se sakte te detyrimeve doganore dhe taksave te tjera per importimin dhe eksportimin e mallrave, si dhe njekohesisht percaktimin e sakte te vleres dhe origjines se mallrave;

Duke pranuar nevojën e bashkepunimit nderkombetar ne çeshtjet qe lidhen me aplikimin dhe zbatimin e legjislacionit doganor;

Te bindur se veprimet kunder shkeljeve doganore mund te behen me efektive permes bashkepunimit ndermjet Autoriteteve te tyre Doganore;

Duke mbajtur parasysh lehtesimin e kalimit te pasagjereve dhe mallrave;

Ne perputhje me Rekomandimet e Keshillit te Bashkepunimit Doganor per Ndihmen e Ndersjellte Administrative te 5 Dhjetorit,1953;

rane dakord si me poshte: Neni 1

PERKUFIZIME

Per qellime te kesaj Marreveshje:

1. Termi "Legjislacion Doganor" do te kuptohet si teresi e ligjeve dhe rregulloreve ne fuqi apo te administruara nga Autoritetet Doganore, ne lidhje me importimin, eksportimin apo tranzitin e mallrave nderkohe qe ato i nenshtrohen detyrimeve doganore, perfshire edhe masat kufizuese, ndalimin dhe kontrollin per levizjen e mallrave pertej kufijve kombetare;

2. Termi "Shkelje Doganore" do te kuptohet si cdo shkelje apo tentative shkeljeje e Legjislacionit Doganor;

3. termi "Detyrime Doganore" do te thote te gjitha detyrimet, taksat, tatimet dhe ose shpenzimet e tjera qe paguhen dhe mblidhen ne territoret e Paleve Kontraktuese ne zbatimin e legjislacionit doganor, ne lidhje me importimin apo eksportimin mallrave, por nuk perfshin tatimet dhe shpenzimet e tjera, te cilat jane te kushtezuara ne sasi per koston e perafert te sherbimeve te ofruara;

4. Termi "Autoritete Doganore" do te kuptoje Administraten Doganore Shqiptare dhe Administraten Doganore Maqedonase.

Neni 2

FUSHA E MARREVESHJES

1. Gjithe ndihma sipas kesaj Marreveshje, nga Secila Pale Kontraktuese, do te kryehet ne perputhje me legjislacionin e brendshem te Pales Kontraktuese perkatese.

2. Administratat Doganore te Paleve Kontraktuese do te kooperojne dhe ndihmojne njera tjetren, ne drejtim te sigurimit te zbatimit te sakte te legjislacionit Doganor, dhe per ndalimin, hetimin dhe luften ndaj shkeljeve doganore ne perputhje me dispozitat e kesaj Marreveshjeje.

Neni 3

FUSHA E NDIHMES

1. Administratat Doganore i japin njera tjetres, qofte me kerkese apo me iniciativen e tyre, te gjitha informacionin e nevojshem qe mund te ndihmoje me sigurimin e zbatimit te sakte te legjislacionit Doganor duke perfshire, interalia, informacion per:

(a) te siguruar mbbledhjen e plote te detyrimeve dhe taksave te importit dhe eksportit;

(b) te ndihmuar aplikimin e sakte te vleres se mallrave per qellimet Doganore;

(c) te ndihmuar ne percaktimin e klasifikimit tarifor dhe origjines se mallrave.

2. Ndhima e parashikuar ne kete Marreveshje, do te perfshijje, por nuk do te kushtezohet vetem ne:

(a) kryerjen e veprimeve qe mund te jene te dobishme per parandalimin shkeljeve dhe, ne vecanti, menytrat e vecanta te luftes ndaj ketyre shkeljeve;

(b) menyra apo metoda te reja te perdorura ne kryerjen e shkeljeve dhe ne vecanti, menytrat e vecanta te luftes ndaj ketyre shkeljeve;

(c) vzhgime dhe gjetje qe kane rezultuar nga zbatimi i suksesshem i ndihmave dhe teknikave te reja;dhe

(d) teknika dhe metoda te permiresuara per kalimin e pasagjereve dhe ngarkesave.

3. Administratat Dognore te Paleve Kontraktuese, ne qofte se nuk bien ne kundershtrim me ligjet kombetare, do te synojne gjithashtu bashkepunimin ne:

(a) inicimin, zhvillimin, ose permiresimin e programeve te vecanta te trajnimit per personelin e tyre;

(b) Ngritjen dhe mbajtjen e kanaleve te komunikimit me njeri; tjetrit, ne menyre qe te lehtësojne sigurimin e njeshkembimi te shpejte te informacionit;

(c) lehtesimin e koordinimit efikas ndermjet njeri tjetrit, duke pershire shkembimin e personelit dhe te eksperteve si dhe te punonjesve nderlidhes;

(d) marrjen ne konsiderate dhe perdorimin e mjeteve dhe procedurave te reja;

(e) thjeshtesimin dhe harmonizimin e procedurave perkatese doganore; dhe

(f) çdo çështjeje tjetër administrative qe mund te kerkoje here pas here veprime te perbashketa.

4. Çdo kerkese per arrestim personi do te perjashtohet nga nje ndihme e tille. Gjithashtu, mbledhja dhe perdorimi i forces per mbledhjen e detyrimeve doganore, taksave te tjera, gjobave dhe detyrimeve te ndryshme do te perjashtohet nga kjo ndihme.

Neni 4

NDIHMA NE KONTROLL

1. Me kereksene e Administrates qe aplikon, Administrata se ciles i behet kerkesa do te komunikojte informacionin ne lidhje me çështjet e meposhtme:

(a) vertetesine e dokumentave zyrtare te nxjerra ne mbeshtetje te deklarates se mallrave qe i paraqitet Autoriteteve Doganore te Pales Kontraktuese qe ka bere kerkesen;

(b) nese mallrat e importuara ne territorin doganor te Pales Kontraktuese qe ka bere kerkesen kane qene te eksportuara sipas rregullave ligjore nga territori i doganor i Pales tjetere Kontraktuese.

(c) nese mallrat e eksportuara nga territori doganor i Pales Kontraktuese qe ben kerkesen kane qene te importuara ligjerisht ne territorin doganor te Pales Kontraktuese qe e ben kerkesen kane qene te importuara ligjerisht ne territorin doganor te Pales Kontraktuese se ciles i behet kerkesa;

(d) informacion ne lidhje me transportimin dhe levizjen e mallrave, disponimin dhe destinacionin e ketyre mallrave, si dhe vleren dhe origjinen e tyre;

(e) katalogun dhe listen e cmimeve te mallrave ne fjale, ne qofte se eshte e mundur.

2. Nje informacion i tille, kur eshte rasti, do te specifikojte dhe proceduren doganore te zbatuar mbi mallrat.

Neni 5

1. Palet Kontraktuese, brenda kompetencave te tyre do t'i japin ndihme njera tjetres ne qofte se e konsiderojne te nevojshme per zbatimin korrekt te legjislacionit doganor dhe, ne vecanti, kur ato marrin informacion qe ka lidhje me: veprime te cilat kane shkelur, shkelin, ose mund te shkelin ligjet ne fuqi dhe qee mu d te jene me interes per Palen tjetere Kontraktuese.

-mallra te cilat dihen se jane objekt i shkeljes themelore te legjislacionit doganor ne territorin e Pales tjetere Kontraktuese;

-persona, apo firma te vecanta qe dihet se kane kryer, apo dyshohet qe mund te kryejne shkelje te legjislacionit ne fuqi ne territorin e Pales tjetere Kontraktuese;

-mjetet e transportit dhe kontenjeret, per te cilet ka njohuri ose ekziston dyshimi qe kane qene, jane ose mund te perdoren ne kryerjen e shkeljeve te legjislacionit doganor ne fuqi te Pales tjetere Kontraktuese.

Neni 6

KOMUNIKIMI I KERKESAVE

1. Forma dhe permbajtja e kerkeses per ndihme:

(a) Kerkesat, ne perputhje te kesaj Marreveshje, duhet te behen me shkrim. Dokumentat e nevojshme per ekzekutimin e kerkesave te tilla duhet te shoqerohen keto kerkesa. Per shkak te nje situates urgjente, mund te behet edhe pranimi i nje kerkeses gojore, por kjo duhet konfirmuar me shkrim sa me shpejt qe te jete e mundur.

(b) Kerkesat duhet te behen ne anglisht. Çdo dokument qee shoqeron kerkesat duhet, kur eshte e nevojshme, te perkthehet ne anglisht.

2. Kerkesat ne zbatim te paragrafit 1 teketij Neni duhet te perfshijne informacionin e meposhtem:

- (a) administraten qe ben kerkesen;
- (b) masen qe kerkohet;
- (c) objektin dhe shkakun per te cilin behet kerkesa;
- (d) emrat dhe adresat e paleve me te cilat ka lidhje kerkesa;
- (e) nje pershkrim i shkurter i ceshtjes ne fjale dhe elementet juridike qe perfshihen ne te;
- (f) lidhjen ndermjet ndihmes qe kerkohet dhe ceshtjes me te cilen ajo lidhet.

3. Kanalet e komunikimit:

- (a) Ndihma do te realizohet me komunikim direkt ndermjet Autoriteteve Doganore.
- (b) Ne rastet kur Administrata Doganore e Pales Kontraktuese te ciles i behet kerkesa, nuk eshte agjencia e pershtatshme per te permbushur kerkesen, ajo, pas konsultimeve perkatese, duhet te beje ose transmetimin direkt te kerkeses ne agjencine perkatese, e cila do te veproje per permbushjen e kerkeses ne zbatim te kompetencave qe i njeh ligji, ose te keshilloje Administraten qe ben kerkesa qe te ndjeke proceduren e pershtatshme per kerkesen ne fjale.

Neni 7

EKZEKUTIMI I KERKESES

1. Administrata te ciles i eshte bere kerkesa do te marre, brenda kompetencave te legjislacionit te brendshem, te gjitha masat per ekzekutimin e kerkeses brenda nje afati kohor te arsyeshem.
2. Administratat Doganore te seciles Pale Kontraktuese, ne baze te kerkeses se Administrates Doganore te Pales tjeter Kontraktuese, duhet te kryeje cdo hetim apo vezhgim te nevojshem, duke perfshire, kur eshte e nevojshme, edhe pyetjen e eksperteve dhe deshmitareve apo te personave te cilet dyshohen te kene kryer nje shkelje.

Neni 8

FORMA NE TE CILEN DUHET BERE KOMUNIKIMI I INFORMACIONIT

1. Administrata te ciles i behet kerkesa duhet t'ia komunikojte rezultatin e kerkimeve Administrates qe ben kerkesen ne formen e dokumentit, kopjeve te certifikuara te dokumentave, raporteve, ose te tjera te ngjashme me keto, dhe, kur eshte e domosdoshme, ne menyre gojore.
2. Dokumentat e parashikuar ne paragrafin 1 mund te zevendesohen me informacionin e kompjuterizuar te realizuar ne cdo lloj menyre dhe qe permbush te njejtin qellim. Çdo informacion i nevojshem per interpretimin apo nxjerrjen e nje informacioni te tille duhet te shoqeroje informacionin ne fjale.

PERJASHTIMET NGA NDIHMA

1. Ne rastet kur Pala Kontraktuese, te ciles i behet kerkesa, gjykon se permbushja e kerkeses mund te demtojte sovranitetin, sigurimin, politiken shoqerore, ose interesa te tjere thelbesore kombetare, ose mund te shkele nje sekret industrial, tregtar apo profesional, mund te refuzoje ndihmen ose mund ta jape ate te kufizuar, per shkak te kushteve dhe kerkesave perkatese.

2. Kur ndihma refuzohet ose shtyhet, duhet te informohet per kete vendim dhe per arsyet Administrata kerkuese, sa me shpejt qe te jete e mundur.

3. Ndhima mund te shtyhet nga Administrata, te ciles i behet kerkesa, mbi bazen e ndermarrjes se nje hetimi, ndjekjeje apo procedure qe eshte ne vazhdim.

4. Ne rastet kur Administrata qe ben kerkesen kerkon nje ndihme qe vete eshte e pamundur per ta dhene ne formen qe kerkohet, kete fakt duhet ta beje te njohur me kerkesen e mesiperme. Pas kesaj, do te jete per Administraten te ciles i behet kerkesa te vendose se si te pergjigjet per nje kerkese te tille.

Neni 10

PERDORIMI I INFORMACIONIT

1. Informacioni, dokumentat dhe informacionet e tjera te marra ne vazhden e ndihmes se nderdjellte mund te perdoren vetem per qellimet e dhena ne kete Marreveshje, duke perfshire perdorimin e tyre ne hetime, procedurat juridike dhe administrative.

2. Administrata qe ben kerkesen nuk duhet te perdore evidencen ose informacionin e marre ne zbatim te kesaj Marreveshjeje per qellime te tjera te ndryshme nga ato te parashtruar ne kerkesen e bere, pa pelqimin me shkrim te Administrates te ciles i behet kerkesa.

3. Dispozitat e paragrafit 1 dhe 2 te ketij Neni nuk perfshijne informacionin qe lidhet me shkeljet qe kane te bejne me drogat narkotike dhe substancat psikotrope. Nje informacion i tille mund t'iu komunikohet autoriteteve te Pales Kontraktuese, qe ben kerkesen, dhe qe perfshihen direkt ne luften kunder trafikut ilegal te droges.

Neni 11

FSHEHTESIA E INFORMACIONIT

Per cdo informacion, dokumenta apo komunikime te tjera te dhena ose te marra ne zbatim te kesaj Marreveshjeje do te trajtohet si e fshehte dhe mund te perdoret vetem per qellimet e parashikuara ne kete Marreveshje. Ato do te mbulohen nga detyrimi i sekretit profesional dhe do te gezojne te njejte ne mbrojtje , te njohur nen ligjet perkatese qe lidhen me informacione te te njejtes natyre, dokumenta ose komunikime te tilla te praktukueshme nga Pala Kontraktuese e cila e merr ate informacion.

Neni 12

DOSJET, DOKUMENTAT DHE DESHMIMTARET

1. Autoritetet Doganore te Paleve Kontraktuese duhet, mbi kerkesen e bere, te japin dokumentacionin qe ka lidhje me transportimin dhe levizjen e mallrave dhe qe permban vleren, origjinen, natyren dhe destinacionin e ketyre mallrave.

2. Origjinalet e dosjeve, dokumentave, dhe materialeve te tjera, do te kerkohen vetem ne rastet kur kopjet nuk jane te mjaftueshme. Mbi nje kerkese te vecante, kopjet e dosjeve, dokumentave dhe materialeve te tjera duhet te vertohen ne menyre te pershtatshme.

3. Origjinalet e dosjeve, dokumentave, dhe materialeve te tjera, qe jepen duhet te rikthehen sa me shpejt qe te jete e mundur. Ne baze te kerkeses, origjinalet e nevojshme per marrjen e vendimeve gjyqesore, apo per qellime te tjera te ngjashme, duhet te kthehen pa vonese.

4. Me kerkesen e Administrates Doganore te njeres Pale Kontraktuese Administrata doganore e Pales tjetere Kontraktuese, kur e gjykon te tille, duhet te autorizojte punonjesit e saj, dhe ne se ata nuk e kundershtojne nje gje te tille, per t'u paraqitur si deshmitare ne procedurat administrative apo juridike ne territorin e Pales tjetere Kontraktues, dhe te jape dosje, dokumenta dhe materiale te tjera, apo kopjet autentike te tyre, ne qofte se keto konsiderohen themelore per procedurat. Nje kerkese e tille duhet te jape kohen, vendin dhe llojin e procedurave dhe kapacitetin me te cilin punonjesit duhet te deshmojne.

Neni 13

SHPENZIMET

1. Autoritetet Doganore te Paleve Kontraktuese normalisht duhet te mos njohin asnje kerkese per rimbursim te shpenzimeve te shfaqura nga ekzekutimi i Marreveshjes ne fjale, me perjashtim te shpenzimeve per deshmimtare, pagesat e eksperteve, dhe shpenzimet per perkthyesit qe nuk jane punonjes zyrtare.

2. Kur shpenzime te nje natyre themelore dhe te jashtezakonshme jane ose do te kerkohen per zbatimin e kerkeses, Administratat Doganore te Paleve Kontraktuese duhet te konsultohen per te vendosur per afatet dhe kushtet ne baze te te cilave do te zbatohet kjo kerkese, si dhe ne te njejten kohe, menyren e ndarjes se shpenzimeve.

Neni 14

ZBATIMI DHE MOSMARREVESHJET

1. Zbatimi i kesaj Marreveshjeje i eshte besuar administratave doganore te Paleve Kontraktuese. Ato vendosin per marrjen e te gjitha masave dhe lehtesirave te nevojshme per zbatimin e saj, duke patur parasysh udhezimet fushen e mbrojtjes te te dhenave.

2. Pas konsultimeve, Administratat Doganore te Paleve Kontraktuese mund te nxjerrin udhezime administrative te nevojshme per zbatimin e kesaj Marreveshejeje.

3. Administrat Doganore te Paleve Kontraktuese duhet te percaktojne zyrtaret pergjegjies per komunikimin e ndersjellte dhe per kete qllim duhet te shkembejne nje liste me emrat, titujt, numrin e telefonit dhe faksit te ketyre personave. Ato mund te marrin gjithashtu masa qe sherbimet hetimore te tyre te jene ne lidhje direkte me njeri tjetrin.

4. Mosmarreveshjet dhe konfliktet per te cilat nuk eshte gjetur asnje zgjidhje duhet te zgjidhen nepermjet kanaleve diplomatike.

Neni 15

ZBATIMI

Kjo Marreveshje do te jete e zbatueshme ne territoret doganore te te dyja Paleve Kontraktuese, sikurse percaktohet ne dispozitat e tyre kombetare, ligjore dhe administrative

Neni 16

HYRJA NE FUQI DHE PERFUNDIMI

1. Kjo Marreveshje do te hyje ne fuqi ne ditën e pare te muajit te dyte pasardhes te dites qe Palet Kontraktuese njoftojne njera tjetren, nepermjet shkembimit te notave diplomatike, se te gjitha kerkesat e nevojshme ligjore kombetare per hyrjen e kesaj Marreveshjeje ne fuqi jane permbushur.

2. Admistratat Doganore te Paleve bien dakord qe me kerkesen e njerës pale, ose ne fund te pese vjeteve nga data e hyrjes ne fuqi, te takohen per te rishikuar kete marreveshje ose te diskutojne cdo lloj ceshtje tjetër doganore qe mund te rezultojne nga marrëdhëniet ndërmjet tyre, me perjashtim te rastit kur ato njoftojne njera tjetren me shkrim qe nuk eshte i nevojshem nje rishikim i tille.

3. Kjo Marreveshje do te qendroje ne fuqi per nje periudhe kohe te papercaktuar. Do te perfundoje brenda gjashte muajve nga date ne te cilen njera nga Palet Kontraktuese ka njoftuar me shkrim, permes kanaleve diplomatike, Palen tjetër qe deshiron ta perfundoje Marreveshjen. Megjithate, procedurat qe kane filluar ne kohen e perfundimit te kesaj Marreveshjeje do te kryhen plotesisht.

Nenshkruar me _____, me date _____ 1997 ne dy origjinale secili ne gjuhet Shqipe, Maqedonisht dhe Anglisht me permbajtje te njejte te teksteve. Ne rast te ndonje divergjence si rezultat i interpretimit te Marreveshjes, do te merret per baze teksti ne gjuhen Angleze.



LIGJ
Nr.8555, datë 22.12.1999

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË ASISTENCËS ADMINISTRATIVE
PËR PARANDALIMIN, ZBULIMIN DHE NDËSHKIMIN E SHKELJEVE
DOGANORE, NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS TË ITALISË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës dhe të nenit 17 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet Marrëveshja e Asistencës Administrative për Parandalimin, Zbulimin dhe Ndëshkimin e Shkeljeve Doganore, Ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Italisë.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare. Shpallur me dekretin nr.2507, date 30.12.1999 te Presidentit te Republikes se Shqiperise Rexhep Meidani.

MARRËVESHJE

**E ASISTENCËS ADMINISTRATIVE PËR PARANDALIMIN, ZBULIMIN DHE
NDËSHKIMIN E SHKELJEVE DOGANORENDËRMJET QEVERISË SË
REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË ITALISË**

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Italisë, këtëj e tutje do t'u referohemi si Palë Kontraktuese; Duke konsideruar se shkeljet e legjislacionit doganor janë të patolerueshme për interesat e tyre ekonomike, tregtare, fiskale, shoqërore, kulturore, industriale dhe bujqësore;

Të bindur se aksionet kundër shkeljeve doganore mund të bëhen më efektive me anë të kooperimit të ngushtë të dy administratave doganore;

Duke konsideruar rëndësinë e llogaritjes së saktë të detyrimeve doganore dhe taksave të tjera mbi importet ose eksportet dhe të të qëniti i sigurtë se masat e duhura merren në drejtim të ndalimeve, kufizimeve dhe kontroleve, ku këto të fundit përfshijnë edhe kontrollin e zbatimit të dispozitave ligjore dhe rregulloreve për mallrat e falsifikuara dhe markat tregtare të regjistruara;

Duke konsideruar se trafiku me drogat narkotike dhe substancat psikotrope paraqet rrezik për shëndetin publik dhe shoqërinë; Duke iu referuar Konventës së Kombeve të Bashkuara, të 20 dhjetorit 1998, për luftën ndaj trafikut të jashtëligjshëm të drogave narkotike dhe substancave psikotrope, përfshi këtu edhe çfarë paraqitet në anekset e Konventës së sipërpërmendur, të amenduar dhe paparagjykuar ndonjë amendament tjetër të mundshëm që mund të aprovohet brenda kompetencave të Grupit të Përbashkët të Vazhdimësisë;

Duke iu referuar instrumenteve përkatëse të Këshillit të Kooperimit Doganor, në veçanti, rekomandimeve mbi asistencën administrative reciproke të 5 dhjetorit 1953;
Ranë dakord për sa më poshtë vijon :

KAPITULLI I

Përcaktime

Neni 1

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje :

a) "legjislacion doganor" do të thotë ligjet dhe rregulloret që janë të detyruara për t'u zbatuar nga të dy Administratat Doganore në lidhje me:

- importimin, eksportimin, tranzitimin dhe magazinimin e mallrave, kapitaleve, përfshi edhe mjetet e pagesës;

- mbledhjen, garantimin dhe ripagesën e detyrimeve dhe taksave për importet dhe eksportet;

- masat ndaluese, kufizuese dhe kontrollet, përfshi dhe këmbimin e ligjeve për kontrollet ;

- luftën kundër trafikut të jashtëligjshëm të drogave narkotike dhe substancave psikotrope ;

b) "Administratë Doganore" do të thotë Administrata Doganore

Italiane së bashku me Guardia di Finanza (Rojen Financiare), për Republikën e Italisë dhe për Republikën e Shqipërisë, Administrata Doganore e Republikës së Shqipërisë, që është kompetente për zbatimin e dispozitave të përmendura në paragrafin a) të kësaj Marrëveshjeje;

c) "shkelje doganore" do të thotë çdo shkelje ose tentative për shkelje të legjislacionit doganor;

d) "detyrimet doganore dhe taksat mbi/për importet dhe eksportet" do të thotë detyrime doganore për eksportet dhe importet, si dhe të gjitha detyrimet, taksat, tatimet e tjera që mbledhen në lidhje me importin apo eksportin, përfshi për Republikën e Italisë, detyrimet dhe taksat që caktohen nga organet kompetente të Bashkimit Europian;

e) "person" do të thotë çdo person fizik ose person juridik;

f) "të dhëna personale" do të thotë çdo informacion që i referohet një qenieje njerëzore të caktuar apo të identifikueshme;

g) "droga narkotike dhe substanca psikotrope" do të thotë të gjithë produktet që përshkruhen në Konventën e Vjenës të 20 dhjetorit 1998, përfshi edhe ato të përcaktuara në anekset e Konventës në fjalë.

KAPITULLI II

Fushëveprimi i Marrëveshjes

Neni 2

1. Palët Kontraktuese, me anë të Administratave të tyre Doganore, do të japin asistencë administrative reciproke me kushtet e përcaktuara në këtë Marrëveshje, në drejtim të zbatimit të rregullt të legjislacionit doganor dhe për parandalimin, zbulimin dhe luftën kundër shkeljeve doganore.
2. E gjithë asistenca, në bazë të kësaj Marrëveshjeje, do të jepet në përputhje me legjislacionin kombëtar, dispozitat administrative dhe brenda kufijve të kompetencave të asaj Administrate Doganore dhe burimeve në dispozicion të saj.
3. Kjo Marrëveshje ka si qëllim të vetëm ndihmën reciproke administrative ndërmjet Palëve Kontraktuese dhe dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk i japin të drejtë ndonjë personi privat të marrë, vendosë ose përjashtojë ndonjë fakt apo të pengojë ekzekutimin e kërkesës.

KAPITULLI III

Fusha që mbulon asistenca

Neni 3

1. Administratat Doganore do t'i japin njëra-tjetrës mbi bazën e kërkesës dhe me iniciativën e tyre personale, informacion dhe inteligjencë në ndihmë të zbatimit të rregullt të legjislacionit doganor dhe për parandalimin, zbulimin dhe luftën kundër shkeljeve doganore.
2. Kur kryen hetime në emër të Administratës Doganore tjetër, Administrata Doganore ose do të veprojnë sikur ato të kryeshin për llogari të vet, ose me kërkesën e ndonjë autoriteti tjetër të asaj Pale Kontraktuese.

Neni 4

1. Mbi bazën e kërkesës, Administrata Doganore të cilës i bëhet ajo kërkesë do të furnizojë të gjithë informacionin mbi legjislacionin dhe procedurat doganore që aplikohen nga ajo Palë Kontraktuese dhe që lidhen me hetimet për shkelje doganore.
2. Secila nga Palët Kontraktuese do të komunikojë, ose me kërkesë, ose me iniciativën e saj personale çdo informacion disponibël që lidhet me :
 - a) teknikat e reja për detyrimin e zbatimit të ligjit të provuara si efektive;
 - b) tendencat e reja, mjetet dhe metodat për kryerjen e shkeljeve doganore.

KAPITULLI IV

Shembuj të asistencës

Neni 5

Mbi bazën e kërkesës, administrata që i drejtohet ajo kërkesë në veçanti do t'i jape administratës kërkuese informacionin që vijon :

- a) nëse mallrat e eksportuar, të importuara në territorin doganor të Palës Kontraktuese që bën kërkesën, ishin eksportuar ligjërisht nga territori doganor i Palës Kontraktuese të kërkuar;
- b) nëse mallrat e eksportuara nga territori doganor i Palës Kontraktuese që bën kërkesë janë importuar ligjërisht në territorin doganor të Palës Kontraktuese, që i bëhet kërkesë dhe, në qoftë se ekziston, në cilën procedurë doganore ishin vendosur mallrat në fjalë.

Neni 6

Në qoftë se në kuadrin e dispozitave ligjore dhe rregullatore, Administratat Doganore të Palëve Kontraktuese do të këmbëjnë ndonjë informacion (mbi bazën e një kërkesë dhe më pas përpara hetimit, në qoftë se është e nevojshme) që i aftëson për të siguruar se detyrimet doganore dhe taksat mbledhen në mënyrë korrekte, ky informacion do të jetë veçanërisht i tillë që të lehtësojë:

- a) përcaktimin e vlerës së taksueshme, klasifikimin tarifor dhe origjinën e mallrave;
- b) zbatimin e dispozitave që lidhen me ndalimet, kufizimet dhe kontrollet.

Neni 7

Mbi bazën e kërkesës, Administrata që i bëhet kjo kërkesë furnizon informacion dhe inteligjencë mbi, si dhe drejton survejime për :

- a) personat e njohur nga administrata që bën kërkesë, si kryerës të shkeljeve doganore apo të dyshuar si të tillë, në veçanti, për ata persona që lëvizin për në dhe nga territori doganor i Palës Kontraktuese që i bëhet kërkesa;
- b) mallrat, në transport apo në ruajtje, që njoftohen nga administrata doganore kërkuese se ka arsye të dyshohet për trafik të jashtëligjshëm drejt territorit doganor të Palës Kontraktuese që bën kërkesën;
- c) mjetet e transportit për të cilat administratat që bën kërkesën dyshon se përdoren për të kryer shkelje doganore në territorin doganor të Palës tjetër Kontraktuese;
- d) ambientet që administrata doganore që bën kërkesën dyshon se përdoren për të kryer shkelje doganore në territorin doganor të Palës tjetër Kontraktuese.

Neni 8

1. Administratat Doganore do t'i sigurojnë njëra-tjetrës, me kërkesë ose me iniciativën e tyre personale, informacion dhe inteligjencë për transaksionet e kryera apo të planifikuara për t'u kryer, të cilat përbëjnë apo duket se përbëjnë shkelje doganore.
2. Në rastet serioze që përbëjnë dëmtime thelbësore për ekonominë, shëndetin publik, sigurinë publike apo ndonjë interes tjetër jetësor të njëjës nga Palët Kontraktuese, Administrata Doganore e Palës tjetër Kontraktuese, sipas mundësisë, jep informacion dhe inteligjencë me iniciativën e saj.

Neni 9

Administratat Doganore:

- a) do të ndihmojnë njëra-tjetrën në drejtim të ekzekutimit të masave tranzicionale dhe proceduriale, përfshi kapjen, ngrirjen ose dorëzimin e pasurive;
- b) do të asistojnë në lidhje me rregullimin e pasurive të

përfituara apo të instrumentalizuara, si rezultat i asistencës së parashikuar në këtë Marrëveshje në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe dispozitat administrative të Palës Kontraktuese mbi kontrollin e pasurive të përfituara apo të instrumentalizuara.

KAPITULLI V

Dokumentet dhe Inteligjencia

Neni 10

1. Dokumentet origjinale do të kërkohen vetëm në rastet kur kopjet e vërtetuara apo autentike do të jenë të pamjaftueshme dhe do të kthehen sapo të jetë e mundur më shpejt. Të drejtate administratës që bën kërkesën apo të palëve të treta që lidhen me këtë çështje nuk do të merren parasysh.
2. Çdo dokument apo informacion inteligjent që do të këmbëhet sipas kësaj Marrëveshjeje do të shoqërohet me informacion të plotë që lidhet me përdorimin apo mospërdorimin e tij.

KAPITULLI VI

Ekspertët dhe dëshmitarët

Neni 11

Sipas kërkesës së Palës Kontraktuese, Administrata Doganore e Palës tjetër Kontraktuese autorizon sa herë që është e mundur, nëpunësit e saj për të deponuar si dëshmitarë apo ekspertë në proceset gjyqësore apo procedimet administrative për shkeljet doganore që gjykohen në territorin e Palës tjetër

Kontraktuese, si dhe për të prodhuar fakte, udhëzues dhe dokumente të tjera, apo kopje të vërtetuara të këtyre të fundit, konform nevojës gjatë procedimeve të sipërpërmendura. Urdhri për paraqitje, në veçanti, përcakton çështjen gjyqësore, si dhe statusin me të cilin nëpunësi thirret të dëshmojë.

Administrata Doganore e Palës Kontraktuese, që pranon kërkesën, shënon në autorizimin që lëshon, në mënyrë specifike në qoftë se kërkohet, kufijtë brenda të cilëve mund të dëshmojnë agjentët e saj.

KAPITULLI VII

Komunikimi i kërkesës

Neni 12

1. Asistenca sipas kësaj Marrëveshjeje do të këmbëhet direkt ndërmjet Administratave Doganore.
2. Kërkesat për asistencë, sipas kësaj marrëveshjeje, bëhen me shkrim dhe shoqërohen nga çdo dokument që mendohet se është i nevojshëm. Kur rrethanat e imponojnë, mund të bëhet edhe kërkesë verbale. Në këtë rast këto kërkesa duhet të konfirmohen menjëherë me shkrim.
3. Kërkesat e bëra në bazë të paragrafit 2 të këtij neni, do të përmbajnë detajet që vijojnë:
 - a) Administratën që bën kërkesën;
 - b) objektin dhe arsyen pse bëhet kjo kërkesë;
 - c) emrat dhe adresat e palëve të përfshira me atë procedurë në qoftë se njihen.

4. Kërkesa nga secila Administratë Doganore, që lidhet menjë procedim të caktuar, do të përmbushet në përputhje dhe në respektim me legjislacionin kombëtar dhe procedurat administrative të Palës Kontraktuese që i bëhet kjo kërkesë.

5. Palë nga Administrata Doganore e Palës tjetër Kontraktuese në përputhje me paragrafin 2 të nenit 19 të kësaj Marrëveshjeje.

KAPITULLI VIII Ekzekutimi i kërkesës

Neni 13

1. Në qoftë se administrata, të cilës i paraqitet një kërkesë nuk i ka dokumentet ose informacionin që kërkohet, në përputhje me legjislacionin kombëtar të saj dhe procedurave administrative ose do të:

a) do të fillojë hetimin për të përftuar dokumentet në fjalë ;

ose

b) do t'ia transmetojë kërkesën agjencisë që mbulon atë fushë;

ose

c) do të njoftojë se cilat autoritete kanë lidhje me këtë çështje.

2. Çdo hetim i kryer sipas paragrafit 1 të këtij neni, mund të përfshijë marrjen e deklaratave (pohimeve) nga personat nga të cilët informacioni nxirret në lidhje me shkeljen doganore dhe nga dëshmitarët dhe ekspertët.

Neni 14

1. Në kërkesën me shkrim, nëpunësit e caktuar enkas nga administrata që e bën atë kërkesë, me autorizimin e administratës së cilës i drejtohet kërkesa dhe conform kushteve që mund të imponojë kjo e fundit, mundet që me qëllim hetimin e një shkeljeje doganore:

a) të konsultohen, në zyrat e administratës së cilës i drejtohet kërkesa, me dokumentet, regjistrat dhe të dhënat e tjera që u interesojnë për të nxjerrë ndonjë informacion në drejtim të shkeljes doganore;

b) të marrin kopje të dokumenteve, regjistrave dhe të dhënave të tjera që kanë lidhje me atë shkelje doganore;

c) të jenë të pranishëm gjatë hetimit që udhëhiqet nga administrata, të cilës i dërgohet kërkesa, në territorin doganor të palës kontraktuese që i bëhet kërkesë dhe që lidhet me administratën që bën kërkesën.

2. Kur nëpunësit e palës që bën kërkesën paraqiten, sipas rrethanave të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, në territorin e palës tjetër kontraktuese duhet që gjatë gjithë kohës të paraqesin prova të kapacitetit të tyre zyrtar.

3. Gjatë kohës që janë atje, ata duhet të gëzojnë të njëjtën mbrojtje me atë që ju garantohet nëpunësve doganorë të palës tjetër kontraktuese, në përputhje me ligjet në fuqi në atë vend dhe të jenë të përgjegjshëm për çdo shkelje që mund të bëjnë.

KAPITULLI IX

Përdorimi i informacionit dhe dokumentacionit si dhe mbrojtja e tyre

1. Informacioni, komunikimet dhe dokumentacioni i marrë në kuadrin e asistencës administrative, mund të përdoren në procedimet civile, penale dhe administrative konform

kushteve të përcaktuara nga legjislacioni respektiv i aplikueshëm në fuqi dhe vetëm për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje.

2. Një informacion, komunikim apo dokumentacion i tillë, mund t'i ekspozohet organeve qeveritare të ndryshme nga ato të përmendura në këtë marrëveshje, vetëm në qoftë se është dhënë leje e veçantë nga Administrata Doganore që e ka dhënë atë dhe me kusht që legjislacioni i brendshëm i Administratës Doganore marrëse nuk e ndalon atë lloj komunikimi.

3. Megjithatë, si pasojë e detyrimeve që i lindin Italisë si vend i BE, dispozitat që përmenden në paragrafet paraardhës nuk ndalojnë që informacioni, komunikimi dhe dokumentet e marra, në qoftë se kërkohen, të mund t'i kalohen Komisionit Europian dhe shteteve të tjera anëtare të BE-së.

4. Informacioni, komunikimi dhe dokumentet në dispozicion të Administratës Doganore të Palës Kontraktuese kërkuese, do të gëzojnë në zbatim të kësaj marrëveshjeje, të njëjtën mbrojtje që sigurohet nga ligjet kombëtare të palës kontraktuese të lartpërmendur për dokumentacionin dhe informacionin e së njëjtës natyrë.

Neni 16

Kur sipas kësaj marrëveshjeje këmbehen të dhëna personale, palët kontraktuese duhet të sigurojnë një standard për mbrojtjen e të dhënave të paktën të njehsueshme me atë që rezulton nga zbatimi i parimeve të caktuara në aneksin e kësaj marrëveshjeje, i cili është pjesë integrale e marrëveshjes.

KAPITULLI X Përfundimet

Neni 17

1. Në rastet kur asistenca sipas kësaj Marrëveshjeje bie në kundërshtim me sovranitetin, sigurimin, politikën publike ose interesa të tjera themelore të palës kontraktuese, apo mund të përbëjë një shkelje të sekretit industrial, tregtar ose profesional, apo të mos përputhet me dispozitat ligjore kombëtare dhe administrative të asaj pale, asistenca mund të refuzohet.

2. Në qoftë se administrata që bën kërkesë nuk do të ishte në gjendje t'i përgjigjej kërkesës së të njëjtit karakter të bërë nga pala, të cilës i paraqitet kërkesa, e para duhet të tërheqë vëmendjen për një fakt të tillë në kërkesën e saj. Përmbushja e një kërkesë të këtij lloji është në dëshirën e administratës që i drejtohet një kërkesë e tillë.

3. Asistenca mund të shtyhet nga administrata të cilës i kërkohet ajo, në kushtet që dhënia e saj do të interferonte menjë investigim në proces, procedurë apo gjykim. Në një rast të tillë, administrata së cilës i drejtohet kërkesa për asistencë konsultohet me administratën që bën kërkesë për të përcaktuar nëse asistenca në fjalë mund të jepet apo jo në kushtet apo afatin që kërkon administrata kërkuese.

4. Në rastet kur dhënia e asistencës mohohet apo shtyhet duhet të jepen edhe arsye për shtyrjen ose refuzimin e saj.

KAPITULLI XI

Shpenzimet

Neni 18

1. Administratat Doganore nuk do të pranojnë asnjë pretendim për shlyerje të shpenzimeve që lidhen me ekzekutimin e kësaj marrëveshjeje, përjashto shpenzimet dhe dietat e paguara për ekspertët dhe dëshmitarët, si dhe shpenzimet për përkthim e interpretim, për personat që nuk janë nëpunës shtetërorë, të cilët do të përballohen nga pala që bën kërkesën.
2. Në qoftë se për ekzekutimin e një kërkesë kërkohen shpenzime të rëndësishme dhe të natyrës së jashtëzakonshme, Palët kontraktuese konsultohen për të përcaktuar kushtet dhe afatet sipas së cilave do të përmbushet kërkesa si dhe mënyrën se si do të përballohen shpenzimet.

KAPITULLI XII

Zbatimi i Marrëveshjes

Neni 19

1. Administratat Doganore do të marrin masa me qëllim që nëpunësit e tyre përgjegjës për hetimin apo luftën kundër shkeljeve doganore të kenë lidhje direkte dhe personale me njëri-tjetrin.
2. Administrata Doganore vendos mbi rregullimet e detajuara që lidhen me vënien në zbatim të kësaj marrëveshjeje.
3. Do të krijohet një Komision i Përbashkët Italo-Shqiptar, në përbërje të të cilit do të jenë drejtorët e përgjithshëm të Doganave të të dy shteteve kontraktuese ose përfaqësuesit e tyre, i asistuar edhe nga ekspertë, që do të takohet sa here që ta paraqesë nevoja, me kërkesën e njërit nga administratat, me qëllim që të realizohet mbikqyrja e zhvillimeve sipas kësaj marrëveshjeje, si dhe të gjenden zgjidhjet e duhura për problemet që mund të dalin.
4. Konfliktet për të cilat nuk do të gjendet zgjidhje miqësore do të fiksohen me anë të kanaleve diplomatike.

KAPITULLI XIII

Aplikimi

Kjo Marrëveshje do të zbatohet brenda territoreve doganore të të dy palëve kontraktuese, në përputhje me dispozitat ligjore dhe administrative kombëtare respektive.

KAPITULLI XIV

Hyrja në fuqi dhe përfundimi

Neni 21

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën e parë të muajit të dytë nga dita e marrjes së njoftimit të dytë, prej dy njoftimeve, me të cilat palët kontraktuese njoftojnë zyrtarisht njëra-tjetrën se janë përmbushur kërkesat e brendshme respektive për ratifikim të kësaj marrëveshjeje. Neni 22

Kjo Marrëveshje është menduar të jetë e pakufizuar në kohë, por secila nga palët kontraktuese mund ta përfundojë në çdo kohë atë me anë të kanaleve diplomatike. Përfundimi hyn në fuqi pas tre muajve që i njoftohet palës tjetër kontraktuese.

Neni 23

Palët Kontraktuese do të takohen me qëllim revizionimin/rishikimin e kësaj Marrëveshjeje mbi bazë të kërkesës, ose në fund të 5 vjetëve nga data e hyrjes së Marrëveshjes në fuqi, në qoftë se nuk njoftojnë nëra-tjetrën me shkrim se një rishikim i tillë është i panevojshëm. Dëshmitarë përsa më sipër, përfaqësuesit e autorizuar sipas rregullave nga qeveritë përkatëse nënshkruajnë këtë Marrëveshje.

Bërë në Tiranë, më 12 mars 1998, në dy origjinale, secila në gjuhët shqip, italisht dhe anglisht, ku të gjitha tekstet janë njëloj autentike. Në rast divergjence për shkak të përkthimit do të mbizotërojë teksti në anglisht.

PËR QEVERINË E REPUBLIKES SE SHQIPERISE

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË ITALISË

ANEKS

PARIMET BAZË PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE¹. Të dhëna personale që i nënshtrohen përpunimit automatik do të jenë ato që:

- a) merren dhe procedohen me ndershmëri dhe në mënyrë ligjore;
- b) ruhen për qëllime të caktuara dhe të ligjshme dhe nuk përdoren në ndonjë mënyrë që nuk përputhet me këtë qëllim;
- c) janë adekuate, me lidhje dhe jo ekstreme me qëllimet për të cilat janë ruajtur,
- d) janë të sakta dhe, kur është e nevojshme, të rinovuara;
- e) ruhen në formën që lejon identifikimin e të dhënave me kusht por jo më gjatë se sa kërkohet për qëllimet për të cilat ruhen ato të dhëna.

2. Të dhënat personale që zbulojnë origjinën racore, opinionet politike apo fetare ose besime të ndryshme, si dhe të dhënat personale që lidhen me shëndetin apo jetën seksuale, mund të përpunohen në mënyrë automatike në qoftë se ligjet e brendshme nuk garantojnë sigurinë e duhur. E njëjta gjë aplikohet edhe për të dhënat personale që i referohen bindjeve kriminale.

3. Duhet të merren masat e duhura të sigurimit për mbrojtjen e të dhënave personale të ruajtura në skedarët e kompjuterizuar të të dhënave, përkundërt ndonjë shkatërrimi të paautorizuar apo humbje aksidentale, si dhe kundër futjes së paautorizuar tek ato, ndryshimit apo publikimit të tyre.

4. Çdo person duhet të jetë i aftë të:

- a) ketë/krijojë një skedar të kompjuterizuar të të dhënave personale, qëllimet kryesore që ka ky skedar, si dhe identitetin dhe vendqëndrimin e rregullt apo vendndodhjen kryesore të kontrolluesit të këtij skedari;
- b) të përftojë në intervale të arsyeshme dhe vonesë të panevojshme apo shpenzime, konfirmimin se nëse të dhënat personale që lidhen me atë janë ruajtur në skedarët e kompjuterizuar të të dhënave dhe se këto të dhëna i komunikohen atij në një formë të lexuesme;
- c) të përftojë, sipas rastit, korrigjimin apo fshirjen e të dhënave të tilla në qoftë se ato janë përpunuar në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit të brendshëm që bëjnë fjalë për parimet bazë të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij Aneksi.

5.1. Nuk lejohet përjashtim nga pikat 1, 2 dhe 4 të këtij Aneksi, me përjashtim brenda kufijve të përcaktuara në këtë pikë.

5.2. Shmangia nga dispozitat e pikave 1, 2 dhe 4 të këtij Aneksi lejohet vetëm atëherë kur një shmangie e tillë parashikohet me ligj të Palës Kontraktuese dhe përbën një masë të domosdoshme për një shoqëri demokratike dhe është në interes të :

- a) mbrojtjes së sigurisë shtetërore, qetësisë publike, interesave monetare të shtetit ose dënimit e shkeljeve kriminale;
- b) mbrojtjen e të dhënave që kufizohen nga e drejta dhe liria e të tjerëve;

5.3. Kufizimi për ushtrimin e të drejtave të përcaktuara në pikën 4, paragrafet b), c) dhe d) të këtij Aneksi mund të sigurohen me ligj në rastin e skedarëve të kompjuterizuar të të dhënave statistikore apo të dhënave për kërkime shkencore kur aty nuk ka asnjë rrezik të dukshëm për abuzim me problemin e të dhënave.

6. Secila nga Palët Kontraktuese merr përsipër të aplikojë sanksione dhe zgj idhje në rastin e shkeljes të dispozitave të legjislacionit të brendshëm që lidhet me parimet bazë të këtij Aneksi.

7. Asnjë nga dispozitat e këtij Aneksi nuk do të interpretohet si me veprim të kufizuar apo ndryshe, të ndikojë në mundësinë që një Palë Kontraktuese të japë të dhëna me kusht që të gëzojnë një gamë mbrojtjeje më të gjerë se sa ajo që përcaktohet në këtë Aneks.



VENDIM

Nr. 744, date 6.11.2003

**PER MIRATIMIN E MARREVESHJES NDERMJET QEVERISE SE REPUBLIKES
TE SHQIPERISE DHE QEVERISE SE REPUBLIKES TE BULLGARISE PER
ASISTENCEN E NDERSJELLE ADMINISTRATIVE NE ÇESHTJET DOGANORE**

Ne mbeshtetje te nenit 100 te Kushtetutes dhe te neneve 5 e 7 te ligjit nr.8371, date 9.7.1998
"Per lidhjen e traktateve dhe marreveshjeve nderkombetare", me propozimin e Ministrit te
Puneve te Jashtme, Keshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e Marreveshjes ndermjet Qeverise se Republikes te
Shqiperise dhe Qeverise se
Republikes te Bullgarise per asistencen e ndersjelle administrative ne ceshtjet doganore.
Ky vendim hyn ne fuqi pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI Fatos Nano

**MARREVESHJE NDERMJET QEVERISE SE REPUBLIKES TE SHQIPERISE DHE
QEVERISE SE REPUBLIKES TE BULLGARISE MBI ASISTENCEN E
NDERSJELLE ADMINISTRATIVE NE ÇESHTJET DOGANORE**

Qeveria e Republikes se Shqiperise dhe Qeveria e Republikes se Bullgarise, qe ne vijim do
te referohen si Pale Kontraktuese:

duke marre ne konsiderate rendesine e vleresimit te sakte te detyrimeve doganore dhe taksave
te tjera dhe per te siguruar zbatimin e duhur nga administratat doganore te masave specifike te
ndalimit, kufizimit dhe kontrollit;

duke marre ne konsiderate qe shkeljet e ligjit doganor jane te demshme per interesat e tyre
ekonomike, tregtare, fiskale, shoqerore, shendetesore dhe kulturore;

duke njohur nevojën për bashkepunim nderkombetar ne ceshtjet qe lidhen me zbatimin e
ligjeve te tyre doganore te bindur se veprimet e ndermarra kunder shkeljeve doganore mund
te jene me efektive ndermjet bashkepunimit te ngushte midis administratave doganore, bazuar
ne dispozitat ligjore per te cilat eshte rene dakord nga te dyja Palet;

duke marre parasysh rekomandimin mbi asistencen e ndersjelle administrative dhe deklaraten
per permiresimin e bashkepunimit doganor dhe asistencen e ndersjelle administrative
(Deklarata e Qipros), adoptuar respektivisht ne dhjetor te vitit 1953 dhe korrik te vitit 2000,
nga Keshilli i Bashkepunimit Doganor, tashme i njohur si Organizata Boterore e Doganave;

duke marre parasysh konventat nderkombetare per ndalimin, kufizimin dhe masat specifike te
kontrollit ne lidhje me mallrat specifike;

duke marre, gjithashtu, parasysh Deklaraten Universale te Kombeve te Bashkuara per te
Drejtat e Njeriut te vitit 1948, rane dakord per sa me poshte vijon:

KAPITULLI I PERKUFIZIME

Neni 1

Per qellimet e kesaj Marreveshjeje:

a) "Administrata Doganore" do te nenkuptoje:

Per Republikën e Shqipërisë: Drejtoria e Pergjithshme e Doganave e Ministrise se Financave.

Per Republikën e Bullgarisë: Agjencia Kombetare e Doganore prane Ministrise se Financave.

b) "Legjislacion doganor" do te nenkuptoje cdo dispozite ligjore ose administrative te zbatueshme nga secila administrata doganore ne lidhje me importin, eksportin, transportimin, trazitin, depozitimin dhe levizjen e mallrave, perfshire dispozitat ligjore dhe administrative qe lidhen me masat e ndalimit, kufizimit dhe kontrollit.

c) "Shkelje doganore" do te nenkuptoje cdo shkelje te mbetur ne tentative te legjislacionit doganor.

d) "Informacion" do te nenkuptoje cdo te dhene, te perpunuar e analizuar ase jo, dhe dokumentet, raportet, si dhe komunikime te tjera ne cdo lloj formati, perfshire elektronik ose kopje te certifikuara ose te autentifikuara te tyre.

e) "Zyrtar" do te nenkuptoje cdo zyrtar doganor ose agjente te tjere qeveritare, te caktuar nga secila administrata doganore.

f) "Person" do te nenkuptoje persona si legale, ashtu edhe fizike, me perjashtime te rasteve kur konteksti e kerkon ndryshe.

g) "Te dhena personale" do te nenkuptoje cdo te dhene te nje personi fizik, te identifikuar ose te identifikueshem.

h) "Administrata e kerkuar" do te nenkuptoje administraten doganore prej se ciles kerkohet asistence.

j) "Administrata kerkuese" do te nenkuptoje administraten doganore, e cila kerkon asistence"

k) "Pala Kontraktuese e kerkuar" do te nenkuptoje Palen Kontraktuese, administrates doganore te se ciles i kerkohet te jape asistence.

l) "Pala Kontraktuese kerkuese" do te nenkuptoje Palen Kontraktuese, administrata doganore

FUSHEMBULIMI I MARREVESHJES

Neni 2

1. Palet Kontraktuese do te sigurojne per njera-tjetren, permes administratave te tyre doganore, asistence administrative sipas kushteve te percaktuara ne kete Marreveshje, me qellim zbatimin e sakte te legjislacionit doganor, si dhe per te parandaluar, hetuar dhe luftuar shkeljet doganore.

2. E gjithë asistencë sipas kesaj Marreveshjeje do te sigurohet nga Palet Kontraktuese, ne perputhje me dispozitat e tyre kombetare ligjore dhe administrative, si dhe brenda kufijve te kompetencave dhe burimeve ne dispozicion te administratave te tyre doganore.

3. Kjo Marreveshje mbulon asistencen e ndersjelle administrative midis Paleve Kontraktuese dhe nuk ka per qellim te ndikojë ne marreveshjet ligjore te asistences dypaleshe midis tyre. Ne rast se asistencë dypaleshe do te sigurohet nga autoritete te tjera te Paleve Kontraktuese te kerkuara, administrata e kerkuar do te tregojë keto autoritete dhe, ne rast se eshte ne dijeni, marreveshjet dhe rregunimet perkatese te zbatueshme.

4. Dispozitat e kesaj Marreveshjeje nuk i japin te drejte asnje personi te pengoje ekzekutimin e nje kerkese.

KAPITULLI III

FUSHA E ZBATIMIT TE ASISTENCES

Neni 3

Informacion per zbatimin e legjislacionit doganor

1. Administratat doganore do t'i japin njera-tjetres, sipas kerkeses ose me iniciative, informacion i cili do te ndihmoje per te siguruar zbatimin e sakte te legjislacionit doganor, si dhe ne parandalimin, hetimin dhe luften ndaj shkeljeve doganore. Ky informacion mund tem perfshije:

a) teknika te reja te zbatimit te legjislacionit doganor, te cilet kane provuar efikasitetin e tyre;
b) tendenca, menyra ose metoda te kryerjes se shkeljeve doganore;
c) mallra qe njihen si objekt i shkeljeve doganore, si dhe metodat e transportit dhe depozitimit qe perdoren ne lidhje me keto mallra.

2. Asistenca e siguruar sipas kesaj Marreveshjeje, sipas kerkeses, do te perfshije dhenien e informacionit per te siguruar percaktimin e sakte te vleres doganore.

3. Secila administrate doganore, ne kryerjen e hetimeve ne territorin perkates kombetar per administraten tjetere doganore, do te perdore te gjitha mjetet ne dispozicion per te.

TIPE TE VEÇANTA ASISTENCE

Neni 4

Informacion lidhur me shkeljet doganore

1. Administratat doganore do t'i sigurojne njera-tjetres, sipas kerkeses ose me iniciative, informacion mbi aktivitetet e planifikuara ne vazhdimesi ose te perfunduara, te cilat perbejne ose mund te perbejne nje shkelje doganore.

2. Ne rastet kur ekonomia, shendeti publik, siguria publike ose çdo interes tjetere jetesor i njeres Pale Kontraktuese mund te kete nje dem te konsiderueshem, administrata doganore e Pales tjetere Kontraktuese do ta jape pa vonese ate informacion me iniciativen e saj, atehere kur eshte e mundur.

Neni 5

Tipe te veçanta informacioni

1. Administrata e kerkuar do te siguroje, sipas kerkeses, per administraten kerkueseinformacion qe lidhet me:

a) faktin nese mallrat e importuara ne territorin e Pales Kontraktuese kerkuese jane eksportuar ne menyre te ligjshme nga territori i Pales Kontraktuese te kerkuar;

b) faktin nese mallrat e eksportuara nga territori i Pales Kontraktuese kerkuese jane importuar ne menyre te ligjshme ne territorin e Pales Kontraktuese te kerkuar dhe regjimin doganor, nese ka, nen te cilin jane vendosur mallrat.

2. Administrata e kerkuar do te siguroje, sipas kerkeses, peradministraten kerkuese informacion lidhur me rastet kur kjo e fundit ka arsye per te dyshuar ne informacionin e dhene nga personi i interesuar ne ceshtjet doganore.

Neni 6
Njoftimi

Administrata e kerkuar do te njoftoje, sipas kerkeses, nje person, resident ose te vendosur ne territorin e Pales Kontraktuese se kerkuar, per cdo vendim zyrtar te administrates kerkuese qe ka te beje me ate person, ne zbatim te legjislacionit doganor.

Neni 7
Mbikeqyrja dhe informacioni

Administrata e kerkuar sipas kerkeses, do te mbaje nen mbikeqyrje dhe do te informoje per:

- a) mallra te transportuara ose magazinuara, te cilat dihet se jane perdorur ose ka dyshim se jane perdorur per shkelje doganore ne territorin e Pales Kontraktuese kerkuese;
- b) mjete transporti, te cilat dihet se jane perdorur ose ka dyshim se jane perdorur per te kryer shkelje doganore ne territorin e Pales Kontraktuese kerkuese;
- c) ambiente, te cilat dihet se jane perdorur ose ka dyshim se jane perdorur per te kryer shkelje doganore ne territorin e Pales Kontraktuese kerkuese;
- d) persona, per te cilet ka dijeni ose ekziston dyshimi te kene kryer shkelje doganore ne territorin e Pales Kontraktuese kerkuese, vecanerisht per ata persona qe hyjne e dalin ne territorin e Pales Kontraktuese te kerkuar.

Neni 8
Shperndarja e kontrolluar

Palet Kontraktuese mund te lejojne, me nje marreveshje dypaleshe, levizjen e mallrave te jashteligjshme ose te dyshimta jashte, permes ose brenda territorit te tyre, me dijenine ose nen kontrollin e autoriteteve kompetente, me qellim hetimin dhe luften ndaj shkeljeve doganore. Ne rast se dhenia e nje lejeje te tille nuk eshte kompetence e administrates doganore. kjo administrate do te perpiqet te bashkepunoje me autoritetet kombetare, te cilat e gezojne kete kompetence ose do t'ia kaloje kete rast ketyre autoriteteve.

Neni 9

Dispozitat e nenit 7 dhe nenit 8 do te zbatohen gjithashtu per drogat narkotike, substancat psikotrope dhe prekursoret, te percaktuar respektivisht ne Konventen e vetme per drogat narkotike (1961), Konventen per substancat psikotropike (1971) dhe Konventen e Kombeve te Bashkuara kunder trafikut te paligjshem te drogave narkotike dhe substancave psikotropike (1988).

KAPITULLI V INFORMACIONI

Neni 10

1. Informacioni origjinal do te kerkohet vetem ne rastet kur kopjet do te jene te pamjaftueshme dhe do te rikthehen ne rastin me te pare. Te drejtat e administrates se kerkuar ose te paleve te treta qe kane lidhje me kete do te mbeten te paprekura.

2. Çdo informacion qe do te shkembet ne kuadrin e kesaj Marreveshjeje do te shoqerohet nga te gjitha informacionet perkatese per interpretimin dhe perdorimin e tyre.

KAPITULLI VI EKSPERTET DHE DESHMITARET

Neni 11

Administrata e kerkuar mund te autorizojë, sipas kerkeses, zyrtaret e saj te paraqiten perpara nje gjykate ne territorin e Pales tjetër Kontraktuese si eksperte ose deshmitare per ceshtjet e shkeljeve doganore.

KAPITULLI VII KOMUNIKIMI I KERKESAVE

Neni 12

1. Kerkesat per asistence, sipas kesaj Marreveshjeje, do t'i adresohen drejtperdrejt administrates doganore te Pales tjetër Kontraktuese. Kerkesat do te behen me shkrim ose elektronikisht dhe do te shoqerohen me cdo informacion qe vleresohet si i dobishem dhe qe perputhet me kerkesen. Administrata e kerkuar mund te kerkoje konfirmim me shkrim te kerkesave elektronike. Kur ta kerkojne rrethanat, kerkesat mund te behen gojarisht. Nje kerkese e tille do te konfirmohet me shkrim sa me shpejt te jete e mundur.

2. Kerkesat e bera sipas paragrafit 1 te ketij neni do te perfshijne detajet e meposhtme:

a) emrin e administrates kerkuese;

b) ceshtjen doganore per te cilen behet fjale, tipin e asistences se kerkuar dhe arsyen per kerkesen;

c) nje pershkrim te shkurter te rastit qe po rishikohet dhe elementet e tij ligjore dhe administrative;

d) emrat dhe adresat e personave me te cilet lidhet kerkesa, ne rast se dihen.

3. Kur administrata kerkuese kerkon te ndiqet nje procedure ose metodologji e caktuar, administrata e kerkuar do te bjere dakord me kete kerkese, kushtezuar nga dispozitat e saj kombetare, ligjore dhe administrative.

4. Informacioni te cilit i referohet kjo Marreveshje do t'i

komunikohet zyrtareve qe jane percaktuar, vecanerisht, per kete qellim nga secila administrate doganore. Nje liste e ketyre zyrtareve do t'i jepet administrates doganore te Pales tjetër Kontraktuese, ne perputhje me nenin 21 te kesaj Marreveshjeje.

1. Kerkesat qe do te paraqiten ne kuadrin e Marreveshjes do te behen me shkrim. Dokumente te nevojshme per ekzekutimin e kesaj kerkese do te shoqerojne kerkesen. Kur te kerkohet, per shkak te situatave urgjente kerkesat e bera gojarisht do te pranohen, por do te konfirmohen menjehere me shkrim.
2. Kerkesat sipas paragrafit 1 te ketij neni do te permbajne informacionin e meposhtem:
 - a) autoritetin qe ben kerkesen;
 - b) natyren e procedimit;
 - c) objektin dhe arsyet per te cilat behet kerkesa;
 - d) emrat dhe adresat e paleve te perfshira ne kerkese, nese dihen;
 - e) nje pershkrim te shkurter te problemit per te cilin behet kerkesa dhe elementet ligjore qe jane perfshire ne te;
 - f) lidhjen midis asistencen se kerkuar dhe problemeve me te cilat lidhet.
3. Kerkesat do te paraqiten ne gjuhen zyrtare te Pales Kontraktuese te kerkuar, ne anglisht ose ne gjuhe te tjera te pranueshme nga te dyja Palet Kontraktuese.
4. Asistenca do te kryhet nepermjet komunikimit te drejtperdrejte ndermjet Autoriteteve Doganore perkatese.
5. Ne rast se autoriteti doganor i kerkuar nuk eshte struktura e duhur per te permbushur kerkesen, ai, pas konsultimeve te duhura, ose do t'ia transmetoje menjehere kerkesen strukturese se duhur, e cila do te veproje me kerkesen ne perputhje me kompetencat e saj sipas

ligjit, ose do te keshilloje autoritetin doganor kerkues per proceduren e duhur qe duhet te ndjeke ne lidhje me kete kerkese.

Neni 13

Perjashtimet nga dhenia e asistences

1. Ne rastet kur Pala Kontraktuese e kerkuar eshte e mendimit se permbushja e kerkeses do te shkelte sovranitetin, sigurine, politikat publike te tij ose interesa te tjera thelbesore kombetare, asistenca mund te refuzohet ose mund te jepet e kushtezuar nga permbushja e disa kushteve ose kerkesave te caktuara.
2. Ne rast se asistenca nuk mund te permbushet, administrate doganore kerkuese do te njoftohet menjehere per kete fakt, si dhe do t'i paraqiten arsyet.
3. Kur autoriteti doganor kerkues kerkon asistencë, te cilen ai vete nuk do te ishte ne gjendje ta ofronte ne rast se do t'i kerkohej, ai do ta paraqese kete fakt ne kerkese. Do te jete autoriteti doganor i kerkuar ai qe do te vendose se si do t'i pergjigjet kesaj kerkese.
4. Asistenca mund te shtyhet nga autoriteti doganor i kerkuar per arsye se mund te nderhyje ne hetimet, ndjekjet penale ose procedimet qe jane duke u kryer. Ne raste te tilla, ajo do te konsultohet me autoritetin doganor kerkues per te percaktuar nese asistenca mund te jepet ne haze te kushteve dhe termave qe do te kerkoje autoriteti doganor kerkues.

Neni 14

Konfidencialiteti

1. Informacionet, si dhe komunikimet e tjera te marra gjate asistences se ndersjelle mund te perdoren vetem per qellimet e specifikuara ne kete Marreveshje, perfshire perdorimin ne procedimet ligjore ose administrative.
2. Çdo informacion ose komunikime te tjera te marra nga Autoritetet Doganore te seciles Pale Kontraktuese, ne kuader te kesaj Marreveshjeje, do te trajtohen si konfidenciale dhe nuk do t'i komunikohen asnje personi ose strukture, me perjashtim te rasteve te parashikuara ne kete Marreveshje.
3. Keto informacione dhe komunikime do te gezojne cdo lloj mbrojtjeje, ne lidhje me konfidencialitetin dhe sekretin e tyre, qe parashikohet ne shtetin e Pales Kontraktuese, Autoriteti Doganor i se ciles i ka marre ato.
4. Dispozitat e paragrafit 2 te ketij neni nuk do te gjejne zbatim per rastet qe kane te bejne me shkeljet lidhur me lendet narkotike dhe substancat psikotrope. Ky informacion mund t'u komunikohet autoriteteve te tjera te Pales Kontraktuese kerkuese, te perfshira drejtperdrejt ne luften kunder trafikut te paligjshem te lendeve narkotike dhe substancave psikotrope.
5. Autoriteti doganor kerkues nuk do t'i perdore provat ose informacionet e marra ne kuader te kesaj Marreveshjeje per qellime te ndryshme nga ato te permendura ne kerkese pa miratimin paraprak te autoritetit doganor te kerkuar.

Neni 15

Ekzekutimi i kerkeses

1. Autoriteti doganor i kerkuar do te marre te gjitha masat per te ekzekutuar kerkesen dhe, nese eshte e nevojshme, do te perpiqet te marre cdo mase zyrtare ose ligjore te nevojshme per kryerjen e kerkeses.

2. Nëse autoriteti doganor i kërkuar nuk e disponon informacionin e kërkuar, ai do të perpiqet ta marrë atë informacion si të ishte duke vepruar për llogari të tij ose për llogari të autoritetit doganor kerkues.
3. Autoritetet Doganore të Paleve Kontraktuese do të kryejnë, me kërkesë të Autoritetit Doganor të njëres prej Paleve Kontraktuese, çdo hetim të nevojshëm, përfshirë marrjen në pyetje të specialistëve, dëshmitarëve ose personave të dyshuar se kanë kryer shkelje doganore, si dhe do të kryejnë verifikime, inspektime dhe hetime për mbledhjen e fakteve në lidhje me çështjet të cilave iu referohet kjo Marrëveshje.
4. Sipas kërkesës, autoriteti doganor i kërkuar mund të lejojë, në maksimumin e mundshëm, zyrtarët e autoritetit doganor kerkues të jenë të pranishëm në territorin e shtetit të Paleve Kontraktuese të kërkuar, kur zyrtarët e kesaj të fundit hetojnë shkelje doganore, të cilat përbejnë shqetësim për autoritetin doganor kerkues.
5. Autoriteti doganor kerkues do të keshillohet, nëse kerkohet, për orën dhe vendin e veprimeve që do të ndermerren në përgjigje të kërkesës, në mënyrë që veprimet të koordinohen.
6. Zyrtarët e autoritetit doganor kerkues, të autorizuar për të hetuar shkeljet doganore, mund të kërkojnë që autoriteti doganor i kërkuar të kontrollojë çdo informacion të nevojshëm, përfshirë libra, regjistra dhe dokumente të tjera ose të dhëna mediatike dhe të paraqesë kopjet e tyre, ose të japë informacion lidhur me ato shkelje doganore.

Neni 16

Perdorimi i informacionit të marrë

1. Autoritetet Doganore mund të përdorin, si prova, informacionin dhe dokumentet e marra në përputhje me dispozitat e kesaj Marrëveshjeje, në procesverbalet e procedimeve, në komunikimet e tyre dhe në depozitimet e dëshmitarëve në rastet e hetimeve, debateve administrative dhe ligjore që lidhen me çështjet doganore.
2. Cilesimi i këtyre dokumenteve dhe informacioneve, si dhe mënyra e përdorimit të tyre gjatë debateve ligjore ose administrative përcaktohet nga legjislacioni i Paleve Kontraktuese kerkuese.

Neni 17

Shpenzimet

1. Autoritetet Doganore të Paleve Kontraktuese normalisht do të heqin dorë nga të gjitha pretendimet për rimbursimin e shpenzimeve si pasojë e ekzekutimit të kesaj Marrëveshjeje, me përjashtim të shpenzimeve për dëshmitarët, dietave të specialistëve, si dhe për shpenzimet e perkthyesve të cilet nuk janë nepunës qeveritare.
2. Në rast se ka ose kerkohen shpenzime të një natyre të konsiderueshme ose të jashtëzakonshme në mënyrë që kërkesa të ekzekutohet, Autoritetet Doganore të Paleve Kontraktuese do të konsultohen për të përcaktuar termat dhe kushtet sipas të cilave do të ekzekutohet kërkesa, si dhe për mënyrën me të cilën do të përballohen shpenzimet.

Neni 18

Zbatimi i Marreveshjes

Autoritetet Doganore do të jenë përgjegjëse për zbatimin e kësaj Marreveshjeje. Ato, inter alia:

- a) do të komunikojnë drejtperdrejt për qëllime që lidhen me eshtë që dalin si rezultat i kësaj Marreveshjeje;
- b) pas konsultimeve, nëse është e nevojshme, do të nxjerrin direktiva administrative ose bien dakord për procedurat mbi vendin në zbatim të kësaj Marreveshjeje;
- c) do të përpqen përmes një marreveshjeje të përbashkët për të zgjidhur çdo problem ose dyshim që lind nga zbatimi i kësaj Marreveshjeje ose çdo çështje tjetër doganore e cila mund të lindë ndërmjet tyre;
- d) do të vendosin kontakt të drejtperdrejtë ndërmjet shërbimeve të tyre të informacionit.

Neni 19

Zbatueshmeria territoriale

Kjo Marreveshje do të zbatohet në territoret doganore të shteteve të të dyja Paleve Kontraktuese.

Neni 20

Hyrja në fuqi dhe përfundimi

1. Palet Kontraktuese do të njoftojnë njëra-tjetren përmes shkëmbimit të notave diplomatike kur të jenë përbushur të gjitha kërkesat ligjore kombëtare për hyrjen në fuqi të kësaj Marreveshjeje. Kjo Marreveshje do të hyjë në fuqi ditën e tridhjetë pasi të jetë marrë njoftimi i fundit.
2. Autoritetet Doganore të Paleve Kontraktuese bien dakord të takohen me synim rishikimin e kësaj Marreveshjeje ose për të diskutuar mbi çdo çështje tjetër doganore që mund të lindë nga marrëdhënia midis tyre, me kërkesë të njerit Autoritet Doganor ose në fund të një periudhe pësevjeçare nga data e hyrjes në fuqi të Marreveshjes, me përjashtim të rastit kur ato njoftojnë njëra-tjetren me shkrim se një rishikim i tillë nuk është i nevojshëm.
3. Kjo Marreveshje është parashikuar të jetë e një kohezgjatjeje të pakufizuar.
4. Kjo Marreveshje mund të përfundojë nga secila prej Paleve Kontraktuese:
 - a) me marrjen nga njëra Pale Kontraktuese të një njoftimi me shkrim përmes kanaleve diplomatike;
 - b) në një rast të tillë, Marreveshja do të përfundojë se çëni në fuqi gjashtë muaj pasi të jetë marrë ky njoftim.Në dëshmi të kësaj nënshkruesit, të autorizuar përkatesisht nga qeveritë e tyre përkatese, nënshkruan këtë Marreveshje.

Nënshkruar në Chisinau, më datë 11 qershor në dy kopje origjinale, në shqip, moldavisht dhe anglisht, ku të gjitha tekstet janë njelloj autentike. Në rast të mosmarreveshjeve në interpretim, teksti në anglisht do të merret për bazë.



VENDIM
Nr .10, date 14.1.2004

**PER MIRATIMIN E MARREVESHJES NDERMJET QEVERISE SE REPUBLIKES
TE SHQIPERISE DHE QEVERISE SE REPUBLIKES TE POLONISE PER
BASHKEPUNIM DHE ASISTENCE TE NDERSJELLE NE ÇESHTJET DOGANORE**

Ne mbeshtetje te nenit 100 te Kushtetutes dhe te nenit 17 dhe 23 te ligjit nr.8371, date 9.7.1998 "Per lidhjen e traktateve dhe marreveshjeve nderkombetare", me propozimin e Ministrit te Puneve te Jashtme, Keshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e Marreveshjes ndermjet Qeverise se Republikes te Shqiperise dhe Qeverise se Republikes te Polonise per bashkepunim dhe asistence te ndersjelle ne Çeshtjet doganore. Ky vendim hyn ne fuqi pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

MARREVESHJE

**NDERMJET QEVERISE SE REPUBLIKES TE SHQIPERISE DHE QEVERISE SE
REPUBLIKES TE POLONISE, PER BASHKEPUNIM DHE ASISTENCE TE
NDERSJELLE NE CESHTJET DOGANORE**

Qeveria e Republikes se Shqiperise dhe Qeveria e Republikes se Polonise, ketej e tutje referuar si "Pale Kontraktuese", duke deshiruar te zhvillojne bashkepunimin ne ceshtjet doganore dhe duke njohur rendesine e asistences se ndersjelle ndermjet autoriteteve doganore;

duke konsideruar se shkeljet e legjislacionit doganor jane te demshme per interesat sociale, ekonomike dhe tregtare te vendeve te tyre;

duke konsideruar se trafiku i paligjshem i lendeve narkotik dhe substancave psikotrope shkakton demtim te interesave sociale te eksportimit te tyre;

duke konsideruar rendesine e sigurimit te percaktimit te sakte te detyrimeve doganore dhe detyrimeve te tjera te grumbulluara gjate importimit apo eksportimit te mallrave dhe zbatimin e sakte te dispozitave te ligjit doganor mbi ndalimet, kufizimet dhe kontrollin;

duke marre ne konsiderate rekomandimet e Keshillit te kooperimit doganor mbi asistencen e ndersjelle administrative te 5 dhjetorit 1953,

rane dakord per sa me poshte vijon:

Neni 1 Percaktime

Termat e meposhtem te perdorur ne Marreveshje shpjegohen si:

1. "Ligje doganore"- dispozitat ligjore ne fuqi ne territoret e Republikes se Shqiperise dhe

Republikes se Polonise ne lidhje me importimin, eksportimin dhe transitimin e mallrave, si dhe detyrimet doganore dhe taksat e tjera, si dhe masat e ndalimit, kufizimit dhe kontrollit te ushtruara nga autoritetet doganore;

2. "Autoritet Doganore"- per Republikën e Shqiperise: Drejtoria e Pergjithshme e Doganave e Ministrise se Financave dhe per Republikën e Polonise: Ministri i Financave;

3. "Detyrimet doganore"- cdo detyrim doganor dhe taksa te tjera te percaktuara dhe te grumbulluara, bazuar ne ligjet doganore;

4. "Autoriteti Kerkues"- Autoriteti doganor, i cili ben nje kerkese per asistencë ne ceshtjet doganore;

5. "Autoriteti i Kerkuar"- Autoriteti doganor, i cili merr nje kerkese per asistencë ne ceshtjet doganore;

6. "Shkelje te ligjeve doganore"- cdo dhunim ose tentative per dhunim te ligjeve doganore;

7. "Person"- nje person fizik ose juridik, ndersa ne Republikën e Polonise, gjithashtu edhe njesi te cilat nuk kane personalitet legal, te vendosura ne perputhje me legjislacionin ne fuqi, qe kryejne import ose eksport mallrash per ne territorin doganor te shteteve te Paleve Kontraktuese;

8. "Lende narkotike"- substancat e permendura ne listen e Konventes standarde te lendeve narkotike te 1961, kryer ne Nju-Jork me 30 mars 1961 dhe Konventa e Kombeve te Bashkuara kunder trafikut te paligjshem te lendeve narkotike dhe substancave psikotrope, kryer ne Vjene me 20 dhjetor 1988.

9. "Substanca psikotrope" - substancat e permendura ne listen e Konventes mbi substancat psikotrope, kryer ne Vjene me 21 shkurt 1971.

Neni 2 Fusheveprimi i marreveshjes

1. Autoritetet Doganore, ne perputhje me dispozitat e percaktuara ne kete Marreveshje, do t'i mundesojne njera-tjetres asistencë me synim qe:

a) te sigurohen se ligjet doganore jane zbatuar saktesisht;

b) te investigohen, te parandalohen dhe te goditen shkeljet e legjislacionit doganor;

c) te grumbullohen dhe te percaktohen me saktësi detyrimet doganore;

d) te shkembejne informacion dhe dokumente, lidhur me zbatimin e legjislacionit doganor;

e) te trajnohen dhe te zhvillojne aftësite profesionale te punonjesve doganore dhe te familjarizohen ata me pajisjet teknike te perdorura nga sherbimet doganore;

f) asistencë brenda kuadrit te kesaj Marreveshjeje do te jepet ne perputhje me legjislacionin kombetar dhe brenda kompetencave dhe burimeve te Autoritetit te Kerkuar.

Nese eshte e nevojshme, Autoriteti i Kerkuar mund te rregulloje qe asistencë te mundesohet nga nje autoritet tjeter kompetent.

Neni 7

Kontrolli i personave, mallrave dhe mjeteve te transportit

Autoritetet Doganore, sipas kerkeses, do te kryejne mbikeqyrjen mbi:

- a) persona per te cilet ka prova ose dyshime se kane shkelur ose jane duke shkelur legjislacionin doganor;
- b) mallra per te cilat importi, eksporti ose transiti i tyre mund te sjelle shkelje te legjislacionit doganor;
- c) mjete transporti dhe konteniere per te cilat ka prova ose dyshime se jane perdorur ape mund te perdoren ne shkeljen e legjislacionit doganor.

Neni 8

Bashkepunimi teknik

Bashkepunimi teknik i Autoriteteve Doganore ne fushen e ceshtjeve doganore do te perfshije:

- a) shkembimin e punonjesve te doganes ose eksperteve, kur kjo ka interes reciprok per qellime te avancimit te perdorimit te teknikave doganore te njeri-tjetrit;
- b) shkembimin e informacionit dhe eksperiencave ne perdorimin e pajisjeve detektuese;
- c) shkembimin e te dhenave profesionale dhe teknike, lidhur me zbatimin e legjislacionit doganor.

Neni 9

Ekzekutimi i kerkeses

1. Autoriteti i Kerkuar do te nise kerkime zyrtare, lidhur me operacione te cilat jane ne kundershtrim me legjislacionin doganor. Ai do t'i komunikojte rezultatet e ketij hartimi autoritetit kerkues.
2. Autoriteti i kerkuar mund te lejoje punonjesit e doganes te autoritetit kerkues te marrin pjese ne hetimet e permendura ne paragrafin 1.
3. Autoritetet Doganore, sipas kerkeses, mund te autorizojne punonjesit e tyre te paraqiten si eksperte ose deshmitare ne proceset penale ose administrative te kryera ne territorin e shtetit te Pales tjeter Kontraktuese brenda autorizimit te dhene nga Autoritetet Doganore dhe per rastet e mbuluara nga kjo Marreveshje. Kerkesa per paraqitje duhet te pasqyroje qarte se per cfare ceshtje dhe me cfare kapaciteti do te paraqitet ky punonjes.
4. Kur ne rastet e parashikuara ne kete Marreveshje punonjesit doganore do te jene prezent ne territorin e shtetit te Pales tjeter Kontraktuese, ata ne cdo kohe te jene ne gjendje te paraqesin prova te pozicionit te tyre zyrtar. Ata nuk duhet te veshin uniforme dhe as te mbajne arme.

Neni 10

Perdorimi i informacionit dhe i dokumenteve

1. Informacioni dhe dokumentet e marra sipas kesaj Marreveshjeje nuk do te perdoren per qellime te tjera vec atyre te specifikuara ne kete marreveshje pa miratimin me shkrim te Autoritetit Doganor qe i ka derguar ate. Dispozitat nuk do te jene te zbatueshme per informacionet dhe dokumentet qe kane te bejne me shkelje te legjislacionit doganor, lidhur me lendet narkotike dhe substancat psikotrope.
2. Autoriteti qe merr informacionin dhe dokumentet do t'u garantoje atyre nivelin e duhur te konfidencialitetit, ne perputhje me legjislacionin kombetar te ketij shteti dhe ne perputhje me karakterin individual te cdo rasti.
3. Autoritetet Doganore te Paleve Kontraktuese, per shkak te fushes se mbulimit dhe nivelit te

kesaj Marreveshjeje do ta perdorin informacionin dhe dokumentet e marra sipas kesaj marreveshjeje ne proceset penale dhe administrative.

Neni 11 Kerkesa per asistence

1. Kerkesat ne zbatim te kesaj Marreveshjeje do te behen me shkrim. Dokumentet e nevojshme per ekzekutimin e nje kerkese te tille duhet te bashkeshoqerojne kerkesen. Kerkesat urgjente mund te behen me goje. Ato duhet te konfirmohen me shkrim sa me shpejt te jete e mundur.
2. Kerkesat e permendura ne paragrafin 1 te ketij neni do te perfshijne informacionin e meposhtem:
 - a) Autoritetin Doganor qe ben kerkesen;
 - b) natyren e procesit;
 - c) objektin e kerkeses;
 - d) ligjet dhe faktet qe justifikojne kerkesen;
 - e) emrat dhe adresat e personave qe kane te bejne me procesin, nese dihen;
 - f) nje pershkrim te shkurter te ceshtjes qe trajtohet, si dhe elementet ligjore te perfshira.
3. Kerkesa duhet te dergohet ne anglisht ose ne nje gjuhe tjeter te pranueshme nga Autoriteti i Kerkuar.
4. Nese kerkesa nuk i permbush standardet formale te permendura ne paragrafet 1, 2 ose 3, Autoriteti i Kerkuar mund te kerkoje korrektimin ose kompletimin e kerkeses.
5. Kerkesa per korrektimin ose kompletimin e kerkeses se permendur ne paragrafin 4 duhet te behet jo me vone se dy muaj nga data e marrjes se kerkeses.

Neni 12 Perjashtime nga detyrimi per te dhene asistence

1. Nese Autoritetet i Kerkuar eshte i mendimit se pergjigja ndaj nje kerkese mund te bjere ndesh me sovranitetin, sigurine, rendin publik, interesat ekonomike ose interesa te tjera themelore te shtetit te vet, asistenca mund te refuzohet, e tera ose pjeserisht, ose mund te permbushet vetem ne baze te respektimit te disa kushteve te caktuara.
2. Nese Autoriteti Doganor ben nje kerkese per asistence, i cili vete nuk do te mund ta permbushte nese i kerkohej dicka e tille, kjo gje duhet te theksohet ne kerkese. Ne kete rast varet nga Autoriteti i Kerkuar vendimi nese do t'i pergjigjet nje kerkese te tille.
3. Nese asistenca refuzohet, shkaqet per refuzimin duhet t'i njoftohen me shkrim Autoritetit Kerkues pa vonese.

Neni 13 Shpenzimet

1. Palet Kontraktuese do te heqin dore nga cdo kerkese per rimbursimin e shpenzimeve te dala gjate venies ne zbatim te Marreveshjes ne fjale, me perjashtim te shpenzimeve lidhur me deshmitaret, ekspertet, dhe shpenzimet per perkthyesit qe nuk jane punonjes shteterore.
2. Shpenzimet jo te zakonshme qe rezultojne nga bashkepunimi teknik i permendur ne paragrafin 1 do te jete objekt i rregullimeve te vecanta ndermjet Autoriteteve Doganore te Paleve Kontraktuese.

Neni 14 Dhenia e asistences

1. Marreveshja ne fjale do te zbatohet direkt ndermjet Autoriteteve Doganore. Rregullimet implementuese qe specifikojne detajet e bashkepunimit te realizuar sipas Marreveshjes ne fjale mund te konkludohen ndermjet Autoriteteve Doganore te Paleve Kontraktuese.

2. Palet Kontraktuese, me konsensus te ndersjelle, do te perpiqen te zgjidhin problemet ose dyshimet qe rezultojne nga interpretimi ose zbatimi i Marreveshjes ne fjale.

Neni 15 Zbatimi territorial

Kjo Marreveshje do te zbatohet ne territorin doganor te Republikes se Shqiperise dhe ne territorin doganor te Republikes se Polonise.

Neni 16 Hyrja ne fuqi dhe perfundimi

Palet Kontraktuese do t'i konfirmojne njera-tjetres nepermjet shkembimit te notave diplomatike se te gjitha kerkesat ligjore kombetare te shteteve te veta, te nevojshme per hyrjen ne fuqi te Marreveshjes, jane permbushur. Marreveshja do te hyje ne fuqi ne ditën e tridhjetë pas marrjes se notes se fundit.

Neni 17

Kjo Marreveshje eshte menduar te jete e pakufizuar ne kohe. Mund te perfundoje nepermjet njoftimit te njerës prej Paleve Kontraktuese; ne kete rast Marreveshja do te pushoje se qeni ne fuqi 6 muaj pas dates se perfundimit.

E nenshkruar ne Tirane, me 12.11.2003, ne dy origjinale, secila ne gjuhet shqip, polonisht dhe anglisht, ku te gjitha tekstet jane njelloj autentike. Ne rast divergjencash perkthimi te dispozitave te kesaj Marreveshjeje, do te mbizoteroje teksti ne gjuhen angleze.



VENDIM
Nr. 9, date 14.1.2004

**PER MIRATIMIN E MARREVESHJES, NDERMJET KESHILLIT TE
MINISTRAVE TE REPUBLIKES SE SHQIPERISE DHE QEVERISE SE
RUMANISE, PER BASHKEPUNIM DHE ASISTENCE TE NDERSJELLE
ADMINISTRATIVE NE CESHTJET DOGANORE**

Ne mbeshtetje te nenit 100 te Kushtetutes dhe te neneve 17 dhe 23 te ligjit nr.8371, date 9.7.1998 "Per lidhjen e traktateve dhe marreveshjeve nderkombetare", me propozimin e Ministrit te Puneve te Jashtme, Keshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e Marreveshjes ndermjet Keshillit te Ministrave te Republikes se Shqiperise dhe Qeverise se Rumanise per bashkepunim dhe asistence te ndersjelle administrative ne ceshtjet doganore.

Ky vendim hyn ne fuqi pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI Fatos Nano

MARREVESHJE

**NDERMJET KESHILLIT TE MINISTRAVE TE REPUBLIKES SE SHQIPERISE
DHE QEVERISE SE RUMANISE PER BASHKEPUNIMIN DHE ASISTENCE TE
NDERSJELLE ADMINISTRATIVE NE CESHTJET DOGANORE**

Neni 1
Perkufizime

Keshilli i Ministrave te Republikes se Shqiperise dhe Qeveria e Rumanise, ketej e tutje referuar si "Pale Kontraktuese":

duke marre ne konsiderate qe shkeljet doganore jane te demshme per interesat e tyre ekonomike, tregtare, financiare, shoqerore dhe kulturore;

duke marre ne konsiderate rendesine e vleresimit te sakte dhe mbledhjen e detyrimeve doganore, taksave dhe pagesave te tjera ne importimin dhe eksportimin e mallrave, si dhe per te siguruar zbatimin e duhur te dispozitave per masat ndaluese, kufizuese dhe kontrollin;

te bindur se veprimet e ndermarra kunder shkeljeve doganore mund te jene me efektive permes bashkepunimit te ngushte midis administratave te tyre doganore;

te shqetesuar per shkallen e rritjes te tendencave te trafikave te paligjshme te drogave dhe substancave psikotrope dhe duke marre ne konsiderate se ato perbejne rrezik per shendetin publik dhe shoqerine;

duke marre gjithashtu parasysh konventat nderkombetare te ngjashme ne fuqi per inkurajimin nga Palet Kontraktuese te asistences se ndersjelle, si dhe rekomandimet e Organizates Boterore te Doganave,

rane dakord per sa me poshte vijon:

Per qellimet e kesaj Marreveshjeje:

a) "Administrata doganore" do te nenkuptoje:

- per Republiken e Shqiperise - Drejtoria e Pergjithshme e Doganave e Ministrise se Financave,

- per Rumanine - Autoriteti Kombetar i Doganave te Autoritetit Kombetar te Kontrollit.

b) "Legjislacion doganor" do te nenkuptoje dispozita te akteve normative ne fuqi, qe kane te bejne me importimin, eksportimin, transitimin e mallrave ose cdo procedure tjeter doganore qe lidhet me detyrimet doganore, taksat ose pagesat e tjera qe mblidhen nga administratat doganore ose me masa te ndalimit, kufizimit dhe kontrollit te zbatueshem nga administratat doganore.

c) "Shkelje doganore" do te nenkuptoje cdo shkelje te legjislacionit doganor, si dhe cdo perpjekje per te shkelur kete legjislacion, sic eshte parashikuar ne ligjet kombetare te secilit shtet te Pales Kontraktuese.

d) "Pala Kontraktuese kerkuese" do te nenkuptoje administraten doganore, e cila ben nje kerkese per asistencë.

e) "Pala Kontraktuese e kerkuar" do te nenkuptoje administraten doganore prej se ciles kerkohet asistencë.

f) "Droga narkotike" do te nenkuptoje cdo substance natyrale ose sintetike, te renditur ne listen I ose listen II te Konventes se vetme mbi drogat narkotike hartuar ne Nju-Jork me 30 mars 1961 (me ndryshimet perkatese).

g) "Substanca psikotrope" do te nenkuptoje cdo substance natyrale ose sintetike, te renditur ne listen I, II, III, IV te Konventes per substancat psikotrope pergatitur ne Vjene, nen mbikeqyrjen e Kombeve te Bashkuara, me 21 shkurt 1971.

h) "Prekursorë" do te nenkuptoje substanca kimike te kontrolluara qe perdoren per prodhimin e drogave dhe substancave psikotrope, te renditura ne listat I dhe II te Konventes se Kombeve te Bashkuara kunder trafikut te paligjshem te drogave narkotike dhe substancave psikotrope, adoptuar ne Vjene me 20 dhjetor 1988.

i) "Dergese e kontrolluar" do te nenkuptoje tekniken e lejimit te ngarkesave te paligjshme ose te dyshimta te drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve ose te substancave qe zevendesojne ata, te kalojne jashte, permes ose brenda territorit te nje ose me shume vendeve, me dijenine dhe nen mbikeqyrjen e autoriteteve kompetente, me qellim identifikimin e personave te perfshire ne kryerjen e shkeljeve.

Neni 2

Fushembulimi i Marreveshjes

1. Palet Kontraktuese, ne perputhje me dispozitat e parashikuara ne kete Marreveshje, do te asistojne njera-tjetren ne sigurimin e dispozitave qe jane parashikuar ne legjislacionin doganor, si vijon:

a) do te ndermarrin masat e nevojshme per te lehtesuar dhe pershpjehuar fluksin e mallrave dhe pasagjereve;

b) do te bashkepunojne dhe asistojne njera-tjetren ne parandalimin dhe hetimin e shkeljeve te legjislacionit doganor;

c) kur kerkohet, do te sigurojne informacione te tjera qe do te sherbejne per zbatimin e legjislacionit doganor;

d) do te perpiqen te bashkepunojne ne gjetjen, zhvillimin dhe zbatimin e procedurave te reja doganore, ne trajnimin dhe shkembimin e personelit dhe ne ceshtje te tjera te interesit te perbashket.

2. Asistenca e ndersjelle, ne kuadrin e kesaj Marreveshjeje, do te jepet ne perputhje me legjislacionin ne fuqi ne territorin e shtetit te Pales Kontraktuese te kerkuar dhe brenda kompetencave dhe mundesive te saj.

Neni 3

Mbikeqyrja e personave, mallrave dhe mjeteve te transportit

Administratat doganore do te kryejne, me iniciativen e tyre ose kur t'u kerkohet, kontroll ose mbikeqyrje mbi:

- a) persona qe jane identifikuar ose dyshohen se kane kryer shkelje doganore ose qe jane perfshire ne trafikun e paligjshem te drogave, substancave psikotrope dhe prekursoreve;
- b) mallra qe dihet ose qe dyshohet se perdoren per kryerjen e shkeljeve doganore ose per qellimet e trafikut te paligjshem te drogave, substancave psikotrope dhe prekursoreve;
- c) cdo mjet transporti qe dihet ose dyshohet se perdoret per kryerjen e shkeljeve doganore ose per qellimet e trafikut te paligjshem te drogave, substancave psikotrope dhe prekursoreve;
- d) pakot postare qe dyshohet se perdoren ne trafikun e paligjshem.

Neni 4

Veprimet kunder trafikut te paligjshem te mallrave te forta

Administratat doganore do te sigurojne per njera-tjetren, me iniciativen e tyre ose kur t'u kerkohet, te gjitha informacionet perkatese mbi qellimin, ose kryerjen nga cdo person te shkeljeve te legjislacionit ne fuqi ne territorin e shtetit te nje prej Paleve Kontraktuese, qe lidhet me:

- a) trafikun e drogave, substancave psikotrope dhe prekursoreve;
- b) trafikun e armeve, municioneve, materialeve eksplozive dhe nukleare, si dhe cdo substance tjeter te demshme per ambientin dhe shendetin publik;
- c) trafikun e veprave te artit me vlere historike, kulturore dhe arkeologjike te rendesishme;
- d) trafikun e mallrave, objekt i detyrimeve te larta doganore dhe taksave.

Neni 5

Dergese e kontrolluar

1. Administratat doganore do te bashkepunojne, brenda kompetencave te tyre, ne zbatimin e metodave per dergesat e kontrolluara.
2. Vendimi per te zbatuar proceduren e dergesave te kontrolluara do te behet sipas rastit, duke qene ne perputhje me legjislacionet ne fuqi ne territoret e shteteve te Paleve Kontraktuese.

Neni 6

Shkembimi i informacionit

1. Administratat doganore do te sigurojne per njera-tjetren, me iniciativen e tyre ose kur t'u kerkohet, cdo informacion i cili mund te ndihmoje ne zbatimin e procedurave me efikase lidhur me: a) percaktimin e vleres doganore dhe certifikimin e dokumentacionit qe paraqitet ne importimin dhe eksportimin e mallrave, si dhe origjinalitetin e te dhenave paraqitur ne to;
- b) klasifikimin e mallrave qe lidhen me aktivitetin e tregtise se jashtme sipas tarifes doganore, si dhe kryerjen e analizave ne laborator per qellimet e klasifikimit tarifar te mallrave sipas kreveve;
- c) percaktimin e origjines se mallrave dhe kontrollin e certifikates se origjines qe paraqitet ne eksport, si dhe kontrollin e procedurave doganore qe zbatohen mbi mallrat ne vendin e

eksportit (transit nen mbikeqyrjen doganore, magazinimin doganor, lejimin e perkohshem, zonat e tregtise se lire, eksport pas perpunimit aktiv etj.).

2. Administratat doganore do t'i sigurojne njera-tjetres, kur t'u kerkohet, informacion lidhur me:

a) mallra te importuara ne territorin e njerit prej shteteve te Paleve Kontraktuese, te cilat jane eksportuar ne menyre te ligjshme nga territori i shtetit te Pales tjetere Kontraktuese;

b) mallra te eksportuara ne territorin e njerit prej shteteve te Paleve Kontraktuese, te cilat jane importuar ne menyre te ligjshme nga territori i shtetit te Pales tjetere Kontraktuese.

3. Administratat doganore do te sigurojne per njera-tjetren, me iniciativen e tyre ose kur t'u kerkohet, cdo informacion qe lidhet me shkeljet, sic eshte parashikuar ne legjislacionin ne fuqi ne territoret e te dy shteteve dhe ne vecanti informacion qe lidhet me:

a) persona fizike apo juridike, qe dihet ose qe dyshohet se kane kryer shkelje doganore ose jane perfshire ne trafikun e paligjshem te drogave, substancave psikotrope dhe prekursiveve ose te cdo malli te ndaluar apo te kufizuar;

b) mallra qe dihet ose dyshohet se jane objekt i shkeljeve doganore ose te trafikut te paligjshem te drogave, substancave psikotrope dhe prekursiveve;

c) mjete transporti qe dihet ose dyshohet se perdoren per kryerjen e shkeljeve doganore ose ne trafikun e paligjshem te drogave, substancave psikotrope dhe prekursiveve.

4. Ne rast se administrata doganore e kerkuar nuk e disponon informacionin e kerkuar, ajo duhet te marre masat e nevojshme per te siguruar kete informacion brenda kompetencave dhe nga burimet e saj ne dispozicion, si te vepronte per interesat e saj dhe ne perputhje me legjislacionin ne fuqi ne territorin e atij shteti.

5. Administrata doganore e njeres prej Paleve Kontraktuese do te siguroje, me iniciativen e saj ose kur t'i kerkohet, per administraten doganore te Pales tjetere Kontraktuese dokumentet doganore, dokumentet e transportit, materialet e provave dhe kopjet e tyre te vertetuara, si dhe informacion mbi veprimet e kryera ose qe planifikohet te kryhen, te cilat perbejne ose mund te perbejne shkelje te legjislacionit doganor ne fuqi ne territorin e shtetit tjetere.

6. Informacioni qe i jepet administrates doganore te Pales tjetere Kontraktuese mund te transmetohet nepermjet mjeteve elektronike ne vend te dokumenteve te specifikuara ne kete Marreveshje. Ai duhet te permbaje shpjegimet e nevojshme per interpretimin dhe perdorimin e ketij informacioni.

Neni 7

Format dhe permbajtja e kerkeses per asistencë

1. Kerkesat qe do te paraqiten ne kuadrin e Marreveshjes do te behen me shkrim. Kerkesat do te permbajne dokumente te bashkengjitura, te nevojshme per realizimin e kerkeses. Ne raste te vecanta, kerkesat mund te behen gojarisht, por do te konfirmohen me shkrim maksimumi brenda 3 diteve.

2. Kerkesat sipas paragrafit (1) te ketij neni do te permbajne informacionin e meposhtem:

a) emrin e administrates doganore qe e ben kerkesen;

b) masat e kerkuara;

c) objektin dhe arsyet per te cilat behet kerkesa;

d) ligjin dhe aktet e tjera ligjore te cilave iu referohet objekti;

e) te dhena sa me te sakta dhe te detajuara per personat fizike ose juridike, qe jane perfshire ne hetim;

f) nje permbledhje te fakteve qe lidhen me objektin e kerkeses;

g) nje komplet te kopjeve te certifikuara te dokumenteve doganore, tregtare dhe te transportit.

3. Kerkesa do te paraqitet ne gjuhen zyrtare te shtetit te Pales Kontraktuese te kerkuar ose ne anglisht.

4. Ne rast se nje kerkese nuk permbush kerkemat e paragrafit (2) dhe (3) te ketij neni, atehere do te kerkohet ndryshimi i saj.

Neni 8 Hetimet doganore

1. Ne rast se administrata doganore e njerës prej Paleve Kontraktuese e kerkon, administrata doganore e Pales tjetër Kontraktuese do te filloje nje hetim te veprimeve, te cilat kane shkelur ose mund te shkelin legjislacionin doganor ne fuqi ne territorin e shtetit te Pales Kontraktuese kerkuese. Ajo do t'ia beje te ditur rezultatet e hetimit Pales Kontraktuese kerkuese.

2. Keto hetime do te kryhen sipas legjislacionit ne fuqi ne territorin e shtetit te Pales Kontraktuese te kerkuar. Pala Kontraktuese e kerkuar do te procedonte njesoj sikur te vepronte per interesat e saj.

3. Zyrtaret e administrates doganore te njerës Pale Kontraktuese mund, ne raste te vecanta, me pelqimin e administrates doganore te Pales tjetër Kontraktuese, te jene te pranishme ne territorin e shtetit te ketij te fundit per hetimin e shkeljeve te legjislacionit doganor te shtetit perkates. Ata duhet te provojne status in e tyre zyrtar.

4. Nje zyrtar i Pales Kontraktuese kerkuese i pranishem ne territorin e shtetit te Pales Kontraktuese se kerkuar sipas paragrafit (3) do te kryeje vetem veprimtari keshillimore dhe nuk do te marre pjese aktivisht ne asnje rast ne hetim, as nuk do te takohet me njerezit qe jane duke u pyetur dhe as nuk duhet te marre pjese ne asnje veprimtari hetimi.

Neni 9 Perdorimi i informacionit dhe i dokumentacionit

1. Informacioni, dokumentet dhe te dhenat e marra ne kuadrin e kesaj Marreveshje nuk do te perdoren per qellime te tjera nga ato te specifikuar ne kete Marreveshje. Ato mund te perdoren per qellime te tjera vetem me aprovimin me shkrim te administrates doganore, e cila e ka ofruar ate informacion.

2. Informacionet dhe dokumentet qe kane te bejne me trafikun e paligjshem te drogave, substancave psikotrope dhe prekursoreve mund t'u jepen autoriteteve te tjera qeveritare te shtetit te Paleve Kontraktuese, te cilat merren me aktivitetet e kontrollit te abuzimit me drogen dhe trafikun e pergjithshem te drogave, substancave psikotrope dhe prekursoreve.

3. Çdo kerkese e bere, si dhe informacionet e dhena ne cfaredolloj menyre sipas kesaj Marreveshjeje do te jene te nje natyre konfidenciale. Ato do te mbahen ne menyre konfidenciale dhe do te gezojne te pakten te njejten mbrojtje qe gezon i njejti informacion dhe dokumentacion sipas legjislacionit ne fuqi ne territorin e shtetit te Pales Kontraktuese te kerkuar.

4. Administrata doganore, e cila ka marre informacionin dhe dokumentet ne kuadrin e kesaj Marreveshjeje, mund, ne varesi te synimeve dhe qellimit, ta perdore kete informacion si prove gjate procedimeve administrative dhe ligjore.

5. Ky dokumentacion dhe informacion mund te perdoret si prove ne gjyq dhe statusi i tyre ligjor do te percaktohet ne perputhje me legjislacionin kombetar ne fuqi ne territorin e shtetit te Pales Kontraktuese qe ka marre informacionin.

Neni 10 Ekspertet dhe deshmitaret

1. Kur te kerkohet, Pala Kontraktuese e kerkuar mund te autorizojë zyrtaret e saj, me pelqimin e tyre, te veprojnë si eksperte ose deshmitare perpara autoriteteve ligjore dhe administratave te Pales Kontraktuese kerkuese. Keta zyrtare do te japin prova te sigumara gjate kryerjes se detyres se tyre.
2. Administrata doganore kerkuese eshte e detyruar te marre te gjitha masat e nevojshme per sigurine e zyrtareve gjate qendrimit te tyre ne territorin e shtetit te saj, sipas paragrafit (1) te ketij neni. Transporti dhe shpenzimet ditore te ketyre zyrtareve do te mbulohen nga administrata doganore kerkuese.
3. Kerkesa per paraqitjen e ketyre zyrtareve duhet te pershkruaje me saktesi se cili eshte rasti dhe se ne cfare statusi duhet te paraqiten zyrtaret.
4. Kerkesa per prezencen e zyrtareve doganore si eksperte dhe deshmitare do te behet ne perputhje me legjislacionin e shtetit te Pales Kontraktuese te kerkuar

Neni 11 Perjashtime nga detyrimi per te dhene asistence

1. Ne rast se Pala Kontraktuese e kerkuar e konsideron permbushjen e kerkeses te demshme per sovranitetin, sigurine ose per interesa te tjera te rendesishme per shtetin e saj, ajo mund te refuzojë te jape asistencen e kerkuar ne kuadrin e kesaj Marreveshjeje, plotesisht ose pjeserisht, ose dhenia e asistences se kerkuar mund te behet ne baze te disa kushteve te caktuara.
2. Ne rast se Pala Kontraktuese kerkuese kerkon asistence te cilen ajo vete nuk do te ishte ne gjendje t'ia ofronte administrates doganore te Pales tjetere Kontraktuese, kete fakt ajo duhet ta permende ne kerkese. Permbushja e nje kerkese te tille do te jete ne gjykimin e Pales Kontraktuese te kerkuar.
3. Ne rast se asistenca refuzohet, arsytet per refuzimin do t'i njoftohen me shkrim dhe pa vonese Pales Kontraktuese kerkuese.

Neni 12 Thjeshtezimi i procedurave doganore

Administratat doganore do te ndermarrin, sic eshte rene dakord bashkerisht, masat e nevojshme per thjeshtimin e procedurave doganore, ne menyre qe te lehtesohet dhe pershpjehet levizja e mallrave midis territoreve te shteteve te Paleve Kontraktuese.

Neni 13 Asistenca teknike

Administratat doganore mund te sigurojne asistence teknike per njera-tjetren ne lidhje me ceshtjet doganore, si vijon:

- a) shkembimin e zyrtareve doganore, ne menyre qe te paraqesin para tyre menytrat e avancuara per kontrollin doganor;
- b) shkembim informacioni dhe aftesish ne perdorimin e pajisjeve teknike te kontrollit;
- c) trajnim dhe ritrajnim te zyrtareve doganore;
- d) shkembimin e specialisteve ne ceshtjet doganore;
- e) shkembimin e te dhenave specifike, shkencore dhe teknike, qe lidhen me zbatimin e dispozitave doganore.

Neni 14 Shpenzimet

Palet Kontraktuese do te heqin dore nga te gjitha pretendimet per njera-tjetren per rimbursimin e shpenzimeve si pasoje e ekzekutimit te kesaj Marreveshjeje, me perjashtim te shpenzimeve per specialistet dhe deshmitaret, si dhe perkthyesit dhe interpretuesit, te cilet nuk varen nga sherbimet publike.

Neni 15 Zbatimi i Marreveshjes

1. Bashkepunimi dhe asistenca reciproke, te parashikuara ne kete Marreveshje, do te ofrohen nga administratat doganore te Paleve Kontraktuese. Keto autoritete do te bien dakord bashkerisht per dokumentet qe do te sherbejne per kete qellim.
2. Perfaqesuesit e administratave doganore te Paleve Kontraktuese do te takohen kur te jete e nevojshme, me rradhe ne te dy Shtetet, per te analizuar zbatimin e dispozitave te kesaj Marreveshjeje, si dhe te zgjidhin ceshtje te tjera praktike te bashkepunimit dhe asistences se ndersjelle te administratave doganore te Paleve Kontraktuese.
3. Administratat doganore te Paleve Kontraktuese do te percaktojne bashkerisht metodat e zbatimit praktik te kesaj Marreveshjeje.
4. Per qellimet e kesaj Marreveshjeje, administratat doganore te Paleve Kontraktuese do te caktojne zyrtaret nderlidhes dhe do te shkembejne listat ku do te tregohen emrat, pozicionet, numrat e telefonit dhe te faksit te ketyre zyrtareve, brenda dy muajve pasi Marreveshja te kete hyre ne fuqi. Ato gjithashtu mund te vendosin kontakte te drejtperdrejta midis strukturave te tyre te hetimit.

Neni 16 Zgjidhja e mosmarreveshjeve

Çdo mosmarreveshje e dale gjate zbatimit dhe interpretimit te kesaj Marreveshjeje do te zgjidhet nepermjet konsultimeve ndermjet administratave doganore te Paleve Kontraktuese. Mosmarreveshja qe nuk mund te zgjidhet nepermjet konsultimeve ndermjet administratave doganore do te zgjidhet nepermjet kanaleve diplomatike.

Neni 17 Hyrja ne fuqi

1. Kjo Marreveshje do te hyje ne fuqi tridhjete dite pas dates se marrjes se njoftimit te fundit, me ane te te cilit Palet Kontraktuese informojne njera-tjetren, nepermjet kanaleve diplomatike, se te gjitha kerkesat ligjore kombetare per hyrjen ne fuqi te kesaj Marreveshjeje jane permbushur.
2. Kjo Marreveshje eshte parashikuar per nje periudhe te pakufizuar kohore.
3. Secila Pale Kontraktuese mund ta denoncoje Marreveshjen me ane te nje njoftimi me shkrim, qe do t'i dergohet Pales tjeter Kontraktuese nepermjet kanaleve diplomatike. Marreveshja do te perfundoje brenda tre muajve nga data e marrjes se njoftimit perkates.

Firmosur ne Bukuresht me date 19 nentor 2003 ne dy kopje origjinale ne gjuhet rumanisht, shqip dhe anglisht, ku te gjitha kopjet jane njesoj autentike. Ne rast te divergjencave midis teksteve shqip dhe rumanisht, teksti ne anglisht do te merret per baze.



VENDIM

Nr.154, datë 9.3.2005

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SLLOVAKISË, PËR BASHKËPUNIMIN DHE ASISTENCËN E NDËRSJELLË NË ÇËSHTJET DOGANORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Sllovakisë, për bashkëpunimin dhe asistencën e ndërsjellë në çështjet doganore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

MARREVESHJE

NDERMJET KESHILLIT TE MINISTRAVE TE REPUBLIKES SE SHQIPERISE DHE QEVERISE SE REPUBLIKES SE SLLOVAKISE .MBI BASHKEPUNIMIN DHE ASISTENCE TE NDERSJLLTE NE ÇESHTJET DOGANORE

Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Sllovakisë, këtë e tutje referuar si "Pale Kontraktuese";

DUKE KONSIDERUAR rendësin e sigurimit të përlogaritjes dhe grumbullimit të sakte të detyrimeve doganore dhe taksave të tjera mbi importet ose eksportet e mallrave, si dhe zbatimin e sakte të dispozitave mbi kufizimet, ndalimet dhe kontrollin;

DUKE KONSIDERUAR se shkeljet ndaj Legjislacionit Doganor janë të dëmshme për interesat ekonomike, fiskale, tregtare dhe sociale të vendeve të tyre respektive, si dhe të interesit të tregtisë së ligjshme;

DUKE NJOHUR nevojën për aksione të kombinuara në luftën kundër trafikut ilegal të lendeve narkotike dhe substancave psikotrope;

TE BINDUR se aksionet për të parandaluar shkeljet kundër legjislacionit doganor dhe përpjekjet të siguruar grumbullimin e sakte të detyrimeve të importit dhe eksportit, taksave dhe detyrimeve të tjera mund të arrihen me efektivisht nëpërmjet kooperimit të ngushtë ndërmjet Autoriteteve të tyre Doganore;

DUKE marrë në konsideratë marrëdhëniet ekzistuese miqësore ndërmjet Republikës së Sllovakisë dhe Republikës së Shqipërisë;

DUKE marrë në konsideratë rekomandimet e Këshillit të Kooperimit Doganor mbi Asistencën Reciproke Administrative, të 5 dhjetorit 1953;

DUKE marrë në konsideratë gjithashtu dispozitat & Konventës mbi Drogat Narkotike të 1961, të amenduar me Protokollin e 1972 dhe Konventën mbi Substancat Psikotrope të 1971 të përgatitur nën autorizimin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, si dhe të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Trafikut Ilegal të Lendeve Narkotike dhe Substancave Psikotrope të 1988; ranë dakord sa më poshtë vijon:

Neni 1 Përkufizime

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje:

- a) "Autoritet Doganor" do të thotë, në Republikën e Shqipërisë - Drejtoria e Përgjithshme e Doganave e Ministrisë së Financave; dhe në Republikën e Sllovakisë - Drejtoria e Doganave e Republikës së Sllovakisë;
- b) "Legjislacion doganor" do të thotë dispozitat e përcaktuara nga ligje apo rregullore të të dyja Palëve Kontraktuese lidhur me importimin, eksportimin, tranzitimin e mallrave apo çfarëdo procedure tjetër doganore, si e lidhur me detyrimet doganore, taksat apo kuotat e tjera të ushtruara nga Autoriteti Doganor ashtu edhe me masat e ndalimit, kufizimit apo kontrollit të ushtruara nga Autoriteti Doganor;
- c) "Shkelje" (kundërvajtje) do të thotë çdo shkelje e Legjislacionit Doganor si dhe çdo përpjekje për shkelje të këtij legjislacioni;
- d) "Autoriteti doganor kërkues" do të thotë autoriteti doganor kompetent i një Pale Kontraktuese i cili bën një kërkesë për asistencë në çështjet doganore;
- e) "Autoriteti doganor i kërkuar" do të thotë autoriteti doganor kompetent i një Pale Kontraktuese i cili merr një kërkesë për asistencë në çështjet doganore;
- f) "Person" do të thotë një person fizik dhe/ose një person juridik;
- g) "Informacion" do të thotë kryesisht raporte, regjistra, dokumente, dokumentacion, të kompjuterizuar ose si dhe kopje të noterizuara të këtyre;
- h) "Te dhëna personale" do të thotë çdo lloj e dhëne lidhur me persona fizike të identifikuar apo të identifikueshëm;

i) "Shpendarie nen Kontroll" do te thotë teknika e kërkimit te ngarkesës se paligjshme apo te dyshuar te drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursoreve. dhe specieve te rrezikuara te florës dhe faunës, ose substancave te zëvendësuara për to, qe te kalojnë jashtë, brenda ose nëpërmjet territorit te Shteteve te Palëve Kontraktuese me njohurinë dhe nen vëzhgimin e autoriteteve te tyre kompetente, me qellim identifikimin e personave te përfshire ne trafikun e paligjshëm te drogave narkotike, substancave psikotropc dhe prekursoreve dhe specieve te rrezikuara te florës dhe faunës se egër.

Neni 2 Qëllimi i Marrëveshjes

1. Palët Kontraktuese, nëpërmjet Autoriteteve Doganore dhe ne përputhje me dispozitat e caktuara ne këtë Marrëveshjet, do t'i mundësojnë njëra-tjetrës asistence te ndërsjelle:
 - a) me synim sigurimin se legjislacioni doganor është zbatuar saktësisht;
 - b) me synim te sigurojnë përcaktimin e sakte te detyrimeve doganore, taksave dhe kuotave te tjera;
 - c) ne ndërmarrjen e masave me synim lehtësimin dhe kontrollin e lëvizjes se pasagjereve dhe rrjedhjes se mallrave;
 - d) me synim parandalimin, hetimin dhe luftën kundër shkeljeve te legjislacionit doganor;
 - e) ne rastet lidhur me dërgimin e dokumenteve lidhur me aplikimin e legjislacionit doganor;
 - f) ne shkëmbimin e eksperiencës teknike me synim promovimin e punës se Autoriteteve Doganore respektive.
2. Asistenca ne kuadrin e Marrëveshjes ne fjale do te jepet ne përputhje me legjislacionin ne fuqi ne territorin e shtetit te Palës Kontraktuese te kërkuar dhe brenda kompetencave dhe resorëve te autoritetit doganor te kërkuar. Nëse është e nevojshme, një autoritet doganor mund te rregulloje asistenca te mundësohet nga një autoritet tjetër kompetent ne përputhje me legjislacionin ne territorin e Shtetit te Palës Kontraktuese te kërkuar. rimi i kësaj Marrëveshjeje nuk do te ndikojë mbi detyrimet e palëve kontraktuese sipas konventave ndërkombëtare apo Marrëveshjeve ne fushat juridike.

Neni 3 Survejimi i personave, mallrave, mjeteve te transportit dhe vendeve

Autoriteti doganor i një Pale kontraktuese, brenda kompetencave dhe mundësive te veta, me iniciativën e vet ose sipas kërkesës se autoritet doganor te Palës tjetër kontraktuese, do te kryeje mbi lëvizjen veçanërisht për hyrjen ne, dhe daljen nga territori i Shtetit te vet te personave te njohur si dyshuar se mund te kryejnë ose kane kryer shkelje te Legjislacionit doganor ne fuqi ne territorin e shtetit te Palës tjetër kontraktuese;

Lëvizjen e mallrave, te raportuar nga autoriteti doganor i Palës tjetër kontraktues që mund të shkaktojë dyshime për kryerjen e trafikut te paligjshëm për ne, ose nga territori i Shtetit te vet; ndaj çdo mjeti transporti ose kontejnerë te njohur ose te dyshuar se janë përdorur për kryerjen e lëvizjeve kundër legjislacionit doganor;

Vende të përdorura për magazinim ilegal te mallrave ne territorin e shtetit te Palës respektive kontraktuese.

Neni 4 Aksionet kundër trafikut te paligjshëm te mallrave te caktuara

Autoritetet doganore, me iniciativën e vet ose sipas kërkesës, bazuar ne konsultime dhe ne koordinim me autoritete te tjera kompetente, pa vonesa, do t'i mundësojnë njëra-tjetrës gjithë informacionin përkatës mbi veprimtari te cilat përbejnë ose mund te përbejnë një shkelje ndaj legjislacionit ne fuqi ne territorin e Shtetit te njërës prej Palëve Kontraktuese, lidhur me:

- trafikun e drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve;
- trafikun e armeve, municioneve, eksploziveve;
- lëvizjen e mallrave sensitive dhe strategjike te kushtëzuara nga kontrole speciale ne përputhje me traktatet ndërkombëtare përkatëse dhe marrëveshje shumëpalëshe qe sjellin detyrime mbi shpërndarjen, ne te cilat te dyja palët Kontraktuese janë anëtare;
- d) trafikun e veprave te artit dhe antikuarëve te cilat përbejnë vlera te rëndësishme historike, kulturore ose arkeologjike për një nga Palët Kontraktuese;
- e) lëvizjen e mallrave helmuese si dhe te mallrave apo substancave te rrezikshme për mjedisin apo shëndetin publik;
- f) trafikun e mallrave te kushtëzuara nga detyrime te larta doganore, taksa apo kuota.

Neni 5

Dërgesa te kontrolluara

1) Ne përputhje me legjislacionin kombëtar, Autoritetet Doganore me konsensus reciprok dhe brenda kompetencave te tyre, mund te përdorin shpërndarjen nen kontroll, me synim identifikimin, e personave te implikuar ne trafikun e paligjshëm te drogave narkotike dhe substancave psikotrope specieve te rrezikuara te florës dhe faunës se egër, dhe për te ndërmarre aksione ligjore kundër këtyre personave.

2) Vendimet lidhur me përdorimin e procedurës se dërgesave të kontrolluara do te bëhen rast pas rasti dhe kur është e nevojshme në përputhje me rregullimet ose marrëveshjet te cilat mund te jene arritur lidhur me rastin ne fjale. Ne këto raste, nëse është e nevojshme, dhe me kusht qe kjo gjë te jete konform legjislacionit kombëtar te Palëve Kontraktuese, mund te marren ne konsiderate rregullimet financiare dhe mirëkuptimet e arritura ndërmjet te dyja Palëve Kontraktuese.

3) Ngarkesat e paligjshme për te cila është rene dakord procedura e dërgesës se kontrolluar, me konsensusin reciprok te autoriteteve kompetente, mund te interceptohen dhe te lejohen te vazhdojnë kalimin paprekur drogat narkotike, substancat psikotrope ose substancat zëvendësuese te tyre, ose ne rast se sigurohen kushtet, ato substanca hiqen ose zëvendësohen pjesërisht apo plotësisht.

Komunikimi i informacionit

Neni 6

Autoritetet doganore, me iniciativën e vet ose sipas kërkesës, do t'i mundësojnë njëra-tjetrës gjithë informacionin i cili mund te ndihmoje ne arritjen e saktësisë mbi:

- a) grumbullin e detyrimeve te importit dhe eksportit, taksat dhe detyrimet e tjera te ushtruara nga autoritetet doganore, dhe ne veçanti informacion i cili mund te ndihmoje ne përcaktimin e vlerës se mallrave për qëllime doganore dhe për te vendosur klasifikimin e t yre tarifor;
- b) zbatimin e ndalimeve dhe kufizimeve te importit, eksportit dhe transitit;
- c) aplikimin e rregullave te origjinës te pambuluara nga marrëveshjet preferenciale te arritura nga njëra ose te dyja Palët kontraktuese.

Neni 7

Autoritetet doganore, me iniciativën e vet ose sipas kërkesës, do t'i mundësojnë njëra-tjetrës informacionin e mëposhtëm:

- a) nëse mallrat e importuara ne territorin e shtetit te njërës prej Palëve kontraktuese janë eksportuar ligjërisht nga territori i shtetit te Palës tjetër kontraktuese, dhe natyrën e procedurave doganore, nëse ka, te aplikuar mbi këto mallra;
- b) nëse mallrat e eksportuara nga territori i Shtetit te njërës prej Palëve Kontraktuese janë importuar ligjërisht ne territorin e Shtetit te Palës tjetër Kontraktuese, dhe natyrën e procedurave doganore nen te cilat janë vendosur këto mallra;
- c) nëse mallrat te cilave iu është dhënë trajtim favorizues mbi eksportin nga territori i Shtetit te një Pale Kontraktuese janë importuar saktësisht ne territorin e Shtetit te Palës tjetër Kontraktuese, me kuptimin qe do te mundësohet gjithashtu informacion mbi çdo mase doganore kontrolli te ushtruar mbi këto mallra.

Neni 8

Autoriteti doganor i një Pale kontraktuese, me iniciativën e vet ose sipas kërkesës, do ti mundësoje autoritetit doganor te Palës tjetër kontraktuese te gjithë informacionin qe mund te jete i dobishëm ose i lidhur me shkeljet ndaj legjislacionit doganor dhe ne veçanti informacion lidhur me:

- a) persona, te njohur ose te dyshuar se janë duke kryer apo kane kryer shkelje ndaj legjislacionit doganor ne fuqi ne territorin e shtetit te Palës tjetër kontraktuese;
- b) mallra te njohura apo te dyshuara se janë subjekt i shkeljeve doganore;
- c) mjetet e transportit apo kontejnerë te njohura apo te dyshuara se ato, kane qene përdorur për kryerjen e shkeljeve kundër legjislacionit doganor ne fuqi ne territorin e shtetit te Palës tjetër kontraktuese;
- d) mjete dhe metoda te reja te përdorura ne kryerjen e shkeljeve kundër legjislacionit doganor;
- e) vende te përdorura për magazinim ilegal te mallrave ne territorin e shtetit te Palës tjetër kontraktuese.

Neni 9

1. Nëse autoriteti doganor i kërkuar nuk e ka informacionin e kërkuar, ai mund te kërkoje këtë informacion ne përputhje me dispozitat e legjislacionit ne fuqi ne territorin e Shtetit te Palës Kontraktuese te Kërkuar.
2. Autoriteti Doganor i Kërkuar, brenda kompetencave te veta, mundësive dhe ne përputhje me legjislacionin e vet kombëtar, do te kërkoje informacion sikur ai te ishte duke vepruar për interes te vet.

Neni 10

1. Autoritetet doganore do ti mundësojnë njëra-tjetrës, sipas kërkesë ose me iniciativën e vet, informacione mbi aktivitete te kryera ose parashikuar për tu kryer te cilat përbejnë ose mund te përbejnë një shkelje.
2. Autoritetet doganore do te kërkojnë origjinalet mbi informacionin, duke përfshire dosje dhe dokument vetëm ne rastet kur kopjet e certifikuar mund te jene te pamjaftueshme. Sipas kërkesës se njërës prej Autoriteteve Doganore te Palëve Kontraktuese, kopje te këtyre dosjeve, dokumenteve dhe materialeve te tjera duhen certifikuar ne mënyrën e duhur.
3. Origjinalet e informacionit, duke përfshire dosjet dhe dokumentet qe janë dërguar, duhet te rikthehen me mundësinë me te pare.
4. Informacioni i mundësuar sipas kësaj Marrëveshjeje mund te transmetohet ne rruge elektronike me çfarëdolloj mënyre për te njëjtin qellim. Duhet te përmbajnë ne te njëjtën kohe te gjitha shpjegimet c nevojshme pet interpretimin dhe përdorimin e këtij informacioni.

Neni 11

Forma dhe përmbajtja e kërkesës për asistencë

1. Kërkesat ne zbatim te kësaj Marrëveshjeje do te bëhen me shkrim. Dokumentet e nevojshme për ekzekutimin e një kërkesë te tille duhet te bashkëshoqërojnë kërkesën. Kur për shkak te emergjencës se situatës mund t ë behet kërkesë gojore, dhe jo kërkesë ne mënyrë imediate duhet të konfirmohet nga një kërkesë me shkrim.
2. Kërkesat ne përputhje me paragrafin I te këtij Neni do te përfshijnë informacionin e mposhtëm:
 - a) emërtimin e autoritetit doganor qe bën kërkesën
 - b) masat qe kërkohet te ndërmerren;
 - c) objekti dhe shkaqet për kërkesë;
 - d) ligjet, rregullat dhe aktet e tjerë ligjore, referuar objektit te kërkesës;
 - e) treguesit sa me ekzakte dhe te zgjeruar te mundur, mbi personat qe janë ne qendër te hetimeve,
 - f) një përmbledhje te fakteve lidhur me objektin e kërkesës;
 - g) lidhjen mes asistencës se kërkuar dhe çështjes për te çilen behet fjale.
3. Kërkesa duhet te dërgohet ne anglisht ose ne një gjuhe tjetër te pranueshme prej autoritetit doganor te kërkuar.
4. Nëse kërkesa nuk i përmbush përcaktimet formale te paragrafit 2 dhe 3 te këtij neni, autoriteti doganor i kërkuar mund te kërkoje korrektimin ose plotësimin e kërkesës, gjithsesi mund te filloje marrja e masave paraprake.

Neni 12 Hetimet zyrtare

1. Nëse Autoriteti doganor i një Pale kontraktuese e kërkon, autoriteti doganor i Palës tjetër kontraktuese do te nise hetime zyrtare lidhur me operacionet te cilat janë apo duket se janë ne kundërshtim me legjislacionin ne fuqi ne territorin e shtetit te Palës kontraktuese kërkuese. Do ti komunikohen rezultatet e këtij hetimi autoritetit doganor kërkues.
2. Hetime te tilla do te kryhen sipas legjilacionit ne fuqi ne territorin e shtetit te Palës kontraktuese te kërkuar. Autoriteti doganor i kërkuar do te veproje si te ishte duke vepruar për interes te tij.
3. Sipas kërkesës, autoriteti doganor i kërkuar, ne raste te veçanta, me miratimin e autoritetit doganor te Palës tjetër kontraktuese, do te lejoje zyrtaret e autoritetit doganor te Palës kërkuese kontraktuese, te jene prezent ne territorin e shtetit te Palës kontraktuese te kërkuar, duke përfshire prezencën ne hetime zyrtare, kur punonjësit e vet janë duke hetuar shkelje qe i interesojnë autoritetit doganor kërkues.
4. Një punonjës i autoritetit doganor te Palës kontraktuese kërkuese prezent ne territorin e shtetit te Palës kontraktuese te kërkuar ne zbatim te kësaj Marrëveshjeje, do te veproje vetëm në kapacitet këshilltari dhe nen asnjë kondite nuk do te marre pjese aktive ne hetim apo te ushroje ndonjë pushtet ligjor ose hetues dhëne punonjësve te autoritetit doganor te kërkuar ne përputhje me legjislacionin kombëtar te Palës kontraktuese te kërkuar.
5. Autoriteti doganor kërkues, nëse kërkon, do te këshillohet mbi kohen dhe vendin e aksioneve qe do te ndërmerren ne përgjigje te kërkesës, ne mënyre qe te mund te kryhen aksione te përbashkëta.
6. Punonjësit e autoritetit doganor kërkues te autorizuar për hetimin e shkeljeve mund te kërkojnë qe 'autoriteti doganor i kërkuar te ekzaminoje librat përkatës, regjistrat dhe dokument te tjerë ose te dhëna nga shtypi, dhe te furnizohet me kopje te certifikuara te këtyre, ose te furnizojë me çdo informacion te lidhur me shkeljen .

7. Kur nen kushtet e vendosura nga kjo Marrëveshje, punonjësit e autoritetit doganor të një Pale kontraktuese janë prezent në territorin e shtetit të Palës tjetër kontraktuese ata duhet të jenë të afte në çdo kohë të provojnë kapacitetin e tyre zyrtar. Ata nuk duhet të mbajnë armë dhe as të veshin uniforme .

Përdorimi i informacionit

Neni 13

1. Informacioni dhe komunikimet e tjera të marra nën këtë Marrëveshje nuk do të përdoren për qëllime të tjera nga ato të specifikuar në këtë Marrëveshje, duke përfshirë përdorimin në procedime penale dhe administrative. Ato mund të përdoren për qëllime të tjera vetëm pas aprovimit paraprak me shkrim të autoritetit doganor të kërkuar dhe kushtëzuar nga konditat dhe kufizimet që mund të vendosen.

2. Dispozitat e paragrafit I të këtij neni nuk zbatohen për informacionin që ka të bëjë me shkelje lidhur me drogën narkotike dhe substancat psikotrope. Ky informacion mund t'u komunikohet autoriteteve të Palës kontraktuese kërkuese të cilat janë direkt të lidhura me luftën kundër trafikut ilegal të drogës. Gjithsesi, ky informacion nuk do të transmetohet palëve të treta pa miratimin paraprak me shkrim të autoritetit doganor të kërkuar.

3. Çdo informacion i dërguar në çfarëdo lloji forme në zbatim të kësaj Marrëveshje do të jetë i natyrës konfidenciale. Do të mbulohet nga detyrimi i sekretit zyrtar dhe do të gëzojë mbrojtjen e dhënë një Informacioni të njëjtit lloj dhe dokumenteve, sipas legjislacionit në fuqi në shtetin e Palës kontraktuese që e merr atë.

4. Pa rënë ndesh me nenin 13 dhe 14, kjo Marrëveshje nuk do të çojë dispozitat e komunitetit të cilat rregullojnë komunikimin midis shërbimeve kompetente të Komisionit të Komunitetit Evropian dhe autoriteteve doganore të Republikës Sllovaqe për çdo informacion në interes të komunitetit i cili ka të bëjë me heshtjet doganore.

Neni 14

1. Autoritetet Doganore të Palëve Kontraktuese, në përputhje me qëllimet dhe brenda fushës së veprimit të kësaj Marrëveshje mund të përdorin si fakte në regjistrat e tyre të evidencave, raportet dhe dëshmitë, dhe në proceset e sjella përpara gjykatës, informacionin dhe dokumentet e përfuara në përputhje me këtë Marrëveshje.

2. Përdorimi i një informacioni të tillë dhe dokumenteve si evidenca në gjyq dhe pesha që do të jepet këtyre do të përcaktohet në përputhje me legjislacionin kombëtar të Palës Kontraktuese.

Neni 15

Mbrojtja e të dhënave personale

Te dhënat personale të shkëmbyera nën këtë Marrëveshje do të përdoren për qëllimet e deklaruara në kërkesën për asistencë dhe kushtëzuar nga konditat që mund të vendosen autoriteti doganor i kërkuar. Te dhënat personale do të trajtohen në një natyrë konfidenciale dhe do të mbrohen në përputhje me legjislacionin në fuqi në territorin e shtetit të Palës kontraktuese kërkuese.

Neni 16
Dorëzimi i dokumenteve

Sipas kërkesës, autoriteti doganor i kërkuar, në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi në territorin e shtetit të Palës kontraktuese të kërkuar, do të njoftojë tek personi fizik apo juridik në fjalë, rezident ose i vendosur në territorin e vet, të gjitha dokumentet që bien nën fushën e veprimit të Marrëveshjes dhe që vijnë nga autoriteti doganor kërkuar.

Neni 17
Ekspertet dhe dëshmitarët

1. Sipas kërkesës së autoritetit doganor të një Pale kontraktuese, autoriteti doganor i Palës tjetër kontraktuese mund të autorizojë punonjësit e vet, me miratimin e tyre, që të paraqiten si eksperte apo dëshmitare në gjykimet ose proceset administrative lidhur me shkelje të procedurave në territorin e Shtetit të Palës kontraktuese kërkuar dhe të përgatisë objekte, akte dhe dokumente të tjera ose kopje të certifikuar të këtyre të fundit për procedime. Këta punonjës duhet të japin evidencat e marra prej tyre gjatë kohës së ushtrimit të detyrës.
2. Pala kontraktuese kërkuar është e detyruar të marrë gjithë masat e nevojshme për mbrojtjen e sigurisë personale të punonjësve gjatë qëndrimit të tyre në territorin e këtij shteti, sipas paragrafit 1 të këtij neni. Transporti dhe shpenzimet ditore të këtyre punonjësve do të mbulohen nga autoriteti doganor kërkuar.
3. Kërkesa për paraqitje duhet të tregojë qartë se në çfarë çështjeje dhe në çfarë kapaciteti do të paraqitet ky punonjës.
4. Punonjësi i autorizuar për tu paraqitur si dëshmitar apo ekspert ka privilegjin të refuzojë dhënien e evidencave apo deklaratave, nëse ka të drejtën apo është i detyruar të veprojë kështu sipas legjislacionit kombëtar të Palës kontraktuese të kërkuar apo të Palës kontraktuese kërkuar.
5. Kërkesa për paraqitje të punonjësve si eksperte apo dëshmitare do të bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi në territoret e shteteve të Palëve kontraktuese.

Neni 18
Përfshirje nga detyrimi për të dhënë asistencë

1. Nëse autoriteti doganor i kërkuar konsideron se përgjegjja ndaj një asistencë të kërkuar mund të bëhet ndesh me sovranitetin, sigurinë, ose interesat e tjera themelore të atij shteti, ose mund të përfshijë shkelje të sekretëve profesionale, komerciale apo industriale, ose mund të jetë në kundërshtim me parimet baze të sistemit të tij ligjor, kjo Pale mund të refuzojë dhënien e asistencës së kërkuar sipas kësaj Marrëveshjeje tërësisht, ose mund ta japë atë pjesërisht, ose kushtëzuar nga disa kondita apo kërkesa të caktuara.
2. Nëse autoriteti doganor i një Pale kontraktuese kërkon asistencë, i cili vete nuk do të ishte në gjendje t'ia jepte autoritetit doganor të Palës tjetër kontraktuese, ky fakt duhet përmendur në kërkesë. Përgjegjja ndaj një kërkesë të tillë do të merret në konsideratë varur nga legjislacioni në fuqi në territorin e shtetit të Palës kontraktuese të kërkuar.
3. Nëse asistencë refuzohet, vendimi dhe shkakun për refuzimin duhet të njoftohet me shkrim autoritetit doganor kërkuar pa vonesë.

Neni 19 Shpenzimet

1. Autoritetet doganore te Palëve kontraktuese do te heqin dore nga çdo kërkesë për rimbursim te shpenzimeve te dala gjate zbatimit te kësaj Marrëveshje, me përjashtim te shpenzimeve lidhur me ekspertet dhe dëshmitaret, dhe shpenzimet për përkthyesit dhe interpretuesit, kur këta nuk janë punonjës shteti. Nëse për ekzekutimin e kërkesës kërkohen ose mund te nevojiten shpenzime thelbësore dhe te një natyre te jashtëzakonshme, autoritetet doganore do te bien dakord për te përcaktuar kushtet dh termat nen te cilat do te ekzekutohet kërkesa, si dhe për mënyrën, me te cilat do te mbulohen shpenzimet.

Neni 20 Zbatimi

1. Zbatimi i kësaj Marrëveshje do ti ngarkohet autoriteteve doganore te Palëve kontraktuese. Këto autoritete do te bien dakord reciprokisht mbi rregullimet e hollësishme për këtë qellim.
2. Autoritetet doganore te Palëve kontraktuese mund te bien dakord qe shërbimet e tyre te Antikontrabandes te jene ne komunikim direkt me njeri-tjetrin.

Neni 21 Zbatimi territorial

Marrëveshja do te zbatohet ne territorin doganor te Republikës Shqipërisë dhe ne territorin doganor te Republikës së Sllovakisë.

Neni 22 Hyrja ne fuqi dhe përfundimi

1. Kjo marrëveshje do te miratohet nga Palët kontraktuese ne përputhje me legjislacionin e vet kombëtar dhe do te hyjë ne fuqi gjashtëdhjetë dite pasi Palët kontraktues te njoftojnë njëra-tjetrën me një njoftim me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike se te gjitha kërkesat ligjore kombëtare te nevojshme për hyrjen ne fuqi te Marrëveshjes janë kompletuar.

2. Kjo Marrëveshje është konkluduar për një kohëzgjatje te pakufizuar. Kjo Marrëveshje mund te përfundojë nëpërmjet një njoftimi me shkrim nga secila prej Palëve kontraktuese nëpërmjet kanaleve diplomatike dhe do te përfundojë se qeni ne fuqi tre muaj pasi një njoftim i tille është mare nga Pala tjetër kontraktuese.

3. Procedimet ne vazhdim ne kohen e përfundimit do te kompletohen ne përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

4. Kjo Marrëveshje mund te amendohet mbi bazën e marrëveshjeve te ndërsjella te Palëve kontraktuese. Amendamentet duhen bere me shkrim.

5. Sapo kjo Marrëveshje te hyje ne fuqi ne marrëdhëniet ndërmjet Republikës se Shqipërisë dhe Republikës se Sllovakisë, Marrëveshja ndërmjet Qeverise se Republikës Popullore te Shqipërisë dhe Qeverise se Republikës Socialiste te Çekosllovakisë mbi Bashkëpunimi min dhe Asistencën e Ndërsjelle ne çështjet Doganore, firmosur ne Tirane the 17 Tetor 1960, do te pushoje se ekzistuari.

Bere ne Tirane me 16.12.2004 ne dy kopje, ne gjuhen shqipe, sllovaqe dhe angleze, ku te gjitha tekstet jane njelloj autentike. Ne rast divergjence per shkak te interpretimit, do te mbizoteroje teksti ne english



VENDIM

Nr. 7, datë 13.1.2006

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS TË QIPROS, PËR ASISTENCËN E NDËRSJELLË
ADMINISTRATIVE, PËR ZBATIMIN E SAKTË TË LEGJISLACIONIT DOGANOR
DHE PËR PARANDALIMIN, HETIMIN DHE LUFTËN NDAJ SHKELJEVE
DOGANORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Qipros, për asistencën e ndërsjellë administrative, për zbatimin e saktë të legjislacionit doganor dhe për parandalimin, hetimin dhe luftën ndaj shkeljeve doganore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

MARRËVESHJE

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË QIPROS, MBI ASISTENCËN E
NDËRSJELLË ADMINISTRATIVE, PËR ZBATIMIN E SAKTË TË
LEGJISLACIONIT DOGANOR DHE PËR PARANDALIMIN, HETIMIN DHE
LUFTËN NDAJ SHKELJEVE DOGANORE**

Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Qipros, këtej e tutje referuar si Palët Kontraktuese,

duke konsideruar se shkeljet ndaj legjislacionit doganor janë të dëmshme për interesat e tyre ekonomike, tregtare, fiskale, shoqërore dhe kulturore;

duke konsideruar rëndësinë e përcaktimit të saktë të detyrimeve doganore dhe të taksave të tjera të grumbulluara gjatë importit apo eksportit, si dhe sigurimin e ushtrimit të duhur të masave mbi ndalimin, kufizimin dhe kontrollin;

duke njohur nevojën për bashkëpunimin ndërkombëtar në çështjet lidhur me zbatimin dhe ushtrimin e legjislacionit doganor;

të bindur se aksionet kundër shkeljeve doganore mund të bëhen më efektive nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet administratave të tyre doganore, bazuar në dispozita të qarta ligjore;

duke marrë në konsideratë instrumentet përkatëse të Këshillit të Kooperimit Doganor (njohur si Organizata Botërore Doganore), në veçanti rekomadimet mbi asistencën e ndërsjellë doganore të 5 dhjetorit 1953;

duke marrë në konsideratë gjithashtu konventat ndërkombëtare detyruese për të dyja palët dhe që përmbajnë ndalime, kufizime dhe masa speciale kontrolli lidhur me mallra specifike, ranë dakord për sa më poshtë vijon:

KAPITULLI I

PËRKUFIZIME

Neni 1

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje:

1. "Shpërndarje e kontrolluar" do të thotë metoda e lejimit të lëndëve narkotike apo substancave psikotrope ose substancave të përdorura zakonisht për prodhimin e paligjshëm të lëndëve narkotike ose substancave psikotrope për të kaluar nga, nëpër apo për në territorin e një apo më shumë vendeve me njohurinë dhe nën vëzhgimin e autoriteteve kompetente me synim identifikimin e personave të përfshirë në kryerjen e shkeljeve;
2. "Administratë doganore" do të thotë në Republikën e Shqipërisë- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave e Ministrisë së Financave dhe në Republikën e Qipros- Departamenti i Doganave dhe Akcizave;
3. "Detyrimet dhe taksat doganore" do të thotë detyrimet, taksat dhe të tjera, të cilat grumbullohen gjatë apo në lidhje me importimin apo eksportimin e mallrave;
4. "Legjislacioni doganor" do të thotë dispozitat rregulatore dhe statusore lidhur me grumbullimin e detyrimeve dhe taksave doganore dhe mbi importimin, eksportimin, lëvizjen dhe magazinimin e mallrave, administrimi dhe ushtrimi i të cilave i është ngarkuar specifikisht doganës, si dhe rregullore të tjera të nxjerra nga doganat sipas fuqive të tyre statusore;
5. "Shkelje doganore" do të thotë çdo shkelje apo përpjekje për shkelje të legjislacionit doganor;
6. "Informacion" do të thotë çdo e dhënë, dokumente, raporte, kopje të certifikuara dhe autentifikuara të këtyre, si dhe komunikime të tjera;
7. "Intelgjencë" do të thotë informacion i cili është përpunuar edhe/ose analizuar për të mundësuar një tregues të lidhur me shkeljet doganore;
8. "Person" do të thotë si një person fizik ashtu edhe një person juridik;
9. "Të dhëna personale" do të thotë të dhënat lidhur me një qenie njerëzore të identifikuar apo të identifikueshëm;
10. "Administratë kërkuese" do të thotë administratë doganore që kërkon asistencë;
11. "Administratë e kërkuar" do të thotë administrata doganore nga e cila kërkohet asistencë.

KAPITULLI II

FUSHËMBULIMI I MARRËVESHJES

Neni 2

1. Palët Kontraktuese nëpërmjet administratave të tyre doganore do t'i mundësojnë njëra-tjetrës asistencë administrative sipas kushteve të vendosura në këtë Marrëveshje, për zbatimin e saktë të legjislacionit doganor dhe për parandalimin, hetimin dhe luftën ndaj shkeljeve doganore.

2. E gjithë asistenca, sipas kësaj Marrëveshjeje, nga secila prej Palëve Kontraktuese do të jepet në përputhje me dispozitat e veta kombëtare konstitucionale, ligjore dhe administrative dhe brenda limiteve të kompetencave dhe e resurseve të mundshme të administratës së vet doganore.

3. Kjo Marrëveshje synon vetëm asistencën e ndërsjellë administrative ndërmjet Palëve Kontraktuese; dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk do t'i japin mundësi një personi privat për të marrë, shkelur ose hequr ndonjë evidencë apo të pengojë ekzekutimin e një kërkesë.

4. Çdo kërkesë për arrestim të ndonjë personi, si dhe për mbledhjen dhe grumbullimin me forcë të detyrimeve doganore, taksave të tjera, gjobave dhe detyrimeve të tjera do të përjashtohet nga një asistencë e tillë.

KAPITULLI III

FUSHËMBULIMI I ASISTENCËS

Neni 3

1. Administratat doganore do t'i mundësojnë njëra-tjetrës, sipas kërkesës pas me iniciativën e vet, informacion dhe inteligjencë që ndihmon në sigurimin e aplikimit të duhur të legjislacionit doganor dhe parandalimin, hetimin dhe luftën ndaj shkeljeve doganore.

2. Secila administratë doganore, gjatë bërjes së kërkimeve për llogari të administratës tjetër doganore, do të veprojë si të ishte duke i bërë këto kërkime për llogari të vet ose sipas kërkesës së një autoriteti tjetër në atë Palë Kontraktuese.

Neni 4

1. Sipas kërkesës, administrata e kërkuar do të mundësojë të gjithë informacionin mbi legjislacionin doganor dhe procedurat e aplikuar në atë Palë Kontraktuese dhe të lidhura me kërkimet që kanë të bëjnë me një shkelje doganore.

2. Secila administratë doganore do të komunikojë, sipas një kërkesë apo me iniciativë të vet, çdo informacion të mundshëm lidhur me:

- a) teknika të reja doganore antikontrabandë, të cilat kanë treguar efektivitetin e vet;
- b) tendenca, metoda apo mjete të reja të përdorura në kryerjen e shkeljeve doganore.

KAPITULLI IV

LLOJE TË VEÇANTA ASISTENCE

Neni 5

Sipas kërkesës, administrata e kërkuar do t'i mundësojë në veçanti administratës kërkuese informacionin e mëposhtëm:

- a) nëse mallrat e eksportuara që janë importuar në territorin doganor të Palës Kontraktuese

Kërkuese, janë eksportuar ligjërisht nga territori doganor i Palës Kontraktuese të Kërkuar; b) nëse mallrat që janë eksportuar nga territori doganor i Palës Kontraktuese Kërkuese, janë importuar ligjërisht në territorin doganor të Palës Kontraktuese të Kërkuar, si dhe procedurat doganore, nëse ka, nën të cilat janë vendosur këto mallra.

Neni 6

Sipas një kërkesë, administrata e kërkuar do të mundësojë informacion dhe inteligjencë dhe do të mbajë survejim special mbi:

- a) mallrat në transport apo magazinim të njoftuara nga Pala Kontraktuese se japin shkak për të dyshuar mbi një trafik të paligjshëm drejt territorit doganor të Palës Kontraktuese Kërkuese;
- b) mjete transporti të dyshuara nga administrata kërkuese se janë përdorur për të kryer një shkelje doganore në territorin doganor të njërës prej Palëve Kontraktuese;
- c) vende të dyshuara nga administrata kërkuese se janë përdorur për kryerjen e një shkeljeje doganore në territorin doganor të njërës prej Palëve Kontraktuese.

Neni 7

1. Administratat doganore do t'i mundësojnë njëra-tjetrës, sipas kërkesës apo me iniciativën e vet, informacion apo inteligjencë mbi transaksionet e kryera apo të planifikuara, të cilat përbëjnë apo duket se përbëjnë një shkelje doganore.

2. Në rastet serioze, të cilat mund të përfshijnë një dëm thelbësor për ekonominë, shëndetin publik, sigurinë publike ose çdo interes vital të një Pale Kontraktuese, administrata doganore e Palës tjetër Kontraktuese, sa herë të jetë e mundur, do të dërgojë informacion dhe inteligjencë me iniciativën e vet.

Neni 8

Administratat doganore:

- a) do të asistojnë njëra-tjetrën në respekt të ekzekutimit të masave dhe procedimeve, duke përfshirë pezullimin dhe kapjen e mallrave;
- b) do të vënë në dispozicion mallrat e konfiskuara apo të ardhurat nga shitja e tyre si rezultat i asistencës së mundësuar nga kjo Marrëveshje, në përputhje me dispozitat ligjore të Palës Kontraktuese në kontroll të mallrave apo të ardhurave.

Shpërndarja e kontrolluar

Neni 9

1. Kushtëzuar nga legjislacioni kombëtar i shteteve të Palëve Kontraktuese, administratat e tyre doganore, sipas nevojës, do të bashkëpunojnë në kontekstin e shpërndarjes ndërkombëtare të kontrolluar të lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope ose substancave të përdorura vazhdimisht për prodhimin e lëndëve narkotike apo substancave psikotrope.

2. Ngarkesat, për të cilat do të kryhet shpërndarja e kontrolluar, mundet, me marrëveshje reciproke ndërmjet administratave doganore, të interceptohen dhe të lejohen të vazhdojnë

udhëtimin e tyre të paprekura ose me mallrat e përmendura në paragrafin 1 të hequra, apo tërësisht ose pjesërisht të zëvendësuara.

3. Shpërndarja e kontrolluar do të vendoset në bazën e rast pas rasti. Këto vendime mund të përfshijnë gjithashtu rregullime financiare dhe mirëkuptime ndërmjet administratave doganore.

Antikitete dhe thesare artistike e kulturore

Neni 10

1. Administrata doganore e secilës prej Palëve Kontraktuese, me iniciativë të vet ose sipas kërkesës, do t'i mundësojë administratës doganore të Palës tjetër Kontraktuese, çdo informacion të mundshëm mbi aktivitetet që përfshijnë kontrabandën e antikiteteve dhe thesareve artistike dhe kulturore, ose mbi personat që janë të përfshirë në arktivitete të tilla.

2. Administrata doganore e secilës prej Palëve Kontraktuese, sipas kërkesës së administratës doganore të Palës tjetër Kontraktuese, do të monitorojë për një periudhë të caktuar kohore lëvizjen e mallrave të përshkruara në paragrafin 1 të këtij neni, si dhe personave të përfshirë dhe mjeteve të transportit të përdorura.

KAPITULLI V

INFORMACIONI DHE INTELIGJENCA

Neni 11

1. Informacioni origjinal do të kërkohet vetëm në rastet kur kopjet e autentifikuara apo certifikuara janë të pamjaftueshme, dhe do të kthehen, sa më shpejt të jetë e mundur, të drejtat e administratës së kërkuar apo të palëve të treta lidhur me to do të mbeten të paprekura.

2. Çdo informacion dhe inteligjencë që do të shkëmbehet sipas kësaj Marrëveshjeje, do të shoqërohet nga i gjithë informacioni i nevojshëm për interpretimin ose shfrytëzimin e tij.

KAPITULLI VI

EKSPERTËT DHE DËSHMITARËT

Neni 12

Sipas kërkesës, administrata e kërkuar mund t'i autorizojë punonjësit e vet, nëse ata pranojnë, për t'u paraqitur para një gjykate në Palën tjetër Kontraktuese si ekspertë apo dëshmitarë në një çështje, lidhur me një shkelje doganore.

KAPITULLI VII

KOMUNIKIMI I KËRKESËS

Neni 13

1. Asistenca sipas kësaj kërkesë do të shkëmbehet direkt ndërmjet administratave doganore.

2. Kërkesat për asistencë sipas kësaj Marrëveshjeje do të bëhen me shkrim dhe do të shoqërohen nga çdo dokument që konsiderohet i dobishëm. Kur situatat e kërkojnë, kërkesat mund të bëhen gjithashtu me gojë. Këto kërkesa do të konfirmohen menjëherë me shkrim.

3. Kërkesat e bëra në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni, do të përfshijnë detajet e mëposhtme:

- a) administratën që bën kërkesën;
- b) thelbin dhe shkakun për kërkesë;
- c) një përshkrim të përmbledhur të çështjes, elementet ligjore dhe natyrën e procedimit;
- d) emrat dhe adresat e palëve të përfshira në proces, nëse njihen.

4. Një kërkesë nga secila prej Palëve Kontraktuese se duhet ndjekur një procedurë e caktuar, duhet të jetë në përshtatje me dispozitat administrative dhe ligjet kombëtare të Palës Kontraktuese të Kërkuar.

5. Informacioni dhe intelijenca e përmendur në këtë Marrëveshje do t'u komunikohet punonjësve të caktuar specifikisht për këtë qëllim nga secila administratë doganore. Një listë e punonjësve të caktuar për këtë qëllim do të shkëmbehet nga administratat doganore të Palëve Kontraktuese, në përputhje me paragrafin 2 të nenit 18 të kësaj Marrëveshjeje.

KAPITULLI VIII

EKZEKUTIMI I KËRKESAVE

Neni 14

1. Nëse administrata e kërkuar nuk e ka informacionin e kërkuar, ajo, në përputhje me dispozitat e veta administrative dhe legjislacionin kombëtar:

- a) do të fillojë kërkime për ta gjetur këtë informacion;
- b) menjëherë, do t'ua transmetojë kërkesën autoriteteve përgjegjëse;
- c) do të informojë mbi autoritetet e përshtatshme përgjegjëse.

2. Çdo kërkim sipas paragrafit 1 të këtij neni mund të përfshijë marrjen e deklaratave nga personat nga të cilët është marrë informacioni në lidhje me një shkelje doganore, si dhe nga dëshmitarë apo ekspertë.

Neni 15

1. Sipas një kërkese me shkrim, punonjësit e caktuar specifikisht nga administrata kërkuese, me autorizimin e administratës së kërkuar dhe kushtëzuar nga kushtet që kjo e fundit mund të vendosë, me qëllim investigimin e një shkeljeje doganore:

- a) mund të shqyrtojnë në zyrat e administratës së kërkuar dokumentet, regjistrat dhe të dhënat e tjera të nevojshme për të nxjerrë informacion lidhur me atë shkelje doganore;
- b) mund të marrin kopje të dokumenteve, regjistrave dhe të dhënave të tjera lidhur me atë shkelje doganore;
- c) mund të jenë prezent gjatë një kërkimi të kryer nga administrata e kërkuar në territorin doganor të Palës Kontraktuese të Kërkuar dhe që ka lidhje me administratën kërkuese.

2. Kur punonjësit e administratës kërkuese janë prezent në territorin e Palës tjetër Kontraktuese sipas situatave të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, ata në çdo kohë duhet të jenë të aftë të japin prova të statusit të tyre zyrtar.

3. Ndërkohë që janë aty, ata do të gëzojnë të njëjtën mbrojtje si ajo që u jepet punonjësve doganorë së Palës tjetër Kontraktuese, në përputhje me ligjet në fuqi aty, dhe do të jenë përgjegjës për ndonjë shkelje që mund të kryejnë.

KAPITULLI IX

KONFIDENCIALITETI I INFORMACIONIT

Neni 16

1. Çdo informacion apo inteligjencë e marrë në kuadrin e asistencës administrative sipas kësaj Marrëveshjeje do të përdoret vetëm për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje dhe nga administratat doganore, me përjashtim të rasteve kur administrata doganore që ka dërguar informacionin ka miratuar shprehimisht përdorimin e tij për qëllime të tjera apo nga autoritete të tjera.

2. Çdo informacion apo inteligjencë e marrë sipas kësaj Marrëveshjeje do të trajtohet si konfidencial dhe do të gëzojë të pa ktën të njëjtën mbrojtje dhe konfidencialitet siç gëzon i njëjti lloj informacioni apo inteligjence sipas legjislacionit kombëtar të Palës Kontraktuese që e ka marrë.

Neni 17

Kur shkëmbehen të dhëna personale nën këtë Marrëveshje, Palët Kontraktuese do të sigurojnë një standard të mbrojtjes së të dhënave të paktën ekuivalent me atë që rezulton nga zbatimi i parimeve në aneksin e kësaj Marrëveshjeje, i cili përbën një pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

KAPITULLI X

PËRJASHTIME

Neni 18

1. Në rastet kur asistenca sipas kësaj Marrëveshjeje do të shkelte sovranitetin, sigurinë, politikat publike ose interesat e tjera thelbësore kombëtare të një Pale Kontraktuese, ose mund të përfshinte një shkelje të sekretit profesional, tregtar apo industrial, ose mund të binte ndesh me legjislacionin kombëtar apo dispozitat administrative, asistenca mund të refuzohet.

2. Nëse administrata kërkuese do ta kishte të pamundur të përgjigjej nëse një kërkesë e ngjashme do të ishte bërë nga administrata e kërkuar, ajo do të tërheqë vëmendjen për këtë faktor në kërkesën e vet. Përgjigjja ndaj një kërkesë e tillë do të varet nga administrata e kërkuar.

3. Asistenca mund të shtyhet nga administrata e kërkuar mbi faktin se ajo mund të ndërhyjë në një investigim në vazhdim, proces apo gjykim. Në një rast të tillë, administrata e kërkuar do të konsultohet me administratën kërkuese për të përcaktuar nëse asistenca mund të jepet në bazë të këtyre termave apo kushteve që mund të kërkojë administrata e kërkuar.

4. Kur asistenca mohohet apo shtyhet, duhet të paraqiten shkaqet për mohimin apo shtyrjen.

KAPITULLI XI

KOSTOT

Neni 19

1. Administratat doganore do të heqin dorë nga të gjitha pretendimet për rimbursimin e kostove të dala gjatë ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje, përveç shpenzimeve dhe dietave paguar ekspertëve dhe dëshmitarëve, si dhe kostot e përkthyesve dhe interpretuesve që nuk janë punonjës qeveritarë, këto do të mbulohen nga administrata kërkuese.
2. Nëse ka apo kërkohen shpenzime të një natyre thelbësore apo të jashtëzakonshme për ekzekutimin e kërkesës, Palët Kontraktuese do të konsultohen për të përcaktuar termat dhe kushtet sipas të cilave do të ekzekutohet kërkesa, si dhe mënyrën sesi do të përballohen shpenzimet.

KAPITULLI XII

ZBATIMI I MARRËVESHJES

Neni 20

1. Administratat doganore do të marrin masa në mënyrë që punonjësit e tyre përgjegjës për investigimin apo luftën ndaj shkeljeve doganore të mbajnë lidhje direkte dhe personale me njëri-tjetrin.
2. Administratat doganore do të vendosin mbi rregullimet e detajuara për lehtësimin e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje.
3. Administratat doganore do të përpiqen të zgjidhin me marrëveshje reciproke çdo problem apo dyshim të dalë nga interpretimi apo zbatimi i kësaj Marrëveshjeje.
4. Konfliktet për të cilat nuk është gjetur zgjedhje, do të zgjidhen nëpërmjet kanaleve diplomatike.

KAPITULLI XIII

ZBATIMI

Neni 21

Kjo Marrëveshje do të zbatohet në territoret doganore Të të dyja Palëve Kontraktuese, siç përcaktohet në dispozitat e tyre kombëtare konstitucionale, ligjore dhe administrative.

KAPITULLI XIV

HYRJA NË FUQI DHE PËRFUNDIMI

Neni 22

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit të dytë, pasi Palët Kontraktuese të kenë njoftuar njëra-tjetrën me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike se kërkesat konstitucionale apo të brendshme për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje janë plotësuar.

Neni 23

1. Kjo Marrëveshje është parashikuar për një kohëzgjatje të pakufizuar, por secila nga Palët Kontraktuese mund ta përfundojë atë në çdo kohë me anë të njoftimit nëpërmjet kanaleve diplomatike.

2. Përfundimi do të ketë efekt tre muaj nga data e dërgimit të njoftimit të denoncimit të Pala tjetër Kontraktuese. Procedimet në vazhdim në kohën e përfundimit do të kompletohen detyrimisht në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 24

Palët Kontraktuese do të takohen me qëllim rishikimin e kësaj Marrëveshjeje sipas kërkesës ose në fund të pesë vjetëve nga data e hyrjes së saj në fuqi, nëse nuk njoftojnë njëra-tjetrën me shkrim se një rishikim i tillë është i panevojshëm.

Dëshmitarë për sa më sipër të poshtëshënuarit, të autorizuar përkatësisht, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Kryer në Nikozia, më datë 28.6.2005 në dy kopje në gjuhët shqip, greqisht dhe anglisht, ku të gjitha janë njësoj autentike. Në rast divergjencash, teksti në anglisht do të mbizotërojë.

ANEKSI

PARIMET BAZË TË MBROJTJES SË TË DHËNAVE

1. Të dhënat personale që i nënshtrohen përpunimit automatik:

a) do të merren dhe përpunohen ndershmërisht dhe ligjërisht;

b) do të storojnë për qëllime të specifikuar dhe të ligjshme dhe nuk do të përdoren në një mënyrë të papërshtatshme me ato qëllime;

c) do të jenë adekuate, të lidhura dhe pa tejkaluar lidhjen me qëllimin për të cilin janë stuar;

d) do të jenë të sakta dhe, kur është e nevojshme, të rifreskuara;

e) do të ruhen në një formë që lejon identifikimin e subjektit të të dhënave për jo më shumë se sa kërkohet nga qëllimi për të cilin janë stuar të dhënat.

2. Të dhënat personale që zbulojnë origjinën racore, opinionet politike, besimin fetar, si dhe besime të tjera, si dhe të dhënat personale lidhur me jetën shëndetësore apo seksuale, nuk mund të përpunohen në mënyrë automatike, me përjashtim të rasteve ku legjislacioni kombëtar mundëson mbrojtjen e saktë. E njëjta gjë do të aplikohet për të dhëna personale që kanë të bëjnë me dënime kriminale.

3. Do të ndërmerren masat e duhura të sigurisë për mbrojtjen e të dhënave personale të

storuara në dosje të dhënash automatike kundër shkatërrimit të paautorizuar ose humbjes aksidentale, si dhe kundër aksesit, ndryshimit apo shpërndarjes së paautorizuar.

4. Çdo person duhet të ketë mundësi:

a) të përcaktojë ekzistencën e një dosjeje të dhënash personale të automatizuar, qëllimin e saj kryesor, si dhe identitetin dhe rezidencën e banesës ose vendin kryesor të punës së kontrolluesit të dosjes.

b) të përfitojë në intervale të arsyeshme dhe pa vonesa të tejkujtura apo shpenzime, konfirmim nëse të dhëna personale lidhur me të janë storuar në dosjen e automatizuar të të dhënave, si dhe komunikimin ndaj tij e këtyre të dhënave në formë inteligjente.

c) të përfitojë, sipas rastit fshirjen apo ndryshimin e këtyre të dhënave, nëse ato janë përpunuar në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit kombëtar që ka efekt mbi parimet bazë të përcaktuara në parimet 1 dhe 2 të këtij aneksi.

d) të informohet nëse një kërkesë për komunikim ose, sipas rastit, konfirmim, ndryshim apo fshirje siç referohet në paragrafët b dhe c të këtij parimi, nuk është plotësuar.

5.1. Nuk do të lejohen përjashtime në dispozitat sipas parimeve 1, 2 dhe 4 të këtij aneksi, me përjashtim të limiteve të përcaktuara në këtë parim.

5.2. Përjashtime nga dispozitat e parimeve 1, 2 dhe 4 të këtij aneksi do të lejohen kur këto përjashtime mundësohen nga ligji i Palës Kontraktuese dhe përbën një masë të nevojshme në një shoqëri demokratike në interes:

a) të mbrojtjes së sigurisë shtetërore, sigurisë publike, interesave monetare së shtetit apo goditjes së akteve kriminale;

b) të mbrojtjes së subjektit të të dhënave ose të drejtave dhe lirive të të tjerëve.

5.3. Kufizimet në ushtrimin e të drejtave të specifikuara në parimin 4, paragrafët b, c dhe d të këtij aneksi mund të mundësohen me ligj në respekt të dosjeve të të dhënave personale të automatizuara të përdorura për qëllime kërkimesh statistikore apo shkencore kur aty është e qartë se nuk ka risk të shkeljes së privatësisë së subjektit të të dhënave.

6. Secila Palë Kontraktuese merr përsipër të caktojë sanksionet dhe dënimet e duhura për shkeljet e dispozitave të ligjit kombëtar, të cilat kanë efekt mbi parimet bazë të caktuara në këtë aneks.

7. Asnjë prej dispozitave të këtij aneksi nuk do të interpretohet si kufizues apo që ka efekt mundësinë e një Pale Kontraktuese për t'i dhënë subjektit të të dhënave një masë më të gjerë mbrojtjeje se ajo e përcaktuar në këtë aneks.



VENDIM
Nr.150, datë 15.3.2006

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË MALIT TË ZI, PËR BASHKËPUNIM TË NDËRSJELLË NË
ÇËSHTJET DOGANORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23, të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998, "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Malit të Zi, për bashkëpunim të ndërsjellë në çështjet doganore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

MARRËVESHJE

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË MALIT TË ZI PËR BASHKËPUNIMIN E
NDËRSJELLË NË ÇËSHTJET DOGANORE**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Malit të Zi (në vijimësi referuar si "Palët kontraktuese");

duke marrë parasysh që shkeljet e legjislacionit doganor janë të patolerueshme për interesat ekonomike, fiskale, tregtare, financiare, sociale dhe ato kulturore të vendeve respektive;

duke marrë parasysh rëndësinë e sigurimit të përlogaritjes dhe vjeljes së saktë të detyrimeve doganore dhe taksave të tjera në importin apo eksportin e mallrave, si dhe përcaktimin e saktë të vlerës dhe origjinës dhe luftës kundër trafikut të paligjshëm;

të shqetësuar për shkallëzimin dhe rritjen e tendencave të trafikut të paligjshëm të lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope, duke i konsideruar ato një rrezik për shëndetin publik dhe shoqërinë;

vlerësojnë nevojën për bashkëpunim ndërkombëtar në çështje lidhur me administrimin dhe forcimin e legjislacionit doganor.

të bindur se përpjekjet për të parandaluar shkeljet doganore do të jenë më efektive nëpërmjet bashkëpunimit të administratave doganore;

duke respektuar konventat në fuqi për bashkëpunimin e ndërsjellë si rekomandimet e Këshillit të Bashkëpunimit Doganor për ndihmë të ndërsjellë administrative të 5 dhjetorit 1953, dhe rekomandimeve të tjera të Organizatës Botërore të Doganave, ranë dakord si më poshtë vijon:

Neni 1

Përkufizime

1. Për qëllime të kësaj marrëveshjeje "Legjislacion doganor" do të thotë të gjitha ligjet apo aktet ligjore të përcaktuara me ligj të shteteve të "palëve kontraktuese" për importimin, eksportimin, tranzitimin e mallrave apo ndonjë procedurë tjetër doganore që lidhen me detyrimet doganore taksat dhe detyrime të tjera, ose me masat për ndalimin, kufizimin ose kontrollin, që zbatohen nga administrata doganore.
2. Detyrime doganore" do të thotë të gjitha detyrimet doganore dhe të gjitha taksat apo pagesat të cilat parashikohen të mblidhen me importimin apo eksportimin e mallrave, por pa përfshirë kuotat dhe detyrimet të cilat kufizohen në koston e përafërt të sasisë së shërbimeve të kryera.
3. "Autoritetet kërkues" do të thotë autoriteti doganor, i cili bënë kërkesë për asistencë në përpjekje me këtë marrëveshje ose autoriteti që merr asistencë të tillë.
4. "Autoriteti i kërkuar" do të thotë autoriteti doganor, i cili merr një kërkesë për asistencë në përpjekje me këtë marrëveshje ose i cili jep një asistencë të tillë.
5. "Kundërvajtjet doganore" do të thotë çdo shkelje e legjislacionit doganor, si edhe çdo përpjekje për shkelje të këtij legjislacioni.
6. "Autoritet doganor" do të thotë ne Republikën e Shqipërisë, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave , në Republikën e Malit të Zi-administrata doganore.
- 7 "Të dhëna personale" do të thotë çdo informacion për një person fizik të identifikuar apo person fizik që mund të identifikohet në shkelje apo përpjekje për të shkelur legjislacionin doganor;
8. "Droga narkotike" do të thotë çdo substancë natyrale apo sintetike e renditur në listën I dhe listën II të Konventës Unike të vitit 1961 të Drogave Narkotike.
9. "Substancat psikotrope" do të thotë çdo substancë natyrale apo sintetike apo çdo material natyral i renditur në listat I, II, II dhe IV të Konventës së substancave psikotrope të vitit 1971.
10. "Prekursor" do të thotë çdo substancë kimike e përdorur për qëllim prodhimin e drogave narkotike dhe substancave psikotrope e renditur në listat I dhe II të Konventës së Kombeve të

Bashkuara të vitit 1988 për luftën kundër trafikut të paligjshëm të drogave norkotike dhe substancave psikotrope.

11 "Dërgesë e kontrolluar" nënkupton mënyrën e kalimit, importimit, eksportimit me dijeninë e autoriteteve doganore apo nën kontrollin e autoriteteve të këtyre vendeve të kalimit ilegal apo dysHEMEVE për kalimin ilegal të drogave narkotike, substancave psikotrope, prekursorëve apo substancave zëvendësuese të tyre me qëllim zbulimin e personave të përfshirë në këto shkelje doganore.

Neni 2

Qëllimi i Marrëveshjes

1. Autoritetet doganore të palëve kontraktuese do të ndihmojnë njëra-tjetrën mbi bazën e kushteve të përcaktuara në këtë marrëveshje për të siguruar zbatimin korrekt të legjislacionit doganor dhe në veçanti parandalimin, zbulimin, hetimin dhe luftën kundër shkeljeve doganore, për të siguruar lehtësi dhe bashkëpunim në metodat doganore.
2. E gjithë asistenca dhe bashkëpunimi dhënë në përpjekje me marrëveshjen në fjalë do të jepet në përpjekje me legjislacionin kombëtar të shteteve të palëve kontraktuese.

Neni 3

Kërkesa për asistencë

1. Mbi bazën e kërkesës së autoritetit kërkues, autoriteti i kërkuar do ta furnizojë atë me të gjithë informacionin përkatës, në mënyrë që të mundësohet siguria që legjislacioni doganor është zbatuar korrektësisht, duke përfshirë inter alia informacion lidhur me transportin dhe ngarkesën e, vendndodhjen dhe destinacionin e mallrave, vlerën dhe origjinën, gjithashtu informacionin lidhur me veprime të kryera ose të planifikuara, të cilat bien ndesh ose mund të bien ndesh me këtë legjislacion.
2. Mbi bazën e kërkesës së autoritetit kërkues, autoriteti i kërkuar do ta informojë atë nëse mallrat e eksportuara nga territori doganor i shtetit të njëjës prej palëve kontraktuese janë importuar ligjërisht në territorin doganor të shtetit të palës tjetër kontraktuese, në përputhje me legjislacionin e vet doganor, duke specifikuar nëse është e nevojshme, procedurat doganore dhe masat e kontrollit të aplikuara mbi këto mallra.
3. Mbi bazën e kërkesës së autoritetit kërkues, autoriteti i kërkuar do ta informojë atë nëse mallrat e importuara në territorin doganor të shtetit të njëjës prej palëve kontraktuese janë eksportuar posaçërisht nga territori doganor i shtetit të palës tjetër kontraktuese, në përputhje me legjislacionin doganor, duke specifikuar, nëse është e nevojshme, procedurat doganore dhe masat e kontrollit të aplikuara ndaj këtyre mallrave.
4. Mbi bazën e kërkesës së autoritetit kërkues, autoriteti i kërkuar, brenda kompetencave dhe mundësive të veta do të ndërmarrë hapat e nevojshme për të siguruar se po mbahen nën survejim:

- a) persona të caktuar, për të cilët ka baza të shëndosha mbi të cilat besohet se ata kanë shkelur apo janë duke shkelur legjislacionin doganor në fuqi në territorin e autoritetit kërkues;
- b) vende ku janë magazinuar mallra në mënyrë të tillë që të bën të dyshosh se ato janë parashikuar për t'u importuar në mënyrë të paligjshme në territorin e autoritetit kërkues;
- c) lëvizjen e mallrave të njoftuara nga autoriteti kërkues si të tilla që mund të sjellin trafik thelbësor të paligjshëm për në, apo nga territori doganor i shtetit të autoritetit kërkues, apo dyshime mbi këtë;
- d) mjetet e transportit, për të cilat ka baza të forta për të besuar se ato kanë qenë, janë ose do të përdoren për shkelje të legjislacionit doganor në territorin e shtetit të palëve kontraktues kërkuese.

Neni 4

Asistencë spontane

Autoritetet doganore të palëve kontraktuese, brenda kompetencave të tyre, do të furnizojnë njera-tjetrën me asistencë, të cilën ato e konsiderojnë të dobishme mbi zbatimin korrekt të legjislacionit doganor, veçanërisht kur ato kanë informacion lidhur me:

- akte të cilat kanë shkelur, shkelin ose do të përbëjnë shkelje të këtij legjislacioni dhe të cilat mund t'u interesojnë palës tjetër kontraktuese;
- mjete të reja ose metoda të përfshira në kryerjen e kundërvajtjeve të legjislacionit doganor;
- mallra të njohura apo të dyshuara që kanë qenë subjekt i shkeljeve doganore ndaj legjislacionit doganor në territorin e shtetit të palëve tjetër kontraktuese;
- persona të veçantë të njohur ose të dyshuar se kanë kundërvajtje ndaj legjislacionit doganor në fuqi në territorin e shtetit të njërës prej palëve kontraktuese;
- mjetet e transportit dhe kontenjerët, për të cilat ekziston informacion ose dyshime se kanë qenë përdorur, përdoren ose mund të përdoren për kryerjen e shkeljeve ndaj legjislacionit doganor në fuqi në territorin e shtetit të palës tjetër kontraktuese.

Neni 5

Asistenca teknike

1. Asistenca, siç parashikohet në këtë marrëveshje, do të përfshijë inter alia informacion lidhur me:

- a) aksione antikontrabandë që mund të ndërmerren për parandalimin e shkeljeve;
- b) metoda të reja aplikuar për kryerjen e shkeljeve;

c) observime dhe gjetje që rezultojnë nga aplikimi i sukseshëm i mjeteve dhe teknikave të reja të antikntrabandës; dhe

d) teknika të reja dhe metoda të përmirësuara të përpunimit të ngarkesave dhe pasagjerëve.

2. Autoritetet doganore të palëve kontraktuese do të kërkojnë gjithashtu kooperim, nëse kjo nuk bie në kundërshtim me legjislacionin e tyre kombëtar lidhur me:

a) iniciimin, zhvillimin ose përmirësimin e programeve specifike të trajnimit për personelin e tyre;

b) krijimin dhe mirëmbajtjen e kanaleve të komunikimit ndërmjet tyre, me qëllim lehtësimin e shkëmbimit të sigurt dhe të shpejtë të informacionit;

c) lehtësimin e koordinimit efektiv ndërmjet tyre, duke përfshirë shkëmbimin e personelit, ekspertëve dhe vendosjen e punonjësve ndërlidhës;

d) marrjen në konsideratë dhe testimin e pajisjeve ose procedurave të reja;

f) thjeshtëzimin dhe harmonizimin e procedurave të tyre respektive doganore; dhe

g) çdo çështje tjetër të përgjithshme administrative që mund të kërkojë aksione të përbashkëta.

Neni 6

Dërgesat/njoftimet

Duke u bazuar në kërkesën e autoritetit kërkues, autoriteti i kërkuar, në përputhje me legjislacionin, do të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim:

a) dorëzimin e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm;

b) njoftimin e të gjitha vendimeve të marra që bien brenda fushës së veprimit të kësaj marrëveshjeje, lidhur me një person rezident ose të vendosur në territorin e vet. Në këtë rast, do të aplikohet paragrafi 3 i nenit 7.

Neni 7

Forma dhe përmbajtja e kërkesës për asistencë

1. Kërkesat në zbatim të kësaj marrëveshjeje do të bëhen me shkrim. Dokumentet apo informacioni i nevojshëm për ekzekutimin e një kërkesë të tillë duhet të bashkëshoqërojnë kërkesën.

Nëse kërkohet, për shkak të emergjencës së situatës, mund të pranohet kërkesë gojore, por duhet të konfirmohet me shkrim, maksimumi, brenda tre ditëve punë. 2. Kërkesat, në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, do të përfshijnë informacionin e mposhtëm:

a) autoritetin kërkues të cilit i bëhet kërkesa;

b) masat që nevojitet të merren;

c) objekti dhe arsytet për kërkesë.

d) ligjet, rregullat dhe elementet e tjera ligjore të përfshira;

e) treguesit sa më ekzaktë dhe të kuptueshëm të mundur mbi personat për të cilët bën fjalë kërkesa;

f) një përmbledhje të fakteve lidhur me çështjen, përveç rasteve të parashikuara në nenin 6 të kësaj marrëveshjeje; dhe

g) lidhjen mes asistencës së kërkuar dhe çështjes për të cilën bëhet fjalë.

Kërkesa duhet të dërgohet në një gjuhë zyrtare të autoritetit doganor, në anglisht ose në një gjuhë të pranueshme prej atij autoriteti.

Asistenca do të kryhet nëpërmjet komunikimit direkt mes autoriteteve respektive doganore.

Në rastin kur autoritetet doganore të palës kontraktuese të kërkuar nuk janë agjencia kompetente për të përmbushur kërkesën, ajo do ta transmetojë në mënyrë ekzakte kërkesën tek organet kompetente, të cilat do të veprojnë sipas kërkesës në përputhje me fuqitë e tyre sipas ligjit ose do të këshillojnë autoritetin kërkuar mbi procedurat që duhen ndjekur lidhur me një kërkesë të tillë.

Nëse kërkesa nuk i përmbush detyrimet formale, mund të kërkohet korrektimi ose kompletimi, gjithsesi mund të bëhet kërkesë për marrjen e masave paraprake.

Neni 8

Ekzekutimi i kërkesës

1. Autoriteti i kërkuar do të marrë të gjitha masat të cilat i gjykon të arsyeshme për të ekzekutuar kërkesën dhe nëse është e nevojshme, do të përpiqet të kërkojë çfarëdolloj mase ligjore apo zyrtare të duhur për realizimin e kërkesës.

2. Autoriteti doganor i një pale kontraktuese, sipas kërkesës së autoritetit doganor të palës tjetër kontraktuese, do të bashkërendojë çfarëdolloj investigimi të nevojshëm, duke përfshirë marrjen në pyetje të ekspertëve ose të dëshmitarëve, ose të personave të dyshuar se kanë kryer një shkelje, dhe do të ndërmarrë verifikime, inspektime dhe hetime për gjetje faktesh lidhur me çështjet e referuara në marrëveshjen në fjalë. Në këto investigime autoriteti i kërkuar i palës kontraktuese do të procedojë si të ishte duke vepruar për interes të vet. Rezultatet e këtij investigimi do t'u dërgohen autoriteteve kërkuese të palës kontraktuese.

3. Sipas kërkesës, autoriteti doganor i kërkuar, në mundësitë e veta maksimale, do të lejojë nëpunësit e autoritetit kërkuar të jenë prezent në territorin e shtetit të autoritetit të kërkuar të palëve kontraktuese, ndërkohë që nëpunësit e vet janë duke kryer investigime mbi shkeljet që i interesojnë autoritetit kërkuar. Ata duhet të provojnë aftësitë e nëpunësve të tyre. Në këto raste, nëpunësit e palës kërkuese mund të marrin pjesë aktivisht në investigim.

4. Autoriteti kërkuar, nëse kërkon, do të informohet mbi kohën dhe vendin e aksioneve që do të ndërmerren në përgjigje të kërkesës së kryer, në mënyrë që aksionet të koordinohen.

5. Nëpunësit e autoritetit kërkuar, të autorizuar për të investiguar shkeljet, mund të kërkojnë që autoriteti i kërkuar të bëjë ekzaminimin e regjistrave, librave, dokumenteve, të dhënave mediatike të tjera dhe të furnizohen me çfarëdolloj informacioni lidhur me shkeljet doganore.

Neni 9

Forma me të cilën do të komunikohet informacioni

1. Autoriteti i kërkuar do t'i komunikojë rezultatet e arritura autoritetit kërkuar në formën e dokumenteve, kopjeve të noterizuara të dokumenteve, raporteve dhe të ngjashmeve me to dhe kur është e nevojshme, gojarisht.

2. Dokumentet e përcaktuara në paragrafin 1 mund të zëvendësohen nga informacion i kompjuterizuar, prodhuar në çdo formë për të njëjtin qëllim, do të shoqërohet bashkë me të

çdo informacion i nevojshëm për interpretimin dhe përdorimin e informacionit të kompjuterizuar.

Neni 10

Përfshirje nga detyrimi për të dhënë asistencë

1. Në rastet kur autoriteti i kërkuar është i mendimit se përgjigja ndaj një kërkesë për asistencë mund të bjerë ndesh me sovranitetin, sigurinë, politikën publike ose interesat tjerë themelore kombëtare, ose mund të shkelë sekrete profesionale, komerciale apo industriale, asistencën mund të refuzohet ose mund të përmbushet vetëm në bazë të respektimit të disa kushteve ose kërkesave. Asistencën gjithashtu mund të refuzohet nëse kërkesa përfshin rregulla (ligje) valutore ose tatimore të tjera nga ligjet mbi detyrimet doganore.
2. Kur autoriteti kërkuar kërkon asistencë, i cili vetë nuk mund ta përmbushë nëse i kërkohej diçka e tillë, kjo gjë duhet të theksohet në kërkesë. Në këtë rast varet nga autoriteti i kërkuar vendimi se si do t'i përgjigjet një kërkesë të tillë.
3. Nëse asistencën pezullohet apo mohohet, autoriteti kërkuar duhet të njoftohet pa vonesë lidhur me këtë vendim dhe mbi shkaqet që çuan aty.

Neni 11

Detyrimet e ruajtjes së konfidencialitetit

1. Çdo informacion i komunikuar në çfarëdo formë në përputhje me këtë marrëveshje, do të jetë i një natyre konfidenciale dhe do të gëzojë të njëjtën mbrojtje të zgjeruar nën ligjet përkatëse lidhur me një informacion të njëjtë me atë të aplikuar në palën kontraktuese që e merr atë.
2. Të dhënat personale mund të transmetohen vetëm nëse legjislacioni i palëve kontraktuese është ekuivalent në lidhje me nivelin e ruajtjes së të dhënave personale. Palët kontraktuese duhet të sigurojnë një nivel mbrojtjeje të bazuar në principet e parashtruara në aneksin bashkëlidhur kësaj marrëveshjeje, e cila është pjesë përbërëse e saj.

Neni 12

Përdorimi i informacionit

1. Informacionet, dokumentet dhe komunikimet e tjera të marra në kursin e asistencës reciproke mund të përdoren vetëm për qëllimet e specifikuar në marrëveshjen në fjalë, duke përfshirë përdorimin në proceset gjyqësore dhe administrative.
2. Autoriteti kërkuar nuk do të përdorë evidencat ose informacionin e marrë nën këtë marrëveshje për qëllime të tjera veç atyre të përcaktuara në kërkesë, përpara marrjes së konsensusit me shkrim nga autoriteti i kërkuar.

3. Kur nën këtë marrëveshje janë shkëmbyer të dhëna personale, autoritetet doganore të palëve kontraktuese duhet të sigurojnë se këto të dhëna do të përdoren vetëm për qëllimet e përcaktuara në kërkesë dhe në përputhje me kushtëzimet që mund të imponojë pala e kërkuar.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni nuk do të zbatohen për informacionet që kanë të bëjnë me shkelje lidhur me drogat narkotike dhe substancat psikotrope. Informacione të tilla mund t'u komunikohen autoriteteve të shtetit të autoritetit kërkuar të cilat janë direkt të lidhura me luftën ndaj trafikut ilegal të drogës.

Neni 13

Lufta kundër trafikut të paligjshëm të drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve

1. Autoritetet doganore të dy palëve do të ndihmojnë njëra-tjetrën në parandalimin dhe investigimin e trafikut të paligjshëm të drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve, duke i siguruar njëra-tjetrës, mbi bazën e një kërkesë me iniciativën e vet, gjithë informacionin e nevojshëm mbi:

a) metodat e luftës së trafikut të paligjshëm të drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve;

b) principet e kontrollit doganor mbi drogat narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve, metodat e reja dhe mënyrat e deduktimit;

c) publikimet profesionale dhe shkencore të kohëve më të fundit dhe ndihma në trajnim lidhur me luftën kundër trafikut të paligjshëm të drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve;

d) llojet e reja të drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve, vendi i prodhimit, rrugët e përdorura nga kontrabandistët dhe metodat e fshehjes, ndryshimet e çmimit të drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve në vende dhe rajone të ndryshme.

2. Autoriteti doganor i njërit nga palët kontraktuese, me iniciativën e vet dhe në formë të dokumentuar, i ofron autoritetit doganor të palës tjetër kontraktuese gjithë informacionin lidhur me:

a) personat fizikë dhe juridikë, të njohur apo të dyshuar si pjesëmarrës në importimin, eksportimin apo trafikimin e paligjshëm të drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve;

b) Metodatat e reja dhe mënyrat e përdorura në trafikun e paligjshëm të drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve;

c) Mallrat apo pakot postale të njohura apo të dyshuara si objekt i trafikut të paligjshëm të drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve;

d) Mjetet e transportit të njohura apo të dyshuara për t'u përdorur me qëllim trafikimi të paligjshëm të drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve.

Neni 14

Dërgesat e kontrolluara

1. Autoritetet doganore të palëve kontraktuese do të bashkëpunojnë në implementimin e metodave për dërgesat e kontrolluara.
2. Vendimi mbi implementimin e metodave të dërgesave të kontrolluara do të merret në çdo rast konkret në përputhje me legjislacionin në fuqi të shteteve të palëve kontraktuese.

Neni 15

Skedarët, dokumentet dhe dëshmitarët

1. Autoritetet doganore të palëve kontraktuese, sipas kërkesës, do të japin dokumentacion l idhur me transportin e mallrave duke treguar vlerën, origjinën, vendndodhjen dhe destinacionin e këtyre mallrave.
2. Origjinalet e skedarëve, dokumenteve dhe materialeve të tjera do të kërkohen vetëm në rastet kur kopjet janë të pamjaftueshme. Në bazë kërkesë specifike, kopjet e këtyre dosjeve, dokumenteve dhe materialeve të tjera duhet të autentifikohen (noterizohen) saktësisht.
3. Origjinalet e dosjeve, dokumenteve dhe materialeve të tjera që kanë qenë dërguar tek autoriteti kërkues, duhet të kthehen me mundësinë si më parë. Të drejtat e autoritetit të kërkuar ose të palëve të treta lidhur me to, do të mbeten të paprekura. Sipas kërkesës së autoritetit të kërkuar, origjinalet e nevojshme për procedime ose qëllime të ngjashme duhet të kthehen pa vonesë
4. Sipas kërkesës së autoritetit doganor të njëjës prej palëve kontraktuese, autoriteti doganor i palës tjetër kontraktuese do të autorizojë nëpunësit e vet (sipas përzgjedhjes së saj) nëse këta nëpunës pranojnë një gjë të tillë, të paraqiten si dëshmitarë në procese penale ose administrative në territorin e autoritetit kërkues, dhe të prodhojnë dokumente, dosje dhe materiale të tjera, ose kopje të autentifikuara të tyre, të cilat mund të konsiderohen të nevojshme për proceset. Një kërkesë e tillë duhet të specifikojë kohën, vendin dhe tipin e procesit, si dhe statusin nën të cilin ky nëpunës do të dëshmojë.

Neni 16

Shpenzimet

1. Autoritetet doganore të palëve kontraktuese do të heqin dorë nga çdo kërkesë për rimbursimin e shpenzimeve të dala gjatë vënies në zbatim të marrëveshjes në fjalë, me përjashtim të shpenzimeve lidhur me dëshmitarët, ekspertët dhe shpenzimet për përkthyesit që nuk janë punonjës shtetërorë.

2. Nëse kërkohen ose do të kërkohen shpenzime të një natyre të jashtëzakonshme lidhur me ekzekutimin e kërkesës, autoritetet doganore të palëve kontraktuese do të konsultohen për përcaktimin e kushteve dhe termave nën të cilat do të ekzekutohet kërkesa, si dhe mbi mënyrën e lindjes së këtyre shpenzimeve.

Neni 17

Zbatimi i marrëveshjes

1. Vënia në zbatim e kësaj marrëveshjeje do t'i ngarkohet autoriteteve doganore të palëve kontraktuese. Ato do të vendosin mbi rregullimet e nevojshme për zbatimin e marrëveshjes, duke respektuar rregullat në fushën e ruajtjes së të dhënave.
2. Autoritetet doganore të palëve kontraktuese mbi bazë konsultimesh mund të paraqesin akte statusore të nevojshme për zbatimin e marrëveshjes.
3. Autoritetet doganore të palëve kontraktuese mund të përcaktojnë vetë për shërbimet e tyre investiguese, komunikimin e tyre të drejtpërdrejtë.

Neni 18

Zgjidhja e konflikteve

Të gjitha konfliktet në lidhje me interpretimin apo zbatimin e dispozitave të kësaj marrëveshjeje do të zgjidhen përmes konsultimesh apo negociatash të palëve kontraktuese.

Neni 19

Procedura e ndryshimeve dhe përmirësimeve

Kjo marrëveshje mund të ndryshohet apo përmirësohet nëpërmjet marrëveshjesh reciproke të palëve kontraktuese. Ndryshimet dhe përmirësimet do të legalizohen nga protokollet respektive, të cilat do të jenë pjesë përbërëse e saj.

Neni 20

Shtrirja territoriale

Kjo marrëveshje do të zbatohet në territoret doganore të dy shteteve të palëve kontraktuese, si parashikohet në legjislacionin e tyre kombëtar.

Neni 21

Hyrja në fuqi dhe përfundimi

1. Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit që pason muajin e marrjes së notës së fundit me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike, me të cilat palët kontraktuese njoftojnë njëra-tjetrën se janë përmbushur të gjitha kërkesat e brendshme respektive ligjore për hyrjen në fuqi të marrëveshjes.

2. Autoritetet doganore të palëve kontraktuese bien dakord të takohen deri në fund të pesë viteve me qëllim rishikimin e kësaj marrëveshjeje ose të diskutojnë probleme në fushën e doganave, të cilat mund të lindin gjatë këtij bashkëpunimi dhe, nëse nuk është e nevojshme, t'i zyrtarizojnë njëra-tjetrës me shkrim se rishikime të tilla nuk janë të nevojshme.

3. Kjo marrëveshje është menduar të jetë e pakufizuar në kohë, derisa njëra nga palët t'i japë fund me shkrim. Marrëveshja zgjidhet pas gjashtë muajve që kur pala tjetër merr njoftimin zyrtar nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Dëshmitarë për sa më sipër, nënshkruesit, të autorizuar nga qeveritë e tyre respektive, kanë nënshkruar këtë marrëveshje.

Bërë në Tiranë më 23 dhjetor 2005, në dy kopje, secila në gjuhën shqip, serbisht dhe anglisht, ku të gjitha tekstet janë njëlloj autentike. Në rast divergjence për shkak të interpretimit, do të mbizotërojë teksti në anglisht.

ANEKS

MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

1. Të dhënat personale që i nënshtrohen përpunimit automatik:

a) do të merren dhe përpunohen me ndershmëri dhe në mënyrë ligjore;

b) do të ruhen për qëllime të caktuara dhe të ligjshme dhe nuk përdoren në ndonjë mënyrë që nuk përputhet me këtë qëllim;

c) janë adekuate, me lidhje dhe jo ekstreme për qëllimet për të cilat janë ruajtur;

d) të sakta, dhe kur është e nevojshme, të rinovuara;

e) ruhen në formën që lejon identifikimin e të dhënave, me kusht për jo më gjatë sesa kërkohet për qëllimet për të cilat ruhen ato të dhëna.

2. Të dhënat personale që lidhen me origjinën raciale, bindjet politike, fetare, dhe të dhëna lidhur me shëndetin apo jetën seksuale, mund të mos përpunohen në mënyrë automatike nëse ligjet e brendshme nuk garantojnë sigurinë e duhur. E njëjta aplikohet edhe për të dhënat personale në lidhje me të dënuarit për krime.

3. Duhet të merren masat e duhura të sigurimit për mbrojtjen e të dhënave personale të ruajtura në skedaret e kompjuterizuar të të dhënave përkundrejt ndonjë shkatërrimi të

paautorizuar apo humbje aksidentale, si dhe kundër futjes së paautorizuar tek ato, ndryshimit apo shpërndarjes së tyre.

4. Çdo person duhet të ketë mundësi:

a) të përcaktojë ekzistencën e një skedari të kompjuterizuar të të dhënave personale, qëllimet kryesore që ka ky skedar, si dhe identitetin dhe vendqëndrimin e rregullt apo vendndodhjen kryesore të kontrolluesit të këtij skedari;

b) të përfitojnë në intervale të arsyeshme dhe pa vonesa të tepruara apo shpenzime, konfirmimin nëse të dhënat personale që lidhen me të janë ruajtur në skedarët e kompjuterizuar të të dhënave dhe se këto të dhëna i komunikohen atij në një formë të lexueshme;

c) të përfitojë, sipas rastit, korrigjimin apo fshirjen e të dhënave të tilla nëse ato janë përpunuar në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit të brendshëm dhe cenojnë parimet bazë të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij aneksi;

d) t'i mundësohet mbështetje nëse një kërkesë për komunikim, ose komunikim sipas rastit, përshtatje, fshirje të dhënash si parashikohet në nënparagrafët b dhe c të këtij paragrafi nuk është e zbatueshme.

5.1 Nuk lejohet përjashtim nga pikat 1, 2 dhe 4 të këtij aneksi, me përjashtim të rasteve brenda kufijve të përcaktuara në këtë paragraf.

2. Shmangia nga dispozitat e pikave 1, 2 dhe 4 të këtij aneksi lejohet vetëm atëherë kur një shmangie e tillë parashikohet me ligj të palës kontraktuese dhe përbën një masë të domosdoshme për një shoqëri demokratike dhe është në interes:

a) të mbrojtjes së sigurisë shtetërore, qetësie publike, interesave monetare të shtetit ose dënimin e shkeljeve kriminale ;

b) të mbrojtjes së thelbit të të dhënave të drejtave të lirisë së të tjerëve.

3. Kufizimi për ushtrimin e të drejtave të përcaktuara në pikën 4, në nënparagrafët "b", "c" dhe "d" të këtij aneksi mund të sigurohen me ligj në rastin e dosjeve të të dhënave personale të kompjuterizuara, të përdorura për qëllime statistikore apo për kërkime shkencore kur aty nuk ka asnjë rrezik të dukshëm për shkelje të privacisë së subjektit të dhënë.

Çdo palë kontraktuese merr përsipër përcaktimin e sanksioneve të duhura dhe përmirësimin e ligjit të brendshëm për shkeljen e dispozitave të cilat kanë efekt në principet bazë të përcaktuara në këtë aneks.

Asnjë nga dispozitat e këtij aneksi nuk do të interpretohet si kufizim apo ndikim mbi mundësitë e një pale kontraktuese për t'i dhënë subjektit të të dhënave një masë më të gjerë mbrojtjeje nga ajo që është përcaktuar në këtë aneks.



MARREVEESHJE

NDERMJET KESHILLIT TE MINISTRAVE TE REPUBLIKES SE SHQIPERISE DHE QEVERISE SE REPUBLIKES SE AUSTRISE MBIBASHKEPUNIMIN PER ZHVILLIM

Keshilli i Ministrave i Republikes se Shqiperise, me poshte permendur. Si Pala Shqiptare” dhe, Qeveria e Republikes se Austrise, me poshte permendur "Pala Austriake"

Duke pasur si qellim forcimin e lidhjeve te miqesise ndermjet te dy vendeve,

Me deshiren per t'i fuqizuar keto marredhenie permes zhvillimit, shtrirjes dhe qellimit te bashkepunimit te tyre per zhvillim,

Duke synuar qe te kontribuojne per nje rritje ekonomike dhe nje zhvillim te qendrueshem e te barabarte nga ana shoqerore si edhe drejt reformave politike, ekonomike e shoqerore te nevojshme qe Shqiperia t'i pershtetet gjithnje e me shume strukturave te BE, dhe,

Duke synuar qe te kontribuojne ne qellimet e pergjithshme te Bashkepunimit Austriak per Zhvillim sic parashikohen ne Ligjin e Bashkepunimit per Zhvillim te vitit 2002, te tilla si ulja e varferise, ruajtja e paqes dhe sigurise njerezore, si edhe ruajtja e mjedisit,

Duke ripohuar perkushtimin e tyre per te nxitur vlerat dhe standartet europiane per gjate gjithje bashkepunimit te tyre sic behet referim ne kriteret per anetaresimin ne BE te pershkruara nga Keshilli European i Kopenhagen-it i vitit 1993 - demokracia, sundimi i ligjit, mbrojtja e te drejtave te njeriut dhe respektimi i pakicave, nje ekonomi tregu funksionale dhe aftesia per t'iu pershtatur *acquis communautaire*,

Kane rene dakord per sa vijon:

Neni 1

Qellimi i Marreveshjes

Kjo Marreveshje percakton afatet dhe kushtet e pergjithshme per bashkepunimin per zhvillim ndermjet Shqiperise dhe Austrise te financuara mbi baze grantesh dhe te neruara si Ndihme Zyrtare per Zhvillim.

Neni 2

Synimet dhe Parimet

Te dy palet do te nxisin, Brenda kuadrit te legjislacioneve perkatese te brendshme te tyre, programe dhe projekte per bashkepunimin e perbashket per zhvillim.

Te dy palet do te bazojne bashkepunimin e tyre ne zotimet e Deklarates se Parisit mbi efektshmerine e ndihmes dhe do te ndermarrin veprime ne drejtim te realizimit te premtimeve te zoterimit, grupimit, harmonizimit, drejtimit me synim rezultatet dhe besueshmerine e ndersjellte.

Te dy palet do te perpiqen te vene ne levizje maksimumin e burimeve oer te bashkefinancuar programe dhe projekte te perbashketa per qellimet e kesaj marreveshje. Si parim, ortaket nga te dyvendet do te kontribuojne me burimet e tyre per venien ne jete te cdo program dhe projekti.

Neni 3

Format e bashkepunimit

Bashkepunimi per zhvillim mund te jete ne formen e bashkepunimit teknik apo financiar, te ndihmeses humanitare apo asaj per raste emergjencash. Ai mund te kryhet mbi baza krejtesisht dypaleshe apo gjithashtu ne bashkepunim me donator te tjere dhe/ose oganizata shumepaleshe.

Neni 4

Delegimi i pushteteve, dialogu mbi politikat

Te dy palet do te perfaqesojne qeverite e tyre perkatese ne ceshtjet qe lidhen me venien ne jete te kesaj Marreveshje. Perfaqesues te ted y Paleve do te takohen rregullishjt me qellim qe te percaktojne perparesi te perbashketa dhe parime te bashkepunimit, te japin udhezime per venien ne jete te programeve dhe projekteve te ardhshme te bashkepunimit per zhvillimi, te perfshihen ne dialogun mbi politikat dhe te vleresojne perparimin e programeve. Perfundimet e cdo takimi do te rregjistrohen me shkrim dhe do te nenshkruhen nga perfaqesuesit e ted y Paleve.

Neni 5

Dispozita te pergjithshme mbi perjashtimet nga taksat dhe tarifat doganore

Me qellim qe te lehtesohet venia ne jete e cfaredo prjekti sipas kesaj Marreveshje, Pala shqiptare do te :

perjashtoje te gjitha mallrat, perfshire ketu pajisjet dhe materialet, punimet dhe sherbimet, e siguruara apo financuara mbi bazen e nje granti nga Austria, nga taksat, detyrimet doganore, detyrimet fiskale (perfshire ketu TVSH) dhe detyrime te tjera, jane te gjitha lejet, autorizimet, licencat, miratimet ose cdo dokumet te ngjashem qe eshte i nevojshem per importin (perfshire ketu importin e perkohshsem)dhe riekspertimin e paisjeve te kerkuara per venien ne jete te projekteve

Neni 6

Kushtet per institucionet, OJQ-te dhe Shoqerite e vendeve te tjera

Kur institucione, organizata joqeveritare, shoqeri apo persona te tjere juridike nga vende te ndryshme nga Shqiperis kontaktohen nga Austria per te kryer detyra ne Shqiperi. Brenda

kuadrit te bashkepunimit per zhvillim ndermjet Austrise dhe Shqiperise, sa vijon do te zbatohet ne Shqiperi:

Persona te tille juridike nuk do te mbajne pergjegjesi per mosarritjen e plotesimit te atyre qe kishin marre persiper nese kjo i detyrohet udhezimeve aapo rekomandimeve ne lidhje me sigurine te leshuara nga Pala Austriake.

Ata do te kene te drejten te importojne dhe riekspertojn, te perjashtuar nga detyrimet doganore dhe detyrime te tjera te ngjashme, pajisje profesionale dhe mallrat qe atyre u nevojiten per te permbushur ato qe kane marre persiper, apo ti shesin te tilla pajisje brenda Shqiperise, pas pagimit te detyrimeve doganore dhe detyrimeve te tjerate ngjashme kur keto nuk jane me te nevojshme per te siguruar sherbimet e tyre.

Ato do te perjashtohen nga taksat dhe taksime te tjera te ngjashme mbi perfitimet e shoqerive, mbi bazen e xhiros apo cdo baze tjeter te ngjashme dhe mbi pagesat apo shperblimet qe u paguhen atyre nga Austria per sherbimet e tyre brenda kuadrit te projekteve / programeve te bashkepunimit per zhvillim.

Ata do te kene te drejten te hapin llogari bankare ne vende te tjera qe t'i vene ato ne veprim per permbushjen e atyre qe kane marre persiper. Mbajtja me efikasitet e llogarive nuk do te pengohet nga kontrolli mbi shkembimet financiare te huaja apo detyrime te vena nga Shqiperia dhe balanca ne keto llogari te huaja do te jete lehtesisht e transferueshme ne cfaredo monedhe te shkembueshme.

Ata do te perjashtohen nga te gjitha detyrimet per tu rregjistruar ne Shqiperi per autorizime te natyres profesionale, taksa apo arsye te tjera, dhe do nuk do te kene asnje detyrim per tu paraqitur informacion autoriteteve te taksave te Shqiperise pervecse kur ato kryejne veprimtari biznesi ne Shqiperi te cilat nuk perfshihen ne kete Marreveshje.

Neni 7

Kushtet e personelit nga vende te tjera

Kushtet ne vijim do te zbatohen ne Shqiperi ndaj personave fizike qe nuk jane banues te perhershem ne Shqiperi, perfshire ketu edhe qytetaret e Shqiperise te ulet:

a) po kryejne detyra ne Shqiperi brenda kuadrit te programeve / projekteve te bashkepunimit per zhvillim te financuara nga Austria; me kusht qe ata apo punedhenesi i tyre te kete nje kontrate me Austrine;

b) jane bashkeshorte, bashkebanues apo persona ne varesi te personave pjese e personelit te permendur ne piken (a) me lart.

Ligjet e Shqiperise do te zbatohen per kete personel te referuar ne pikat (a) dhe (b) te paragrafit te mesiper, pervecse kur eshte rene dakord ndryshe ne kete Marreveshje apo ne marreveshje te tjera ndermjet paleve.

Pala shqiptare do ta garantoje personelin referuar ne pikat (a) dhe (b) te paragrafit te pare te ketij neni, per sa vijon:

a) Miratimin dhe leshimin e shpejte, pa pagese, me shume hyrje dalje, te vizave per te rihyre dhe dale per gjate gjithë kohes se detyres se tyre.

b) Levizjen e lire brenda vendit dhe te drejten per te hyre dhe per tu larguar nga vendi ne shtrirjen e nevojshme per venien ne jete te programit/projektit.

c) Leshimin e shpejte te te gjithë lejeve apo licencave te tilla si leje qendrimi, leje pune, leje kerkimore dhe leje profesionale si edhe perjashtimin nga kufizimet mbimigrimin dhe rregjistrimin e te huajve gjate periudhes qe ata jane te mbuluar ngakjo Marreveshje.

d) Lehtesi te njejta riatdhesimi si per personelin e misioneve diplomatike ne raste krizash te brendshme apo nderkombetare.

Pala shqiptare do ta garantoje personelin per sa vijon:

a) Perjashtimin nga taksa mbi te ardhurat vetjake dhe cdo takse tjeter e drejtperdrejte ne lidhje me pagat qe u paguhen atyre nga Austria ose nga nje punedhenes qe ka marre persiper te kryeje sherbime apo te shperndaje mallra ne nje kontrate me Austrine apo Shqiperine drejtperdrejt apo si nenkontraktues.

b) Te drejten per te importuar dhe riekportuar, te perjashtuar nga detyrimet doganore apo detyrime te tjera, pajisje profesionale dhe mallra qe i nevojiten personelit per te kryer detyren e tyre.

Personelit qe sherben per me shume se gjashte muaj do t'i garantohet edhe sa vijon:

a) E drejta per ta hapur dhe vene ne veprim nje llogari te jashtme bankare ne Shqiperi per nevojat e tyre vetjake, llogari te tilla do te jene te perjashtuara nga cdo kontroll mbi shkembimet financiare apo detyrime te vena nga Shqiperia dhe balancat do te jene lehtesisht te transferueshme ne cfaredo monedhe tjeter te shkembyseshme.

b) Perjashtimi nga detyrimet mbi importin dhe eksportin, tarifate doganore dhe detyrime te tjera, pagesa, taksime apo cfaredo detyrimesh te tjera perfshire ketu edhe TVSH, mbi sendet vetjake dhe shtepiake, duke perfshire por duke mos u kufizuar ne pajisjet shtepiake, sendet vetjake dhe automjetet. Sendet e importuara ne kete menyre mund t'i shiten personave te tjere te cilet edhe ata gezojne perjashtime. Nese sendet e importuara ne kete menyre disponohen ndryshe, per te paguhen detyrimet dhe/ose pagesat e pershtatshme.

Shqiperia mund te kerkoje largimin apo zevendesimin e cilitdo pjesetar te personelit te vene ne dispozicion nga Austria, puna apo sjellja e te cilit leresohet e pakenaqshme. Austria mund te largoje cilindo pjesetar te personelit te saj.

Neni 8

Zbatimi

Per palen Austriake, pergjegjesia per venien ne jete te Programit Austriak per Bashkepunimin per Zhvillim te Ministrise Austriake te Puneve te Jashtme, bie mbi Agjencine Austriake te Zhvillimit. Bashkerendimi i projekteve do te sigurohet nga perfaqesuesi i Bashkepunimit Austriak per Zhvillim ne Tirane. Per Palen shqiptare, bashkerendimi i projekteve do te sigurohet nga Departamenti i Bashkerendimit te strategjive dhe Koordinimit te Ndhimes se Huaj. Ata do te informojne rregullisht njeri tjetrin mbi perparimin e bere ne lidhje me venien ne jete te projekteve te marra persiper sipas kesaj Marreveshje.

Secili projekt sipas qellimit te kesaj Marreveshje do ti nenshkrohet nje kontrate te posacme ndermjet partnereve te vecante te projektit duke percaktuar me hollesi te drejtat dhe detyrimet qe i lindn cdo partneri te projektit.

Rregullat dhe procedurat e zbatueshme per blerjen e sherbimeve, mallrave dhe sherbimeve do te percaktohen ne kontratat qe do te rregullojne programet/projektet sipas kesaj Marreveshje.

Neni 9

Klauzola kunder korrupsionit

Te dy Palet kane si shqetesim te perbashket luften kunder korrupsionit cka ve ne rrezik e mire dhe perdorimin e duhur te burimeve te nevojshme per zhvillim e per me teper rrezikon konkurrimin e lire e te hapur te bazuar mbi cmimin e cilesine. Si rrjedhim, ato deklarojne qellimin e tyre per te kombinuar perpjekjet per te luftuar korrupsionin dhe deklarojne ne vecanti se asnje oferte, dhurate, pagese, konsiderate apo perfitim i cfaredolloji, i cili perben nje veprim te paligjshem jo praktike korruptive, as nuk eshte bere e as do te behet drejtperdrejt apo terthorazi si nje shtyse apo shperblim per zbatimin e kesaj Marreveshje. Cfaredo shperdorimi i ketij lloji perben nje baze e mjaftueshme per ta perfunduar kete Marreveshje apo per te ndermarre cfaredo mase tjeter shtrenguese te parashikuar nga legjislacioni ne fuqi, perkates i paleve.

Neni 10

Shtesa, interpretime

Cfaredo shtese ndaj kesaj Marreveshje do te behet me shkrim. Cfaredo shtese e tille te hyje ne fuqi sipas procedures se percaktuar ne Nenin 11.

Cfaredo konflikti ne lidhje me interpretimin apo zbatimin e kesaj Marreveshje do te lidhet miqesisht perms kanaleve diplomatike

Neni 11

Hyrja ne fuqi, perfundimi

Kjo Marreveshje do te hyje ne fuqi ne ditën e pare te muajit qe pason muajin ne. cilin te dy Palet kane njoftuar njera tjetren per permbushjen e te gjitha procedurave te nevojshme ne vendet e tyre perkatese. Zbatimi i kesaj Marreveshje do te mbuloje te gjitha projektet vazhdim dhe projekte qe jane duke u pergatitur, pervecse kur parashikohet ndryshe ne Marreveshjen perkatese te projektit.

Marreveshja mund te perfundohet me shkrim nga cilado Pale ne cdo kohe. Perfundimi do te kete fuqi ne ditën e pare te muajit te trete pas njoftimit permes kanaleve diplomatike. Ai nuk do te preke programet dhe projektet kohen e njoftimit perfundimit te perfundimi.

Bere ne dy kopje te njejta, secila prej tyre ne gjuhen Shqipe, Gjermane dhe Angleze.

Ne raste mosperputhjeje, versioni ne gjuhen Angleze do te mbizoteroje.

**Per Keshillin e Ministrave
te Republikës se Shqiperise
Tirane, me 03.06.2008**

**Per Qeverine e Republikës
se Austrise
Tirane, me 03.06.2008**



VENDIM

Nr.959, datë 11.6.2009

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MBRETËRISË SË SPANJËS, PËR BASHKËPUNIM DHE ASISTENCË TË NDËRSJELLË NË ÇËSHTJET DOGANORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Ministrisë të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Mbretërisë së Spanjës, për bashkëpunim dhe asistencë të ndërsjellë në çështjet doganore, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

MARRËVESHJE

NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MBRETËRISË SË SPANJËS LIDHUR ME BASHKËPUNIMIN DHE ASISTENCËN RECIPROKE MBI ÇËSHTJET DOGANORE

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe qeveria e Mbretërisë së Spanjës, këtej e tutje referuar si palët;

duke konsideruar se shkeljet e legjislacionit doganor janë të dëmshme për interesat ekonomike, fiskale dhe sociale për vendet e tyre respektive, si dhe për interesat legjitime të tregtisë;

duke konsideruar se trafiku i lëndëve narkotike, substancave psikotrope dhe mallrave të tjera të dëmshme përbën një rrezik për shëndetin publik dhe shoqërinë;

duke konsideruar rëndësinë e vlerësimit të saktë të detyrimeve doganore dhe taksave të mbledhura nga importimi apo eksportimi i mallrave, si dhe zbatimin e duhur të dispozitave mbi ndalimin, kufizimin dhe kontrollin;

të bindur se përpjekjet për të parandaluar shkeljet kundër legjislacionit doganor dhe përpjekjet për të garantuar mbledhjen e saktë të detyrimeve dhe taksave të importit dhe eksportit mund të bëhen më efektive nëpërmjet kooperimit ndërmjet autoriteteve doganore;

duke marrë në konsideratë rekomandimet e Këshillit të Kooperimit Doganor mbi asistencën reciproke administrative, të 5 dhjetorit 1953;

duke marrë në konsideratë gjithashtu konventën e veçantë mbi drogat narkotike (Nju- Jork, 1961), konventën mbi substancat psikotrope (Vjenë, 1971) dhe konventën kundër trafikut të paligjshëm të drogave narkotike dhe substancave psikotrope (Vjenë, 1988), ranë dakord për sa më poshtë vijon:

Neni 1

Përcaktime

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje:

a) "Autoritet doganor" nënkupton:

- Në Republikën e Shqipërisë: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave e Ministrisë së Financave;
- Në Mbretërinë e Spanjës: Ministria e Ekonomisë dhe e Financave pa paragjykim për kompetencat e ministrive të tjera.

b) "Legjislacion doganor" do të thotë çdo ligj apo dispozitë për t'u zbatuar nga autoritetet doganore në lidhje me importimin, eksportimin dhe tranzitimin e mallrave, dhe gjithashtu çdo procedurë apo regjim doganor, lidhur me detyrimet doganore dhe taksat, ose të masave të ndalimit, kufizimit apo kontrollit, duke përfshirë trafikun e paligjshëm të drogave dhe të mallrave të tjera.

c) "Shkelje" do të thotë çdo shkelje e legjislacionit doganor, si dhe çdo përpjekje për shkelje të këtij legjislacioni.

d) "Detyrimet doganore" do të thotë të gjitha detyrimet, taksat dhe kuotat që ushtrohen dhe grumbullohen nga autoritetet doganore.

e) "Person" do të thotë çdo person fizik apo juridik.

f) "Autoriteti kërkues" do të thotë autoriteti doganor, i cili bën një kërkesë për asistencë mbi çështjet doganore.

g) "Autoriteti i kërkuar" do të thotë autoriteti doganor, i cili merr një kërkesë për asistencë mbi çështjet doganore.

i) "Dërgesa nën kontroll" do të thotë teknika e lejimit të dërgesave të paligjshme, të cilat përmbajnë ose dyshohet se përmbajnë lëndë narkotike, substanca psikotrope ose substanca të përbëra prej tyre, ose lëndë sensitive, që kalojnë nëpërmjet ose brenda territorit të palëve, me dijëninë dhe nën vëzhgimin e autoriteteve kompetente, me qëllim lehtësimin e hetimeve.

Neni 2

Fushëveprimi i Marrëveshjes

1. Autoritetet doganore të palëve do t'i japin asistencë njëra-tjetrës sipas kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje, me synim lehtësimin e lëvizjes së ligjshme të mallrave, zbatimin e legjislacionit doganor dhe gjithashtu parandalimin, hetimin dhe luftimin e shkeljeve në fushat e sipërpërmendura.

2. Asistenca e ndërsjellë, brenda kuadrit të kësaj Marrëveshjeje, do të jepet në përputhje me legjislacionin në fuqi në territorin e shtetit të palës së kërkuar dhe brenda kompetencave dhe burimeve të mundshme të autoritetit doganor të kërkuar.

3. Përmbajtja e kësaj Marrëveshjeje nuk do të ndikojë në asistencën e ndërsjellë lidhur me çështjet kriminale, të cilat do të jepen në përputhje me legjislacionin në fuqi në territorin e palëve dhe në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare të nënshkruara nga palët.

Neni 3

Asistenca sipas kërkesës

1. Sipas kërkesës së autoritetit kërkues, autoriteti i kërkuar do ta furnizojë autoritetin kërkues me çfarëdo informacioni të dobishëm lidhur me:

- a) zbatimin kor rekt të legjislacionit doganor dhe ndryshime thelbësore në këtë legjislacion;
- b) përcaktimin korrekt të detyrimeve doganore, veçanërisht ato informacione lidhur me përcaktimin e vlerës doganore, klasifikimin tarifor dhe origjinën e mallrave;
- c) parandalimin, hetimin dhe goditjen e shkeljeve.

2. Sipas kërkesës së autoritetit kërkues, autoriteti i kërkuar do të mbajë, për aq sa ka mundësi, survejim special mbi:

- a) persona të njohur nga autoriteti doganor kërkues që kanë kryer një shkelje ose dyshohen për shkelje të legjislacionit doganor;
- b) mallra, në transport apo magazinim, njoftuar nga autoriteti kërkues doganor se mund të shkaktojnë një trafik të dyshuar të paligjshëm ndaj territorit të vet;

c) mjete transporti të njohura ose të dyshuara se janë përdorur për kryerjen e shkeljeve doganore;

d) vende të dyshuara nga autoriteti kërkues doganor si të përdorura për të kryer shkelje doganore ose të përdorura për kundërvajtje të legjislacionit doganor.

3. Autoritetet doganore, sipas kërkesës, do t'i japin njëra-tjetrës informacion i cili tregon nëse:

a) mallrat e importuara në territorin e një prej palëve kontraktuese janë eksportuar ligjërisht nga territori i palës tjetër kontraktuese;

b) mallrat e eksportuara nga territori i një prej palëve kontraktuese janë importuar ligjërisht në territorin e palës tjetër kontraktuese, duke specifikuar, nëse ka, llojin e procedurave doganore të aplikuara mbi këto mallra.

Neni 4

Asistenca spontane

Autoritetet doganore do të furnizojnë njëra-tjetrën me asistencë, pa kërkesë paraprake, nëse ato e konsiderojnë këtë gjë të nevojshme për zbatimin korrekt të legjislacionit doganor, veçanërisht kur ato kanë informacion lidhur me:

a) veprime të konsideruara kontradikte me legjislacionin doganor;

b) mjete ose metoda të reja të përdorura për ndërmarrjen e veprimeve të tilla;

c) mallra të njohura si subjekt veprimesh në kundërshtim me rregullat doganore mbi importet, eksportet, transitin apo të ndonjë procedure tjetër doganore, veçanërisht për sa i përket drogave, substancave psikotrope dhe prekursorëve të drogave.

Neni 5

Dërgesë nën kontroll

1. Duke marrë në konsideratë ligjet e veta kombëtare, rregullat dhe procedurat, të dyja autoritetet doganore, me marrëveshje të ndërsjellë, mund të aplikojnë metodën e dërgesës nën kontroll të drogave, substancave psikotrope dhe lëndëve sensitive, me qëllim identifikimin e personave të implikuar në trafikun ilegal të këtyre drogave, substancave dhe mallrave, dhe gjithashtu për konfiskimin e tyre.

2. Ngarkesat e paligjshme në lidhje me të cilat janë kryer dërgesat nën kontroll, mund të zbulohen dhe të lejohen për transport të brendshëm, duke e lënë të paprekur ose duke e hequr ngarkesën e paligjshme, pjesërisht ose plotësisht.

3. Vendimet lidhur me përdorimin e dërgesave nën kontroll duhet të merren mbi një bazë rast pas rasti.

Neni 6

Informacion mbi trafikun e paligjshëm të lëndëve të ndjeshme (sensitive)

Autoritetet doganore, me iniciativën e tyre apo sipas kërkesës dhe pa vonesë, duhet të furnizojnë njëra-tjetrën me gjithë informacionin e përshtatshëm mbi aktivitetet të cilat përbëjnë ose mund të përbëjnë një shkelje ndaj legjislacionit doganor në fuqi në territorin e një prej palëve në fushat e mëposhtme:

- a) qarkullimit të armëve, municioneve, eksplozivëve dhe pajisjeve për eksplozivë;
- b) lëvizjes së objekteve të artit dhe antikuarëve, të cilat përbëjnë vlerë të rëndësishme historike, kulturore ose arkeologjike për një nga palët;
- c) qarkullimit të lëndëve helmuese, materialeve nukleare dhe radioaktive, si dhe të substancave të tjera të rrezikshme për ambientin dhe shëndetin publik;
- d) qarkullimin e mallrave që u nënshtrohen detyrimeve apo taksave doganore të konsiderueshme.

Neni 7

Forma dhe thelbi i kërkesës për asistencë

1. Kërkesat në zbatim të kësaj Marrëveshjeje do të bëhen me shkrim, shoqëruar nga ato dokumente që mund të konsiderohen të dobishme për ekzekutimin e kërkesave të tilla shkelje. Kur është e nevojshme, për shkak të emergjencës së situatës dhe në kushtet kur nuk ekziston mundësia e dërgimit të tyre me faks, kërkesat gojore mund të jenë të pranueshme, por kjo kërkesë në mënyrë imediate duhet të konfirmohet nga një kërkesë me shkrim.

2. Kërkesat, në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, do të përfshijnë informacionin e mëposhtëm:

- a) Autoritetin kërkues;
- b) Masa që kërkohet të merret;
- c) Objekti dhe shkaqet për kërkesë;
- d) Treguesit, sa më të saktë dhe të kujdesshëm të jetë e mundur, mbi personat fizikë dhe juridikë nën hetim, si dhe mjetet e transportit, nëse njihen;
- f) Një përmbledhje të fakteve lidhur me çështjen, si dhe të hetimeve të kryera ndërkohë.

3. Kërkesa duhet të dërgohet në gjuhën zyrtare të autoritetit të kërkuar doganor ose në anglisht.

4. Nëse kërkesa nuk i përmbush detyrimet formale, korrektimi ose kompletimi i saj mund të kërkohet, por gjithsesi mund të bëhet kërkesë për marrjen e masave paraprake.

Neni 8

Ekzekutimi i kërkesës

1. Kërkesa për asistencë dhe hetimet do të kryhen dhe zbatohen në përputhje me ligjet dhe rregullat e palës së kërkuar.
2. Në mënyrë që t'i përgjigjet një kërkesë për asistencë, autoriteti i kërkuar do të procedojë brenda kompetencave dhe burimeve të veta të mundshme, si të ishte duke proceduar për llogari të vet ose sikur kërkesa të ishte bërë nga autoritete të tjera ose të së njëjtës palë, duke dhënë informacionin që posedon ndërkohë, duke kryer hetimet e duhura ose duke marrë masat e duhura që hetimet të kryhen.
3. Nëse autoriteti doganor i kërkuar nuk është institucioni i duhur për t'iu përgjigjur kërkesës, ai duhet t'ia transmetojë këtë kërkesë institucionit të duhur dhe nëse kërkohet, duhet të informojë autoritetin doganor kërkues.

Neni 9

Prania gjatë hetimeve e punonjësve të palës kërkuese

1. Punonjës të autorizuar në mënyrën e duhur të njëjës palë, në raste të veçanta, me aprovimin e palës së kërkuar, sipas kushteve të vendosura nga kjo e fundit dhe kushtëzuar nga legjislacioni i shtetit të palës së përmendur, mund të jenë prezent në hetimet e kryera në territorin e shtetit të autoritetit tjetër doganor. Hetimet do të kryhen nga punonjës të palës, në territorin e së cilës janë duke kryer hetimet dhe punonjësit e palës tjetër mund të mundësojnë dhe të marrin informacion nga këto hetime.
2. Kur, sipas situatave të paraqitura në këtë Marrëveshje, punonjësit e njëjës palë do të jenë prezent në hetimet e zhvilluara në territorin e palës tjetër, ata në çdo kohë duhet të jenë të aftë të tregojnë identitetin dhe pozicionin e tyre zyrtar. Ata nuk duhet të mbajnë uniformë dhe as të kenë armë dhe duhet të jenë përgjegjës për çfarëdo shkelje të rregullave të palës në të cilën janë duke kryer hetimet.
3. Punonjësit e autorizuar të njëjës nga palët, në raste të caktuara, me aprovimin e autoritetit doganor të përfshirë, sipas kushteve të vëna nga ky i fundit dhe kushtëzuar nga legjislacioni kombëtar apo ndërkombëtar në fuqi, mund të hipin në bordin e anijeve apo avionëve të palës tjetër, gjatë operacioneve reale dhe gjithashtu për trajnime apo ushtrime. Pala pronare e mjeteve nuk mban asnjë përgjegjësi për ndonjë dëmtim apo paragjykim që mund të pësojnë punonjësit e palës tjetër në bordin e këtyre mjeteve në kryerje të operacioneve të përmendura.
4. Duke marrë në konsideratë legjislacionin kombëtar të palëve dhe marrëveshjet ndërkombëtare ku bëjnë pjesë palët, anijet dhe avionët, duke pasur në bord punonjësit e palës tjetër, mund të procedojnë në kapjen e anijeve që kanë kryer shkelje ndaj legjislacionit doganor në ujërat territoriale të palës kërkuese apo në detet e hapura.

Për t'i dhënë efekt dispozitave të këtij paragrafi, pala kërkuese duhet të ketë autorizimin legal të nevojshëm për të hipur në bord për inspektim apo, kur është e nevojshme, ta drejtojë në port anijen që ka kryer shkeljen, duke marrë parasysh koston që mund të lindë si pasojë e

dëmtimeve apo reklamimeve. Fakti që aksioni do të kryhet nga një anije me pronar palën e kërkuar, duhet të deklarohet në kërkesën për autorizim.

Kur flamuri i anijes që ka kryer shkeljen është i palës kërkuese, do të merret si e mirëqenë se është lëshuar autorizimi i nevojshëm për arsye të ekzistencës së punonjësve të saj në bordin e anijes apo avionit të palës së kërkuar.

Neni 10

Komunikimi i informacionit

1. Sipas kushteve dhe brenda kufijve të caktuar në këtë Marrëveshje, dhe me kushtin që legjislacioni kombëtar ta lejojë, autoritetet doganore do t'i komunikojnë informacion njëri-tjetrit në formën e dokumenteve, kopjeve të noterizuara të dokumenteve, raporteve etj., që mund të jenë dispozicioni i tyre
2. Dokumentet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, me aprovim të palës së kërkuar, mund të zëvendësohen nga informacion i kompjuterizuar, prodhuar në çfarëdolloj forme për të njëjtin qëllim.

Neni 11

Përdorimi i informacionit

1. Informacioni i përftuar sipas Marrëveshjes në fjalë mund të përdoret vetëm për qëllimet e specifikuar në Marrëveshjen në fjalë. Mund të përdoren brenda çdo shteti për qëllime të tjera, vetëm me aprovimin me shkrim paraprak të autoritetit doganor i cili ka dërguar informacionin dhe do të kushtëzohet nga kufizimet që mund të vendosë ky autoritet.
2. Dispozitat e paragrafit 1 nuk do të pengojnë përdorimin e informacionit në çfarëdo proces, administrativ apo penal, i cili është hapur për shkelje të legjislacionit doganor.
3. Autoritetet doganore në regjistrat e tyre të evidencave, raportet dhe dëshmitë, si dhe në procedimet e çuara në gjykatë, mund të përdorin si fakte informacionin e marrë dhe dokumentet e përftuara në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.
4. Përdorimi i këtij informacioni si fakt në gjykatë dhe pesha që do t'i jepet këtij, do të përcaktohen në përputhje me legjislacionin kombëtar të palëve.

Neni 12

Konfidencialiteti i informacionit

1. Çdo informacion i komunikuar në çfarëdolloj forme në zbatim të kësaj Marrëveshjeje do të jetë i një natyre konfidenciale. Do të mbulohet nga detyrimi i sekretit zyrtar dhe do të gëzojë mbrojtjen që i ofrohet këtij informacioni sipas ligjeve të palës që e merr atë.
2. Të dhënat personale nuk do të transmetohen kur ka shkaqe të arsyeshme që të bëjnë të besosh se transmetimi ose përdorimi i të dhënave të transferuara do të jetë në kundërshtim me parimet ligjore bazë të njëjës prej palëve dhe në veçanti, nëse personi që ka të bëjë me këtë,

mund të vuajë një diskriminim të të drejtave themelore të njeriut. Sipas kërkesës, pala marrëse do të informojë palën dërguese mbi mënyrën e përdorimit të informacionit të marrë dhe mbi rezultatet e arritura.

3. Të dhënat personale mund të transmetohen vetëm tek autoritetet doganore dhe në rast nevojë, për qëllime procedurale, te prokuroria apo autoritetet gjyqësore. Persona apo autoritete të tjera mund të marrin një informacion të tillë vetëm sipas një autorizimi paraprak të autoritetit dërgues.

Neni 13

Ekspertët dhe dëshmitarët

Një punonjës i autoritetit të kërkuar mund të autorizohet për t'u paraqitur, brenda kufijve të autorizimit të dhënë, si ekspert apo dëshmitar, në një proces penal apo administrativ lidhur me çështjet që mbulohen nga kjo Marrëveshje nën juridiksionin e shtetit tjetër dhe të prodhojë produkte të tilla, dokumente dhe kopje të noterizuara, sipas nevojës së procesit. Kërkesa për një paraqitje duhet të identifikojë në mënyrë specifike se mbi çfarë çështjeje dhe në çfarë pozicioni, titulli apo kualifikimi do të pyetet ky punonjës.

Neni 14

Përgjashtime dhe detyrimi për të dhënë asistencë

1. Në rastet kur autoriteti i kërkuar është i mendimit se përgjigja ndaj një kërkesë mund të bjerë ndesh me sovranitetin, sigurinë, rendin publik ose interesa të tjera themelore të shtetit të vet, ose mund të përfshijë shkelje të sekreteve profesionale, komerciale apo industriale, ky autoritet mund të refuzojë dhënien e asistencës së kërkuar sipas kësaj Marrëveshjeje, ta japë atë pjesërisht ose mund ta përmbushë atë sipas respektimit të disa kushteve ose kufizimeve.

2. Kur autoriteti kërkues bën një kërkesë për asistencë, i cili vetë nuk do të mund ta përmbushte nëse i kërkohej diçka e tillë nga autoriteti tjetër doganor, kjo gjë duhet të theksohet në kërkesë. Në këtë rast varet nga autoriteti i kërkuar vendimi nëse do t'i përgjigjet një kërkesë të tillë.

3. Nëse asistenca pezullohet apo mohohet, autoriteti kërkues duhet të njoftohet pa vonesë me shkrim lidhur me këtë vendim dhe mbi shkaqet që çuan aty.

Neni 15

Shpenzimet mbi asistencën

1. Autoritetet doganore do të heqin dorë nga çdo kërkesë ndaj njëri-tjetrit për rimbursimin e shpenzimeve të dala gjatë vënies në zbatim të Marrëveshjes në fjalë, me përjashtim të shpenzimeve lidhur me ekspertët dhe dëshmitarët, si dhe shpenzimet për përkthyesit që nuk janë punonjës shtetërorë.

2. Kur shpenzime të konsiderueshme apo shumë të mëdha do të ose mund të kërkohen për ekzekutimin e kërkesës, palët duhet të konsultohen të vendosin afatet dhe kushtet nën të cilat kërkesa do të ekzekutohet, po ashtu dhe mënyrën sesi këto shpenzime do të dalin.

Neni 16

Zbatimi i Marrëveshjes

1. Bashkëpunimi dhe asistenca e mundësuar në zbatim të kësaj Marrëveshjeje do t'i ngarkohet direkt autoriteteve doganore. Ato do të rakordojnë reciprokisht mbi rregullimet e hollësishme për këtë qëllim.

2. Të dyja autoritetet doganore mund të organizojnë kontakte direkte ndërmjet shërbimeve të tyre të ushtrimit të ligjit, investigimit dhe nëse është e nevojshme, mes departamenteve të tjera me synimin e lehtësimit të mjeteve të shkëmbimit të informacionit mbi parandalimin, investigimin dhe goditjen e kundërvajtjeve të ligjeve dhe të rregullave të doganës. Do të shkëmbehet një listë e punonjësve të caktuar me këtë punë dhe kjo listë do të rifreskohet herë pas here nga autoritetet doganore.

3. Autoritetet doganore mund të bien dakord për takime me synim rishikimin e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 17

Zbatimi territorial

Kjo Marrëveshje do të jetë e zbatueshme në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë dhe në territorin doganor të Mbretërisë së Spanjës.

Neni 18

Hyrja në fuqi dhe përfundimi

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e trembëdhjetë që nga data e njoftimit të fundit me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike, që komunikon se procedurat respektive të brendshme të nevojshme për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes janë plotësuar nga palët.

2. Kjo Marrëveshje është përcaktuar të jetë e pakufizuar në kohë dhe do të qëndrojë në fuqi edhe gjashtë muaj pas datës së një njoftimi me shkrim nëpërmjet kanalesh diplomatike të njëjërës prej palëve mbi synimin e vet për ta përfunduar këtë Marrëveshje.

E nënshkruar në Tiranë, më 20 maj 2009, në tre origjinale, në gjuhët shqip, spanjisht dhe anglisht, ku të gjitha tekstet janë njëloj autentike. Në rast divergjence për shkak të përkthimit, do të mbizotërojë teksti në anglisht.



VENDIM
Nr. 851, date 05.08.2009

MARRËVESHJE

**NDERMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS MBI BASHKËPUNIMIN DHE
NDIHMËN RECIPROKE NË ÇËSHTJET DOGANORE**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Kosovës këtej e tutje të referuara si “Palë Kontraktuese”;

Duke patur parasysh se shkeljet ndaj legjislacionit doganor janë të dëmshme për sigurinë e palëve dhe për interesat e tyre ekonomike, fiskale, shoqërore dhe kulturore;

Duke vlerësuar se trafikimi i paligjshëm i narkotikëve, drogave dhe substancave psikotropike, përbën një rrezik për shëndetin publik dhe shoqërinë;

Duke patur parasysh kërcënimin e krimit të organizuar ndërkombëtar dhe grupet terroriste me burimet e tyre thelbësore si dhe nevojën për luftimin e tyre në mënyrë efektive;

Duke patur parasysh rëndësinë e vlerësimit të saktë të detyrimeve doganore dhe të taksave të tjera të grumbulluara në eksportimin ose importimin e mallrave, duke përfshirë edhe përcaktimin e saktë të vlerës dhe origjinës së mallrave, si dhe sigurimin e ushtrimit të duhur të masave mbi ndalimin, kufizimin dhe kontrollin;

Të bindur se përpjekjet për të parandaluar shkeljet e legjislacionit doganor dhe përpjekjet për të siguruar mbledhjen e saktë të detyrimeve të importit dhe eksportit, taksave dhe detyrimeve të tjera, do të bëhen më efektive nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet Autoriteteve të tyre Doganore, bazuar në dispozita të qarta ligjore;

Duke marrë në konsideratë nevojën për thjeshtëzimin e formaliteteve doganore dhe kontrollit të mallrave, të pasagjerëve dhe ngarkesave;

Duke pasur parasysh nxitjen e instrumenteve ndërkombëtare dypalëshe të ndihmës së dyanshme, dhe në veçanti të Rekomandimit të Këshillit të Bashkëpunimit Doganor (njohur si Organizata Botërore e Doganave) të datës 5 dhjetor 1953 mbi Asistencën e Ndërsjellë Doganore;

Duke pasur parasysh dispozitat e Konventës mbi narkotikët e vitit 1961, e ndryshuar, dhe të Konventës mbi të substancat psikotropike e vitit 1971, e ndryshuar, e hartuar nën kujdesin e

Organizatës së Kombeve të Bashkuara, si dhe Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Trafikut të Paligjshme të narkotikëve dhe substancave psikotropike e vitit 1988;

Duke marrë në konsideratë, gjithashtu Konventat ndërkombëtare detyruese për të dyja palët dhe që përmbajnë ndalime, kufizime dhe masa të vecanta kontrolli lidhur me mallra specifike;

Duke pasur parasysh edhe marrëdhëniet ekzistuese kontraktuale midis Palëve kontraktuese dhe Bashkimit Evropian;

Kanë rënë dakord si vijon:

Neni 1

Përkufizime

Për qëllimet e kësaj Marrëveshje:

- a) "legjislacioni doganor" do të thotë teresia e dispozitave ligjore dhe nenligjore të detyrueshme për tu zbatuar nga Autoritetet Doganore në lidhje me importin, eksportin dhe tranzitin e mallrave dhe mjetet e pagesës që kanë të bëjnë me detyrimet doganore, apo detyrime të tjera që vihen nga autoritetet e doganave, apo me masat kufizuese, ndaluese të kontrollit të këtyre mallrave;
- b) "shkelje doganore" nënkupton kundravajtjet administrative doganore dhe kontrabandën në fushën doganore që kanë si qëllim shkeljen e legjislacionit doganor;
- c) "Autoritet Doganor" do të thotë për Republikën e Shqipërisë, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe për Republikën e Kosovës, Sherbimi Doganor Kosovar/Doganat e Kosovës ;
- d) " autoritet kërkues" do të thotë autoriteti kompetent doganor i një pale , i cili bën një kërkesë për ndihmë në fushën e çështjeve doganore në përputhje me këtë marrëveshje;
- e) "autoritet i kerkuar, do të thotë 'autoriteti doganor i një Pale, i cila merr një kërkesë për ndihmë në çështjet doganore;
- f) "dërgim i kontrolluar" do të thotë metoda e lejimit të ngarkesave të paligjshme për të hyre, dale ose levizur përmes ose në territoret e Palëve Kontraktuese, me dijeninë dhe nën mbikëqyrjen e autoriteteve të tyre kompetente, me qëllim të zbulimit dhe identifikimit të personave të përfshirë në kryerjen e shkeljeve të legjislacionit doganor;
- g) "të dhëna personale" do të thotë çdo informacion apo e dhene në lidhje me një individ të identifikuar ose të identifikueshëm;
- h) "narkotiket" (drogat) do të thotë çdo substancë, natyrore ose sintetike, në listat I dhe II të Konventës së Vetme të narkotikëve, të vitit 1961, të ndryshuar, si dhe çdo substancë e asimiluar e narkotike (drogave) në legjislacionin kombëtar;

i) "substancat psikotropike dhe prekusoret " do të thotë çdo substancë, natyrore ose sintetike, ose ndonjë material natyror në listat I, II, III dhe IV të Konventës mbi substancave psikotropike, te vitit 1971, të ndryshuar, si dhe çdo substancë e asimiluar në substancave psikotropike ne legjislacionin kombëtar;

j) "shenja paralajmeruese" do të thotë substanca kimike të listuara në aneksin e Konventës së OKB-së se vitit 1988, e ndryshuar.

k) "informacion" do te thote, *inter –alia*, te dhena, raporte, dokumente si dhe dokumentacion i kompjuterizuar ose jo, gjithashtu kopje te ketyre dokumentave te njehsuar me origjinalin.

Neni 2

Qëllimi i marrëveshjes

1. Palët Kontraktuese, nëpërmjet autoriteteve te tyre doganore dhe në përputhje me dispozitat e parashikuara në këtë Marrëveshje, do te mundesojne njera– tjetres ndihme te ndersjellte :

a) në mënyrë që të sigurohet se zbatimi i sakte i legjislacionit doganor;

b) me qëllim parandalimin, hetimin dhe luften ndaj shkeljeve te legjislacionit doganor;

c) ne lidhje me njoftimin e dokumenteve me qëllim zbatimin e legjislacionit doganor.

2. Ndhima në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje do të bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi në territorin e kërkuar te pales Kontraktuese dhe brenda kompetencave dhe burimeve në dispozicion të autoritetit doganor të kërkuar. Nëse është e nevojshme, autoriteti doganor mund të ofroje një ndihmë te siguruar permes një autoriteti tjetër kompetent.

3. Kjo Marrëveshje nuk parashikon kthimin e detyrimeve, taksave dhe çdo ngarkese tjetër, në emër të pales tjetër Kontraktuese.

4. Kjo Marrëveshje nuk do të ndikojë në zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare mbi ndihmën ligjore në çështjet penale në të cilat kanë hyrë Palët Kontraktuese.

Neni 3

Rastet e Ndhimes

1. Autoritetet doganore, me nismën e tyre ose sipas kërkesës, do të furnizojnë njëra-tjetrën me të gjitha informacionet, të cilat mund të ndihmojnë në saktësinë e informacionit te siguruar per:

a) mbledhjen e detyrimeve të importit dhe eksportit, taksat apo detyrimet e tjera qe vihen nga autoritetet doganore dhe, në veçanti, të dhëna të cilat mund të ndihmojë për të vlerësuar vlerën e mallrave për qëllime doganore dhe për të vendosur klasifikimin tarifor te tyre;

b) zbatimin e dispozitave ne lidhje me ndalimet, kufizimet dhe kontrollin;

c) zbatimin e rregullave të origjinës qe nuk mbulohen nga marrëveshjet preferenciale vendosur nga një ose që të dy prej Palëve Kontraktuese.

2. Nëse autoriteti doganor i kërkuar nuk posedon/disponon informacionin e kërkuar, ai do të kërkojë informacion me të gjitha mjetet në dispozicion në bazë të dispozitave të legjislacionit në fuqi në territorin e kërkuar të Palës Kontraktuese.

3. Autoriteti doganor i kërkuar do të kërkojë informacion sikur të kishte vepruar në bazë të llogarisë së vet.

4. Në rast se autoriteti doganor i kërkuar nuk është autoriteti kompetent në përputhje me kërkesën, ai, pas konsultimit të duhur, duhet që menjëherë kërkesën t'ia përcjellë autoritetit kompetent që do të veprojë sipas kërkesës në bazë të kompetencave të saj sipas ligjit, ose të këshillojë autoritetin doganor që ka kërkuar ndihmë për procedurën e duhur që duhet ndjekur në lidhje me një kërkesë të tillë .

5. Autoritetet Doganore të Palëve Kontraktuese, në përputhje/pa rënë ndesh me legjislacionin kombëtar, mund të kërkojnë bashkëpunim në:

a) iniciimin, zhvillimin, apo përmirësimin e programeve specifike të trajnimit për personelin e tyre;

b) krijimin dhe mbajtjen e kanaleve të komunikimit midis tyre për lehtësimin e shkëmbimit të shpejtë dhe të sigurt të informacionit;

c) tendencat dhe testimin e pajisjeve dhe procedurave të reja;

d) çdo çështje tjetër administrative që mund të kërkojë kohë pas kohe për aktivitetin e tyre të përbashkët, duke përfshirë edhe mundësinë e shkëmbimit të personelit dhe të ekspertëve.

Neni 4

Shkëmbimi i informacioni mbi mallrat dhe procedurat

Autoritetet Doganore duhet që, sipas kërkesës, të furnizojnë njëra-tjetrën me çdo informacion që tregon se:

a) mallrat e importuara që janë në territorin e një Pale Kontraktuese janë eksportuar në mënyrë të ligjshme nga territori i Pale tjetër Kontraktuese;

b) mallrat e eksportuara nga territori i një Pale Kontraktuese janë importuar ligjërisht në territorin e Pale tjetër Kontraktuese, duke specifikuar nëse është e nevojshme, llojin e procedurës doganore të aplikuar mbi këto mallra ;

c) mallra të cilat janë dhënë me trajtim favorizues pas eksportimit nga territori i një Pale Kontraktuese kanë qenë siç duhet të importuara në territorin e Pale tjetër Kontraktuese, kjo kuptohet se informacioni duhet gjithashtu të sigurohet për çdo masë të kontrollit doganor të mallrave të cilat kanë qenë të nënshtruara.

Neni 5

Informacioni ne rast shkeljesh

Autoritetet e doganave, me nismën e tyre ose sipas kërkesës, do të furnizojnë njëra-tjetran me të gjithë informacionin që mund të jetë i nevojshëm dhe që ka të bëjë me shkeljet e legjislacionit doganor dhe në veçanti, në lidhje me:

- a) personat fizik ose juridik që janë të njohur, ose të dyshuar si kundërvajtës që kane kryer shkelje te legjislacionit doganor në fuqi në territorin e një Pale tjetër Kontraktuese;
- b) mallrat e njohura apo te dyshuara që mund te jene subjekt i trafikut të paligjshëm;
- c) mjetet e transportit dhe kontenierë të njohur, ose të dyshuar, që mund te përdoren në shkeljen e legjislacionit doganor në fuqi në territorin e një pale tjetër Kontraktuese;
- d) mënyrat e reja, që do të thotë të jenë të njohur, ose të dyshuar për momentin, të punësuar në kundërshtim me legjislacionit doganor. Çdo kërkesë për arrestimin e personave do të përjashtohet nga një ndihmë e tillë.

Neni 6

Shkëmbimi i dokumentacionit

Autoriteti Doganor i një Pale Kontraktuese, me iniciativën e vet ose me kërkesë, do të furnizojë autoritetin doganor të Palës tjetër Kontraktuese me raporte, të dhëna, ose kopje te njehsuara me origjinalin të dokumenteve duke i dhënë informacion mbi te gjitha transaksionet që janë në dispozicion, të përfunduara ose të planifikuara, të cilat përbëjnë ose mund te përbëjnë një shkelje/ ne perputhje me legjislacionit doganor në fuqi në territorin e asaj Pale Kontraktuese.

Neni 7

Informacioni elektronik

Dokumentet e parashikuara në këtë Marrëveshje mund të zëvendësohen me informacion të kompjuterizuar të prodhuar në ndonjë formë tjetër për të njëjtin qëllim. I gjithë informacioni i duhur për interpretimin ose shfrytëzimin e materialit duhet të plotësohet në të njëjtën kohë.

Neni 8

Perdorimi i dokumentave origjinale dhe kopje

1. Autoritetet doganore do të kërkojnë dokumentat të njësuar me origjinalin. Në rastet kur kopjet e këtyre dokumentave të njësuar me origjinalin do të jenë të pamjaftueshme, autoritetet doganore do të kërkojnë dokumentet origjinale.

2. Dokumentet origjinale të marra nga autoriteti doganor i Palëve të tjera Kontraktuese do të kthehen në rastin e parë të mundshëm. Në momentin e kërkesës, origjinalet e nevojshme për verifikim apo qëllime të ngjashme, do të kthehen pa vonesë.

Neni 9

Mbikëqyrja e personave, mallrave dhe mjeteve të transportit

1. Autoritetet Doganore të Palëve Kontraktuese me nismën e tyre ose sipas kërkesës, do të mbajnë nën mbikëqyrje doganore:

- a) personat e njohur, ose të dyshuar, kundërvajtësit e legjislacionit doganor të Palëve të tjera Kontraktuese;
- b) lëvizjen e mallrave dhe mjeteve për pagesë e të cilat janë raportuar nga ana e autoriteteve doganore të palëve tjera Kontraktuese duke i dhënë të drejtë për të dyshuar për trafikim të paligjshëm në ose përmes territorit të tij;
- c) çdo mjet i transportit i cili është i njohur për të ose i dyshuar apo përdorur në kundërvajtjen doganore të legjislacionit në fuqi në territorin e palëve të tjera Kontraktuese;
- d) vende të përdorura për magazinimin e mallrave, e cila mund të përbëjë trafikun e paligjshëm thelbësor në territorin e Pales tjetër Kontraktuese.

2. Brenda kompetencave të tyre, autoritetet doganore të Palëve Kontraktuese do të parandalojnë:

- a) eksportimin e mallrave të cilat janë të njohura për të, ose, në baza të arsyeshme, të dyshuar e të qenit të eksportuara në territorin e Pales tjetër Kontraktuese që do të përdoret për qëllime të tjera të paligjshme në tregtinë midis Palëve Kontraktuese;
- b) eksportimin e mallrave importi i të cilave është i ndaluar në territorin e pales tjetër Kontraktuese.

Neni 10

Dërgimi i kontrolluar

1. Autoritetet doganore me pëlqimin e ndërsjellë dhe brenda kompetencave të përcaktuara në legjislacionin kombëtar të secilit shtet, mund të lejojnë përdorimin e metodës së dërgimit të kontrolluar, në mënyrë që të identifikohen personat e përfshirë në një kundërvajtje. Kur një vendim për përdorimin e metodës së dërgimit të kontrolluar nuk është në kompetencë të autoriteteve doganore atëherë autoritetet doganore do të fillojnë bashkëpunimin me autoritetet e tjera kombëtare që kanë kompetenca të tilla ose transferimin e rastit tek ai autoritet.

2. Ngarkesat e Paligjshme për të cilat është rënë dakord që mund të kontrollohen, me pëlqimin e autoriteteve kompetente kombëtare, të zbuluar dhe të lejohet të vazhdojë me mallra të paprekura ose largohen dhe konfiskohen ose zëvendësohet në tërësi ose pjesërisht.

3. Vendimet lidhur me përdorimin e dërgesave të kontrolluara që do të merren rast pas rasti, dhe nëse është e nevojshme duke marrë parasysh marrëveshjet financiare dhe mirëkuptimin.

Neni 11

Veprimet kundër trafikut të paligjshëm të mallrave

Autoritetet doganore, më nismën e tyre ose sipas kërkesës dhe pa vonesë, do të furnizojnë njëri-tjetrin me cdo informacion që disponojnë, mbi trafiket e paligjshme apo cdo aktivitet tjetër që përbën ose dyshohet se përbën një shkelje të legjislacionit doganor në fuqi në territorin e një prej Palëve kontraktuese lidhur me:

a) Lëvizjen e armëve, municioneve dhe eksplozivëve;

b) Lëvizjen e mallrave strategjike dhe sensitive që i nënshtrohen kontrolleve të posaçme, në përputhje me traktatet ndërkombëtare në fjalë dhe të marrëveshjeve perkatëse multilaterale dhe bashkëpunimit për mospërhapjen e detyrimeve;

c) Lëvizjes së lëndëve narkotike (drogave), substancave psikotrope dhe shënjave paralajmëruese;

d) lëvizjen e veprave të artit, antikave dhe pasurive të tjera kulturore të cilat janë të rëndësishme për arkeologjinë, parahistorinë, historinë, literaturën, artin dhe shkencën, sipas parimeve të paragrafit (a)-(k) të nenit 1 të Konventës UNESCO lidhur me kufizimin dhe parandalimin e transportit ilegal, eksportin dhe transportimin e vlerave kulturore, për aq kohë sa vepra e artit, antikrat dhe pasuritë e tjera kulturore të jenë subjekt kontrabande dhe operacionet financiare të ndërmarra lidhur me këtë kontrabandë të cenojnë vlerën historike, kulturore ose arkeologjike për një prej Palët Kontraktuese;

e) lëvizjen e mallrave/lendëve helmuese si dhe mallrave apo substancave të rrezikshme për mjedisin ose për shëndetin;

dh) lëvizjen e mallrave që janë subjekt i detyrimeve të larta të taksave apo ngarkesave të tjera fiskale, e në veçanti të mallrave për të cilat paguhet akcizë.

g) lëvizjen e mallrave që çenojnë të drejtat e pronësisë industriale dhe intelektuale.

Neni 12

Hetimet

1. Bazuar në kërkesën e njëres palë kontraktuese, pala tjetër, do të fillojë hetime zyrtare lidhur me operacione të cilat janë ose mund të jenë në kundërshtim me legjislacionin doganor në fuqi në territorin e kërkuar të Pales Kontraktuese. Ai duhet të komunikojë rezultatet e hetimeve të tilla tek autoriteti doganor që i ka kërkuar.

2. Hetimet e tilla, duhet të kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi në territorin e kërkuar të Pales Kontraktuese. Autoriteti doganor i kërkuar do të veproje sikur të ishte duke vepruar në llogarinë e vet.

3. Autoriteti doganor i kërkuar mund të lejojë zyrtarët e autoritetit doganor kërkues të jenë të pranishëm në hetimet e tilla kur shkelësit e legjislacionit doganor të palës kerkuese janë duke u hetuar.

Neni 13

Ekspertët dhe dëshmitarët

1. Me kërkesën e një Pale Kontraktuese, në lidhje me shkeljet e legjislacionit doganor, autoriteti doganor i kërkuar mund të autorizojë zyrtarët e vet brenda kufizimeve të autorizimit të dhënë, për të dalë si ekspertë apo dëshmitarë në procedimet gjyqësore ose administrative në territorin e Pales Kontraktuese të kërkuar. Zyrtarët e tillë do të japin dëshmi lidhur me faktet e krijuara gjatë ushtrimit të detyrave të tyre. Kërkesa për Paraqitje/ Veprim duhet të përcaktojë qartë ceshtjen dhe statusin në të cilin do të dëshmojë/do të veprojë zyrtari.

2. Zyrtari i kërkuar që paraqitet si ekspert ose dëshmitar ka të drejtë të refuzojë të japë dëshmi ose një deklaratë, në qoftë se e drejta e refuzimit, i lind në mbështetje të legjislacionit të shtetit të tij apo të palës tjetër kontraktuese.

Neni 14

Marrëveshjet për vizita zyrtare

Kur, në rrethanat e ofruara nga kjo Marrëveshje, zyrtarët e autoritetit doganor të një Pale Kontraktuese janë të pranishëm në territorin e Pales tjetër Kontraktuese, ata në çdo kohë duhet të jetë në gjendje të japin dëshmi për cilësinë e tyre zyrtare. Ata duhet të mos jetë në uniformë dhe as të mbajnë armë. Ata gëzojnë të njëjtën mbrojtje si zyrtarët e tjerë të doganave të Palës Kontraktuese, në përputhje me ligjet në fuqi atje dhe do të jenë përgjegjës për ndonjë krim që ata mund të kryejnë.

Neni 15

Përdorimi i dokumentave dhe informacionit

1. Informacione, dokumente dhe komunikime të tjera të marra sipas kësaj Marrëveshje nuk do të përdoren për qëllime të tjera përveç atyre të specifikuara në këtë Marrëveshje apo të transmetohen më tej, pa pëlqimin me shkrim të autoriteteve doganore respektive, e cila e furnizon dhe do të jetë subjekt i kufizimeve të përcaktuara nga ndonjë autoritet. Këto

dispozita nuk janë të aplikueshme për rastet e informatave, dokumenteve dhe të tjera në lidhje me kontradiktat, komunikimet etj, me drogat dhe substancat psikotropike. Informacione të tilla mund të jetë objekt i komunikimit mes autoriteteve të tjera të përfshira drejtpërdrejt në luftën kundër trafikut të paligjshëm të drogave dhe substancave psikotropike.

2. Informacioni i siguruar në bazë të kësaj marrëveshjeje do të jetë i natyrës konfidenciale. Ai duhet të jetë i mbuluar nga detyrimi i sekretit profesional dhe do të gëzojë mbrojtjen e parashikuar për të njëjtin lloj informacioni dhe dokumentacioni në bazë të legjislacionit në fuqi në territorin e Palës Kontraktuese e cila mori atë.

3. Paragrafi 1 i këtij neni nuk do të pengojë përdorimin e informacionit në procedimet civile, penale ose administrative, nëse dicka e tillë nuk bie ndesh me përcaktimet e legjislacionit kombëtar respektiv.

4 Autoriteteve doganore të Palëve Kontraktuese mund, në përputhje me qëllimet dhe brenda fushës së kësaj marrëveshjeje, të paraqesin si provë në gjykatë regjistrat e të dhënave, raportet , informacionin dhe dokumentet e marra në pajtim me këtë Marrëveshje si dhe dëshmitë përkatëse.

5. Përdorimi i këtyre informacioneve, dokumenteve si dhe dëshmimeve në gjykata do të ketë vlerën e provës sipas përcaktimeve në përputhje me legjislacionin kombëtar.

Neni 16

Trajtimi i të dhënave personale

Legjislacioni në fuqi në territoret e Palëve Kontraktuese do të jetë i aplikueshëm për trajtimin e të dhënave personale të shkëmbyera në bazë të kësaj Marrëveshjeje dhe për të drejtat e të dhënave të përshkruara si më poshtë:

a) të dhënat personale që merren në bazë të kësaj marrëveshjeje do të trajtohen në përputhje me legjislacionin në fuqi në territoret e palëve kontraktuese.

b) të dhënat personale nuk do të transmetohen në qoftë se transferimi do të jetë në kundërshtim me dispozitat ligjore të një prej Palëve Kontraktuese, si dhe me dispozitat ligjore mbi mbrojtjen e të dhënave, në mënyrë të veçantë. Asnje kërkesë nuk mund të injorohet në rastet kur mund të konsiderohet se transmetimi i të dhënave mund të shkaktojë shqetësim për personin në fjalë. Në momentin e marrjes së kërkesës nga autoriteti doganor, ky i fundit do të informojë autoritetin doganor kerkues të informacionit për rezultatet e arritura;

c) autoritetet e doganave mund transmetojnë të dhënat personale tek autoritetet e tjera vetëm për zbatimin e ligjit, dhe në rast se është e nevojshme për qëllime të ndjekjes penale, për të publikuar ndjekjen penale dhe për autoritetet gjyqësore. Një informacion i tillë nuk do t'i komunikohet autoriteteve të tjera, vetëm në qoftë se autoritetet e doganave furnizuese shprehimisht bien dakort, dhe ligji që rregullon autoritetet të cilat i lejon të marrin të dhënat e tilla të komunikimit;

d) Furnizimi i autoritetit doganor duhet të përcaktojë vlefshmërinë dhe korrektësinë e të dhënave personale që do të paraqiten. Në rast se autoriteti doganor furnizues, i gjen të dhënat personale që janë dorëzuar, të pasakta apo të kufizuara, ajo duhet të informojë autoritetin respektiv doganor që ta marrë në konsideratë këtë fakt pa vonesë. Autoriteti doganor që merr të dhënat personale, apo si dhe autoritete të tjera që kanë marrë këto të dhëna, do të shkatërrojnë ose fshijnë të dhënat personale pa vonesë;

e) Autoriteti doganor që merr të dhënat, duhet të japë informacion mbi afatin kohor të kërkuar në lidhje me të dhënat e shuara sipas legjislacionit të shtetit të tij. Të dhënat personale të fshihen sa më shpejt sipas propozimit për të cilin të dhënat personale mund të përdoren në pajtim me këtë Marrëveshje;

f) Autoritetet doganore respektive do të mbajnë një regjistër të të dhënave personale të dërguara apo të pranuar;

g) Autoritetet doganore duhet të marrin masa për të siguruar që të dhënat personale të mos jepen në mënyrë të pa autorizuar, të jenë objekt, modifikimi, shkatërrimi, dëmtimi ose transmetimi të paautorizuar, si dhe veprimeve të tjera të paautorizuara të përpunimit ose keqpërdorimit;

h) Trajtimi i të dhënave personale të dërguara në bazë të kësaj marrëveshjeje do të mbikëqyren nga autoritetet kombëtare të mbrojtjes së të dhënave në përputhje me legjislacionin në fuqi në territoret e Palëve Kontraktuese.

Neni 17

Njoftimi i dokumentave

1. Me kërkesë të njëjës Palë Kontraktuese, Pala tjetër Kontraktuese do të njoftojë personat fizik apo juridik në fjalë, që banojnë ose janë të vendosur në territorin e saj, për dokumentat që kanë të bëjnë me masat dhe vendimet e marra ndaj tyre, në zbatim të legjislacionit doganor.

2. Njoftimi i dokumentave do të bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi të palës që jep informacion. Njoftimi i dokumentave mund të bëhet gjithashtu me anë të një formulari të veçantë përcjellës me kusht që përmbajtja e kësaj kërkesë të mos jetë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi të palëve Kontraktuese

3. Marrja e njoftimit mund të marrë formën e një njohje të nënshkruar, ku të ketë edhe datën e marrjes nga ana e personit në fjalë ose mund të jetë në formën e një certifikate të autoritetit kompetent, bazuar në kërkesën e palëve kontraktuese, duke treguar metodën dhe datën e njoftimit.

Neni 18

Forma dhe përmbajtja e kërkesave për ndihmë

1. Kërkesat në bazë të kësaj marrëveshjeje do të bëhen me shkrim dhe do të shoqerohen me cdo dokument të nevojshem për përmbushjen e kërkesave të tilla. Për shkak të situatës së urgjencës, kërkesa mund të bëhet gojarisht me kusht që menjëherë sapo të jetë e mundur kjo kërkesë të bëhet edhe me shkrim.
2. Kërkesat sipas paragrafit 1 të këtij neni, duhet të përfshijnë elementet e mëposhtëm:
 - a) autoritetin doganor kerkues;
 - b) masat e kërkuara;
 - c) objektin dhe arsyen e kërkesës;
 - d) ligjet, rregullat dhe elemente të tjera ligjore të përfshira;
 - e) gjeneralitetet e plota aq sa është e mundur për personat fizik ose juridik që janë objekt i hetimeve;
 - f) një përmbledhje të fakteve përkatëse, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 17.
3. Kërkesat duhet të dorëzohen në gjuhën Shqipe, ose në një gjuhën tjetër të pranueshme për të kërkuar nga autoriteti doganor.
4. Nëse një kërkesë nuk i përmbush kërkesat formale, autoriteti doganor i kërkuar mund të kërkojë korigjim ose plotësim të tij, ose të marrë masa parandaluese.

Neni 19

Përjashtimet nga detyrimi për të siguruar ndihmë

1. Nëse Autoriteti doganor i një Pale Kontraktuese konsideron se dhënia e ndihmës do të jetë në dëm të sovranitetit, sigurisë, rendit publik, politikave publike, parimeve bazë të sistemit juridik të brendshëm të saj apo të tjera që mund të dëmtojnë interesat thelbësore të shtetit, ose që do të përbënte një shkelje industriale, tregtare ose profesionale të fshehtë, autoriteti doganor mund të refuzojë të japë ndihmë, ose ta ofrojë atë pjesërisht ose ajo t'i nënshtrohet disa kushteve apo kërkesave.
2. Nëse ndihma është refuzuar, vendimi dhe arsyet e refuzimit duhet të njoftohen me shkrim tek autoriteti doganor kerkues pa vonesë.
3. Ndihma mund të shtyhet nga autoriteti doganor i kërkuar nëse ajo bazohet në faktin se nderhyn në një proces hetimi, ndjekje ose procedim të paperfunduar. Në një rast të tillë

kërkohet që autoriteti doganor të konsultohet me autoritetin doganor kërkues për të kërkuar nëse ndihma mund të jepet sipas termave apo kushteve që mund të vihen nga autoriteti doganor i kërkuar.

4. Nëse autoriteti doganor i një Pale Kontraktuese kërkon ndihmë, të cilën ai vetë nuk mund ta përmbushë nëse dicka e tillë do t'i kërkohej atij vetë, kjo duhet të theksohet në kërkesë. Kërkesa e paraqitur duhet të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi në territorin e palës tjetër kontraktuese.

Neni 20

Shpenzimet

1. Autoritetet doganore do të heqin dorë nga të gjitha pretendimet për rimbursimin e kostove të dala gjatë ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje, përveç shpenzimeve dhe dietave paguar ekspertëve dhe dëshmitarëve si dhe kostot e përkthyesve dhe interpretuesve që nuk janë punonjës qeveritarë, këto do të mbulohen nga administrata kërkuese.

2. Nëse ka apo kërkohen shpenzime të një natyre të jashtëzakonshme për ekzekutimin e kërkesës, Palët kontraktuese do të konsultohen për të përcaktuar termat dhe kushtet sipas të cilave do të ekzekutohet kërkesa, si dhe mënyrën se si do të përballohen shpenzimet.

Neni 21

Shkëmbimi i ndihmës

1. Për ndihmën e dhënë sipas kësaj marrëveshjeje, autoritetet doganore të Palëve Kontraktuese do të furnizohen direkt mes tyre.

2. Autoritetet doganore do të marrin masa që punonjësit e tyre përgjegjës për investigimin apo luftën ndaj shkeljeve doganore të mbajnë lidhje direkte dhe personale me njëri – tjetrin. Mund të instruktojnë organet vartëse të tyre që të jenë në komunikim të drejtpërdrejtë me njëri-tjetrin.

Një listë e zyrtarëve të caktuar për këtë qëllim nga çdo autoritet doganor, do të dërgohet në administratën doganore të Palës tjetër Kontraktuese.

Neni 22

Zbatueshmëria territoriale, zbatimi dhe interpretimi

1. Kjo Marrëveshje do të jetë e aplikueshme në territoret doganore të të dyja Palëve Kontraktuese sic përcaktohet në dispozitat e tyre kombëtare kushtetuese, ligjore dhe administrative.

2. Autoritetet doganore do të vendosin mbi rregullimet e detajuara për lehtësimin e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje.

3. Autoritetet doganore do zgjidhin me marrëveshje reciproke cdo problem apo dyshim të dalë nga interpretimi apo zbatimi i kësaj Marrëveshjeje. Mosmarrëveshjet për të cilat nuk është gjetur zgjidhje, do të zgjidhen nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 23

Hyrja në fuqi dhe përfundimi

1. Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit të dytë pasi Palët kontraktuese të kenë njoftuar njëra – tjetrën me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike se kërkesat e brendshme ligjore për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje janë plotësuar.
2. Kjo Marrëveshje është parashikuar për një kohëzgjatje të pakufizuar, por secila nga Palët kontraktuese mund ta përfundojë atë në cdo kohë me anë të njoftimit nëpërmjet kanaleve diplomatike.
3. Përfundimi do të ketë efekte tre muaj nga data e dërgimit të njoftimit të denoncimit tek Pala tjetër Kontraktuese. Procedimet në vazhdim në kohën e përfundimit do të mbyllen detyrimisht në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.
4. Palët kontraktuese do të takohen me qëllim rishikimin e kësaj Marrëveshjeje sipas kërkesës ose në fund të pesë vjetëve nga data e hyrjes në fuqi, nëse nuk njoftojnë njëra – tjetrën me shkrim se një rishikim i tillë është i panevojshëm.

DESHMITARE PER SA ME SIPER të poshtëshënuarit, të autorizuar përkatësisht, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

BERE NE.....Prishtine..... me datë06/10/.....2009, në dy kopje origjinale, në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze, duke qënë të gjitha tekstet njëjloj të vlefshme. Në rast mospërputhje në interpretim, do të mbizotërojë teksti në gjuhën angleze.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Z. Endri Pema

DREJTOR I PERGJITHSHEM I DOGANAVE

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Z. Bedri Hamza

ZV/MINISTËR I EKONOMISË DHE FINANCAVE